

Liahona

Fjalime në Konferencën e Përgjithshme

Presidenti Nelson i Nxit Shenjtorët që ta Dëgjojnë Zotin

Presidenti Nelson Shpall Proklamatën në Dyqindvjetor mbi Rivendosjen

Kisha Miraton Simbolin Duke Theksuar Vendin Qendror të Shpëtimtarit në Kishën e Tij

Mbështeten Autoritetet e Përgjithshme Të Shtatëdhjetë të Rinj dhe Presidenca e Përgjithshme e Re e Të Rinjve

Njoftohen 8 Tempuj të Rinj





Për Këtë Shkak, nga Yongsung Kim

“Ne kujtojmë, gjithmonë e kujtojmë, vuajtjen dhe vdekjen e Krishtit që të shlyente për mëkatet tona, dhe ne kremtojmë të dielën më të mrekullueshme, ditën e Zotit, në të cilën Ai u ngrit së vdekuri. Për shkak të Ringjalljes së Jezu Krishtit, Rivendosja ka kuptim, jeta jonë e vdekshme ka kuptim dhe përfundimisht vetë ekzistenca jonë ka kuptim.”

Plaku D. Tod Kristoferson, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, “Shpërndarja e Mesazhit të Rivendosjes dhe Ringjalljes”, f. 113.

Sesioni i Paradites të së Shtunës

- 6 Mesazhi i Hapjes
Presidenti Rasëll M. Nelson
- 8 A Nuk do të Vazhdojmë në një Kauzë Kaq të Madhe?
Presidenti M. Rasëll Ballard
- 12 Sigurimi i një Gjykimi të Drejtë
Plaku Xhejms R. Rasband
- 15 Një Thirrje Veçanërisht Fisnike
Xhoi D. Xhons
- 18 Kujtime që të Përcaktojnë Shpirtërisht
Plaku Nil L. Andersen
- 23 Thellë në Zembrën Tonë
Daglas D. Holms
- 27 Lutje me Besim
Presidenti Henri B. Ajring

Sesioni i Pasdites të së Shtunës

- 30 Mbështetja e Autoriteteve të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetëve Zonalë dhe Drejtuesve të Përgjithshëm
Presidenti Dallin H. Ouks
- 31 Raporti i Sektorit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2019
Kevin R. Xhergensen
- 32 Dalja në Dritë e Librit të Mormonit
Plaku Ulises Soares
- 36 Ejani te Krishti – Jetesa si Shenjtorë të Ditëve të Mëvonshme
Plaku Xhon A. Mek-Kjun
- 38 Një Dëshmitar i Gjallë i Krishtit të Gjallë
Peshkopi Zherald Kosë
- 41 Kini Parasysh Mirësinë dhe Madhësinë e Perëndisë
Plaku Dejll G. Renland
- 45 Fuqia e Librit të Mormonit për Kthimin në Besim
Plaku Benxhamin M. Z. Tai
- 48 Një Themel të Mirë për të Ardhmen
Plaku Geri E. Stivenson

Sesioni i Mbrëmjes të së Shtunës

- 52 Hosana dhe Aleluja – Jezu Krishti i Gjallë: Zemra e Rivendosi dhe e Pashkës
Plaku Gerit W. Gong
- 56 Mënyra se si Priftëria e Bekon Rininë
Laudi Ruth Kouk


- 58 Mënyra se si Priftëria e Bekon Rininë
Enco Serhe Petelo
- 60 Të Bashkuar në Përbushjen e Punës së Perëndisë
Xhin B. Bingham
- 66 Ai Ecën përpara Nesh
Presidenti Henri B. Ajring
- 69 Priftëria Melkizedeke dhe Çelësat
Presidenti Dallin H. Ouks
- 72 Hapja e Qiejve për Ndhimë
Presidenti Rasëll M. Nelson

Sesioni i Paradites të së Dielës

- 75 Përbushja e Profecisë
Plaku Ronald A. Rasband
- 78 Që Ata të Shohin
Boni H. Kordën
- 81 Një Ndrichim i Përkryer i Shpresës
Plaku Xhefri R. Holland
- 84 “Kjo Shtëpi Duhet të Ndërtohet për Emrin Tim”
Plaku Dejvid A. Bednar
- 88 Dëgjojeni Atë
Presidenti Rasëll M. Nelson
- 92 Thirrja Hosana
Presidenti Rasëll M. Nelson

Sesioni i Pasdites të së Dielës

- 93 Plani i Madh
Presidenti Dallin H. Ouks
- 96 Bekimi i Zbulesës së Vazhdueshme të Dhënë Profetëve dhe i Zbulesës Vetjake për ta Udhërrëfyer Jetën Tonë
Plaku Kuentin L. Kuk
- 101 Të Gjejmë Strehë nga Stuhitë e Jetës
Plaku Rikardo P. Himenez
- 104 Ejani dhe Kini Përkatësi
Plaku Diter F. Uhtdorf
- 107 Shtëpitë më të Mira
Plaku L. Uitni Klejton
- 110 Shpërndarja e Mesazhit të Rivendosi dhe Ringjalljes
Plaku D. Tod Kristoferson
- 114 Shkoni Përpara me Besim
Presidenti Rasëll M. Nelson
- 64 Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
- 116 Raporti Statistikor, 2019
- 117 Lajme të Kishës
- 127 Eja, Më Ndiq – Të Mësojmë nga Mesazhet e Konferencës së Përgjithshme



San-Paolo, Brazil

Konferenca e Përgjithshme Vjetore e 190-të

Sesioni i Paradites të së Shtunës, 4 Prill 2020

Drejtimi: Presidenti Dallin H. Ouks
Lutja e hapjes: Plaku Riçard J. Meinis
Lutja e mbylljes: Mishel Krejg
Muzika nga The Tabernacle Choir at Temple Square [Kori i Tabernakullit në Sheshin e Tempullit]: "Awake and Arise" ["Zgjohuni dhe Ngrihuni"], *Hymns*, nr. 8; "Mëngjesi Nis", *Himne*, nr. 1, përsh. Wilberg; "It Is Well with My Soul" ["Është Mirë me Shpirtin Tim"], Spafford dhe Bliss, përsh. Wilberg; "Eni, Ju F'mij' të Zotit", *Himne*, nr. 30; "Lutja e Parë e Jozef Smithit", *Himne*, nr. 18; "Come, Thou Fount of Every Blessing" ["Eja, Ti Burim i Çdo Bekimi"], melodi popullore Robinson/Amerikane, përsh. Wilberg.

Sesioni i Pasdites të së Shtunës, 4 Prill 2020

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring
Lutja e hapjes: Milton Kamargo
Lutja e mbylljes: Plaku Ruben V. Alliod
Muzika nga The Tabernacle Choir at Temple Square [Kori i Tabernakullit në Sheshin e Tempullit]: "Maj' Malit Atje Lart", *Himne*, nr. 5, përsh. Wilberg; "Kur Kërkoj Shkrimet e Shenjta", *Himne*, nr. 180, përsh. Murphy; "Gëzim, Zoti Është Mbret!", *Himne*, nr. 35; "Shëlbues i Izraelit", *Himne*, nr. 6, përsh. Wilberg.

Sesioni i Mbrëmjes të së Shtunës, 4 Prill 2020

Drejtimi: Presidenti Dallin H. Ouks
Lutja e hapjes: Plaku Kajl S. Mek-Kei
Lutja e mbylljes: Kristina B. Franko
Muzika nga The Tabernacle Choir at Temple Square [Kori i Tabernakullit në Sheshin e Tempullit]: "Sioni n'Bukuri Le t'Ngrihet", *Himne*, nr. 25, përsh. Kasen; "Drit', më Drejto", *Himne*, nr. 50, përsh. Wilberg; "Fëmi' i Per'ndis' Jam", *Himne*, nr. 196; "Dëgjoni Kombe!", *Himne*, nr. 171, përsh. Wilberg.

Sesioni i Paradites të së Dielës, 5 Prill 2020

Drejtimi: Presidenti Dallin H. Ouks
Lutja e hapjes: Plaku Bruk P. Hejls
Lutja e mbylljes: Plaku Piter M. Xhonson
Muzika nga The Tabernacle Choir at Temple Square [Kori i Tabernakullit në Sheshin e Tempullit]: "Truth Eternal" ["E Vërteta e Përgjithshme"], *Hymns*, nr. 4; "Sa i Fort' një Themel", *Himne*, nr. 41, përsh. Wilberg; "This Is My Beloved Son" ["Ky Është Biri Im i Dashur"], *Children's*

Songbook [Libri i Këngëve të Fëmijëve], f. 76, përsh. Cardon; "Tani Le t'Gëzojmë", *Himne*, nr. 3; "Izrael, Per'ndia po Th'rret", *Himne*, nr. 7, përsh. Wilberg; "Hosanna Anthem [Himni Hosana] / Shpirti i Per'ndis'", Stephens dhe *Himne*, nr. 2, përsh. Stephens.

Sesioni i Pasdites të së Dielës, 5 Prill 2020

Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring
Lutja e hapjes: Plaku Kevin R. Dankan
Lutja e mbylljes: Plaku Lin G. Robins
Muzika nga The Tabernacle Choir at Temple Square [Kori i Tabernakullit në Sheshin e Tempullit]: "Lavdi Burrit", *Himne*, nr. 19, përsh. Wilberg; "The Day Dawn Is Breaking" ["Agimi po Shkrep-tin"], *Hymns*, nr. 52, përsh. Murphy; "E Di, Jeton Shëlbuesi Im", *Himne*, nr. 74; "T'Falemi, Per'ndi për Profetin", *Himne*, nr. 13, përsh. Wilberg.

* Muzika për secilin sesion, nën drejtimin e dirigjentëve të ndryshëm dhe me organistë të ndryshëm, u regjistrua më parë; himni i mbylljes u regjistrua nga Kori i Tabernakullit dhe gjashtë kore të tjera nga Akra, Ganë; Meksiko-Siti, Meksikë; Seul, Koreja e Jugut; San-Paolo, Brazil; Frankfurt, Gjermani; dhe Okland, Zealanda e Re.

Mundësohen Bisedat e Konferencës

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në internet në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.ChurchofJesusChrist.org dhe

përzgjidhni një nga gjuhët. Bisedat mundësohen gjithashtu në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit]. Përgjithësisht, brenda gjashtë javëve pas konferencës së përgjithshme, mundësohen gjithashtu regjistrime pamore e zanore në anglisht në qendrat e shpërndarjes. Informacion për konferencën e përgjithshme në formate të përdorshme nga anëtarë me paafësi, mundësohet në faqen disability.ChurchofJesusChrist.org.

Në Kapak

Përpara: Pikturë e Vegimit të Parë, nga Dan Burr Prapa: Fotografi nga Mason Coberly

Fotografimi i Konferencës

Fotografitë në Solt-Lejck-Siti u bënë nga Cody Bell, Janae Bingham, Mason Coberly, Weston Colton, Brian Nicholson dhe Leslie Nilsson. Fotografitë shtesë nga Alexandre Borges, Mark Brunson, Nicolas Serey Bustamante, Annette Campbell, Karisa Creer, Cathie Frost, Alejandro Gutierrez, Natalia Hepworth, Korene Knight, Ashlee Larsen, Bruno Lima, Ashley Malili, Melanie Miza, Kendrick Navarro, Arteh Odjidja, Veronica Olson, Alaine Palmer, Melanie Porter, Jonas Rebicki, Mark Romesser, Elizabeth Thompson, Chung Ho Tsai, Emily Utykanski, Marco Vargas, Christopher Walker, Dave Ward, Jonathan Wing, Justin Wright.



Uest-Xhordan, Jutë, SHBA

MAJ 2020 VËLLIMI 22 NR. 3
LIAHONA 16720 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, Henri B. Ajring
Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A. Rasband, Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland, Gerit W. Gong, Ulises Soares

Kryeredaktor: Randy D. Funk

Këshilltarë: Becky Craven, Sharon Eubank, Cristina B. Franco, Walter F. González, Larry S. Kacher, Jan E. Newman, Adrián Ochoa, Michael T. Ringwood, Vern P. Stanfill

Drejtor Përgjegjës: Richard I. Heaton

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg

Përgjegjës i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Përgjegjës: Adam C. Olson

Ndihmësredaktor Përgjegjës: Ryan Carr

Ndihmëse e Botimit: Camila Castrillón

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Garrett H. Garff, Jon Ryan Jensen, Aaron Johnston, Charlotte Larcabal, Michael R. Morris, Eric B. Murdock, Joshua J. Perkey, Jan Pinborough, Richard M. Romney, Mindy Selu, Lori Fuller Sosa, Chakell Wardleigh, Marissa Widdison

Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Faqesjes: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, Mandie Bentley, C. Kimball Bott, Thomas Child, Joshua Dennis, David Green, Colleen Hinckley, Eric P. Johnsen, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Aleni Regehr, Mark W. Robison, K. Nicole Walkenhorst

Bashkënduuese për Pronësinë Intelektuale: Collette Nebeker Aune
Përgjegjëse e Prodhimit: Ammon Harris, Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Ira Glen Adair, Julie Burdett, José Chavez, Bryan W. Gygi, Ginny J. Nilson, Marrisona M. Smith

Përgatitja për Shtyp: Joshua Dennis, Ammon Harris

Drejtor Shtypi: Steven T. Lewis

Drejtor i Shpërndarjes: Nelson Gonzalez

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Sparti Kashari

Për abonimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, shkoni në store.lds.org ose kontaktoni me qendrën tuaj vendore të Kishës për shpërndarjen ose me udhëheqësin e lagjes apo degës.

Paraqitni dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ChurchofJesusChrist.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona*, FL 23, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0023, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bulgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihisht, finlandisht, frengjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kambodhianisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallsht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebanisht, slovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2020 nga Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Informacion për të drejtën e autorit: Përveç nëse sugjerohet ndryshe, individët mund të kopjojnë material nga *Liahona* për përdorimin e tyre vetjak, jo për tregti (përfshirë për thirrjet në Kishë). Kjo e drejtë mund të anulohet në çdo kohë. Lënda figurative nuk lejohet të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të drejtohen tek Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., FL 13, Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ChurchofJesusChrist.org.

For Readers in the United States and Canada: May 2020 Vol. 22 No. 3. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published six times a year (January, April, May, July, October, and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address must be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone or at store. lds.org. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 507.1.5.2). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.



Sendi, Jutë, SHBA

Treguesi i Folësve

Ajring, Henri B., 27, 66
Andersen, Nil L., 18
Ballard, M. Rasëll, 8
Bednar, Dejvid A., 84
Bingham, Xhin B., 60
Gong, Gerit W., 52
Himenez, Rikardo P., 101
Holland, Xhefri R., 81
Holms, Daglas D., 23
Klejton, L. Uitni, 107
Kordën, Boni H., 78
Kosë, Zherald, 38
Kouk, Laudi Ruth, 56
Kristoferson, D. Tod, 110
Kuk, Kuentin L., 96
Mek-Kjun, Xhon A., 36
Nelson, Rasëll M., 6, 72, 88, 92, 114
Ouks, Dallin H., 30, 69, 93
Petelo, Enco Serhe, 58
Rasband, Ronald A., 75
Rasband, Xhejms R., 12
Renland, Dejll G., 41
Soares, Ulises, 32
Stivenson, Geri E., 48
Tai, Benxhamin M. Z., 45
Uhtdorf, Diter F., 104
Xhergensen, Kevin R., 31
Xhons, Xhoi D., 15

Treguesi Tematik

Adami dhe Eva, 60
Agjërimi, 72
Ati Qiellor, 18, 41, 81, 88
Begatia, 107
Bekimet, 58
Gong, Gerit W., 56
Bekimet e priftërisë, 56
Bekimet patriarkale, 56
Besëlidhjet, 84
Besimi, 27, 48, 72, 101, 114
Bujaria, 41
Burrat, 60
Çelësat, 69
Dashuria, 18, 23, 36, 81, 110
Denjësia, 58
Dëshmia, 18, 32, 48
Dija, 18
Dishepullimi, 104, 107
Drejtësia, 12
Drita e Krishtit, 78
Emri i Kishës, 72
E vërteta, 69
Familja, 69
Fatkeqësia, 6, 8, 32, 36, 38, 56, 88, 93, 101, 107
Frika, 6
Fryma e Shenjtë, 88, 96
Fuqia, 27
Gëzimi, 101
Gratë, 15, 60
Gjykimi, 12, 69
Historia familjare, 84, 88
Jezu Krishti, 6, 12, 36, 38, 41, 45, 48, 52, 66, 72, 78, 81, 84, 88, 93, 101, 104, 110, 114
Jozef Smithi, 6, 8, 15, 18, 27, 32, 58, 60, 66, 75, 84, 88, 96, 101, 104, 110
Kthimi në besim, 45
Libri i Mormonit, 12, 32, 38, 45, 110
Liria e zgjedhjes, 23, 69
Lutja, 27, 72
Martesa, 69
Martirizimi, 8
Marrëdhëniet, 23

Mbledhja e Izraelit, 66, 78
Mëshira, 12
Mirënjohja, 41
Ordinancat, 69, 84
Paqja, 6, 12, 36
Pashka, 52
Pashka e Hebrenjve, 52
Pendimi, 23, 45, 104
Përgatitja, 6
Përndjekja, 8
Plani i shpëtimit, 69
Priftëria, 15, 58, 60, 66, 84
Priftëria Melkizedeke, 69
Profecia, 75
Profetët, 1, 75, 88, 96
Puna misionare, 27, 66, 75, 104, 110
Puna në tempull, 52, 66, 81, 84, 114
Ringjallja, 52, 93, 110
Rivendosja, 8, 15, 27, 52, 60, 66, 75, 81, 88, 93, 110, 114
Rritja vetjake, 15, 45, 69
Sakrifica, 23, 110
Studimi i shkrimeve të shenjta, 107
Shembulli, 78, 110
Shërimi, 12
Shkrimet e shenjta, 88
Shlyerja, 12, 38, 41, 52, 56, 93, 101
Shoqata e Ndhmës, 60
Shpirtshmëria, 48, 107
Shpresa, 81
Shtëpia, 107
Tempujt, 48, 56, 75, 88, 92, 114
Të mësuarit, 104
Thirrjet në Kishë, 96
Udhëheqësit e Kishës, 30
Udhëheqja, 23
Uniteti, 23, 60
Vegimi i Parë, 6, 8, 15, 18, 27, 69, 92
Zbulesa, 15, 23, 88, 96
Zbulesa vetjake, 18, 88, 96

Pjesë të Spikatura nga Konferenca e Përgjithshme Vjetore e 190-të



Presidenti Rasëll M. Nelson pati një mesazh të qartë në konferencën e përgjithshme: “Dëgjojeni Atë”.

“Në çdo mënyrë që të mundemi, ne duhet të kërkojmë ta dëgjojmë Jezun Krishtin, që na flet nëpërmjet fuqisë dhe shërbesës së Frymës së Shenjtë”, dha mësim Presidenti Nelson.

“Qëllimi i kësaj konference dhe i çdo konference të përgjithshme, është që të na ndihmojnë ta dëgjojmë Atë” (faqe 7).

Në një konferencë që u përqendrua te Vegimi i Parë dhe Rivendosja, na u dha mësim se mund ta dëgjojmë Atë, pikërisht ashtu siç e dëgjoji Jozef Smithi në Korijen e Shenjtë. Të rrethuar nga efektet e një pandemie të përbotshme që po ndikojnë te miliona njerëz, na u dha mësim që ta dëgjojmë Atë për udhërrëfim në shqetësimet tona. Duke parë drejt një të ardhmeje të shndritshme si për Kishën ashtu edhe për secilin prej nesh individualisht, na u dha mësim që t’i përtërijmë

përpjekjet tona për ta dëgjuar Atë dhe për ta ndjekur Atë.

“Përbërësit e shumë frymëzues të kësaj konference të përgjithshme të prillit 2020”, tha Presidenti Nelson, “. . . mund të përmblihen nga dy fjalë të dekretuara hyjnisht: ‘Dëgjoje Atë’. Ne lutemi që nga gjithçka që ka ndodhur, përqendrimi juaj tek Ati Qiellor, i cili i tha ato fjalë, dhe te Biri i Tij i Dashur, Jezun Krishtin, të jetë ai që ngulitet më gjatë në kujtesën tuaj.”

Kur i studioni mesazhet e kësaj konference dhe përqendri “t’i dëgjoni, t’i mbani vesh e t’u kushtoni

vëmendje . . . fjalëve të Shpëtimtarit”, ju do ta shihni të përmbushet në jetën tuaj premtimi profetik i “pakësimi[t të] frikës dhe shtimi[t të] besimit” (faqe 114).

- Presidenti Nelson paraqet një simbol të ri për Kishën në faqen 73.
- Presidenti Nelson paraqet një proklamata mbi Rivendosjen në faqen 91.
- Presidenti Nelson udhëheq një kuvend solemn mbarëbotëror në faqen 92.
- Presidenti Nelson njofton tetë tempuj të rinj në faqen 115.
- Mësoni më shumë rreth mënyrës se si mund t’i ndihmojmë të tjerët ta dëgjojnë Atë tek #HearHim në [HearHim.ChurchofJesusChrist.org](https://www.HearHim.ChurchofJesusChrist.org). ■

FIGURAT NË KËTË BOTIM

Ne përqijemi ta dokumentojmë çdo konferencë të përgjithshme nëpërmjet fotografive që botojmë. Ndërkohë që çdo konferencë është e pashoqe, figurat në këtë botim përfaqësojnë disa nga rrethanat më të pazakonta që paraqiti kjo konferencë.

Përveç fotografive nga transmetimi, ju do të gjeni fotografi nga Sheshi i bukur i Tempullit (edhe pse i zbrazët si asnjëherë tjetër për shkak të COVID-19 dhe punimeve të ndërtimit), si edhe piktura që lidhen me Rivendosjen e ungjillit dhe fotografi të dërguara nga anëtarët për ata vetë duke marrë pjesë në konferencë anëmbanë botës.



ME THIRRI ME EWER, NGA WALTER RANE



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson,
President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve
të Ditëve të Mëvonshme

Mesazhi i Hapjes

Në çdo mënyrë që të mundemi, ne duhet të kërkojmë ta dëgjojmë Jezu Krishtin, që na flet nëpërmjet fuqisë dhe shërbesës së Frymës së Shenjtë.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, teksa ju urojmë mirëseardhjen në këtë konferencë të përgjithshme historike të prillit 2020 të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, për arsye që ju i dini, unë qëndroj përpara jush në një sallë të zbrazët!

Nuk ma merrte mendja, kur ju premtova në konferencën e përgjithshme të tetorit 2019 që kjo konferencë e prillit do të ishte “e shënuar” dhe “e paharrueshme”, se të flas para një bashkësie të dukshme me më pak se 10 vetë, do ta bënte këtë konferencë

kaq të “shënuar” dhe të “paharrueshme” për mua! Sidoqoftë, dijenia se ju po merrni pjesë me anë të transmetimit elektronik dhe interpretimi i mrekullueshëm nga kori i këngës “It Is Well with My Soul” [“Është Mirë në Shpirtin Tim”], i sjellin ngushëllim të madh shpirtit tim.

Siç e dini, pjesëmarrja në këtë konferencë të përgjithshme është kufizuar rreptësisht si pjesë e përpjekjeve tona që të jemi qytetarë të mirë të botës dhe që të bëjmë gjithçka mundemi për ta kufizuar përhapjen e virusit COVID-19. Ky virus ka pasur ndikim

të madh anekënd botës. Ka sjellë ndryshim gjithashtu në mbledhjet tona të Kishës, shërbimin misionar dhe punën në tempull për njëfarë kohe.

Edhe pse masat frenuese të sotme lidhen me një virus jashtëzakonisht të rrezikshëm, sprovat vetjake të jetës shtrihen shumë përtej kësaj pandemie. Sprovat e ardhshme mund të rrjedhin nga një aksident, një fatkeqësi natyrore apo një pikëllim i papritur vetjak.

Si mund t’i durojmë sprovat të tilla? Zoti na ka thënë se “nëse jeni të përgatitur, ju s’do të frikësoheni”¹. Sigurisht, ne mund të vëmë në ruajtje vetë rezervat tona të ushqimit, ujit dhe kursimeve monetare. Por po aq vendimtare është nevoja jonë që t’i mbushim vendet tona të ruajtjes vetjake *shpirtërore* me besim, të vërtetë dhe dëshmi.

Kërkimi ynë përfundimtar në jetë është që të përgatitemi për ta takuar Krijuesin tonë. E bëjmë këtë duke u përpjekur fort çdo ditë që të bëhemi më shumë si Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti.² Dhe e bëjmë atë teksa pendohe mi çdo ditë dhe e marrim fuqinë

e Tij pastruese, shëruese dhe forcuese. Atëherë ne mund të ndiejmë paqe dhe gëzim të qëndrueshëm, edhe gjatë kohëve të turbullta. Kjo është pikërisht arsyeja pse Zoti na është përgjyruar që të qëndrojmë në vende të shenjta dhe të “mos lëvizim!”³.

Këtë vit, ne përkujtojmë 200-vjetorin e njëres prej ngjarjeve më të rëndësishme në historinë e botës – domethënë



shfaqjen e Perëndisë, Atit, dhe Birit të Tij të Dashur, Jezu Krishtit, ndaj Jozef Smithit. Gjatë atij vegimi të jashtëzakonshëm, Perëndia, Ati, tregoi drejt Jezu Krishtit dhe tha: “Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!”⁴

Ai këshillim i dhënë Jozefit është për secilin prej nesh. Në çdo mënyrë që të mundemi, ne duhet të kërkojmë ta dëgjojmë Jezu Krishtin, që na flet nëpërmjet fuqisë dhe shërbesës së Frymës së Shenjtë.

Qëllimi i kësaj konference dhe i çdo konference të përgjithshme, është që të na ndihmojnë ta dëgjojmë Atë. Ne jemi lutur dhe ju ftojme edhe ju të luteni, që Shpirti i Zotit do të jetë me ne me aq shumë bollëk sa që ju të mund t'i dëgjoni mesazhet që Shpëtimtari ka posaçërisht për ju – mesazhe që do t'i sjellin paqe shpirtit tuaj. Mesazhe që do ta shërojnë zemrën tuaj të thyer. Mesazhe që do ta ndriçojnë mendjen tuaj. Mesazhe që do t'ju ndihmojnë të dini se çfarë të bëni teksa shkoni përpara përmes kohëve të trazirës dhe sprovës.

Ne lutemi që kjo konferencë të jetë e shënuar dhe e paharrueshme për shkak të mesazheve që do të dëgjoni, njoftimeve të pashoqe që do të bëhen, dhe përvojave në të cilat do të ftohemi të merrni pjesë.

Për shembull, në përfundim të sesionit të paradites të së dielës, ne do të mbledhim një kuvend solemn mbarëbotëror ku unë do t'ju udhëheq në Thirrjen e shenjtë Hosana. Ne lutemi që ky të jetë një çast kulmor shpirtëror për ju teksa ne shprehim në një zë në mbarë botën mirënjohjen tonë të thellë ndaj Perëndisë, Atit, dhe Birit të Tij të Dashur duke i përlëvduar Ata në këtë mënyrë të pashoqe.

Për këtë përvojë të shenjtë, ne përdorim shami të bardha, të pastra. Por nëse nuk e keni një të tillë, ju thjesht mund të valëvitni dorën. Në




FIGURA E KRISHTIT, NGA HEINRICH HOFMANN

përfundim të Thirrjes Hosana, bashkësia do të bashkohet me korin për të kënduar himnin “Shpirti i Perëndisë”⁵.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, kjo konferencë do të jetë e madhërishtme. Ky vit do të jetë i jashtëzakonshëm teksa përqendrohemi me qëllim të Shpëtimtari dhe ungjilli i Tij i rivendosur. Ndikimet më të rëndësishme e më të qëndrueshme të kësaj konference historike do të jenë kur zemrat tona ndryshojnë dhe ne fillojmë një kërkim që zgjat gjithë jetën, që ta dëgjojmë Atë.

Mirë se vini në konferencën e përgjithshme të prillit 2020! Unë e di që Perëndia, Ati ynë Qiellor, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, kujdesen

për ne. Ata do të jenë me ne gjatë gjithë punimeve të këtyre dy ditëve të lavdishme teksa ne kërkojmë të shkojmë më pranë Atyre dhe t'i nderojmë Ata. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 38:30.
2. Shih 3 Nefi 27:27.
3. Doktrina e Besëlidhje 87:8.
4. Joseph Smith – Historia 1:17.
5. *Himne*, nr. 2.



Kuritiba, Parana, Brazil



Nga Presidenti M. Rasëll Ballard,
President Veprues i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

A Nuk do të Vazhdojmë në një Kauzë Kaq të Madhe?

Ne duhet ta kujtojmë gjithmonë çmimin që paguan Jozef dhe Hajrëm Smithi, së bashku me kaq shumë burra, gra e fëmijë të tjerë besnikë për të themeluar Kishën.

Faleminderit shumë, President, për një hapje kaq të mrekullueshme. Vëllezër e motra, 215 vjet më parë, një djalë i vogël u lindi Jozef dhe Lusi Mek Smithit në Vermont, në një krahinë të njohur si Nju-Inglënd, në pjesën verilindore të Shteteve të Bashkuara.

Jozefi dhe Lusi Meku besonin te Jezu Krishti, i studionin shkrimet e

shenjta, luteshin me çiltërsi dhe ecnin me besim te Perëndia.

Ata e quajtën birin e tyre të sapolindur, Jozef Smith i Riu.

Për familjen Smith, Brigam Jangu tha: “Zoti ishte në djepin e [Jozef Smithit] dhe atit të tij, dhe atit të atit të tij, dhe të paraardhësve të tyre deri tek Abrahami, dhe nga Abrahami te

përmbytja, nga përmbytja tek Enoku, dhe nga Enoku tek Adami. Ai e ka vëzhguar atë familje e atë gjak tekrsa ka qarkulluar që nga burimi i tij deri te lindja e atij njeriu. [Jozef Smithi] u parashugurua në përjetësi.”¹

Tërë familja e tij e donte por Jozefi i Riu ishte veçanërisht i lidhur me vëllanë e tij më të madh, Hajrëmin, i cili ishte gati gjashtë vjeç kur lindi Jozefi.


Tetorin e kaluar, u ula pranë gurëve të vatrës që ishte në shtëpinë e vogël të familjes Smith në Sharon të Vermontit, vendi ku lindi Jozefi. E ndjeva dashurinë e Hajrëmit për Jozefin dhe e përfytyrova atë duke e mbajtur vëllanë e tij foshnjë në krahë dhe duke e mësuar se si të ecë.

Babai dhe nëna Smith përjetuan pengesa vetjake, që i detyruan ata ta zhvendosnin familjen e tyre shumë herë para se të hiqnin dorë përfundimisht nga Nju-Inglëndi dhe të merrnin vendimin e guximshëm për t'u shpërngulur më larg në perëndim, në shtetin e Nju-Jorkut.

Për shkak se familja ishte e bashkuar, ata u mbijetuan këtyre sfidave dhe së bashku u përballën me detyrën e frikshme për t'ia filluar përsëri nga e para në një sipërfaqe të madhe toke të pyllëzuar prej 40,5 hektarësh (0,4 km²) në Mançester, afër Palmirës në Nju-Jork.

Nuk jam i sigurt a i kuptojnë shumë prej nesh sfidat fizike dhe emocionale që paraqiste fillimi nga e para për familjen Smith – pastrimi i tokës, mbjellja e pemishteve dhe fushave, ndërtimi i një shtëpie të vogël prej druri dhe strukturave të tjera të fermës, punësimi si punëtorë ditore dhe bërja e produkteve në shtëpi për t'i shitur në qytet.

Në kohën kur familja mbërriti në Nju-Jorkun perëndimor, zona gëlonte nga zelli për fenë – i njohur si Zgjimi i Dytë i Madh.



Buenos Ajres, Argjentinë

Gjatë kësaj kohe debati dhe grindjeje midis grupeve fetare, Jozefi përjetoi një vegim të mahnitshëm, që sot njihet si Vegimi i Parë. Ne jemi të bekuar që kemi katër rrëfime kryesore tek të cilat unë do të mbështetem.²

Jozefi mbajti shënim: “Gjatë kësaj kohe gjallërimi të madh [fetar] mendja ime u nxit të mendonte seriozisht dhe nuk gjente rehati; por edhe pse ndjenjat e mia ishin të thella dhe shpesh të fuqishme, përsëri unë qëndrova larg nga të gjitha këto grupe, edhe pse i ndoqa disa prej mbledhjeve të tyre, sa herë që ma lejonte rasti. . . . [Prapëseprapë] kaq e madhe ishte ngatërrësia dhe grindja midis zotërimeve të ndryshme, sa ishte e pamundur për një njeri, të ri si unë dhe të pamësuar me njerëzit dhe gjërat, të arrija në njëfarë përfundimi se kush kishte të drejtë dhe kush ishte gabim.”³

Jozefi iu drejtua Biblës që të gjente përgjigje për pyetjet e tij dhe lexoi te Jakob [Bibël] 1:5: “Por në qoftë se ndonjëri nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t’i jepet”⁴.

Ai shënoi: “Kurrë ndonjë pjesë e shkrimit të shenjtë nuk erdhi më me fuqi në zemrën e një njeriu, sesa ky varg erdhi tek unë në këtë kohë. M’u duk se hyri me forcë të madhe në çdo ndjenjë të zemrës sime. Mendova për të herë pas here.”⁵

Jozefi arriti të kuptonte se Bibla nuk përmbante të gjitha përgjigjet për pyetjet e jetës; përkundrazi, ajo u mësonte burrave dhe grave se si mund të gjenin përgjigje për pyetjet e tyre duke komunikuar drejtpërdrejt me Perëndinë nëpërmjet lutjes.

Ai shtoi: “Kështu, në përputhje me këtë, vendosmërinë time për t’i kërkuar Perëndisë, unë u tërhoqa në pyll për t’u përpjekur. Ishte në mëngjesin e një dite të bukur, të



ktjhellët, në fillim të pranverës së njëmijetëtdqindënjëzetës.”⁶

Shpejt pas kësaj, Jozefi tha: “[Një shtyllë] drit[e] pushoi mbi mua [dhe] unë pashë dy Personazhe, shkëlqimi dhe lavdia e të cilëve i kapërcejnë të gjitha përshkrimet, duke qëndruar mbi mua në ajër. Një prej tyre më foli, duke më thirrur në emër dhe tha, duke treguar tjetrin: [Jozef,] *Ky Është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!*”⁷

Shpëtimtari më pas tha: “Jozef, biri im, mëkatet e tua të janë falur. Shko në udhën tënde, sillu sipas statuteve të mia dhe zbatoji urdhërimet e mia. Vër re, unë jam Zoti i lavdisë. Unë u kryqëzova për botën, që të gjithë ata që besojnë në emrin tim, të mund të kenë jetë të përjetshme.”⁸

Jozefi shtoi: “Si rrjedhim, sapo e zotërova përsëri veten, aq sa të isha në gjendje të flisja, atëherë u kërkoja Personazheve që qëndronin mbi mua në dritë, se cili nga të gjitha sektet ishte i drejti”⁹.

Ai kujtoi: “Ata më thanë se gjithë besimet fetare po besonin në doktrina të pasakta dhe se asnjëri prej tyre nuk pranohej nga Perëndia si kisha dhe mbretëria e Tij. Dhe . . . në të njëjtën kohë, mora një premtim se plotësia e ungjillit në një kohë të ardhme do të më bëhej e njohur.”¹⁰

Jozefi gjithashtu shënoi: “Pashë shumë engjëj në këtë vegim”¹¹.

Pas këtij vegimi të lavdishëm, Jozefi shkroi: “Shpirti im u mbush me dashuri dhe për shumë ditë mund të ngazëlleshë me gëzim të madh. . . . Zoti ishte me mua.”¹²

Ai doli nga Korija e Shenjtë për të filluar përgatitjen e tij që të bëhej një profet i Perëndisë.

Jozefi filloi gjithashtu të mësonte ato që përjetuan profetët e lashtë – refuzimin, kundërshtimin dhe përndjekjen. Jozefi kujtoi se ia tregoi atë që kishte parë e dëgjuar njërit prej shërbëtarëve që kishte qenë aktiv në rigjallërimin fetar:

“U habita shumë nga sjellja e tij; ai e trajtoi komunikimin tim jo vetëm si të parëndësishëm, por me shumë mllef, duke thënë se e gjitha ishte nga djalli, se nuk kishte gjëra të tilla si vegime ose zbulesa në këto ditë; se të gjitha këto gjëra k[ishin] mbaruar me apostujt dhe se nuk do të kishte më të tilla.

Shpejt mësova, megjithatë, se tregimi im i historisë kishte nxitur shumë paragjykim kundër meje midis profesorëve të fesë dhe ishte shkaku i përndjekjes së madhe, e cila vazhdoi të rritej . . . dhe kjo ishte e përbashkët mes të gjitha sekteve – të gjithë të bashkuar për të më përndjekur mua.”¹³

Tre vjet më vonë, në vitin 1823, qiejt u hapën përsëri si pjesë e Rivedosjes së vazhdueshme të ungjillit të Jezu Krishtit në ditët e fundit. Jozefi vuri në dukje se një engjëll, i quajtur Moroni, iu shfaq atij dhe tha “se Perëndia kishte një punë për mua për ta bërë . . . [dhe që] një libër ishte fshehur, i shkruar mbi fletë të arta” i cili përmbante “plotësi[në] e Ungjillit të përjetshëm . . . sikurse iu dha nga Shpëtimtari banorëve të lashtë [të kontinentit amerikan]”¹⁴.

Përfundimisht, Jozefi e mori, e përktheu dhe e botoi analin e lashtë, që sot njihet si Libri i Mormonit.

Vëllai i tij, Hajrëmi, i cili kishte qenë përkrahësi i tij i vazhdueshëm, veçanërisht pas operacionit të tij në këmbë, që ishte i dhembshëm dhe i rrezikshëm për jetën, në vitin 1813, ishte njëri nga dëshmitarët e fletëve prej ari. Ai ishte gjithashtu një nga gjashtë anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit kur ajo u organizua në vitin 1830.

Gjatë jetës së tyre, Jozefi dhe Hajrëmi u përballën së bashku me turmat dhe përndjekjen. Për shembull, ata lënguan në kushtet më të mjerueshme në burgun e Libertisë në Misuri për pesë muaj gjatë dimrit të ftohtë të viteve 1838–1839.

Në prill 1839, Jozefi i shkroi bashkëshortes së tij, Emës, duke i përshkruar gjendjen e tyre në burgun e Libertisë: “Besoj se tani është bërë rreth pesë muaj e gjashtë ditë që kur kam qenë nën ngërdheshjen e një rojeje, natë e ditë, dhe brenda mureve, hekurave dhe dyerve çjerrëse prej hekuri, të një burgu të shkretët, të errët e të ndyrë. . . . Ne do të shpërngulemi nga ky [vend] me çdo kusht dhe jemi të lumtur për këtë. Le të bëhet ç’është bërë me ne, nuk mund të jemi më keq se kaq. . . . Uroj më që të mos kthehemi më kurrë në Liberti, në kontenë Klej të Misurit. Na mjafton kjo sa për gjithë përjetësinë.”¹⁵

Ndërkohë që përballej me përndjekje, Hajrëmi shfaqti besim te premtimet e Zotit, përfshirë një garanci se do të shpëtonte prej armiqve të vet nëse kjo do të ishte zgjedhja e tij. Në një bekim që Hajrëmi e mori në vitin 1835 nga duart e Jozef Smithit, Zoti i premtoi atij: “Ti do të kesh fuqi të shpëtosh nga duart e armiqve të tu. Jeta jote do të kërkohet me zell të palodhur, por ti do të shpëtosh. *Nëse të pëlqen* dhe e dëshiron, *ti do të kesh fuqinë që ta japësh jetën tënde në mënyrë të vullnetshme* për t’i dhënë lavdi Perëndisë.”¹⁶



Në qershor 1844, Hajrëmit iu paraqit zgjedhja që të jetonte ose të jepte jetën e vet për t’i dhënë lavdi Perëndisë dhe për ta “vulos[ur] dëshminë e tij me gjakun e tij” – krah për krah së bashku me vëllanë e tij të dashur, Jozefin.¹⁷

Një javë përpara udhëtimit fatal për në Karthixh, ku ata i vrau me gjakftohtësi një turmë e armatosur burracakësh, të cilët i kishin lyer fytyrat e tyre për të mos u zbuluar, Jozefi mbajti shënim se “unë e këshillova vëllanë tim, Hajrëmin, që me familjen e vet të merrte anijen tjetër me avull dhe të shkonte në Sinsinati”.

Ende kam emocion të madh teksa e kujtoj përgjigjen e Hajrëmit: “Jozef, *nuk mund të të lë*”¹⁸.

Kështu Jozefi dhe Hajrëmi shkuan në Karthixh, ku u bënë martirë për kauzën dhe emrin e Krishtit.

Në njoftimin zyrtar të martirizimit thuhej sa vijon: “Joseph Smith-i, Profeti dhe Shikuesi i Zotit, . . . ka sjellë Librin e Mormonit, të cilin e përktheu me anë të dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë, dhe ka qenë mjeti i botimit të tij në dy kontinente; u ka dërguar plotësinë e ungjillit të përjetshëm, që ai përmbante, katër anëve të dheut; ka sjellë zbulesat dhe urdhërimet që përbëjnë këtë libër të ‘Doktrina e Besëlidhje-ve’ dhe shumë dokumente dhe udhëzime të tjera të urta për të mirën e fëmijëve të njerëzve; mblodhi me mijëra Shenjtorë të Ditëve të Mëvonshme, themeloi një qytet të madh dhe la një famë e një emër që nuk mund të vritet. . . . Dhe si shumica e

të vajosurve të Zotit në kohët e lashta, [Jozefi] i ka vulosur misionin e tij dhe veprat e tij me vetë gjakun e tij; dhe kështu e ka bërë vëllai i tij, Hajrëmi. *Në jetë nuk u ndanë dhe në vdekje nuk u veçuan!*”¹⁹

Pas martirizimit, trupat e Jozefit dhe të Hajrëmit i kthyen në Navu, i lanë dhe i veshën në mënyrë që familja Smith të mund t’i shihte të dashurit e vet. Nëna e tyre e çmuar kujtoi: “Për një kohë të gjatë kisha kalitur çdo nerv, kisha përdorur gjithë energjinë e shpirtit tim dhe i kisha thirrur Perëndisë që të më forconte; por kur hyra në dhomë dhe pashë djemtë e mi të vrarë, të shtrirë që të dy njëherazi përpara syve të mi, dhe dëgjova dënesat dhe ofshamat e familjes sime dhe klithmat . . . nga buzët e bashkëshorteve, fëmijëve, vëllezërve dhe motrave të tyre, kjo ishte tepër e rëndë. U plandosa prapa duke i thirrur Zotit, në agoninë e shpirtit tim: ‘Perëndia im! Perëndia im! Përse e ke braktisur këtë familje?’”²⁰

Në atë çast pikëllimi dhe hidhërimi, asaj iu kujtua që ata i thoshin: “Nënë, mos vajto për ne, ne e kemi mposhtur botën me anë të dashurisë”²¹.

Ata me të vërtetë e kishin mposhtur botën. Jozef dhe Hajrëmi Smithi, sikurse ata shenjtorë besnikë që u përshkruan në librin e Zbulesës, “[erdhën] nga shtrëngimi i madh, dhe i kanë larë rrobat e tyre dhe i kanë zbardhur në gjakun e Qengjit [dhe] janë . . . përpara fronit të Perëndisë dhe i shërbeljnë] atij ditë e natë në tempullin e tij; dhe ai që rri ulur mbi fron do të banojë në mes tyre.

Ata nuk do të kenë më uri, as nuk do të kenë etje, as nuk do t’i godasë më dielli, as kurrfarë vape, sepse Qengji, që është në mes të fronit, do t’i kullosë dhe do t’i çojë te burimet e gjalla të ujërave; dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre.”²²

Ndërsa e kremtojmë këtë ngjarje të gëzuar, 200-vjetorin e Vegimit të Parë, duhet ta kujtojmë gjithmonë çmimin që paguan Jozef dhe Hajrëm Smithi, së bashku me kaq shumë burra, gra e fëmijë të tjerë besnikë, për të themeluar Kishën në mënyrë që ju dhe unë të mund të gëzojmë bekimet e shumta dhe të gjitha këto të vërteta të zbuluara që kemi sot. Besnikëria e tyre nuk duhet të harrohet kurrë!

Shpeshherë e kam pyetur veten pse Jozefi, Hajrëmi dhe familjet e tyre duhej të vuanin kaq shumë. Mund të jetë ngaqë ata arritën ta njihnin Perëndinë nëpërmjet vuajtjes së tyre në mënyra që nuk mund të kishin ndodhur pa të. Nëpërmjet saj, ata reflektuan mbi Gjetsemanin dhe kryqin e Shpëtimtarit. Ashtu siç tha Pali: "Sepse juve ju është dhënë hiri për hir të Krishtit, jo vetëm që të besoni në të, por edhe të vuani për hir të tij"²³.

Përpara vdekjes së tij në vitin 1844, Jozefi u shkroi shenjtoreve një letër plot gjallëri. Ishte një thirrje për vepër, e cila vazhdon në Kishë sot:

"Vëllezër [dhe motra], a nuk do të vazhdojmë në një kauzë kaq të madhe? Ecni përpara dhe jo prapa. Kura-jo, vëllezër [dhe motra]; dhe përpara, përpara drejt fitores! . . .

. . . Si rrjedhim, ne, si një kishë e si një popull dhe si Shenjtorë të Ditëve të Mëvonshme, le t'i ofrojmë Zotit një blatim me drejtësi."²⁴

Ndërsa e dëgjojmë Shpirtin gjatë këtij kremtimi të 200-vjetorit këtë fundjavë, merrni parasysh se çfarë blatimi do t'i paraqitni Zotit me drejtësi në ditët e ardhshme. Jini të guximshëm – tregojini për të dikujt të cilit i mirëbesoni, dhe më e rëndësishmja, ju lutemi gjeni kohë për ta bërë atë!

Unë e di se Shpëtimtari është i kënaqur kur i paraqitim Atij një blatim nga zemrat tona me drejtësi, ashtu siç

Ai ishte i kënaqur me blatimin besnik të atyre vëllezërve të shquar, Jozef dhe Hajrëm Smithit, dhe të të gjithë shenjtorëve të tjerë besnikë. Për këtë unë dëshmoj solemnisht në emrin e shenjtë dhe të shenjtëruar të Zotit tonë, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Brigham Young, në *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 580; shih edhe Brigham Young, "Remarks", *Deseret News*, 26 tetor 1859, f. 266.
2. Ka katër rrëfime kryesore për Vegimin e Parë nga të cilat unë citoj; shih "Joseph Smith's Accounts of the First Vision", josephsmithpapers.org.
3. Joseph Smith – Historia 1:8.
4. Shih Joseph Smith – Historia 1:11.
5. Joseph Smith – Historia 1:12.
6. Joseph Smith – Historia 1:14.
7. Joseph Smith – Historia 1:17.
8. Në Joseph Smith, "History, circa Summer 1832", f. 3, josephsmithpapers.org; germëzimi, pikësimi dhe përdorimi i germave të mëdha janë standardizuar.
9. Joseph Smith – Historia 1:18.
10. Joseph Smith, "Church History", *Times and Seasons*, 1 mars 1842, f. 707; shih

- edhe josephsmithpapers.org.
11. Joseph Smith, "Journal, 1835–1836", f. 24, josephsmithpapers.org.
 12. Joseph Smith, "History, circa Summer 1832", f. 3, josephsmithpapers.org; pikësimi dhe përdorimi i germave të mëdha janë standardizuar.
 13. Joseph Smith – Historia 1:21–22.
 14. Joseph Smith – Historia 1:33–34.
 15. Joseph Smith, "Letter to Emma Smith, 4 April 1839", f. 1–2, josephsmithpapers.org; germëzimi, pikësimi dhe përdorimi i germave të mëdha janë standardizuar.
 16. Joseph Smith, në "Minute Book 1", f. 186, josephsmithpapers.org; theksimi i shtuar; pikësimi i standardizuar.
 17. Shih Doktrina e Besëlidhje 136:39.
 18. Joseph Smith, "History of Joseph Smith", *The Latter-day Saints' Millennial Star*, 19 prill 1862, f. 248; theksimi i shtuar.
 19. Doktrina e Besëlidhje 135:3; theksimi i shtuar.
 20. "Lucy Mack Smith, History, 1845", f. 312–313, josephsmithpapers.org; germëzimi dhe pikësimi janë standardizuar.
 21. "Lucy Mack Smith, History, 1845", f. 313, josephsmithpapers.org.
 22. Zbulesa 7:14–17.
 23. Filipianëve 1:29.
 24. Doktrina e Besëlidhje 128:22, 24; theksimi i shtuar.



JOZEF DHE HAJRËM SMITHI DUKË QËNDRUAR ANËS LUMIT, NGA THEODORE S. GORICA



Nga Plaku Xhejms R. Rasband,
i Të Shtatëdhjetëve

Sigurimi i një Gjykimi të Drejtë

Që të sigurohet një gjykim i drejtë, flijimi shlyes i Shpëtimtarit do t'i heqë gëmushën e paditurisë dhe gjembat e dhembshëm të lëndimit të shkaktuar nga të tjerët.

Libri i Mormonit na Mëson Doktrinën e Krishtit

Tetorin e kaluar, Presidenti Rasëll M. Nelson na nxiti të merrnim në shqyrtim se si jeta jonë do të ishte e ndryshme nëse “njohuria [jonë] e fituar nga Libri i Mormonit do të hiqej befaz”.¹ E kam përsiatur pyetjen e tij, sikurse jam i sigurt se e kanë përsiatur shumë prej jush. Një mendim më ka ardhur vazhdimisht – pa Librin e Mormonit dhe çartësinë e tij lidhur me doktrinën e Krishtit dhe flijimin e Tij shlyes, ku do të drejtohesha për paqe?

Doktrina e Krishtit – që përbëhet nga parimet dhe ordinancat shpëtuëse të besimit të Krishtit, të pendimit, pagëzimit, dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund – jepet mësim shumë herë në të gjitha shkrimet e shenjta të Rivendosjes, por me fuqi të veçantë në Librin e Mormonit.² Doktrina fillon me besimin të Krishtit dhe secili prej elementeve të saj varet nga mirëbesimi të flijimi të Tij shlyes.

Siç ka dhënë mësim Presidenti Nelson: “Libri i Mormonit jep kup-tueshmërinë më të plotë dhe më

të besueshme për Shlyerjen e Jezu Krishtit që gjendet në ndonjë vend”.³ Sa më shumë që kuptojmë rreth dhuratës hyjnore të Shpëtimtarit, aq më shumë do të arrijmë të dimë, në mendjen tonë dhe në zemrën tonë⁴ për realitetin e sigurisë së Presidentit Nelson se “të vërtetat e Librit të Mormonit kanë *fujinë* ta shërojnë, ngushëllojnë, rivendosin, ndihmojnë, forcojnë, përkrahin dhe gëzojnë shpirtin tonë”.⁵

Shlyerja e Shpëtimtarit i Plotëson të Gjitha Kërkesat e Drejtësisë

Një ndihmesë jetike dhe paqendhë-nëse e Librit të Mormonit kundrejt të kuptuarit tonë për Shlyerjen e Shpëtimtarit është mësimi prej tij se flijimi plot mëshirë i Krishtit i përmbush të gjitha kërkesat e drejtësisë. Sikurse shpjegoi Alma: “Perëndia vetë shlyen për mëkatet e botës, që të realizohet plani i mëshirës, për të plotësuar kërkesat e drejtësisë, që Perëndia të mund të jetë një Perëndi i përsosur, i drejtë dhe gjithashtu një Perëndi i mëshirshëm”.⁶ Planin e Atit për mëshirën⁷ – atë që shkrimet e shenjta e quajnë

edhe planin e lumturisë⁸ ose planin e shpëtimit⁹ – nuk mund të përmbushesh nëse nuk plotësoheshin të gjitha kërkesat e drejtësisë.

Por çfarë janë saktësisht “kërkesat e drejtësisë”? Merrreni parasysh përvojën e vetë Almës. Mbani mend se kur ishte i ri, Alma po përpiquej lart e poshtë që “të shkatërronte kishën”.¹⁰ Në fakt, Alma i tha të birit, Helamanit, se ai “mundohej me dhimbjet e ferrit” ngaqë vërtet kishte “vrrarë shumë prej fëmijëve të [Perëndisë] duke i udhëhequr “ata drejt shkatërrimit”.¹¹

Alma i shpjegoi Helamanit se paqja më së fundi i erdhi kur “mendja [e tij] po . . . përqendrohej” te mësimi i dhënë nga i ati “në lidhje me ardhjen e . . . Jezu Krishtit . . . për të shlyer mëkatet e botës”.¹² Alma i penduar u lut për mëshirën e Krishtit¹³ dhe më pas ndjeu gëzim e lehtësim kur e kuptoi se Krishti kishte shlyer për mëkatet e tij dhe kishte paguar gjithçka që e kërkonte drejtësia. Sërish, çfarë do të kishte kërkuar drejtësia nga Alma? Siç dha mësim Alma vetë më vonë: “Asnjë gjë e papastër nuk mund të trashëgojë mbretërinë e Perëndisë”.¹⁴ Prandaj, pjesë e lehtësimit të Almës duhet të kishte qenë që, në qoftë se nuk ndërhynte mëshira, drejtësia do ta kishte penguar atë që të kthehej për të jetuar me Atin Qiellor.¹⁵

Shpëtimtari Shëron Plagët që Ne Nuk Mund t'i Shërojmë

Por, a u përqendrua gëzimi i Almës vetëm mbi vetveten – mbi shmangien e ndëshkimit ndaj tij dhe në të qenit i aftë që ai të kthehej tek Ati? Ne e dimë se Alma kishte agoni edhe për njerëzit që ai i kishte udhëhequr larg nga e vërteta.¹⁶ Por Alma vetë nuk mund të shëronte dhe të kthente të gjithë ata që i kishte çuar në udhë të gabuar. Ai vetë nuk mund të siguronte

që atyre t'u jepej një mundësi e drejtë për të mësuar doktrinën e Krishtit dhe për t'u bekuar nëpërmjet të jetuarit të parimeve të tij të gëzueshme. Ai nuk mund të kthente ata që mund të kishin vdekur ende të verbuar nga mësimet e tij të rreme.

Sikurse dha mësim dikur Presidenti Bojd K. Paker: "Mendimi që e shpëtoi Almën, . . . është ky: 'Rikthimi i asaj që ju nuk mund ta riktheni, shërimi i plagës që nuk mund ta shëroni, rregullimi i asaj që e thyet dhe nuk mund ta rregulloni, është pikërisht qëllimi i shlyerjes së Krishtit'"¹⁷. E vërteta e gëzueshme tek e cila u "përqendruar" mendja e Almës, nuk ishte thjesht që ai vetë të mund të bëhej i pastër, por gjithashtu që ata të cilëve iu kishte bërë dëm, të mund të shëroheshin dhe të bëheshin të pacenuar.

Flijimi i Shpëtimtarit Siguron një Gjykim të Drejtë

Vite përpara se Alma të shpëtohej nga kjo doktrinë që jep siguri, mbreti Benjamin dha mësim rreth shkallës së gjerë të shërimit të ofruar nga flijimi shlyes i Shpëtimtarit. Mbreti Benjamin shpalli se "lajmet e gëzuara të gëzimit të madh" iu dhanë atij "nëpërmjet një engjëlli nga Perëndia"¹⁸. Mes atyre lajmeve të gëzuara ishte e vërteta që Krishti do të vuante dhe vdiste për mëkatet dhe gabimet tona për të siguruar që "një gjykim i drejtë të vi[nte] mbi fëmijët e njerëzve"¹⁹.

Çfarë kërkon saktësisht një "gjykim i drejtë"? Në vargun vijues, mbreti Benjamin shpjegoi se, që të sigurohet një gjykim i drejtë, gjaku i Shpëtimtarit shleu "për mëkatet e atyre që kanë rënë nga shkëlja e Adamit" dhe për ata "që kanë vdekur pa ditur vullnetin e Perëndisë në lidhje me ta, ose që kanë bërë mëkat nga padituria"²⁰. Ai dha mësim se një gjykim i drejtë gjithashtu

kërkonte që "gjaku i Krishtit [të] shlyejë për" mëkatet e fëmijëve të vegjël.²¹


Këto shkrime të shenjta na mësojnë një doktrinë të lavdishme: flijimi shlyes i Shpëtimtarit shëron, si një dhuratë falas, ata që mëkatojnë në padituri – ata të cilët, sikurse e tha Jakobi, "nuk ka[në] ligj të dhënë"²². Përgjegjshmëria për mëkatin varet nga drita që na është dhënë, dhe është në varësi të aftësisë sonë për ta ushtruar lirinë tonë të zgjedhjes.²³ Ne e dimë këtë të vërtetë shëruese dhe ngushëlluese vetëm për shkak të Librit të Mormonit dhe shkrimeve të tjera të shenjta të Rivendosjes.²⁴

Sigurisht, atje ku është dhënë një ligj, atje ku nuk jemi të paditur për vullnetin e Perëndisë, ne jemi të përgjegjshëm. Siç e theksoi mbreti Benjamin: "Mjerë ai që e di se ngre krye kundër Perëndisë! Pasi shpëtimi nuk vjen tek asnjë i tillë, veçse nëpërmjet pendimit dhe besimit në Zotin Jezu Krisht."²⁵

Ky gjithashtu është lajmi i gëzuar i doktrinës së Krishtit. Jo vetëm që Shpëtimtari shëron dhe i rivendos ata që mëkatojnë në padituri, por edhe, për ata që mëkatojnë kundër dritës, Shpëtimtari ofron shërim me kushtin e pendimit dhe të besimit tek Ai.²⁶

Alma duhet të jetë "përqendruar" tek të dyja këto të vërteta. A do ta kishite ndier Alma vërtet atë që ai e përshkruan si "të ëmb[lin] . . . gëzim"²⁷, në qoftë se mendonte se Krishti e shpëtoi atë, por i la të dëmtuar përgjithmonë njerëzit që ai i kishte udhëhequr larg nga e vërteta? Sigurisht që jo. Që Alma të ndiente paqe të plotë, ata të cilët ai i dëmtoi, gjithashtu kishin nevojë për mundësinë që të shëroheshin.

Por si do të shëroheshin saktësisht ata – ose si do të shërohen njerëzit që ne mund t'i dëmtojmë? Edhe pse nuk e kuptojmë tërësisht dinamikën e shenjtë me anë të së cilës flijimi shlyes i Shpëtimtarit shëron e rivendos, ne



KRISHTI DUKE U LUTUR NE KOPSHIN E GJIFSEMANIT, NGA HERMANN CLEMENTZ

dimë vërtet se, që të sigurohet një gjykim i drejtë, Shpëtimtari do t'i heqë gëmushën e paditurisë dhe gjembat e dhembshëm të lëndimit të shkaktuar nga të tjerët.²⁸ Nëpërmjet kësaj, Ai siguron që të gjithë fëmijëve të Perëndisë do t'u jepet mundësia, me një përfytyrim të paerrësuar, që të zgjedhin për ta ndjekur Atë dhe për të pranuar planin e madhërishtë të lumturisë.²⁹

Shpëtimtari do të Ndreqë Gjithçka që Ne e Kemi Thyer

Janë këto të vërteta që do t'i kenë sjellë paqe Almës. Dhe janë këto të vërteta që gjithashtu do të na sjellin paqe të madhe. Si burra e gra të natyrshme, ne të gjithë goditemi, ose nganjëherë përplasemi, me njëri-tjetrin dhe shkaktojmë dëmtim. Siç mund të dëshmojë çdo prind, dhembja e shoqëruar me gabimet tona nuk është thjesht frika për vetë ndëshkimin tonë, por frika që ne mund ta kemi kufizuar gëzimin e fëmijëve tanë ose në njëfarë mënyre t'i kemi penguar ata që të mos e shohin dhe kuptojnë të vërtetën. Premtimi i lavdishëm i flijimit shlyes të Shpëtimtarit është që, për sa u përket gabimeve tona si prindër, Ai i konsideron fëmijët tanë të pafajshëm dhe premtim shërim për ta.³⁰ Dhe, madje kur ata kanë mëkatur kundër dritës – siç bëjmë ne të gjithë – krahu i Tij i

mëshirës është i shtrirë³¹ dhe Ai do t'i shëlbojë nëse thjesht do të shohin tek Ai dhe do të jetojnë³².

Edhe pse Shpëtimtari ka fuqi ta ndreqë atë që ne nuk mund ta rregullojmë, Ai na urdhëron të bëjmë gjithçka mundemi për ta bërë dëmshpërblimin si pjesë të pendimit tonë.³³ Mëkatet dhe gabimet tona zënë vendin jo vetëm të marrëdhënies sonë me Perëndinë, por edhe të marrëdhënieve tona me të tjerët. Nganjëherë përpjekjet tona për të shëruar dhe rivendosur mund të jenë po aq të thjeshta sa kërkimi i faljes, por herë të tjera rivendosja mund të kërkojë vite të përpjekjes së përlur.³⁴ Prapëseprapë, për shumë prej mëkateve dhe gabimeve tona, ne thjesht nuk jemi në gjendje që t'i shërojmë tërësisht ata që i kemi lënduar. Premtimi i madhërishtëm, paqedhënës i Librit të Mormonit dhe ungujllit të rivendosur është që Shpëtimtari do të ndreqë gjithçka që ne e kemi thyer.³⁵ Dhe Ai do të na ndreqë edhe ne, në qoftë se kthehemi tek Ai me besim dhe pendohemi për dëmtimin që kemi shkaktuar.³⁶ Ai i ofron që të dyja këto dhurata, sepse Ai na do ne të gjithëve me një dashuri të përsosur³⁷ dhe sepse Ai zotohet që të sigurojë një gjykim të drejtë, i cili i nderon edhe drejtësinë edhe mëshirën. Unë dëshmoj se kjo është e vërtetë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, "Fjala e Mbylljes", *Liahona*, nëntor 2019, f. 122.
2. Shih 2 Nefi 31; 3 Nefi 11:28, 32, 35, 39–40; Doktrina e Besëlidhje 10:62–63, 67–70; 68:25; Moisiu 6:52–54; 8:24; Nenet e Besimit 1:4.
3. Rasëll M. Nelson, "Libri i Mormonit: Si do të ishte Jeta Juaj pa Të?", *Liahona*, nëntor 2017, f. 62.
4. Shih Doktrina e Besëlidhje 8:2–3.
5. Rasëll M. Nelson, "Libri i Mormonit: Si do të ishte Jeta Juaj pa Të?", f. 62.
6. Alma 42:15.
7. Shih Alma 42:15.
8. Shih Alma 42:8.

9. Shih Alma 24:14; Moisiu 6:62.
10. Shih Mosia 27:8–10.
11. Alma 36:13, 14.
12. Alma 36:17, 18.
13. Shih Alma 36:18.
14. Alma 40:26; shih edhe 1 Nefi 15:34; Alma 7:21; 11:37; Helamani 8:25.
15. Shih 3 Nefi 27:19; shih edhe Moisiu 6:57.
16. Shih Alma 36:14–17.
17. Boyd K. Packer, "The Brilliant Morning of Forgiveness", *Ensign*, nëntor 1995, f. 19–20.
18. Mosia 3:2, 3.
19. Mosia 3:10; theksimi i shtuar.
20. Mosia 3:11; shih edhe 2 Nefi 9:26.
21. Mosia 3:16; shih edhe Mosia 15:25; Moroni 8:11–12, 22.
22. 2 Nefi 9:25.
23. Shih 2 Nefi 2:26–27; Helamani 14:29–30.
24. Shih Nenet e Besimit 1:2; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 45:54. Duke menduar thëllë për doktrinën e pagëzimit për të vdekurit, njëherë Profeti Jozef Smith tha: "Ndërkohë që një pjesë e racës njerëzore e gjykon dhe e dënon pa mëshirë pjesën tjetër, Prindi i Madh i universit e trajton të gjithë familjen njerëzore me kujdes dhe vëmendje atërore; Ai i konsideron ata si fëmijët e Tij. . . . Ai është një Ligjvënës i mençur dhe do t'i gjykojë të gjithë njerëzit, jo sipas ideve të kufizuara, zemërngushta të njerëzve. . . . Ai do t'i gjykojë ata, 'jo sipas asaj që ata nuk e kanë, por sipas asaj që ata e kanë'; ata që kanë jetuar pa ligj, do të gjykohen pa ligj dhe ata që kanë një ligj, do të gjykohen sipas atij ligji. Ne nuk duhet të dyshojmë për urtësinë dhe inteligjencën e të Madhit Jehova; Ai do t'u japë gjykim ose mëshirë gjithë kombeve sipas meritave të tyre të ndryshme, mjeteve të tyre për të fituar inteligjencë, ligjeve sipas të cilave ata qeverisen, mjeteve të disponueshme për ta për të marrë informacionin e saktë dhe . . . ne të gjithëve do të na duhet të pranojmë se Gjykatësi i tërë tokës ka bërë drejtësi" (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 432–433).
25. Mosia 3:12; shih edhe 2 Nefi 9:27.
26. Shih Mosia 3:12; Helamani 14:30; Moroni 8:10; Doktrina e Besëlidhje 101:78. Individët mund të jenë të paditur për urdhërimet dhe besëlidhjet e caktuara ose mund të jenë

të paaftë për ta ushtruar lirinë e tyre të zgjedhjes në disa rrethana, por ata ende mund të jenë të përgjegjshëm në rrethana të tjera për shkak të Dritës së Krishtit që zotërojnë (shih 2 Nefi 9:25; Moroni 7:16–19). Shpëtimtari, i cili është gjykatësi ynë dhe i cili ka siguruar një gjykim të drejtë, do ta bëjë dallimin e këtyre rrethanave (shih Mormoni 3:20; Moisiu 6:53–57). Dhe Ai e ka paguar çmimin për të dyja – për të parën pa kushte dhe për të dytën me kushtin e pendimit.

27. Alma 36:21.
28. Shih Mosia 3:11; shih edhe D. Tod Kristoferson, "Shëlbimi", *Liahona*, maj 2013, f. 110; Alma 7:11–12 ("Ai do të marrë përsipër dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij. . . . Dhe ai do të marrë përsipër dobësitë e tyre"); Isaia 53:3–5 ("Megjithatë ai mbante sëmundjet tona dhe kishte marrë përsipër dhembjet tona"); 61:1–3 ("Zoti më ka vajosur për . . . të lidh[ur] plagën e atyre që e kanë zemrën të thyer, . . . për t'u dhënë gëzim atyre që pikëllohen në Sion, për t'u dhënë atyre një diademë në vend të hirit, vajin e gëzimit në vend të zisë"). Është udhëzuese që Shpëtimtari citoi nga këto vargje tek Isaia kur Ai shpalli se ishte Mesia: "Sot ky Shkrim u përmbush në veshët tuaj" (shih Luku 4:16–21).
29. Në botën e shpirtrave, "ungjilli u predikohet të paditurve, të papenduarve dhe rebelëve, në mënyrë që ata të mund të çlirohen nga robëria e tyre dhe të shkojnë përpara drejt bekimeve që një Atë i dashur Qiellor i ka të ruajtura për ta" (Dallin H. Oaks, "Ki Besim tek Zoti", *Liahona*, nëntor 2019, f. 27). Shih 1 Pjetër 4:6; 2 Nefi 2:11–16; Doktrina e Besëlidhja 128:19; 137:7–9; 138:31–35.
30. Shih Moisiu 6:54. Presidenti M. Rasëll



Provo, Jutë, SHBA



Nga Xhoi D. Khons,
Presidente e Përgjithshme e Filllores

Një Thirrje Veçanërisht Fisnike

Si gra besimi, ne mund të nxjerrim parime të vërteta nga përvojat e Profetit Jozef, të cilat na japin ide për të marrë vetë zbuluesen tonë.

- Ballard dha mësim këtë doktrinë për sa i përket vetëvrasjes: “Vetëm Zoti i di të gjitha hollësitë dhe është Ai që do t’i gjykojë veprimet tona këtu në tokë. Kur Ai të na gjykojë, unë mendoj se Ai do t’i marrë parasysh të gjitha gjërat: përbërjen tonë gjenetike dhe kimike, gjendjen tonë mendore, aftësinë tonë intelektuale, mësimet që kemi marrë, traditat e etërve tanë, shëndetin tonë e kështu me radhë. Ne mësojmë në shkrimet e shenjta se gjaku i Krishtit do të shlyejë për mëkatet e njerëzve ‘që kanë vdekur pa e ditur vullnetin e Perëndisë në lidhje me ta, ose që kanë bërë mëkat nga padituria’ (Mosia 3:11)” (“Suicide: Some Things We Know, and Some We Do Not”, *Ensign*, tetor 1987, f. 8; *Tambuli*, mars 1988, f. 18).
31. Shih Jakobi [LiM] 6:5; Mosia 29:20; 3 Nefi 9:14; Doktrina e Besëlidhje 29:1.
32. Shih Helamani 8:15.
33. Shih Levitikun 6:4–5; Ezekiel 33:15–16; Helamani 5:17; Doktrina e Besëlidhje 58:42–43.
34. Ishte pikërisht kjo lloj përpjekjeje në të cilën u përfshi vetë Alma (shih Alma 36:24).
35. Presidenti Bojd K. Paker e dha mësim këtë parim në mënyrë të fuqishme:
“Ka raste që nuk mund ta ndreqni atë që e keni thyer. Ndoshta fyerja ishte shumë kohë më parë ose i lënduari nuk e pranoi pendesën tuaj. Ndoshta dëmi që kaq i rëndë saqë nuk mund ta ndreqni, sado skajshëm ta dëshironi.
Pendimi juaj nuk mund të pranohet, në qoftë se nuk ka dëmshpërblim. Nëse nuk mund ta zhbëni atë që keni bërë, ju zihen në grackë. Është e lehtë të kuptoni se sa të padobishëm e të pashpresë ndiheni atëherë dhe përse mund të donit të hiqnit dorë, pikërisht siç bëri Alma. . . .
Si mund të rregullohet gjithçka, ne nuk e dimë. Mund të mos arrihet gjithçka në këtë jetë. Ne e dimë nga vegimet dhe vizitimet se shërbëtorët e Zotit e vazhdojnë punën e shëlbimit përtej velit.
Kjo njohuri duhet të jetë po aq ngushëlluese për të pafajshmin, sa është për fajtorin. Unë po mendoj për prindër që vuajnë në mënyrë të jashtëzakonshme për gabimet e fëmijëve të tyre të pabindur dhe që po e humbasin shpresën” (“The Brilliant Morning of Forgiveness”, f. 19–20).
36. Shih 3 Nefi 12:19; shih edhe Mateu 6:12; 3 Nefi 13:11.
37. Shih Gjoni 15:12–13; 1 Gjon 4:18; Diter F. Uhtdorf, “Dashuria e Përsosur e Nxjerr Jashtë Frikën”, *Liahona*, maj 2017, f. 107.

Unë jam mirënjohëse që ta përqendroj bisedën time sot te rolet e vazhdueshme të grave në Rivendosjen. Është e qartë që gjatë gjithë historisë gratë kanë zënë një vend të spikatur në planin e Atit tonë Qiellor. Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim: “Do të ishte e pamundur të matej ndikimi që kanë gra[të] . . . jo vetëm mbi familjet, por gjithashtu mbi Kishën e Zotit, si bashkëshorte, nëna dhe gjyshe; si motra dhe si teto; si mësuese dhe udhëheqëse; dhe veçanërisht si shembuj dhe si mbrojtëse të devotshme të besimit”¹.

Në Shoqatën e hershme të Ndhimës në Navu 178 vjet më parë, Profeti Jozef Smith i këshilloi motrat që të “jetonin në përputhje me privilegjin [e tyre]”². Shembulli i tyre na mëson ne sot. Në unitet, ato e ndoqën zërin e një profeti dhe jetuan me besim të qëndrueshëm te Jezu Krishti, ndërkohë që ndihmonin për të ngritur themelin mbi të cilin ne qëndrojmë sot. Motra, është radha jonë. Ne kemi një punë hyjnore nga Zoti dhe ndihmesat tona besnike dhe të pashoqe janë jetike.

Presidenti Spenser W. Kimball shpjegoi: “Të jesh një grua e drejtë gjatë skenave përmblyëse në këtë tokë,

përpara ardhjes së dytë të Shpëtimtarit tonë, është një thirrje veçanërisht fisnike. Forca dhe ndikimi i gruas së drejtë sot mund të jetë dhjetëfishi i çfarë mund të ishte në kohë më të qeta.”³

Presidenti Nelson po ashtu na është lutur: “Unë iu lutem motrave të mia të Kishës . . . të bëjnë një hap përpara! Zëreni vendin tuaj të ligjshëm dhe të nevojshëm në shtëpinë tuaj, në komunitetin tuaj dhe në mbretërinë e Perëndisë – më shumë sesa e keni zënë ndonjëherë më parë.”⁴

Kohët e fundit pata privilegjin, së bashku me një grup të fëmijëve të Filllores, të takoheshim me Presidentin





Rasëll M. Nelson në modelin e shtëpisë së familjes Smith në Palmira të Nju-Jorkut. Dëgjoni teksa profeti ynë i dashur u mëson fëmijëve se çfarë mund të bëjnë *ata* për të bërë një hap përpara.

Motra Xhons: “Jam kureshtarë të di a mund të keni pyetje që do të donit t’ia bënit Presidentit Nelson. Jeni të ulur këtu me profetin. A ka ndonjë gjë për të cilën gjithmonë keni dashur ta pyesni profetin? Po, Përl.”

Përl: “A është e vështirë të jesh profet? A keni, pra, vërtet shumë punë?”

Presidenti Nelson: “Sigurisht, është e vështirë. Çdo gjë që lidhet me bërjen më shumë si Shpëtimtari, është e vështirë. Për shembull, kur Perëndia donte që t’i jepte Moisiut Dhjetë Urdhërimet, ku i tha Ai të shkonte Moisiut? Lart në majë të një mali, në majë të malit Sinai. Kështu që Moisiut iu desh të bënte të gjithë rrugën deri lart në majë të atij mali për të marrë Dhjetë Urdhërimet. Tani, Ati Qiellor mund të kishte thënë: ‘Moisi, filloje atje dhe unë do ta filloj këtu dhe do të takoj në gjysmë të udhës’. Jo, Zotit i pëlqen shumë përpjekja, sepse përpjekja sjell shpërblime që nuk mund të vijnë pa të. Për shembull, a keni marrë ndonjëherë mësim pianoje?”

Fëmijët: “Po.”

Përl: “Unë marr mësim violine.”

Presidenti Nelson: “Dhe a ushtrohemi?”

Fëmijët: “Po.”

Presidenti Nelson: “Çfarë ndodh nëse nuk ushtrohemi?”

Përl: “Harron.”

Presidenti Nelson: “Po, nuk përparon, apo jo? Prandaj përgjigja është:

‘Po, Përl’. Kërkon përpjekje, shumë punë të palodhur, shumë studim dhe nuk ka asnjëherë mbarim. Kjo është e mirë! Është e mirë, sepse përparojmë gjithmonë. Edhe në botën që vjen ne përparojmë.”

Përgjigja e Presidentit Nelson ndaj këtyre fëmijëve të çmuar gjen zbatim për secilin prej nesh. Zoti e pëlqen shumë përpjekjen dhe përpjekja sjell shpërblime. Ne vazhdojmë të ushtrohemi. Ne gjithmonë përparojmë për aq kohë sa përpiqemi fort ta ndjekim Zotin.⁵ Ai nuk pret përsosje sot. Ne vazhdojmë t’i ngjitemi malit tonë vetjak të Sinait. Si në kohët e shkuara, udhëtimi ynë vërtet kërkon përpjekje, punë të shumtë dhe studim, por zotimi ynë për të përparuar sjell shpërblime të përjetshme.⁶

Çfarë mësojmë më shumë nga Profeti Jozef Smith dhe Vegimi i Parë rreth përpjekjes, punës së palodhur dhe studimit? Vegimi i Parë na jep drejtim për rolet *tona* të pashoqe, të vazhdueshme. Si gra besimi, ne mund të nxjerrim parime të vërteta nga përvojat e Profetit Jozef, të cilat na japin ide për të marrë vetë zbuluesen tonë. Për shembull:

- Ne punojmë në kushte të vështira.
- Ne iu kthehemi shkrimeve të shenjta që të marrim urtësi për të vepruar.
- Ne shfaqim besimin dhe mirëbesimin tonë te Perëndia.
- Ne e ushtrojmë fuqinë tonë që t’i përgjrohemi Perëndisë për të na ndihmuar që ta pengojmë ndikimin e kundërshtarit.
- Ne ia japim Perëndisë dëshirat e zemrave tona.
- Ne përqendrohemi te drita e Tij që i udhërrëfen zgjedhjet e jetës sonë dhe qëndron mbi ne kur i drejtohemi Atij.

- Ne e kuptojmë se Ai e një secilën prej nesh me emër dhe ka role individuale që ne t’i plotësojmë.⁷

Përveç kësaj, Jozef Smithi e rivedosi diturinë që ne kemi potencial hyjnor dhe vlerë të përjetshme. Për shkak të asaj marrëdhënieje me Atin tonë Qiellor, unë besoj se Ai *pret* nga ne që të marrim zbuluesë prej Tij.

Zoti e udhëzoi Ema Smithin që ta “[merte] Frymën e Shenjtë”, të mësonte shumë, të “[linte] mënjane gjërat e kësaj bote[,] . . . të kërko[n]te gjërat e një më të mire” dhe të “kap[ej] pas besëlidhjeve [të saj]” me Perëndinë.⁸ Të mësuarit është pjesë përbërëse e përparimit, veçanërisht kur shoqërimi i vazhdueshëm i Frymës së Shenjtë na mëson atë që është e nevojshme që secili prej nesh ta lërë mënjane – domethënë atë që mund të na e *tërheqë vëmendjen* ose ta *vonojë* përparimin tonë.

Presidenti Rasëll M. Nelson tha: “Ju lutem që ta rritni aftësinë tuaj shpirtërore për të marrë zbuluesë”.⁹ Fjalët e profetit tonë janë vazhdimisht me mua teksa mendoj thellë për aftësinë e grave për të bërë një hap përpara. Ai na lutet, gjë që tregon përparësi. Ai po na mëson se si të mbijetojmë shpirtërisht në një botë të sëmure nga mëkati nëpërmjet marrjes dhe veprimit sipas zbuluesës.¹⁰ Kur e bëjmë këtë, duke i nderuar e jetuar urdhërimet e Zotit, neve na premtohet, sikurse iu premtua Ema Smithit, “një kurorë drejtësie”.¹¹ Profeti Jozef dha mësim për rëndësinë e *dijes* se shtegu që po ndjekim në këtë jetë, miratohet prej Perëndisë. Pa atë dije, ne “do të lodhemi në mendjen [tonë] dhe do të ligështohemi”.¹²

Në këtë konferencë, ne do të dëgjojmë të vërteta që na frymëzojnë ta ndryshojmë, përmirësojmë

e pastrojmë jetën tonë. Nëpërmjet zbulësës vetjake, ne mund ta parandalojmë atë që disa njerëz e quajnë “trulloja nga konferenca e përgjithshme” – kur ne largohemi kaq të vendosur për ta bërë gjithçka tani. Gratë kanë shumë lloje përgjegjësish, por është e pamundur dhe e panevojshme që ato të kryen të gjitha njëherësh. Shpirti na ndihmon që të përcaktojmë se te cila punë të përqendrohemi sot.¹³

Ndikimi plot dashuri i Zotit nëpërmjet Frymës së Shenjtë na ndihmon të dimë përparësinë e Tij për përparimin tonë. Vënia e veshit ndaj zbulësës vetjake çon drejt përparimit vetjak.¹⁴ Ne dëgjojmë e veprojmë.¹⁵ Zoti tha: “I kërkoni Atit në emrin tim me besim, duke besuar se do të merrni dhe ju do të keni Frymën e Shenjtë, që i manifeston gjithë gjërat të cilat janë të domosdoshme”¹⁶. Roli ynë i vazhdueshëm është që të marrim zbulësë të vazhdueshme.

Kur fitojmë një shkallë më të lartë mjeshtërie në bërjen e kësaj gjëje, ne mund të marrim më shumë fuqi në rolet tona individuale për të dhënë shërbesë dhe për të plotësuar punën e shpëtimit dhe të ekzaltimit – që vërtet t’i “lë[më] mënjanë gjërat e kësaj bote

dhe të kërkojmë] gjërat e një më të mire”¹⁷. Atëherë ne mund ta frymëzojmë në mënyrë më të efektshme brezin tonë të ri që të bëjë të njëjtën gjë.

Vëllezër e motra, ne të gjithë kërkojmë fuqinë e Perëndisë në jetën tonë.¹⁸ Ka një unitet të këndshëm midis grave dhe burrave në plotësimin e punës së Perëndisë sot. Ne kemi të drejtën e përdorimit të fuqisë së priftërisë nëpërmjet besëlidhjeve, të bëra së pari në ujërat e pagëzimit dhe më pas brenda mureve të tempujve të shenjtë.¹⁹ Presidenti Nelson na mësoi: “Çdo grua e çdo burrë që bën besëlidhje me Perëndinë dhe i mban ato besëlidhje, dhe që merr pjesë me denjësi në ordinancat e priftërisë, ka të drejtë përdorimi të drejtpërdrejtë të fuqisë së Perëndisë”²⁰.

Pohimi im vetjak sot është që si grua, më herët në jetën time, unë nuk e kuptova se unë, nëpërmjet besëlidhjeve të mia, kisha të drejtën e përdorimit të fuqisë së priftërisë.²¹ Motra, unë lutem që ne do ta dallojmë fuqinë e priftërisë dhe do të gëzohemi me të kur “kap[emi] pas besëlidhjeve [tona]”²², përqafojmë të vërtetat e shkrimeve të shenjta dhe ua vëmë veshin fjalëve të profetëve tanë të gjallë.

Le ta shpallim me guxim përkushtimin tonë ndaj Atit tonë Qiellor dhe Shpëtimtarit tonë, “me besim të patundur në të, duke u mbështetur tërësisht në meritat e atij që është i fuqishëm të shpëtojë”²³.

Le ta vazhdojmë plot gëzim këtë

udhëtim drejt potencialit tonë më të lartë shpirtëror dhe le t’i ndihmojmë njerëzit përreth nesh që të bëjmë të njëjtën gjë me anë të dashurisë, shërbimit, udhëheqjes e dhembshurisë.

Plaku Xhejms E. Talmixh me dhembshuri na kujtoi: “Mbrotjtësi më i madh botëror i grave dhe i të qenit grua është Jezusi, Krishti”²⁴. Në analizën përfundimtare të rolit të vazhdueshëm të grave në Rivendosjen dhe për ne të gjitha, cili rol është më i lartë? Unë dëshmoj se është ta dëgjojmë Atë²⁵, ta ndjekim Atë²⁶, të kemi mirëbesim tek Ai²⁷ dhe ta shtrijmë dashurinë së Tij tek të tjerët²⁸. E di se Ai jeton.²⁹ Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 95–96.
2. Joseph Smith, në “Nauvoo Relief Society Minute Book”, f. 38, josephsmithpapers.org.
3. *Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* (2006), f. 217.
4. Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, f. 97.
5. Shih Doktrina e Besëlidhje 58:26–28.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 6:33.
7. Shih Joseph Smith – Historia 1:11–17.
8. Doktrina e Besëlidhje 25:8, 10, 13.
9. Rasëll M. Nelson, “Zbulësë për Kishën, Zbulësë për Jetën Tonë”, *Liahona*, maj 2018, f. 96.
10. Shih 2 Nefi 9:39.
11. Doktrina e Besëlidhje 25:15.
12. *Lectures on Faith* (1985), f. 68.
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 42:61.
14. Presidenti Henri B. Ajring tha:

“Tani, nëse ju dhe unë do të takoheshim më vete (sa do të doja të ishte kështu), në një vend ku do të ndiheshit të lirë të bënit çfarëdo pyetje që donit të bënit, mund ta përfytyroj që do të thoshit diçka si kjo: ‘O, Vëllai Ajring, i kam ndier disa prej gjërave që keni përshkruar. Fryma e Shenjtë e ka prekur zemrën dhe mendjen time herë pas here. Por do të kem nevojë për të vazhdimisht nëse do të doja të mos mposhtesha ose mashtrohesh. A është e mundur kjo? A është e mundur dhe, nëse është, çfarë do të kërkohet për ta marrë atë bekim?’

Pra, le ta fillojmë me pjesën e parë të pyetjes suaj. Po, është e mundur.



San Bernardo, Santiago, Kili



Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Kujtime që të Përcaktojnë Shpirtërisht

Kur vështirësitë vetjake ose rrethanat e botës, përtej kontrollit tonë na e errësojnë shtegun, kujtimet që na përcaktojnë shpirtërisht nga libri ynë i jetës, janë si gurë të shndritshëm që ndihmojnë të na e ndriçojnë udhën para nesh.

Kurdoherë që kam nevojë për atë siguri – dhe kam nevojë për të herë pas here gjithashtu – unë sjell ndërmend dy vëllezër. Nefi e Lehi dhe shërbëtorët e tjerë të Zotit që punuan me ta, u përballën me kundërshtim të ashpër. Ata po shërbenin në një botë gjithnjë e më të ligë. Iu desh të vepronin ndaj mashtrimeve të tmerrshme. Prandaj unë marr guxim – dhe kështu mund të merrni ju – nga fjalët në këtë njërin varg nga Helamani. Siguria sërish ndërfutet në rrëfimin e gjithçkaje që ndodhi në një vit të tërë, pothuajse sikur të mos ishte e habitshme për shkrimtarin. Dëgjoni:

‘Dhe, në vitin e shtatëdhjetenëntë filluan të kishin shumë kundërshtime. Por ndodhi që Nefi dhe Lehi dhe shumë prej vëllezërve të tyre, që dinin në lidhje me pikat e vërteta të doktrinës, duke patur përditë shumë zbulosa, kështu që ata i predikuan popullit, kaq sa u dhanë fund kundërshtimeve të tyre po atë vit.’ [Helamani 11:23.]

Ata kishin ‘përditë shumë zbulosa’. Prandaj, për ju dhe për mua, kjo i jep përgjigje pyetjes suaj të parë. Po, është e mundur të kemi shoqërimin e Frymës së Shenjtë mjaftueshëm sa të kemi përditë shumë zbulosa. Nuk do të jetë e lehtë. Por është e mundur. Ajo që do të kërkohet, do të jetë e ndryshme për secilin person ngaqë ne fillojmë prej vendit ku jemi në tërësinë tonë unike të përvojave në jetë” (“Gifts of the Spirit for Hard Times” [takim rreth vatrës i Universitetit “Brigam Jang”, 10 shtator 2006], f. 3–4, speeches.byu.edu).

15. Shih 2 Nefi 2:16.
16. Doktrina e Besëlidhje 18:18.
17. Doktrina e Besëlidhje 25:10.
18. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:26, 33, 41, 45–46.
19. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:19–21.
20. Rasëll M. Nelson, “Thesaret Shpirtërore”, *Liahona*, nëntor 2019, f. 77.
21. Shih Rasëll M. Nelson, “Thesaret Shpirtërore”, f. 76–79; Dallin H. Oaks, “Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Liahona*, maj 2014, f. 49–52; Henri B. Ajring, “Gratë dhe të Mësuarit e Ungjillit në Shtëpi”, *Liahona*, nëntor 2018, f. 58–60.
22. Doktrina e Besëlidhje 25:13.
23. 2 Nefi 31:19.
24. James E. Talmage, *Jesus the Christ*, bot. i 3-të (1916), f. 475.
25. Shih Joseph Smith – Historia 1:17.
26. Shih Mateu 4:19–20.
27. Shih Fjalët e Urta 3:5–6; Doktrina e Besëlidhje 11:12.
28. Shih Gjoni 13:34; Moroni 7:47.
29. Shih 2 Nefi 33:6; Doktrina e Besëlidhje 76:22.

Tetëmbëdhjetë vjet pas Vegimit të Parë, Profeti Jozef Smith shkroi një rrëfim të zgjeruar të përvojës së tij. Ai ishte përballur me kundërshtim, përndjekje, ngacmime, kërcënime dhe sulme mi-zore¹. Sidoqoftë, ai vazhdoi të dëshmonte trimërisht për Vegimin e tij të Parë: “Unë kisha parë me të vërtetë një dritë dhe në mes të asaj drite pashë dy Personazhe dhe ata me të vërtetë më folën; edhe pse urrehesha dhe përndiqesha, sepse kisha thënë se kisha parë një vegim, përsëri ai ishte i vërtetë. . . . Unë e dija atë dhe e dija se Perëndia e dinte atë dhe nuk mund ta mohojta.”²

Gjatë orëve të tij të vështira, kujtesa e Jozefit u kthye te pothuajse dy dekada më parë, te siguria e dashurisë së Perëndisë ndaj tij dhe te ndodhitë që e mirëpritën Rivendosjen e parashikuar kohë më parë. Duke reflektuar mbi rrugëtimin e tij shpirtëror, Jozefi tha: “Nuk i vë faj askujt që nuk e beson historinë time. Në qoftë se nuk do të kisha përjetuar atë që provova, nuk do ta kisha besuar as vetë.”³

Por përvojat ishin reale dhe ai kurrrë nuk i harroi apo i mohoi ato, duke e vërtetuar pa zhurmë dëshminë e tij ndërsa u largua për në Karthixh. “Unë po shkoj si një qengj për t’u therur”, tha ai, “por jam i qetë si një mëngjes vere; kam një ndërgjegje të paqortueshme përpara Perëndisë dhe kundërejt gjithë njerëzve.”⁴



Solt Lejk Siti, Jutë, SHBA

Përvojat Tuaja që ju Përcaktojnë Shpirtërisht

Ka një mësim për ne te shembulli i Profetit Jozef. Bashkë me udhëzimin plot paqe që marrim nga Fryma e Shenjtë, herë pas here, Perëndia e siguron fuqimisht dhe shumë personalisht secilin prej nesh, se Ai na njeh dhe na do dhe se Ai po na bekon në veçanti dhe haptas. Atëherë, në çastet tona të vështirësisë, Shpëtimtari na i sjell këto përvoja sërish në mendje.

Mendoni për vetë jetën tuaj. Me kalimin e viteve, kam dëgjuar mijëra përvoja të thella shpirtërore nga shenjtorë të ditëve të mëvonshme në mbarë botën, që më vërtetonin përtej çdo dyshimi se Perëndia e njeh dhe e do secilin prej nesh dhe se Ai dëshiron shumë fort të na e zbulojë Vetën. Këto përvoja mund të vijnë në kohë kulmore gjatë jetës sonë ose gjatë atyre që mund të duken fillimisht si ndodhi të qeta, por që shoqërohen gjithnjë me një pohim shpirtëror jashtëzakonisht të fortë për dashurinë e Perëndisë.

Të kujtuarit e këtyre përvojave që të përcaktojnë shpirtërisht, na bën të biem në gjunjë, duke shpallur ashtu siç bëri Profeti Jozef: “Ajo që mora ishte nga qielli. Unë e di atë dhe e di se Perëndia e di që unë e di atë.”⁵

Katër Shembuj

Reflektoni mbi kujtimet tuaja që ju përcaktojnë shpirtërisht, teksa unë jap disa shembuj nga njerëz të tjerë.

Vite më parë, një patriark kunji i moshuar me dy valvula zemre jofunkionale iu lut në atë kohë mjekut Rasëll M. Nelson që ta operonte, ndonëse në atë kohë nuk kishte një zgjidhje me operim për valvulën e dytë të dëmtuar. Mjeku Nelson, si përfundim, pranoi ta bënte operimin. Këto janë fjalët e Presidentit Nelson:

“Pasi pastruam bllokimin e valvulës së parë, ne hapëm valvulën e dytë. Zbuluam se ishte e paprekur por ishte zgjeruar aq keq sa që nuk mund ta kryente më siç duhej funksionin. Ndërsa po e ekzaminoja këtë valvul, një mesazh më erdhi qartë në mendje: *Zvogëlo perimetrin e unazës*. Ia komunikova atë mesazh ndihmësit tim. ‘Membrana e valvulës do të mjaftojë *në qoftë se* arrijmë me sukses ta zvogëlojmë unazën në përmasën e saj të zakonshme.’

Por si? . . . Një pamje m’u shfaq shumë qartë në mendje, ku më tregojë se si mund të vendoseshin penjtë – të bëja një rrudhë këtu e një palë atje. . . . Ende e kujtoj atë imazh mendor – bashkë me vijat e pikëzuara ku duhej të bëheshin qepjet. Riparimi u krye ashtu siç qe paraqitur në mendjen time. Ne e provuam valvulën dhe zbuluam se rrjedhja ishte zvogëluar në mënyrë të jashtëzakonshme. Ndihmësi im tha: ‘Është një mrekulli!’⁶ Patriarku jetoi për shumë vjet.

Mjeku Nelson kishte marrë udhëzimin. Dhe ai e dinte se Perëndia e dinte që ai e dinte se kishte marrë udhëzimin.

Kethi dhe unë e takuam fillimisht Beatris Magrenë në Francë, 30 vjet

më parë. Beatrisa më tregoi së fundi një përvojë që kishte ndikuar në jetën e saj shpirtërore, fill pas pagëzimit, kur ishte adoleshente. Këto janë fjalët e saj:

“Të rinjtë e të rejtat e degës sonë bënë një udhëtim me udhëheqësit e tyre në plazhin Lakanu, një orë e gjysmë larg nga Bordoja.

Përpara se të ktheheshim në shtëpi, njëri nga udhëheqësit vendosi të notonte edhe një herë të fundit dhe u zhyt mes dallgëve me syze shikimi. Kur doli në sipërfaqe, syzet e shikimit ishin zhdukur. . . . I kishte humbur në oqean.

Mospasja e syzeve të shikimit nuk do ta lejonte që t’i jepte makinës. Do të mbeteshim pa transport larg shtëpisë.

Një motër me shumë besim sugjeroi që të luteshim.

Murmurita se lutja nuk do të na vlente absolutisht për asgjë dhe me zor iu bashkova grupit për t’u lutur haptas, teksa qëndronim të zhytur deri në gjysmë të trupit në ujin e mugët.

Sapo lutja mbaroi, zgjata duart që t’i spërkatja me ujë të gjithë. Ndërsa po prekja sipërfaqen e ujit syzet e tij më ngecën në dorë. Një ndjenjë e fuqishme ma përshkoi shpirtin se



Dr. Rasëll M. Nelson



Beatris Magre

Perëndia vërtet i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve tona.”⁷

Dyzet e pesë vjet më vonë, asaj iu kujtua sikur të kishte ndodhur dje. Beatrisa ishte bekuar dhe ajo e dinte se Perëndia e dinte që ajo e dinte se ishte bekuar.

Përvojat e Presidentit Nelson dhe të Motrës Magre ishin shumë të ndryshme, sidoqoftë, për të dy ata, një kujtim i paharrueshëm që të përcakton shpirtërisht, për dashurinë e Perëndisë u ngulit në zemrën e tyre.

Këto ndodhi përcaktuese shpesh vijnë kur je duke mësuar rreth ungjillit të rivendosur ose duke e përhapur ungjillin tek të tjerët.

Kjo fotografi u bë në San-Paolo, Brazil në vitin 2004. Floripes Luiza Damasio nga Kunji Ipaçinga Brazil, ishte 114 vjeçe. Duke folur për kthimin e saj në besim, Motra Damasio më tha se misionarët në fshatin e saj i kishin dhënë një bekim priftërie një fëmije të sëmurë rëndë që u shërua mrekullisht. Ajo donte të dinte më shumë. Teksa u lut për mesazhin e tyre, një dëshmi e pamohueshme e Shpirtit i pohoi asaj se Jozef Smithi ishte një profet i Perëndisë. Në moshën 103-vjeçare u pagëzua dhe në moshën 104-vjeçare mori dhurimin



Motra Floripes Luiza Damasio me Plakun Andersen.

[indaumentin]. Çdo vit më pas, ajo bënte 14 orë me autobus që të kalonte një javë në tempull. Motra Damasio kishte marrë një pohim qiellor dhe ajo e dinte se Perëndia e dinte që ajo e dinte se dëshmia ishte e vërtetë.

Ja tek është një kujtim shpirtëror nga misioni im i parë në Francë, 48 vjet më parë.

Ndërkohë që po shpërndanim fletushka, shoku im i misionit dhe unë i lamë një Libër Mormoni një gruaje të moshuar. Kur u kthyem në banesën e gruas rreth një javë më vonë, ajo e hapi derën. Përpara se të thosha ndonjë fjalë, ndjeva një fuqi të dallueshme shpirtërore. Ndjenjat e forta vazhduan teksa zonja Alisa Odëberi na ftoi brenda dhe na tha se e kishte lexuar Librin e Mormoni dhe se e dinte që ai ishte i vërtetë. Ndërsa u larguam nga banesa e saj atë ditë, u luta: “Atë Qiellor, të lutem më ndihmo që të mos e harroj kurrë atë që sapo ndjeva”. Kurrë nuk e kam harruar.

Në një çast në dukje të zakonshëm, te një derë e ngjashme me qindra dyer të tjera, kisha ndier fuqinë e qiellit. Dhe e dija se Perëndia e dinte që unë e dija se një dritare e qiellit ishte hapur.



Plaku Andersen duke pagëzuar Alisa Odëberin.

Të Posaçme për Ne dhe të Pamohueshme

Këto çaste që të përcaktojnë shpirtërisht, vijnë në kohë të ndryshme dhe në mënyra të ndryshme, të posaçme për secilin prej nesh.

Mendoni për shembujt tuaj të parapëlqyer në shkrimet e shenjta. Njerëzit që e dëgjuan Apostullin Pjetër u “pikëlluan në zemër”⁸. Gruaja lamanite, Abishi, e besoi “vegimi[n e] pazakontë të atit të saj”⁹. Dhe një zë i erdhi Enosit në mendje¹⁰.

Miku im Klejton Kristenseni e përshkroi një përvojë gjatë një leximi plot lutje të Librit të Mormoni në këtë mënyrë: “Një Shpirt i bukur, i ngrohtë e i dashur . . . më rrethoi dhe ma përshkoi shpirtin, duke më mbështjellë me një ndjenjë dashurie që nuk e kisha imagjinuar se mund ta ndieja [dhe këto ndjenja vazhduan për net me radhë]”¹¹.

Ka çaste kur ndjenjat shpirtërore na hyjnë thellë në zemër si zjarr, duke na e ndriçuar shpirtin. Jozef Smithi shpjegoi se ne nganjëherë marrim “befas ide” dhe me raste inteligjencë të pastër që rrjedh¹².

Presidenti Dallin H. Ouks, duke iu përgjigjur një burri të sinqertë, i cili pretendonte se nuk kishte pasur kurrë një përvojë të tillë, e këshilloi: “Ndoshta ke marrë përgjigje për lutjet e tua vazhdimisht, por i ke pasur pritshmëritë e tua të përqendruara te një shenjë aq e madhe apo te një zë aq i lartë, saqë mendon se nuk ke marrë përgjigje”¹³. Vetë Shpëtimtari foli për njerëzit me besim të madh, të cilët “u [bekuan] me zjarr dhe me Frymën e Shenjtë [por të cilët] nuk e dinin”¹⁴.

Në ç’Mënyrë e Dëgjoni Ju Atë?

E kemi dëgjuar kohët e fundit Presidentin Rasëll M. Nelson të thotë: “Unë ju ftoj të mendoni thellë

dhe shpesh për këtë pyetje kyç: Në ç'mënyrë e dëgjoni *ju* Atë? Unë ju ftoj gjithashtu që të ndërmerrni hapa për ta dëgjuar Atë më mirë dhe më shpesh.¹⁵ Ai e përsëriti atë ftesë këtë mëngjes.

Ne e dëgjojmë Atë në lutjet tona, në shtëpitë tona, në shkrimet e shenjtë, në himnet tona, teksa e marrim denjësisht sakramentin, teksa e tregojmë besimin tonë, teksa u shërbejmë të tjerëve dhe teksa e frekuentojmë tempullin me bashkëbesimtarët. Çastet që të përcaktojnë shpirtërisht, vijnë teksa ne e dëgjojmë plot lutje konferencën e përgjithshme dhe teksa i zbatojmë më mirë urdhërimet. Dhe ju fëmijë, këto përvoja janë edhe për ju! Kujtoni, Jezusi “i mësoi dhe u shërbeu fëmijëve . . . dhe [fëmijët] thanë . . . gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme”¹⁶. Zoti tha:

“[Kjo njohuri] ju jepet me anë të Shpirtit tim . . . dhe nëse nuk është me anë të fuqisë sime, ju nuk mund [ta] keni at[ë];

Prandaj, ju mund të dëshmoni se e keni dëgjuar zërin tim dhe i dini fjalët e mia.”¹⁷

Ne mund ta “dëgjojmë Atë” për shkak të bekimeve të Shlyerjes së pashoqe të Shpëtimtarit.

Meqenëse ne nuk mund ta zgjedhim kohën e marrjes së këtyre çasteve përcaktuese, Presidenti Henri B. Ajring dha këtë këshillë për përgatitjen tonë: “Sonte dhe nesër mbrëma, ju mund të luteni dhe të përsiatni, duke bërë pyetjet: ‘A dërgoi Perëndia një mesazh që ishte vetëm për mua? A e pashë dorën e Tij në jetën time apo në atë të [familjes sime]?’”¹⁸ Besimi, bindja, përlësia dhe qëllimi i vërtetë i hapin dritaret e qiellit¹⁹.

Një Ilustrim

Ju mund të mendoni në këtë mënyrë për kujtimet tuaja shpirtërore. Me lutje të vazhdueshme, me një vendosmëri për t'i mbajtur besëlidhjet tona dhe me dhuratën e Frymës së Shenjtë, ne e përshkojmë rrugëtimin tonë gjatë jetës. Kur vështirësia vetjake, dyshimi, ose shkurajimi na e errësojnë shtegun, ose kur rrethanat e botës përtej kontrollit tonë na shtyjnë të vrasim mendjen për të ardhmen, kujtimet që na përcaktojnë shpirtërisht nga libri ynë i jetës, janë si gurë të shndritshëm që ndihmojnë të na e ndriçojnë udhën para nesh, duke na siguruar se Perëndia na njuh, na do dhe ka dërguar Birin e Tij, Jezu Krishtin për

të na ndihmuar që të kthehemi në shtëpi. Dhe kur dikush i lë në harresë kujtimet e veta përcaktuese dhe është i përhumbur apo i pështjelluar, i drejtojmë ata te Shpëtimtari, teksa u tregojmë besimin dhe kujtimet tona, duke i ndihmuar që t'i zbulojnë sërish ato çaste shpirtërore të çmuara që dikur i kishin të vyera.

Disa përvoja janë aq të shenjta sa që ruajmë në kujtesën tonë shpirtërore dhe nuk i tregojmë ato²⁰.

“Engjëjt flasin nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë; prandaj, ata flasin fjalët e Krishtit.”²¹

“Engjëjt nuk kanë pushuar së shërbyeri fëmijëve të njerëzve.


Pasi vini re, ata i janë nënshtuar [Krishtit], që të shërbejnë sipas . . . urdhrat të tij, duke iu shfaqur atyre që kanë besim të fortë dhe mendje të vendosur në çdo formë drejtësie.”²²

Dhe “Ngushëlluesi, [i cili është] Fryma e Shenjtë, . . . do t'ju mësojë çdo gjë dhe do t'ju kujtojë të gjitha këto që ju thashë”²³.

Përqafojini kujtimet tuaja të shenjta. Besojini ato. Hidhini në letër. Tregojuni familjes suaj. Mirëbesoni se ato ju vijnë nga Ati juaj Qiellor dhe Biri i Tij i Dashur²⁴. Le t'ju sjellin ato durim ndaj



Lutja, mbajtja e besëlidhjeve dhe Fryma e Shenjtë na ndihmojnë të drejtohemi në jetë.



Kujtimet shpirtërore janë si gurë të shndritshëm që na e ndriçojnë udhën para nesh.



Ne e tregojmë besimin dhe kujtimet tona që t'i kthejmë njerëzit e humbur drejt Shpëtimtarit.



dyshimeve tuaja dhe kuptueshmëri ndaj vështirësive tuaja!²⁵ Ju premtoj se ndërsa i pranoni me gatishmëri dhe i ruani me kujdes si thesar ndodhitë që ju përcaktojnë shpirtërisht në jetën tuaj, shumë e më shumë të tilla do t'ju vijjnë. Ati Qiellor ju njeh dhe ju do!

Jezusi është Krishti, ungjilli i Tij është rivendosur dhe teksa qëndrojmë besnikë, dëshmoj se do të jemi gjithmonë të Tijtë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

- Shih *Saints: The Story of the Church of Jesus Christ in the Latter Days*, vëll. 1, *The Standard of Truth, 1815–1846* (2018), f. 150–153; shih edhe Joseph Smith, “History, 1838–1856, volume A-1 [23 December 1805–30 August 1834]”, f. 205–9, josephsmithpapers.org; *Saints*, 1:365–366.
- Joseph Smith – Historia 1:25.
- Mësimet të Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 507.
- Doktrina e Besëlidhje 135:4.
- Gjithnjë më kanë lënë mbresa fjalët te Joseph Smith – Historia: “Unë kisha parë një vegim; unë e dija atë dhe e dija se Perëndia e dinte atë” (Joseph Smith – Historia 1:25). Atij do t'i duhej të qëndronte përpara Perëndisë dhe të pranonte se këto ngjarje në Korijen e Shenjtë i ndodhën njëmend në jetë dhe se jeta e tij nuk mund të ishte më kurrë e njëjta për shkak të tyre. Rreth 25 vjet më parë, dëgjova për herë të parë një variant të kësaj fraze nga Plaku Nil A. Makuell. Ai dha këtë shembull: “Shumë kohë më parë, në maj 1945 pata një çast të tillë në ishullin Okinava, në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare. Sigurisht nuk ishte aspak heroizëm nga ana ime por përkundrazi, një bekim për mua dhe të tjerët gjatë bombardimit të pozicionit tonë nga artileria japoneze. Pas bombardimeve të përsëritura që nuk e goditën pozicionin tonë, artileria e armikut së fundi u përqendrua te ne. Faktikisht duhet të kishin shtënë mbi ne, por pati një përgjigje hyjnore ndaj të paktën një lutjeje të trembur, egoiste. Bombardimi u ndal. . . . Isha bekuar dhe e dija se Perëndia e dinte që unë e dija” (“Becoming a Disciple”, *Ensign*, qershor 1996, f. 19).
- Plaku Makuell shtoi se, jo vetëm që ai e dinte, dhe jo vetëm që Perëndia e dinte, por se Perëndia e dinte që ai e dinte se ishte bekuar. Nga ana simbolike për mua kjo më ngre një shkallë më lart në përgjegjësi. Hera-herës, Ati ynë Qiellor e shoqëron një bekim që na jepet me një pohim të fortë shpirtëror se qiejt ndërhyjnë në emrin tonë. Nuk ka mohim për këtë. Ai mbetet me ne dhe nëse jemi të ndershëm dhe besnikë, do t'i japë formë jetës sonë në vitet e ardhshme. “Isha bekuar, dhe e dija se Perëndia e dinte që unë e dija se isha bekuar.”
- Russell M. Nelson, “Sweet Power of Prayer”, *Liahona*, maj 2003, f. 8.
- Histori vetjake e Beatrice Magrë-së treguar Plakut Andersen më 29 tetor 2019; mesazhi elektronik i radhës më 24 janar 2020.
- Veprat e Apostujve 2:37.
- Alma 19:16.
- Shih Enosi 1:5.
- Clayton M. Christensen, “The Most Useful Piece of Knowledge”, *Liahona*, janar 2009, f. 23.
- Shih *Mësimet: Jozef Smith* f. 339.
- Dallin H. Oaks, *Life's Lessons Learned: Personal Reflections* (2011), f. 116.
- 3 Nefi 9:20.
- Russell M. Nelson, “How Do You #HearHim? A Special Invitation”, 26 shkurt 2020, blog.ChurchofJesusChrist.org.
- 3 Nefi 26:14.
- Doktrina e Besëlidhje 18:35–36. Ndjenjat e shoqërojnë gjithnjë njohurinë shpirtërore. “Ju jeni të shpejtë të bëni paudhësi, por të ngadalshëm të kujtoni Zotin, Perëndinë tuaj. Ju keni parë një engjell dhe ai ju foli; po, ju keni dëgjuar zërin e tij herë pas here; dhe ai ju ka folur me një zë të qetë, të ulët,

por ju kishit humbur ndjesinë, që ju nuk mund të ndjenit fjalët e tij” (1 Nefi 17:45).

18. Shih Henri B. Ajring, “O Kujtoni, Kujtoni”, *Liahona*, nëntor 2007, f. 69.

19. Shih 2 Nefi 31:13; Moroni 10:4. Presidenti Dallin H. Oaks, vizitoi misionin tonë në Bordo të Francës në vitin 1991. Ai u shpjegoi misionarëve tanë se qëllim i vërtetë do të thotë që personi që lutet po i thotë Zotit diçka të tillë: “Unë nuk pyes për kureshtje, por me sinqeritet të plotë për të vepruar sipas përgjigjes së lutjes sime. Nëse Ti do të ma japësh këtë përgjigje, do të veproj për ta ndryshuar jetën. Unë do të reagoj.”

20. “Shumë njerëzve u është dhënë të dinë misteret e Perëndisë; por ata janë nën urdhër të rreptë që t'u thonë të tjerëve vetëm atë pjesë të fjalës së tij, që ai ua lejon fëmijëve të njerëzve, sipas vëmendjes dhe zellit që i japin atij” (Alma 12:9).

Plaku Nil A. Makuell tha: “Duhet frymëzim për të ditur se kur t'i tregosh [përvojat shpirtërore]. Kujtoj kur e dëgjova Presidentin Marion G. Romni, i cili ndërthurte zgjuarsinë dhe mençurinë, të thoshte: ‘Do të kishim më shumë përvoja shpirtërore nëse nuk do të flisnim kaq shumë rreth tyre’” (“Called to Serve” [takim shpirtëror në Universitetin “Brigam Jang”, 27 mars 1994], speeches.byu.edu.

21. 2 Nefi 32:3.

22. Moroni 7:29–30.

23. Gjoni 14:26.

24. Të vërtetat e ungjillit janë të disponueshme për të gjithë. Javën përpara se të fillonte konferenca, pasi e përfundova bisedën time, më tërhoqi shpirtërisht një libër që titullohet *Divine Signatures: The Confirming Hand of God* (2010), i shkruar nga Gerald N. Land, i cili shërbeu si Autoritet i Përgjithshëm i Shtatëdhjetë nga viti 2002 deri në 2008. Për kënaqësinë time, fjalët e Vëllait Land ishin një dëshmi e dytë e bukur për parimet që u shprehën në këtë bisedë konferencie dhe që do t'i japin gëzim kujtdo që ka dëshirën të studiojë më shumë rreth kujtimeve që të përcaktojnë shpirtërisht.

25. Një nga citimet më të parapëlqyera të Presidentit Tomas S. Monson, ishte nga poeti skocez, James M. Barrie: “Perëndia na dha kujtime, që të mund të kemi trëndafila qershori gjatë dhjetorit të jetës sonë” (në Thomas S. Monson, “Think to Thank”, *Liahona*, janar 1999, f. 22). E njëjta gjë është e vërtetë edhe për kujtimet shpirtërore. Ato mund të jenë më të dobishmet në kohët e vështira, të frohta të jetës sonë kur të kemi nevojë për ato çaste shpirtërore “qershori”.



Nga Daglas D. Holms,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Përgjithshme
të Të Rinjve, i Liruar nga Thirrja së Fundi

Thellë në Zembrën Tonë

Ne do të shohim se si Zoti përpiqet të na ndihmojë – të gjithë ne – që ta futim ungjillin më thellë në zembrën tonë.

Motra dhe Vëllezër, në çfarë kohe të lavdishme po jetojmë! Ndërsa kremtojmë fillimin e Rivendosjes është gjithashtu e përshtatshme të kremtojmë Rivendosjen e vazhdueshme që po dëshmojmë. Unë gëzohem me ju që jetoj në këtë kohë.¹ Zoti vazhdon të vendosë në vend, nëpërmjet profetëve të Tij, gjithçka duhet për të na ndihmuar të përgatitemi për ta pritur Atë.²

Një nga ato gjëra që nevojiten, është nisma e re Fëmijët dhe Rinia. Shumë nga ju janë njohur me theksin e këtij programi të vendosja e synimeve, emblemat e reja të përkatësisë dhe konferencat Për Forcën e Rinisë [FSY]. Por ne duhet të mos lejojmë që ato të na errësojnë pamjen e parimeve mbi të cilat është ndërtuar programi dhe të qëllimit të tyre: të ndihmojnë të futet ungjilli i Jezu Krishtit thellë në zembrën e fëmijëve dhe të rinisë sonë.³

Besoj se kur arrijmë t'i kuptojmë më qartë këto parime, do ta shohim që ky është më shumë se një program për anëtarët e moshës 8 deri 18 vjeç. Ne do të shohim se si Zoti po përpiqet të na ndihmojë – të gjithë ne – që ta futim ungjillin më thellë në zembrën tonë. Unë lutem që Fryma e Shenjtë të na ndihmojë të mësojmë së bashku.

Marrëdhëniet – “Jini me Ta”⁴

Parimi i parë janë marrëdhëniet. Ngaqë janë një pjesë aq e natyrshme e Kishës së Jezu Krishtit, ne e harrojmë ndonjëherë rëndësinë e marrëdhënieve në udhëtimin tonë të vazhdueshëm drejt Krishtit. Nuk pritet që ne ta gjejmë apo të ecim të vetmuar në shtegun e besëlidhjeve. Neve na nevojitet dashuria dhe përkrahja nga prindërit, pjesëtarët e tjerë të familjes, miqtë dhe udhëheqësit që po ecin gjithashtu në atë shteg.

Këto lloj marrëdhëniesh kërkojnë kohë. Kohë për të qenë bashkë. Kohë



për të qeshur, mësuar dhe shërbyer së bashku. Kohë për të vlerësuar interesat dhe sfidat e njëri-tjetrit. Kohë për të qenë të hapur dhe të ndershëm me njëri-tjetrin ndërsa përpiqemi fort të bëhemi më të mirë së bashku. Këto marrëdhënie janë një nga qëllimet parësore të të mbledhurit së bashku si familje, kuorume, klasa dhe bashkësi. Ato janë themeli për një dhënie të efektshme të shërbesës.⁵

Plaku Dejll G. Renland na dha një çelës për t'i zhvilluar këto marrëdhënie kur tha: “Që t'u shërbejmë të tjerëve me efektshmëri, ne duhet t'i shohim ata . . . nëpërmjet syve të Atit Qiellor. Vetëm atëherë ne mund të fillojmë ta kuptojmë vlerën e vërtetë të një shpirti. Vetëm atëherë ne mund ta ndiejmë dashurinë që Ati Qiellor ka për të gjithë fëmijët e Tij.”⁶

T'i shohim të tjerët sikurse i sheh Perëndia është një dhuratë. E ftoj secilin prej nesh që të kërkojë për këtë dhuratë. Kur i kemi sytë të hapur për të parë⁷, ne do të jemi gjithashtu në gjendje t'i ndihmojmë të tjerët ta shohin veten sikurse i sheh Perëndia.⁸ Presidenti Henri B. Ajring e theksoi fuqinë e kësaj kur ai tha: “Ajo që do të ketë më shumë rëndësi është ajo që [të tjerët] mësojnë nga [ju] rreth asaj që ata janë vërtet dhe që ata vërtet mund të bëhen. Mendoj se këtë nuk do ta mësojnë aq shumë nga leksionet. Ata do ta marrin nga *ndjesitë* e asaj se çka ju jeni, cilët mendoni se janë ata dhe çfarë mendoni se ata mund të bëhen.”⁹ Të ndihmojmë të tjerët të kuptojnë identitetin dhe qëllimin e tyre të vërtetë është një nga dhuratat më të mëdha që mund të japim.¹⁰ Të parit e të tjerëve dhe të vetes siç bën Perëndia i bën “zemrat [tona] të thurura në bashkim dhe në dashuri”¹¹.

Me forcat laike gjithnjë në rritje që na tërheqin, neve na nevojitet fuqia që

vjen nga marrëdhëniet e përzemërta. Kështu, kur planifikojmë veprimtari, mbledhje dhe grumbullime të tjera, le të kujtojmë se qëllimi parësor i tyre është të ndërtohen marrëdhënie që na bashkojnë e na ndihmojnë ta futim ungjillin e Jezu Krishtit më thellë në zemrat tona.¹²

Zbulesa, Liria e Zgjedhjes dhe Pendimi – “Lidhini Ata me Qiellin”¹³

Sigurisht, nuk mjafton thjesht të jemi të lidhur së bashku. Ka shumë grupe dhe organizata që arrijnë unitet për një mori kauzash. Gjithsesi, uniteti që kërkojmë është të bëhemi një në Krisht, ta lidhim veten me Të.¹⁴ Për ta lidhur zemrën tonë me qiellin, neve na nevojiten përvoja shpirtërore vetjake, sikurse sapo na foli shumë qartë Plaku Andersen për to.¹⁵ Ato përvoja vijnë kur Fryma e Shenjtë e mbart fjalën dhe dashurinë e Perëndisë në mendjen dhe zemrën tonë.¹⁶

Kjo zbulesë na vjen nëpërmjet shkrimeve të shenjta, veçanërisht Librit të Mormonit; nëpërmjet fjalëve të frymëzuara nga profetët e gjallë dhe dishepuj të tjerë besnikë dhe nëpërmjet zërit të qetë e të ulët.¹⁷ Këto fjalë janë më shumë se bojë mbi letër, valë zanore në veshët tanë, apo mendime në mendjen tonë, apo ndjenja në zemrën tonë. Fjala e Perëndisë është fuqi shpirtërore.¹⁸ Ajo është e vërtetë dhe dritë.¹⁹ Është mënyra se si e dëgjojmë Atë! Ajo lind dhe rrit besimin tonë në Krisht dhe ndez brenda nesh një dëshirë për t'u bërë më shumë si Shpëtimtari – që do të thotë të pendoresh dhe të ecësh në shtegun e besëlidhjeve.²⁰

Prillin e kaluar Presidenti Rasëll M. Nelson na ndihmoi ta kuptojmë rolin qendror të pendimit në këtë udhëtim zbulesë.²¹ Ai tha: “Kur zgjedhim të pendohemi, ne zgjedhim të ndryshojmë!



Ne e lejojmë Shpëtimtarin që të na shndërrojë në variantin më të mirë të vetes sonë. . . . Ne zgjedhim të bëhemi më shumë si Jezu Krishti!”²² Ky proces ndryshimi, i ushqyer nga fjala e Perëndisë, përbën mënyrën se si lidhemi me qiellin.

Në bazë të ftesës së Presidentit Nelson për t'u penduar është parimi i lirisë së zgjedhjes. Ne duhet *ta zgjedhim* pendimin vetë. Ungjilli nuk mund të futet me forcë në zemrën tonë. Sikurse tha Plaku Renland: “Qëllimi i Atit tonë Qiellor si prindi ynë nuk është që t'i bëjë fëmijët e Tij të bëjnë atë që është e drejtë, është që t'i bëjë fëmijët e Tij të *zgjedhin* të bëjnë atë që është e drejtë”²³.

Në programet e zëvendësuara nga programi Fëmijët dhe Rinia, ishin mbi 500 kërkesa të ndryshme për t'u plotësuar për të marrë njohje [certifikata] të ndryshme.²⁴ Sot, në thelb është një. Është një ftesë që të *zgjedhësh* të bëhesh më shumë si Shpëtimtari. Ne e bëjmë këtë duke marrë fjalën e Perëndisë nëpërmjet Frymës së Shenjtë dhe duke lejuar Krishtin të na ndryshojë në variantin më të mirë të vetes sonë.

Kjo është shumë më tepër sesa një ushtrim për vendosje synimesh apo vetëpërmirësim. Synimet janë thjesht mjete që na ndihmojnë të lidhemi me qiellin nëpërmjet zbulesës, lirisë së zgjedhjes dhe pendimit – për të ardhur te Krishti dhe për ta marrë ungjillin e Tij më thellë në zemrën tonë.

Përfshirje dhe Sakrificë – “Lërimi të Udhëheqin”²⁵

Së fundi, për ta futur ungjillin e Jezu Krishtit thellë në zemrën tonë, nevojitet të përfshihemi në këtë – të japim kohën e talentet tona për këtë, të sakrifikojmë për këtë.²⁶ Ne të gjithë duam të jetojmë një jetë me kuptim dhe kjo është posaçërisht e vërtetë për brezin e ri. Ata dëshirojnë një kauzë.

Ungjilli i Jezu Krishtit është kauza më e madhërishtme në botë. Presidenti Ezra Taft Benson tha: “Ne jemi urdhëruar nga Perëndia që ta çojmë këtë ungjill në gjithë botën. Ajo është kauza që duhet të na bashkojë sot. Vetëm ungjilli do ta shpëtojë botën nga fatkeqësia e vetëshkatërrimit të saj. Vetëm ungjilli do t'i bashkojë njerëzit e të gjitha racave dhe kombësive në paqe. Vetëm ungjilli do t'i sjellë gëzim, lumturi dhe shpëtim familjes njerëzore.”²⁷

Plaku Dejvid A. Bednar premtoi: “Kur ne i fuqizojmë të rinjtë dhe të rejtat duke i ftuar dhe lejuar të veprojnë, Kisha do të shkojë përpara në mënyra të mrekullueshme”²⁸. Më shpesh nga sa mendojmë, ne nuk e kemi ftuar dhe lejuar rininë të sakrifikojë për këtë kauzë të madhe të Krishtit. Plaku Nil A. Maksuell vërejti: “Nëse rinia [jonë] është tepër pak e ngarkuar [nga puna e Perëndisë] ajo ka më shumë gjasa të jetë tepër e mbingarkuar nga bota”²⁹.

Programi Fëmijët dhe Rinia përqendrohet te fuqizimi i rinisë. Ata i zgjedhin vetë synimet e veta. Presidentat e kuorumeve dhe të klasave janë vënë në rolin e duhur të tyre. Këshilli i lagjes për rininë, pikërisht si këshilli i lagjes, përqendrohet te puna e shpëtimtari dhe ekzaltimit.³⁰ Dhe kuorumet dhe klasat i fillojnë mbledhjet e tyre duke u këshilluar rreth mënyrës se si ta bëjnë punën që Perëndia u ka dhënë.³¹

Presidenti Nelson i tha rinisë së Kishës: “Nëse e zgjidhni, nëse e dëshironi ju . . . mund të jeni një pjesë e madhe e diçkaje të madhe, diçkaje të madhërishtme, diçkaje madhështore! . . . Ju jeni nga më të mirët që Zoti ka dërguar *ndonjëherë* në këtë tokë. Ju keni kapacitetin për të qenë më të zgjuar e më të mençur dhe për të pasur më shumë ndikim mbi botën sesa çdo brez i mëparshëm!”³² Në një rast tjetër, Presidenti Nelson u tha të rinjve e të rejave: “Unë kam besim të plotë te ju”. Unë ju dua dhe po kështu edhe Zoti. Ne jemi populli i Tij, të përfshirë së bashku në punën e Tij të shenjtë.”³³ Të rinj e të reja, a mund ta ndieni mirëbesimin që Presidenti Nelson ka te ju dhe se sa të rëndësishëm jeni për këtë punë?

Prindër dhe udhëheqës në moshë madhore, unë ju ftoj ta shihni rininë sikurse Presidenti Nelson. Kur rinia e ndien dashurinë dhe mirëbesimin tuaj, kur ju i nxitni dhe i mësoni ata se si të udhëheqin – dhe mandej i lini të lirë të udhëheqin – ata do t’ju mahnitin me idetë, aftësitë dhe zotimin e tyre ndaj ungjillit.³⁴ Ata do të ndiejnë gëzimin e zgjedhjes për t’u përfshirë dhe për të sakrifikuar për kauzën e Krishtit. Ungjilli i Tij do të shkojë më thellë në zemrën e tyre dhe

puna do të përparojë në mënyra të mrekullueshme.

Premtim dhe Dëshmi

Unë premtoj se, ndërsa përqendrohemi në këto parime – marrëdhënie, zbulesë, liri e zgjedhjes, pendim dhe sakrifikim – ungjilli i Jezu Krishtit do të futet më thellë në zemrën tonë. Ne do ta shohim Rivendosjen të shkojë përpara te qëllimi i saj më i lartë, shëlbimi i Izraelit dhe vendosja e Sionit,³⁵ ku Krishti do të mbretërojë si Mbreti i mbretërve.

Unë dëshmoj se Perëndia vijon të bëjë gjithë gjërat e nevojshme për ta përgatitur popullin e Tij për atë ditë. E pafshim dorën e Tij në këtë punë të lavdishme ndërsa të gjithë përpiqemi të “vijmë te Krishti dhe përsos[emi] në të”³⁶. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 45:12.

Presidenti Nelson tha: “Vetëm mendoni për emocionin dhe ngutën në gjithë këtë: çdo profet, duke filluar nga Adami, e ka parë kohën tonë. Dhe çdo profet ka folur rreth kohës *sonë*, kur Izraeli do të mblidhet dhe bota do të përgatitet për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit. Mendoni për këtë! Nga të gjithë njerëzit që kanë jetuar ndonjëherë në planetin tokë, *ne* jemi ata që na u dha mundësia të marrim pjesë në këtë ngjarje të fundit, në këtë mbledhje të madhe. Sa emocionuese është kjo! (“Shpresa e Izraelit” [takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018], HopeofIsrael. ChurchofJesusChrist.org.

Plaku Xhefri R. Holland dha mesim: “Ç’kohë e mrekullueshme për të qenë gjallë. Ungjilli i Jezu Krishtit është e vërteta më bindëse, më e sigurt, më e besueshme dhe më shpërblyese në tokë e në qiell, në kohë dhe në përjetësi. Asgjë – asnjë gjë, asnjë

njeri, asnjë ndikim – nuk do ta pengojë këtë Kishë në përmbushjen e misionit të saj dhe në plotësimin e fatit të saj të përcaktuar që përpara krijimit të botës. . . . Nuk ka nevojë të ketë frikë ose druajtje për të ardhmen.

Ndryshe nga çdo epokë tjetër përpara nesh, kjo periudhë ungjillore nuk do të përjetojë braktisje prej Kishës si institucion; nuk do të shohë humbje të çelësave të priftërisë; nuk do të pësojë ndërprerje të zbulësës prej zërit të Perëndisë së Plotfuqishëm. . . . Çfarë kohe për të jetuar!

. . . Nëse nuk e keni vënë re, unë jam optimist për ditët e mëvonshme. . . . Besoni. Ngrihuni. Jini besnikë. Dhe bëni më të mirën që mundeni për kohën mbresëlënëse në të cilën jetojmë!” (Postim në Facebook, 27 maj 2015; shih edhe “Be Not Afraid, Only Believe” (bisedë me Mësuesit Fetarë të SAK-ut, 6 shkurt 2015), broadcasts.ChurchofJesusChrist.org).

2. Shih Gjoni 1:12.

3. Pak kohë pasi ishim thirrur si Presidencë e Përgjithshme e Të Rinjve, Presidenti Henri B. Ajring diskutoi me ne sfidat dhe mundësitë unike me të cilat përballet rinia e Kishës sot. Ai na këshilloi të përqendrohemi në ato gjëra të cilat do të ndihmonin që ungjilli i Jezu Krishtit të futet thellë në zemrën e tyre. Ajo këshillë ka qenë një fener për ne si Presidencë e Të Rinjve.

4. Shih “Be with Them”, ChurchofJesusChrist.org/callings/aaronic-priesthood-quorums/my-calling/leader-instruction/be-with-them.

5. Shih Mosia 18:25; Moroni 6:5.

6. Dejl G. Renland, “Nëpërmjet Syve të Perëndisë”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 94; shih edhe Moisiu 1:4–6.

Presidenti Tomas S. Monson dha mesim: “Ne kemi përgjegjësinë për t’i parë individët jo siç janë, por përkundrazi, ashtu si mund të bëhen. Do t’ju lutesha që të mendoni për ta në këtë mënyrë” (“Shihini të Tjerët ashtu siç Mund të Bëhen”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 70).

Plaku Nil A. Maksuell dha mesim: “Më shpesh nga sa mendojmë, sjellja e dukshme e një personi të ri *jo sipas* standardeve të Kishës, ose pyetjet e tij kundërvënëse në dukje, ose dyshimet e tij të shprehura e bëjnë të etiketohet me të shpejtë. Përfundimet mund të jenë largim dhe, ndonjëherë, shpëputje prej tij. Dashurisë së vërtetë nuk i pëlqejnë etiketimet!” (“Unto the Rising Generation”, *Ensign*, prill 1985, f. 9).

7. Shih 2 Mbretërve 6:17.

8. Stephen L. Richards, si anëtar i Presidencës së Parë, tha: “Lloji më i lartë i dallimit është ai që i percepton të tjerët dhe zbulon për ta tiparet e tyre më të mira, të mirën që kanë brenda tyre” (te Conference Report,



Blafdeil, Jutë, SHBA



- prill 1950, f. 162; te David A. Bednar, "Quick to Observe", *Ensign*, dhjetor 2006, f. 35; *Liahona*, dhjetor 2006, f. 19). Shih edhe 2 Mbretërit 6:17.
9. Henry B. Eyring, "Teaching Is a Moral Act" (fjalim në Universitetin Brigham Jang, 27 gusht 1991), f. 3, speeches.byu.edu; theksimi i shtuar; shih edhe Henry B. Eyring, "Ndhimjoni të Vënë Qëllime të Larta", *Liahona*, nëntor 2012, f. 60–67.
 10. Shih Moisiu 1:3–6.
 11. Mosia 18:21; shih edhe Moisiu 7:18.
 12. "Të rinjtë që kanë marrëdhënie të forta, pozitive me një familje aktive [shenjtore] të ditëve të mëvonshme, shokë dhe udhëheqës, që i ndihmojnë të zhvillojnë marrëdhënie me Atin e tyre Qiellor, kanë më shumë gjasa të mbeten aktive. Elemente të veçanta të programit – të tilla si programi mësimor i së dielës, programi i veprimtarive [të Të Rinjve], pritshmëritë vetjake të arritjeve . . . mund të kenë pak ndikim të pavarura nga ato marrëdhënie. . . . Pyetja e rëndësishme nuk është sa elemente tërësisht të veçanta të programit janë vënë në zbatim, por si ndihmojnë ato për [të ndërtuar] marrëdhënie pozitive që e forcojnë identitetin fetar [shenjtore] të ditëve të mëvonshme" të të rinjve ("Be with Them", *ChurchofJesusChrist.org/callings/aaronic-priesthood-quorums/my-calling/leader-instruction/be-with-them*).
 13. Shih "Connect Them with Heaven", *ChurchofJesusChrist.org/callings/aaronic-priesthood-quorums/my-calling/leader-instruction/connect-them-with-heaven*.
 14. Shih Gjoni 15:1–5; Gjoni 17:11; Filipianëve 4:13; 1 Gjon 2:6; Jakobi [LiM] 1:7; Omni 1:26; Moroni 10:32.
 15. Shkrimet e shenja janë plot me shembuj për këtë; këtu janë vetëm dy: 1 Nefi 2:16; Enosi 1:1–4.
 16. Shih Lluca 24:32; 2 Nefi 33:1–2; Jakobi [LiM] 3:2; Moroni 8:26; Doktrina e Besëlidhje 8:2–3.
 17. Shih 2 Timoteut 3:15–16; Doktrina e Besëlidhje 68:3–4; 88:66; 113:10.
 18. Shih 1 Thesalonikasve 1:5; Alma 26:13; 31:5; Helamani 3:29; 5:17; Doktrina e Besëlidhje 21:4–6; 42:61; 43:8–10; 50:17–22; 68:4.
 19. Shih Gjoni 6:63; 17:17; Alma 5:7; Doktrina e Besëlidhje 84:43–45; 88:66; 93:36.
 20. Shih Gjoni 15:3; 1 Pjetër 1:23; Mosia 1:5; Alma 5:7, 11–13; 32:28, 41–42; 36:26; 62:45; Helamani 14:13.
 21. Shih 2 Nefi 31:19–21; 32:3, 5.
 22. Rasëll M. Nelson, "Ne Mund të Bëjmë më Mirë dhe të Jemi më të Mirë", *Liahona*, maj 2019, f. 67.
 23. Dejl G. Renland, "Zgjidhni Sot", *Liahona*, nëntor 2018, f. 104.
 24. Kjo shifër përfshin kërkesa të programeve të skautizmit, që deri së fundi ishin pjesë e programit të aktiviteteve të Kishës për djem dhe të rinj, kryesisht në Shtetet e Bashkuara dhe Kanada. Në zona që nuk marrin pjesë në skautizëm, numri i kërkesave ishte mbi 200. Përveç kësaj, programet e ndryshme të veprimtarive për djem, vajza, të rinj dhe të reja ishin ndërtuar ndryshe, duke e bërë tërë përvojën më të ndërlikuar për familjet.
 25. Shih "Let Them Lead", ChurchofJesusChrist.org/callings/aaronic-priesthood-quorums/my-calling/leader-instruction/let-them-lead.
 26. Shih Omni 1:26; 3 Nefi 9:20; 12:19; Doktrina e Besëlidhje 64:34. "Një fe që nuk kërkon sakrificën e të gjitha gjërave, nuk ka kurrë fuqi të mjaftueshme për të prodhuar besimin e mjaftueshëm për jetën e për shpëtimin" (*Lectures on Faith* [1985], f. 69).
 27. Ezra Taft Benson, *Mësimet e Ezra Taft Benson* (1988), f.167; te *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2019), f. 13; shih edhe Rasëll M. Nelson, "Shpresa e Izraelit", *HopeofIsrael.ChurchofJesusChrist.org*.
 28. Takim me Plakun Dejvid A. Bednar; shih edhe "2020 Temple and Family History Leadership Instruction", 27 shkurt 2020, ChurchofJesusChrist.org/family-history.
 29. Neal A. Maxwell, "Unto the Rising Generation", *Ensign*, f. 11. Plaku Maksuell vijoi: "Nga pikëpamja e funksionit që kryejnë, sa presidenca të kuorumeve të dhjakëve dhe mësuesve anë që thjesht ta ftojë dikë për të dhënë një lutje apo për ta shpërndarë sakramentit? Vëllezër, këta vërtet janë shpirta të veçantë dhe ata mund të bëjnë gjëra me rëndësi po t'u jepet mundësia!"
 30. Shih *General Handbook: Serving in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints*, 2.2, ChurchofJesusChrist.org.
 31. Disa burime janë në dispozicion në Gospel Library [Bibliotekën e Ungjillit] për ta ndihmuar rininë të udhëheqë, përfshirë "Quorum and Class Presidency Resources", "Përdorimi i Materialit *Eja, Më Ndiq – Për Kuoromet e Priftërisë Aaronë dhe Klasat e Të Rejave*", dhe në burimet për klasat – ndoshta, mund të them, përfundimtare. Ata shpirta fisnikë – ata lojtarë më të mirë, ata heronj – jeni ju!"
 32. Rasëll M. Nelson, "Shpresa e Izraelit", HopeofIsrael.ChurchofJesusChrist.org. Gjatë së njëjtës mbremje shpirtërore, Presidenti Nelson tha: "Ati ynë Qiellor ka ruajtur shumë nga shpirtat e Tij më fisnikë – ndoshta, mund të them, skuadrën e Tij më të mirë – për këtë fazë përfundimtare. Ata shpirta fisnikë – ata lojtarë më të mirë, ata heronj – jeni ju!"
 33. Rasëll M. Nelson, fjalë të hapjes në "Fëmijët dhe Rinia: Ngjarje Ballë për Ballë me Plakun Gerit W. Gong", 17 nëntor 2019, broadcasts.ChurchofJesusChrist.org.
 34. Presidenti Nelson tha: "Ne kemi nevojë t'i lemë të rinjtë dhe të rejtat të udhëheqin, veçanërisht ata që janë thirrur dhe veçuar për të shërbyer në presidenat e klasave dhe të kuorumeve. Autoriteti i priftërisë do t'u jetë deleguar atyre. Ata do të mësojnë se si të marrin frymëzim për të udhëhequr klasat ose kuoromet e tyre" (te "Paraqitja e Materialit Filmik Hyrës për nismën Fëmijët dhe Rinia", 29 shtator 2019, ChurchofJesusChrist.org).
Plaku Kuentin L. Kuk tha: "Rinisë sonë po i kërkohej të ndërmarrë më shumë përgjegjësi individuale në mosha më të vogla – pa prindërit dhe udhëheqësit duke marrë përsipër atë që të rinjtë e të rejtat mund ta bëjnë vetë" ("Përshtatje për të Forcuar Rininë", *Liahona*, nëntor 2019, f. 41).
 35. Presidenti Xhorxh Q. Kenon, dha mësim: "Perëndia ka ruajtur për këtë periudhë ungjillore shpirta që kanë kurajën dhe vendosmërinë për t'i bërë ballë botës dhe gjithë fuqive të të ligut, të dukshme e të padukshme, për të shpallur ungjillin e ruajtur të vërtetën dhe për të vendosur e ndërtuar Sionin e Perëndisë tonë, shpirta të patrembur nga të gjitha pasojat. Ai i ka dërguar këta shpirta në këtë brez për të ngritur themelin e Sionit që të mos përmbysen më kurrë, dhe për të rritur një farë që do të jetë e drejtë dhe që do ta nderojë Perëndinë, dhe do ta nderojë Atë plotësisht, dhe do të jetë e bindur ndaj Tij në të gjitha rrethanat" ("Remarks", *Deseret News*, 31 maj 1866, f. 203); shih edhe *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 217.
 36. Moroni 10:32.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Lutje me Besim

Ndërsa lutemi me besim, ne bëhemi një pjesë jetike në punën e Zotit ndërsa Ai e përgatit botën për Ardhjen e Tij të Dytë.

Lutja e Plakut Meinis në fillim të këtij sesioni të konferencës së përgjithshme po merr përgjigje. Frymëzimi na ka ardhur nëpërmjet mesazheve të mrekullueshme dhe muzikës së bukur. Premtimi i Presidentit Rasëll M. Nelson se kjo konferencë do të jetë e paharrueshme, tashmë ka filluar të përmbushet.

Presidenti Nelson e ka përcaktuar këtë vit si “një periudhë dyqindvjeçare për përkujtimin e 200 vjetëve që nga koha kur Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij i Dashur, Jezu Krishti, iu shfaqën Jozef Smithit në një vegim”. Presidenti Nelson na ftoi që të bëjmë një plan vetjak për t’u përgatitur për këtë konferencë historike, përkujtimi i së cilës tha ai do të ishte “një pikë përcaktuese në historinë e Kishës dhe pjesa juaj është jetike”¹.

Ashtu si dhe unë, ndoshta ju e dëgjuat këtë mesazh dhe e pyetët veten: “Në ç’mënyrë është jetike pjesa ime?” Ndoshta ju lexuat dhe u lutët rreth ngjarjeve të Rivendosjes. Ndoshta, më shumë se kurrë më parë, ju i lexuat rrëfimet e atyre pak rasteve kur Perëndia, Ati, paraqiti Birin e Tij të Dashur. Ndoshta ju lexuat për rastet kur Shpëtimtari u foli fëmijëve të Atit tonë Qiellor. E di se unë vetë i bëra të gjitha ato gjëra, madje dhe më shumë.

Gjeta referenca në leximin tim rreth priftërisë së Perëndisë dhe hapjes së periudhave ungjillore. U përula kur kuptova se përgatitja ime për këtë konferencë ishte një pikë përcaktuese në historinë time vetjake. Ndjeva ndryshime në zemrën time. Ndjeva mirënjohje sërish. U ndjeva i mbushur me gëzim nga perspektiva se isha i ftuar të merrja pjesë në këtë kremtim të Rivendosjes së vazhdueshme.


I përfytyroj të tjerët që po ndihen, për shkak të përgatitjes së kujdeshme, më të gëzuar, më optimistë dhe më të vendosur për të shërbyer në çfarëdo pozicioni që i nevojitet Zotit.

Ngjarjet e jashtëzakonshme që ndërojmë ishin fillimi i periudhës së fundit ungjillore të profetizuar, në të cilën Zoti po i përgatit Kishën e Tij dhe popullin e Tij, ata që e mbajnë emrin e Tij, për ta pranuar Atë. Si pjesë e përgatitjes sonë për ardhjen e Tij, Ai do ta lartësojë secilin prej nesh, që të mund të ngrihemi në nivelin e sfidave dhe mundësive shpirtërore siç nuk është parë asnjëherë në historinë e kësaj bote.

Në shtator 1840, Profeti Jozef Smith dhe këshilltarët e tij në Presidencën e Parë deklaruan sa vijon: “Puna e Zotit në këto ditë e fundit është e një madhësie të gjerë dhe thuajse përtej kuptueshmërisë së të vdekshmëve.

Lavditë e saj janë përtej përshkrimit dhe madhështia e saj e pakapërcyeshme. Është motivi që ka gjallëruar kraharorin e profetëve dhe njerëzve të drejtë që nga krijimi i botës përmes çdo brezi pasues deri në kohën e tanishme; dhe është vërtet periudha e plotësisë së kohëve, kur të gjitha gjërat që janë në Krishtin Jezus, qoftë në qiell apo në tokë, do të mblidhen së bashku tek Ai dhe kur të gjitha gjërat do të rivendosen, siç është folur nga gjithë profetët e shenjtë që nga fillimi i botës; sepse në të do të ndodhë përmbushja e lavdishme e premtimeve të bëra etërve, ndërsa shfaqjet e fuqisë së Më Të Lartit do të jenë të shkëlqyera, të lavdishme dhe sublime.”

Ata vazhduan duke thënë: “Ne ndihemi të prirur të ecim përpara e të bashkojmë energjitë tona për ndërtimin e Mbretërisë dhe vendosjen e Priftërisë në plotësinë dhe lavdinë e tyre. Puna që duhet të përmbushet në ditët



Miksko, Guatemalë



e fundit është e një rëndësie të madhe dhe do të thërrasë në veprim energjinë, aftësinë, talentin dhe zotësinë e shenjtoreve, që të mund të shpalojë me atë lavdi e madhësi të përshkruar nga profeti [Daniel] [shih Daniel 2:34–35, 44–45]; dhe si rrjedhim do të kërkojë përqendrimin e shenjtoreve, për të përmbushur punë të një madhësie dhe madhështie të tillë.²

Shumë prej hollësive të gjërave që do të bëjmë dhe kohës kur do t'i bëjmë në Rivendosjen që po shpalojë, nuk janë zbuluar ende. Sidoqoftë, Presidenti e Parë edhe në ato ditë të hershme dinte diçka për gjerësinë dhe thellësinë e punës që Zoti ka vendosur përpara nesh. Këtu janë disa shembuj të gjërave që ne e dimë se do të ndodhin:

Nëpërmjet shenjtoreve të Tij, Zoti do t'ia ofrojë dhuratën e ungjillit të Tij “çdo kombi, fisi, gjuhe dhe populli”³. Teknologjia dhe mrekullitë do të vazhdojnë të luajnë një rol – ashtu si edhe “peshkatarët [individualë të] njerëz[ve]”⁴, të cilët japin shërbesë me fuqi e besim të shtuar.

Ne si popull do të bëhemi më të bashkuar mes konfliktit që po shtohet. Ne do të mblidhemi me forcën shpirtërore të grupeve dhe familjeve të mbushura me dritën e ungjillit.

Edhe një botë mosbesuese do ta pranojë Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme dhe do ta kuptojë fuqinë e Perëndisë mbi të. Dishepuj besnikë dhe të guximshëm do të marrin mbi vete pa frikë, me përlulësi dhe hapur emrin e Krishtit në jetën e tyre të përditshme.

Atëherë, si mund të marrë pjesë secili prej nesh në këtë punë të një madhësie dhe madhështie të tillë? Presidenti Nelson na ka mësuar se si të rritemi në fuqi shpirtërore. Kur e konsiderojmë pendimin si një mundësi të gëzueshme për shkak të besimit tonë që po rritet se Jezusi është Krishti, kur e kuptojmë dhe besojmë se Ati Qiellor e dëgjon çdo lutje tonën, kur përpiqemi fort t'u bindemi urdhërimeve dhe t'i jetojmë ato, ne rritemi në fuqinë tonë për të marrë zbuluesë të vazhdueshme. Fryma e Shenjtë mund të jetë shoqëruesi ynë i përhershëm. Një ndjesi drite do të qëndrojë me ne madje edhe kur bota përreth nesh bëhet më e errët.

Jozef Smithi është shembull i mënyrës se si të rritemi në një fuqi të tillë shpirtërore. Ai na tregoi se lutja me besim është kyç për zbuluesë nga Perëndia. Ai u lut me besim, duke besuar se Perëndia, Ati, do t'i përgjigjej

lutjes së tij. Ai u lut me besim, duke besuar se vetëm nëpërmjet Jezu Krishtit ai mund të lirohej nga faji që ndiente për mëkatet e veta. Dhe ai u lut me besim, duke besuar se kishte nevojë të gjente Kishën e vërtetë të Jezu Krishtit për ta marrë atë falje.

Gjatë gjithë shërbesës së tij profetike, Jozef Smithi përdori lutjet me besim për të marrë zbuluesë të vazhdueshme. Ndërsa përballemi me sfidat e sotme dhe ato që nuk kanë ardhur ende, edhe neve do të na duhet të ushtrojmë të njëjtin model. Presidenti Brigam Jang tha: “Nuk di asnjë mënyrë tjetër për shenjtoret e ditëve të mëvonshme veçse që çdo frymëmarrje të jetë praktikisht një lutje, në mënyrë që Perëndia t'i udhëzojë dhe drejtojë njerëzit e tij”⁵.

Këto fjalë nga lutja e sakramentit duhet të përshkruajnë atëherë jetën tonë të përditshme: “Gjithmonë ta kujtojnë atë”. “Atë” i referohet Jezu Krishtit. Fjalët vijuese “e të zbatojnë urdhërimet [e tij]”, sugjerojnë se çfarë do të thotë ta kujtojmë Atë.⁶ Ndërsa e kujtojmë gjithmonë Jezu Krishtin, ne mund të pyetim në lutje të heshtur: “Çfarë do Ai që unë të bëj?”

Një lutje e tillë, e bërë me besim të Jezu Krishti, e hapi këtë periudhë të fundit ungjillore. Dhe ajo do të jetë në thelb të pjesës që secili prej nesh do të luajë në shpalojen e saj të vazhdueshme. Kam zbuluar, sikurse ju, shembuj të mrekullueshëm të një lutjeje të tillë.

Së pari, Jozef Smithi. Ai pyeti me një besim si të një fëmije se çfarë donte Zoti që të bënte ai. Përgjigjja që mori e ndryshoi historinë e botës.

Për mua, një mësim i rëndësishëm vjen nga reagimi i Jozefit ndaj sulmit të Satanit ndërkohë që Jozefi u gjuhëzua të lutej.

E di nga përvoja se Satani dhe shërbëtorët e tij përpiqen të na bëjnë

të ndiejmë sikur nuk duhet të lutemi. Kur Jozef Smithi përdori gjithë fuqinë e tij për t'i bërë thirrje Perëndisë që ta çlironte nga fuqia që u përpoq ta lidhte atë, lutja e tij për lehtësim mori përgjigje dhe Ati Qiellor e Jezu Krishti iu shfaqën.

Përpjekja e Satanit për të penguar fillimin e Rivendosjes ishte shumë e ashpër sepse lutja e Jozefit ishte shumë e rëndësishme. Ju dhe unë do të kemi pjesë më të vogla për të luajtur në Rivendosjen e vazhdueshme. Pra-pëseparapë, armiku i Rivendosjes do të përpiqet të na ndalojë që të lutemi. Shembulli i besimit të Jozefit dhe vendosmëria e tij mund të na forcojnë në vendimin tonë. Kjo është një nga arsyet e shumta përse lutjet e mia përfshijnë falënderime ndaj Atit Qiellor për Profetin Jozef.

Enosi në Librin e Mormonit është një model tjetër për lutjen time të besimit ndërsa përpiqem të bëj pjesën time në Rivendosjen e vazhdueshme. Cilado që do të jetë pjesa juaj, ju mund ta konsideroni atë si këshilltar vetjak.

Ashtu si Jozefi, Enosi u lut me besim. Ai e përshkroi përvojën e tij në këtë mënyrë:

“Dhe shpirti im ishte i uritur; dhe unë u gjuhëzoza para Krijuesit tim dhe iu përgjërrova atij në lutje të fuqishme dhe kërkesë të sinqertë për shpirtin tim; dhe gjithë ditën unë iu përgjërrova atij; po, dhe kur ra nata, unë e ngrita akoma zërin tim lart, saqë ai arriti qiejt.

Dhe erdhi një zë tek unë duke thënë: Enos, mëkatet e tua të janë falur dhe ti do të jesh i bekuar.

Dhe unë, Enosi, e dija se Perëndia nuk mund të gënjente, prandaj fajësia ime u fshi.

Dhe unë thashë: Zot, si u bë ajo?

Dhe ai më tha: Për shkak të besimit tënd në Krishtin, të cilin ti kurrë më parë as e ke dëgjuar, as e ke parë.

Dhe shumë vjet kalojnë para se ai të shfaqë veten e tij në mish; prandaj shko, besimi yt të ka bërë ty të shëruar.⁷

Mësimi që më ka bekuar gjendet në këto fjalë: “Për shkak të besimit tënd në Krishtin, të cilin ti kurrë më parë as e ke dëgjuar, as e ke parë”.

Jozefi kishte besim te Krishti aq sa të shkonte në korije dhe gjithashtu të lutej për çlirim nga fuqitë e Satanit. Ai nuk i kishte parë ende Atin dhe Birin, por u lut me besim me gjithë energjinë e zemrës së vet.

Përvoja e Enosit më ka mësuar të njëjtin mësim të çmuar. Kur lutem me besim, unë e kam Shpëtimtarin si avokatim tim para Atit dhe mund ta ndiej se lutjet e mia arrijnë qiellin. Vijnë përgjigje. Merren bekime. Ka paqe e gëzim edhe në kohë të vështira.

Më kujtohet kur, si anëtar i ri i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, u gjuhëzoza në lutje me Plakun Dejvid B. Heit. Ai ishte në moshën që jam unë tani, me sfida që tani i përjetoj vetë. Më kujtohet zëri i tij teksa lutej. Nuk i hapa sytë për të parë, por m'u duk sikur po buzëqeshte. Ai foli me Atin Qiellor me gëzim në zërin e tij.

Mund të dëgjoj në mendjen time lumturinë e tij kur tha: “Në emër të Jezu Krishtit”. M'u duk sikur Plaku Heit e ndjeu se Shpëtimtari po e miratonte në atë çast mesazhin për të cilin ishte lutur Atit. Dhe isha i sigurt se do të pranohej me një buzëqeshje.

Aftësia jonë për të dhënë ndihmesën tonë jetike

për Rivendosjen e mrekullueshme të vazhdueshme do të shtohet ndërsa rritemi në besimin tonë te Jezu Krishti si Shpëtimtari ynë dhe tek Ati ynë Qiellor si Ati ynë i dashur. Ndërsa lutemi me besim, ne bëhemi një pjesë jetike në punën e Zotit ndërsa Ai e përgatit botën për Ardhjen e Tij të Dytë. Lutem që të gjithë ne të mund të gjejmë gëzim për të bërë punën që Ai e fton secilin prej nesh të kryejë.

Dëshmoj se Jezu Krishti jeton. Kjo është Kisha dhe mbretëria e Tij në tokë. Jozef Smithi është profeti i Rivendosjes. Presidenti Rasëll M. Nelson është profeti i Zotit në tokë sot. Ai mban të gjithë çelësat e priftërisë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Rasëll M. Nelson, “Ftesa Ime e 2020-ës për Ju: Shpërndajeni Mesazhin e Rivendosjes së Ungjillit të Shpëtimtarit”, 1 janar 2020, blog.ChurchofJesusChrist.org.
2. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 546–547.
3. Mosia 15:28.
4. Mateu 4:19.
5. *Discourses of Brigham Young*, përzgjedhur nga John A. Widtsoe (1954), f. 43–44.
6. Doktrina e Besëlidhje 20:77.
7. Enosi 1:4–8



Sendi, Jutë, SHBA



Paraqitur nga Presidenti Dallin H. Ouks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Autoriteteve të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetëve Zonalë dhe Drejtuesve të Përgjithshëm

Vëllezër dhe motra, unë tani do t'ju paraqit Autoritetet e Përgjithshme, Të Shtatëdhjetët Zonalë dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës për votën tuaj mbështetëse.

Ju lutemi ta shprehni votën tuaj në mënyrën e zakonshme kudo ku mund të jeni. Nëse ka persona që e kundërshtojnë ndonjë prej propozimeve siç parashtrohet, ju kërkohet të viheni në kontakt me presidentin tuaj të kishës.

Propozohet që ne të mbështetim Rasëll Marion Nelsonin, si profet, shikues e zbulues dhe si President të Kishës

së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Dallin Harris Ouksin, si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Henri Benion Ajringun, si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, mund ta shfaqin atë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta shfaqin atë.

Propozohet që ne të mbështetim Dallin H. Ouksin si President të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe M. Rasëll Ballardin si President Veprues të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë.

Ndonjë kundër mund ta shfaqë.

Propozohet që ne të mbështetim sa vijojnë si anëtarë të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve: M. Rasëll Ballard, Xhefri R. Holland, Diter F. Uhtdorf, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen, Ronald A.

Rasband, Geri E. Stivenson, Dejll G. Renland, Gerit W. Gong dhe Ulises Soares.

Atyre që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ndonjë kundër mund ta bëjë të ditur po ashtu.

Propozohet që ne t'i mbështetim këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Kundër, në qoftë se ka ndonjë, me të njëjtën shenjë.

Propozohet që t'i lirojmë nga thirrja Të Shtatëdhjetët Zonalë vijues: Pleqtë Horhe T. Besera, Mark S. Brajs, Xheremi R. Jagi, Kelli R. Xhonson, Adejinka A. Oxhediran dhe Moses Vijanueva.

Atyre që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësimin për shërbimin e tyre të shkëlqyer, u lutemi ta shfaqin.

Propozohet që ta lirojmë nga thirrja me mirënjohje të përzemërt Presidencën e Përgjithshme të Të Rinjve me përbërjen si vijon: Stiven W. Ouen si President, Daglas D. Holms si Këshilltar i Parë dhe M. Xhozef Brof si Këshilltar i Dytë.

Të gjithë atyre që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësimin këtyre vëllezërve për shërbimin e tyre të shquar, u lutemi ta shfaqin.

Propozohet që t'i mbështetim personat që vijojnë si Autoritete të Përgjithshme Të Shtatëdhjetë: Horhe T. Besera, Methju S. Holland, Uilliam K. Xhekson, Xheremi R. Jagi, Kelli R. Xhonson, Tieri K. Mutombo, Adejinka A. Oxhediran, Siro Shmail dhe Moses Vijanueva.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata që janë kundër,



Kuritiba, Parana, Brazil

me të njëjtën shenjë.

Propozohet që ne të mbështetim sa vijojnë si Të Shtatëdhjetë Zonalë: Xhei D. Andersen, Faapito Auapaau, Frederik K. Bali i Riu, Kevin W. Bëç, Xhon W. Bosuell III, J. Francisko Byrer, Suhat Çaiçana, Methju R. Klark, L. Guido Kristobal, Edmark R. Dumas, Karlos A. Gabaldon, M. Endrju Galt IV, Klark G. Gilbert, Leonard D. Grir, Vladislav Y. Gornostaev, D. Martin Guri, Riçard I. Hiton, Brok C. Hajët, Dejvid H. Hantsman, Norman C. Insong, Daniel Kabason, Federiko M. Kenlain, Xhefri J. Kerr, Jungiun Kuon, David G. LaFranse, Rikardo C. Leij, Marselo Luza, Hose G. Manarin, Xheremia J. Morgan, Mark A. Mortensen, Eduardo F. Ortega, Neithën D. Pejs, Majkëll M. Paker, Omar I. Palasios, Horhe W. Perez, Kirilo Pokilko, Serhio A. Ponsio, Arthur Raskon, Migel A. Reinoso, Gustavo G. Rezenxh, Robert G. Rivarola, Tonga J. Sai, Lusiano Sankari, Rosendo Santos, Henri Savstrom, J. Methju Skot, Xhejms E. Slotter, Robert T. Smith, Rikardo A. Spenser, Kolin C. Staufur, Dejvid C. Stjuart, Xhared W. Stoun, Arlen M. Tumaliuan, Martin J. Turvei, Jan C. Vega, Pol B. Uipi, Çad R. Uilkinson dhe Dou R. Uilson.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që të mbështetim si Presidenca e re e Përgjithshme e Të Rinjve: Stiven J. Land si President, Ahmad Salem Korbit si Këshilltar të Parë dhe Bredli Rej Uilkoks si Këshilltar të Dytë.

Ata që janë dakord, mund ta shfaqin atë.

Ndonjë kundër, mund ta tregojë po ashtu.

Propozohet që ne t'i mbështetim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetë Zonalë dhe Drejtuesit e

Përgjithshëm me përbërjen e tyre të tanishme.

Të gjithëve që janë dakord, u lutemi ta shfaqin.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Sërisht, ne i ftojmë ata që mund të

kenë qenë kundër ndonjërit prej propozimeve, që të vihen në kontakt me presidentët e tyre të kunjeve.

Ju falënderojmë për besimin dhe lutjet tuaja të vazhdueshme në emrin e udhëheqësve të Kishës. ■

Raporti i Sektorit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2019

Paraqitur nga Kevin R. Xhergensen,
Drejtor Përgjegjës, Sektori i Kontrollit Financiar të Kishës

Drejtuar Presidencës së Parë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Të dashur Vëllezër: Drejtuar me anë të zbulësës, siç shënohet në seksionin 120 të Doktrinës e Besëlidhjeve, Këshilli mbi Planifikimin e Të Dhjetave – i përbërë nga Presidenca e Parë, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhe Peshkopata Kryesuese – e autorizon shpenzimin e fondeve të Kishës. Subjektet e Kishës i shpenzojnë fondet në përputhje me buxhetet, rregulloret dhe procedurat e miratuara.

Sektori i Kontrollit Financiar të Kishës, i cili përbëhet nga profesionistë me leje profesioni dhe është i pavarur nga të gjithë sektorët dhe subjektet e tjera të Kishës, ka përgjegjësinë të kryejë kontrolle financiare me qëllim që të japë siguri të arsyeshme lidhur me kontributet e marra, shpenzimet e bëra dhe mbrojtjen e pasurive të Kishës.

Bazuar te kontrollet financiare të kryera, Sektori i Kontrollit Financiar të Kishës është i mendimit se, në çdo hollësi të rëndësishme, kontributet e marra, shpenzimet e bëra dhe pasuritë e Kishës për vitin 2019, janë regjistruar dhe administruar në përputhje me buxhetet, rregulloret dhe praktikatat llogaritëse të miratuara të Kishës. Kisha i ndjek praktikatat që u jepen mësim anëtarëve të saj, të të jetuarit brenda një buxheti, të shmangies së borxhit dhe të kursimit për një rast nevojë.

Dorëzuar me respekt nga

Sektori i Kontrollit Financiar të Kishës

Kevin R. Xhergensen

Drejtor Përgjegjës ■



Nga Plaku Ulises Soares,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Dalja në Dritë e Librit të Mormonit

Faktet historike dhe dëshmitarët e veçantë të Librit të Mormonit dëshmojnë se dalja në dritë e tij ishte vërtet e mrekullueshme.

Në një rast, ndërsa u takua me pleqtë e Kishës, Profeti Jozef Smith deklaroi: “Hiqni Librin e Mormonit e zbulesat dhe ku është besimi ynë? Ne nuk kemi asgjë.”¹ Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, pas Vegimit të Parë, dalja e mrekullueshme në dritë e Librit të Mormonit është ngjarja e dytë themelore e Rivendosjes së shpалosur të ungjillit të Jezu Krishtit në këtë periudhë ungjillore. Libri i Mormonit dëshmon për dashurinë e Perëndisë për fëmijët e Tij, për flijimin shlyes,



Baunifull, Jutë, SHBA

vetëmohues dhe hyjnor të Zotit Jezu Krisht dhe për shërbesën e Tij kurorëzuese midis nefitëve, fill pas Ringjalljes së Tij². Ai dëshmon edhe se mbetja e shtëpisë së Izraelit duhet të bëhet një nëpërmjet veprës së Tij në ditët e mëvonshme dhe se ata nuk janë braktisur përgjithmonë³.

Ndërsa e studiojmë daljen në dritë të këtij libri të shenjtë me shkrime të shenjta në këto ditë të mëvonshme, ne arrijmë të kuptojmë se e gjithë sipërmarrja ishte e mrekullueshme – që nga marrja e fletëve të arta prej Profetit Jozef nga një engjell i shenjtë deri te përkthimi i tij “nëpërmjet dhoratës dhe fuqisë së Perëndisë”⁴, ruajtja dhe botimi i tij nga dora e Zotit.

Dalja në dritë e Librit të Mormonit filloi kohë përpara se Jozef Smithi t’i merrte fletët e arta nga duart e engjellit Moroni. Profetët e lashtësisë profetizuan rreth ardhjes së këtij libri të shenjtë në kohën tonë⁵. Isaia foli për një libër të vulosur që, kur të shfaqej, njerëzit do të ishin duke u grindur për fjalën e Perëndisë. Kjo rrethanë do të mundësonte kushtet ku Perëndia mund ta kryente “mrekulli[në] dhe çudi[në]” e Tij, duke shkaktuar që “dituria e

njerëzve të tij të urtë . . . të shuhel[j] dhe zgjuarësia e të mënçurve të tij . . . të zhdukel[j]” ndërkohë që të përlurrit do të “gëzo[nin] akoma te Zoti dhe të varfërit e njerëzimit . . . të ngazël[eheshin] tek i Shenjti i Izraelit”⁶. Ezekieli foli rreth drurit të Judës (Bibla) dhe drurit të Efraimit (Libri i Mormonit) që do të bashkoheshin në një. Edhe Ezekieli (në Dhiatën e Vjetër), edhe Lehi (në Librin e Mormonit) tregojnë se ato do të “rriten së bashku” për të ngatërruar doktrinat e rreme, për të vendosur paqe dhe për të na sjellë në njohurinë e besëlidhjeve⁷.

Mbrëmjen e 21 shtatorit 1823, tre vjet e gjysmë pas përjetimit të Vegimit të Parë; Jozefin e vizitoi tri herë engjëlli Moroni, profeti i fundit i nefitëve në Amerikën e lashtë, si rrjedhojë e lutjeve të tij të sinqerta. Gjatë takimeve të tyre që zgjatën gjithë natën, Moroni i tha Jozefit se Perëndia kishte një vepër të mrekullueshme që ai duhej ta përmbushte – [t’i sillte] botës përkthimin dhe botimin e fjalëve të frymëzuarara të profetëve të lashtë të kontinentit amerikan⁸. Të nesërmen, Jozefi shkoi te vendi, jo shumë larg shtëpisë së tij, ku ishin groposur fletët nga Moroni në fund të jetës së tij, shekuj më parë. Atje, Jozefi e pa sërish Moronin, i cili e udhëzoi që të përgatitej për t’i marrë fletët në të ardhmen.

Gjatë katër vjetëve që vijuan, më 22 shtator të çdo viti, Jozefi mori udhëzime shtesë nga Moroni në lidhje me njohurinë rreth mënyrës se si mbretëria e Zotit duhej të qeverisej në ditët e mëvonshme. Përgatitja e Jozefit përfshiu edhe vizita nga engjëjt të Perëndisë, duke shpалosur kështu madhësitinë dhe lavdinë e ngjarjeve që do të ndodhnin në këtë periudhë ungjillore⁹.

Martesa e tij me Ema Hejlin në vitin 1827 ishte pjesë e asaj përgatitjeje. Ajo luajti një rol të rëndësishëm në

ndihmën që i dha Profetit gjatë gjithë jetës dhe shërbesës së tij. Në fakt, në shtator 1827, Ema e shoqëroi Jozefin te kodra ku ishin fshehur fletët dhe ajo e priti ndërsa engjëlli Moroni ia dorëzoi analin Jozefit. Jozefi mori premtimin se fletët do të ruheshin nëse ai do ta derdhte gjithë mundin e tij për t'i mbajtur ato të sigurta derisa do të duhej të riktheheshin në duart e Moronit¹⁰.

Bashkëshoqëruesit e mi të dashur në ungjill, shumë zbulime të sotme nga kohët e lashta ndodhin gjatë një gërmimi arkeologjik apo qoftë rastësisht gjatë një projekti ndërtimi. Përkundrazi, Jozef Smithin e udhëhoqi një engjëll për te fletët. Vetë ai rezultat që një mrekulli.

Procesi i përkthimit të Librit të Mormonit ishte gjithashtu një mrekulli. Ky anal i shenjtë, i lashtë nuk u “përkthye” sipas mënyrës tradicionale që studiuesit i përkthejnë tekste e lashta duke mësuar një gjuhë të lashtë. Ne duhet ta shohim procesin më shumë si një “zbuluesë” me ndihmën e mjeteve fizike të siguruar nga Zoti, ndryshe nga një “përkthim” prej dikujt me dije gjuhësore. Jozef Smithi deklaroi se nëpërmjet fuqisë së Perëndisë ai e “përkthe[ui] Librin e Mormonit nga hieroglifet, njohja e të cilave kishte humbur në botë dhe në këtë ngjarje të mrekullueshme [ai] vepro[i] i vetëm, një i ri i pamësuar, që të lufto[nte] urtësinë e botës dhe paditurinë e grumbulluar prej tetëmbëdhjetë shekujsh, me një zbuluesë të re”¹¹. Ndiham e Zotit për përkthimin e fletëve – ose zbulesa, për ta thënë kështu – është gjithashtu një fakt kur merret parasysh koha mrekullisht e shkurtër që iu desh Jozef Smithit për t'i përkthyer ato¹².

Shkruesit e Jozefit dëshmuuan për fuqinë e Perëndisë që u manifestua ndërkohë që punonin për përkthimin



ILUSTRIMI NGA JOSHUA DENNIS

e Librit të Mormonit. Oliver Kaudëri njëherë tha: “Këto ishin ditë për të mos u harruar kurrë – të ulesh nën tingullin e një zëri të diktuar nga frymëzimi i qiellit, duke zgjuar mirënjohjen më të madhe të këtij kraharori! Ditë pas dite, unë vazhdova, i pandërprerë, të shkruaja nga goja e tij, ndërkohë që ai përkthente . . . ‘Libri[n] e Mormonit’.”¹³

Burimet historike zbulojnë se që nga çasti që Jozefi i mori fletët në vitin 1827, pati përpjekje për t’ia vjedhur ato. Ai vërejti se “përpjekjet më të pazakonta u përdorën për [t’ia] marrë [fletët]” dhe se “çdo lloj strategjie që mund të shpikej, u përdor për atë qëllim”¹⁴. Si përfundim, Jozefi dhe Ema u detyruan që të largoheshin nga Mançesteri në Nju-Jork, drejt Harmonisë në Pensilvani, për të gjetur një vend të sigurt që ta vazhdonin punën e përkthimit, larg turmave dhe individëve, të cilët donin t’ua vidhnin

fletët¹⁵. Siç shënon një historian: “Kështu mbaron faza e parë e vështirë e kujdestarisë së fletëve nga Jozefi. . . . Prapëseprapë anali u mbajt i sigurt dhe gjatë mundimit të tij për t’i ruajtur fletët, Jozefi pa dyshim kishte mësuar shumë rreth mënyrave të Perëndisë dhe njeriut, gjë që do t’i shërbente mirë atij për kohët që do të vinin.”¹⁶

Ndërsa e përkthente Librin e Mormonit, Jozefi mësoi se Zoti do të zgjidhte dëshmitarë për t’i parë fletët¹⁷. Kjo është pjesë e asaj që vendosi Vetë Zoti kur Ai tha: “Çdo fjalë të vërtetohet nga goja e dy ose tre dëshmitarëve”¹⁸. Oliver Kaudëri, Dejvid Uitmeri dhe Martin Herrisi, të cilët qenë disa nga shoqëruesit e parë të Jozefit në themelimin e veprës së mrekullueshme të Perëndisë në këtë periudhë ungjillore, ishin dëshmitarët e parë që u thirrën për t’i dhënë botës një dëshmi të veçantë për Librin e Mormonit. Ata dëshmuuan se një engjëll, i cili erdhi nga prania

e Zotit, u tregoi atyre analin e lashtë dhe se ata panë karakteret e gdhendura te fletët. Ata dëshmuan edhe se e dëgjuan zërin e Perëndisë nga qielli duke shpallur se anali i lashtë ishte përkthyer nëpërmjet dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë. Më pas ata u urdhëruan që t'i dëshmonin të gjithë botës për të.¹⁹

Zoti mrekullisht thirri edhe tetë dëshmitarë të tjerë që t'i shihnin personalisht fletët e arta dhe të ishin dëshmitarë të veçantë ndaj botës për vërtetësinë dhe hyjninë e Librit të Mormonit. Ata dëshmuan se i panë dhe i shqyrtuan me kujdes fletët dhe karakteret e gdhendura mbi to. Edhe mes fatkeqësive, përndjekjeve, të gjitha llojeve të vështirësive e madje ndonëse disa prej tyre më vonë u lëkundën në besim, këta njëmbëdhjetë dëshmitarë të zgjedhur të Librit të Mormonit nuk i mohuan kurrë dëshmitë e tyre se i kishin parë fletët. Jozef Smithi nuk qe më vetëm për sa i përket njohurisë rreth vizitave të Moronit dhe fletëve të arta.

Lusi Mek Smithi shënoi se i biri mbërriti në shtëpi i pushtuar nga gëzimi pasi iu ishin treguar fletët dëshmitarëve. Jozefi u shpjegoi prindërve: "Ndiej sikur u çlirova nga një barrë që ishte pothuajse tepër e rëndë për mua për t'u mbajtur; dhe kjo ma gëzon zemrën se nuk do të jem më krejt i vetëm në botë"²⁰.

Jozef Smithi u përball me shumë kundërshtim për shtypjen e Librit të Mormonit kur përfundoi përkthimi. Ai mundi ta bindte një tipograf që quhej Ekbert B. Grandin në Palmira, Nju-Jork, që ta shtypte librin, vetëm pasi Martin Herrisi, duke bërë një vepër besimi dhe sakrifice të madhe, la fermën e tij si garanci për kostot e shtypjes. Për shkak se herë pas here [kishte] kundërshtime të vazhdueshme pas botimit të Librit të Mormonit,

Martin Herrisi shiti besnikërisht 61 hektarë (0.6 km²) të fermës së tij për të paguar kostot e botimit. Nëpërmjet një zbuluese që iu dha Jozef Smithit, Zoti e udhëzoi Martin Herrisin që të mos e lakmonte pronën e tij dhe t'i paguante kostot e shtypjes për librin që "përmban të vërtetën dhe fjalën e Perëndisë"²¹. Në mars 1830, u botuan 5 000 kopjet e para të Librit të Mormonit dhe sot janë shtypur më shumë se 180 milionë kopje në mbi njëqind gjuhë.

Faktet historike dhe dëshmitarët e veçantë të Librit të Mormonit dëshmojnë se dalja në dritë e tij ishte vërtet e mrekullueshme. Sidoqoftë, fuqia e këtij libri nuk bazohet vetëm në historinë e tij madhështore por në mesazhin e tij të fuqishëm e të pashoq që ka ndryshuar jetë të panumërta – përfshirë dhe jetën time!

E lexova të gjithë Librin e Mormonit për herë të parë kur isha student seminari i ri në moshë. Siç ma këshilluan mësuesit, nisa ta lexoja duke e filluar nga faqet e parathënies. Premtimi që përmbahet në faqet e para të Librit të Mormonit, më kumbon ende në mendje: "Mendo[ni] në zemrat [tuaja] . . . dhe pastaj . . . kërko[jini] Perëndisë [me besim], . . . në emrin e Krishtit, në qoftë se libri është i vërtetë. Ata që do të ndjekin këtë udhë . . . do të marrin, me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë një dëshmi të vërtetësisë dhe të hyjnisë së tij."²²

Me atë premtim në mendje, duke kërkuar me zell për të ditur më shumë rreth vërtetësisë së tij dhe me një shpirt lutjeje, e studiova Librin e Mormonit, pak e nga pak, teksa i përfundova mësimet e përjavshme të seminarit që më ishin caktuar. E mbaj mend sikur të ishte dje, që një ndjenjë e ngrohtë gradualisht filloi të ma mbushte zemrën, duke e ndriçuar kuptueshmërinë time dhe duke u bërë

gjithnjë e më e kënaqshme, siç përshkruhet nga Alma gjatë predikimit të fjalës së Perëndisë ndaj popullit të tij²³. Ajo ndjenjë përfundimisht u kthye në njohuri që zuri rrënjë në zemrën time dhe u bë themeli i dëshmisë sime për ngjarjet dhe mësimet e mëdha që gjenden në këtë libër të shenjtë.

Nëpërmjet këtyre përvojave vetjake të vyera dhe të tjera si ato, Libri i Mormonit u bë vërtet guri kyç që e mban besimin tim në Jezu Krisht dhe dëshminë time për doktrinën e ungjillit të Tij. Ai u bë një nga shtyllat që më dëshmon për flijimin shlyes, hyjnor të Krishtit. Ai u bë një mburojë gjatë gjithë jetës sime ndaj sulmeve të vazhdueshme të kundërshtarit për ta dobësuar besimin tim dhe për të rrënjësuar mosbesim në mendjen time dhe më jep kurajë për t'ia shpallur me guxim botës dëshminë time për Shpëtimtarin.

Miqtë e mi të dashur, dëshmia ime për Librin e Mormonit erdhi rresht pas rreshti²⁴, si një mrekulli në zemrën time. Deri më sot, kjo dëshmi vazhdon të rritet ndërsa jam vazhdimisht në kërkim, me një zemër të sinqertë, për ta kuptuar më plotësisht fjalën e Perëndisë siç përmbahet në këtë libër të jashtëzakonshëm me shkrime të shenjta.

Të gjithëve ju që e dëgjoni zërin tim sot, ju ftoj që të jeni pjesë e daljes së mrekullueshme në dritë të Librit të Mormonit, në vetë jetën tuaj. Ju premtoj se teksa i studioni fjalët e tij plot lutje dhe në mënyrë të vazhdueshme, ju mund t'i merrni premtimet dhe bekimet e tij të shumëllojta, në jetën tuaj. Unë ju siguroj edhe njëherë për premtimin që jehon në faqet e tij, që në qoftë se e "pyesni Perëndinë, Atin e Amshuar, në emrin e Krishtit, në qoftë se këto gjëra nuk janë të vërteta; dhe në qoftë se ju do të kërkonte me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë duke pasur besim në Krisht",

Ai plot mëshirë “do t’ju tregojë të vërtetën, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë”²⁵. Unë mund t’ju siguroj se Ai do t’jua japë përgjigjen në një mënyrë shumë vetjake, siç ka bërë Ai për mua dhe shumë të tjerë në mbarë botën. Përvoja juaj do të jetë po aq e lavdishme dhe e shenjtë për ju sa ishin edhe përvojat e Jozef Smithit për vetë atë, si edhe për dëshmitarët e parë dhe për të gjithë njerëzit që kanë kërkuar të marrin një dëshmi për integritetin dhe besueshmërinë e këtij libri të shenjtë.

Unë jap dëshminë time se Libri i Mormonit është vërtet fjala e Perëndisë. Unë dëshmoj se ky anal i shenjtë “shpjego[n] doktrinat e ungjillit, thekso[n] në vija të përgjithshme plani[n] e shpëtimit dhe u trego[n] njerëzve se ç’duhet të bëjnë që të arrijnë paqe në këtë jetë dhe shpëtim të përjetshëm në jetën që do të vijë”²⁶. Unë dëshmoj se Libri i Mormonit është mjete i Perëndisë për realizimin e mbledhjes së Izraelit në kohën tonë dhe për t’i ndihmuar njerëzit që të arrijnë ta njohin Birin e Tij, Jezu Krishtin. Unë dëshmoj se Perëndia jeton dhe na do ne, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, është Shpëtimtari i botës, guri kryesor i qoshes i besimit tonë. I them këto gjëra në emrin e shenjtë të Shëlbuesit tonë, Mësuesit tonë dhe Zotit tonë, madje Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Joseph Smith, në “Minute Book 1”, f. 44, josephsmithpapers.org; [Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith, f. 205]; edhe në Bibliotekën e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti, përdorimi i gërmës së madhe i standardizuar.
2. Shih 3 Nefi 11–26.
3. Shih Ezekiel 37:21–28; 1 Nefi 13:34–41; 3 Nefi 20:46; 21:1–11; faqja e titullit e Librit të Mormonit.
4. Parathënia për Librin e Mormonit.
5. Shih Zbulesa 14:6–7; 1 Nefi 19:21.
6. Isaia 29:14, 19; shih edhe vargjet 11–13.
7. Shih Ezekiel 37:16–17; 2 Nefi 3:12.
8. Shih Joseph Smith – Historia 1:27–47; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 27:5; Joseph Smith, “History, 1838–1856, volume A-1 [23 December 1805–30 August 1834]”, f. 5, josephsmithpapers.org.
9. Shih Joseph Smith – Historia 1:54; shih edhe Joseph Smith, “Church History”, *Times and Seasons*, 1 mars 1842, f. 707, josephsmithpapers.org.
10. Shih Joseph Smith – Historia 1:59; *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 61–63.
11. Joseph Smith, “History, 1838–1856, volume E-1 [1 July 1843–30 April 1844]”, 1775, josephsmithpapers.org; [Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith, f. 63]; edhe në Bibliotekën e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti, përdorimi i shenjave të pikësimit i standardizuar. Shih edhe Joseph Smith, “Letter to James Arlington Bennet, 13 November 1843”, f. 1, josephsmithpapers.org; edhe në Bibliotekën e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti.
12. Shih John W. Welch, “Timing the Translation of the Book of Mormon: ‘Days [and Hours] Never to Be Forgotten’”, *BYU Studies*, vëll. 57, nr. 4 (2018), f. 11–50.
13. Oliver Cowdery, cituar në Joseph Smith – Historia 1:71, poshtëshënim; shih edhe *Latter Day Saints’ Messenger and Advocate*, tetor 1834, f. 14.
14. Joseph Smith – Historia 1:60.
15. Shih Joseph Smith – Historia 1:60–62.
16. Andrew H. Hedges, “‘All My Endeavors to Preserve Them’: Protecting the Plates in Palmyra, 22 September–December 1827”, *Journal of Book of Mormon Studies*, vëll. 8, nr. 2 (1999), f. 23.
17. Shih 2 Nefi 27:12–14; Ethëri 5:1–3.
18. Mateu 18:16.
19. Shih “Dëshmia e Tre Dëshmitarëve”, Libri i Mormonit.
20. Joseph Smith, në Lucy Smith, *Biographical Sketches of Joseph Smith, the Prophet, and His Progenitors for Many Generations* (1880); shih edhe “Lucy Mack Smith, History, 1845”, f. 154, josephsmithpapers.org.
21. Doktrina e Besëlidhje 19:26.
22. Parathënia për Librin e Mormonit; shih edhe Moroni 10:3–5.
23. Shih Alma 32:41–43.
24. Shih 2 Nefi 28:30.
25. Moroni 10:4.
26. Parathënia për Librin e Mormonit.



Olmue, Marga Marga, Kili



Nga Plaku Xhon A. Mek-Kjun,
i Të Shtatëdhjetëve

Ejani te Krishti – Jetesa si Shenjtorë të Ditëve të Mëvonshme

Ne mund të bëjmë gjëra të vështira dhe mund t'i ndihmojmë të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë, sepse e dimë se kujt mund t'i mirëbesojmë.

Faleminderit, Plaku Soares, për dëshminë tënde të fuqishme dhe profetike për Librin e Mormonit. Kohët e fundit, pata mundësinë e pashoqe që të mbaja në duar një faqe nga dorëshkrimi original i Librit të Mormonit. Në këtë faqe të veçantë, për herë të parë në këtë periudhë ungjillore, ishin shënuar këto fjalë të guximshme të Nefit: “Unë do të shkoj dhe do të bëj gjërat që Zoti ka urdhëruar, pasi e di se Zoti nuk u jep urdhërime fëmijëve të njerëzve pa përgatitur një udhë për ta, që ata të mund të plotësojnë gjënë, që ai i urdhëron”¹.

Teksa e mbaja faqen në duar, u mbusha me një vlerësim të thellë për përpjekjet e Jozef Smithit 23-vjeçar, i cili e përktheu Librin e Mormonit nëpërmjet “dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë”². Gjithashtu ndjeva vlerësim për fjalët e Nefit të ri në moshë, të cilin i qe kërkuar të kryente një detyrë shumë të vështirë siç qe marrja e fletëve prej tunxhi nga Labani.

Nefi e dinte që nëse vazhdonte të qëndronte i përqendruar te Zoti, ai do

të ishte i suksesshëm në përmbushjen e asaj që Zoti i urdhëroi. Ai qëndroi i përqendruar te Shpëtimtari gjatë gjithë jetës së vet ndonëse vuajti tundime, sprova fizike dhe madje tradhtinë nga disa pjesëtarë të familjes së tij të ngushtë.

Nefi e dinte se kujt mund t'i mirëbesonte.³ Pak pasi thirri: “O, ç'njeri i mjerë që jam! Po, zemra ime brengoset për shkak të mishit tim”⁴, Nefi shpalli:



Millkrik, Jutë, SHBA

“Perëndia im ka qenë mbështetja ime; ai më ka nxjerrë prej vuajtjeve të mia në vendin e shkretëtë; dhe ai më ka ruajtur mbi ujërat e thellësisë së madhe”⁵.

Si ndjekës të Krishtit, neve nuk na kursehen sfidat dhe sprovat në jetën tonë. Shpesh na kërkohet të bëjmë gjëra të vështira që, nëse orvatemi t'i bëjmë vetëm, do të ishin rraskapitëse dhe ndoshta të pamundura. Teksa e pranojmë ftesën e Shpëtimtarit “ejani tek unë”⁶, Ai do të sigurojë përkrahjen, ngushëllimin dhe paqen që janë të nevojshme, ashtu siç bëri për Nefin dhe Jozefin. Edhe në sprovat tona më të vështira, ne mund të ndiejmë përqafimin e ngrohtë të dashurisë së Tij teksa i mirëbesojmë Atij dhe e pranojmë vullnetin e Tij. Ne mund të përjetojmë gëzimin e ruajtur për dishepujt e Tij besnikë, sepse “Krishti është gëzim”⁷.

Në vitin 2014, ndërkohë që po shërbenim në një mision kohëplotë, familja jonë përjetoj një rrjedhë të paparashikuar ngjarjesh. Duke zbritur një kodër të thepisur mbi një dërrasë patinash me rrota, djali ynë më i vogël u rrëzua dhe pësoi një dëmtim në tru që i kërcënoi jetën. Teksa situata përkeqësohej, personeli mjekësor e futi me ngut në një operacion urgjent.

Familja jonë u gjunjësua në dyshemenë e një dhome bosh të spitalit dhe ia hapëm zemrat tona Perëndisë. Në mes të këtij çasti pështjellues e të dhembshëm, ne u mbushëm me dashurinë dhe paqen e Atit tonë Qiellor.

Nuk e dinim se çfarë do të sillte e ardhmja ose a do ta shihnim djalin tonë sërish të gjallë. E kishim shumë të qartë se jeta e tij ishte në duart e Perëndisë dhe rrjedhojat, nga një pikëpamje e përjetshme, do të ishin për të mirën e tij dhe për të mirën tonë. Nëpërmjet dhuratës së Shpirtit, ne ishim plotësisht të përgatitur për të pranuar çfarëdo rezultati.

Nuk ishte e lehtë! Ky aksident rezultoi në një shtrim dymujor në spital ndërkohë që ne po kryesojmë mbi 400 misionarë kohëplotë. Djali ynë përjetoi një humbje domethënëse të kujtesës. Shërimi i tij përfshiu sesione të gjata dhe të vështira të terapisë fizike, të të folurit dhe terapi të tjera aftësuese. Sfidat mbeten, por me kalimin e kohës ne kemi dëshmuar një mrekulli.

Ne e kuptojmë qartësisht se jo çdo sprovë me të cilën përballemi do të ketë një rezultat të dëshirueshëm. Sidoqoftë, kur qëndrojmë të përqendruar te Krishti, ne do të ndiejmë paqe dhe do të shohim mrekullitë e Perëndisë, cilatdo qofshin ato, në kohën e Tij dhe në mënyrën e Tij.

Do të ketë raste kur nuk do të jemi në gjendje të shohim asnjë mënyrë në të cilën situata e tanishme do të përfundojë mirë dhe madje mund të shprehemi ashtu si Nefi: “Zemra ime brengoset për shkak të mishit tim”⁸. Mund të ketë raste kur shpresa e vetme që kemi është te Jezu Krishti. Çfarë bekimi është ta kemi atë shpresë dhe mirëbesim tek Ai! Krishti është Ai që do t’i mbajë gjithmonë premtimet e Tij. Prehja e Tij është e sigurt për të gjithë ata që vijnë tek Ai.⁹

Udhëheqësit tanë dëshirojnë thellësisht që të gjithë ta ndiejnë paqen dhe ngushëllimin që vijnë nëpërmjet mirëbesimit të Shpëtimtari Jezu Krishtit dhe përqendrimit tek Ai.

Profeti ynë i gjallë, Presidenti Nelson ka qenë duke komunikuar vegimin e Zotit për botën dhe për anëtarët e Kishës së Krishtit: “Mesazhi ynë drejtuar botës është i thjeshtë dhe i sinqertë: ne i ftojme të gjithë fëmijët e Perëndisë në të dyja anët e velit të *vijnë te Shpëtimtari i tyre*, të marrin bekimet e tempullit të shenjtë, të kenë gëzim të përhershëm dhe të kualifikohen për jetën e përjetshme”¹⁰.



Kjo ftesë “ejani te Krishti” ka domethënie të veçanta për shenjtorët e ditëve të mëvonshme.¹¹ Si anëtarë të Kishës së Shpëtimtarit, ne kemi bërë besëlidhje me Të dhe jemi bërë bij dhe bija shpirtërore të lindura të Tij.¹² Neve na është dhënë gjithashtu mundësia të punojmë me Zotin për t’i ftuar të tjerët që të vijnë te Ai.

Kur punojmë me Krishtin, përpjekjet tona duhet të jenë të përqendruara më thellësisht brenda vetë shtëpive tona. Do të ketë raste kur pjesëtarë të familjes dhe miq të ngushtë do të përballen me sfida. Zërat e botës dhe ndoshta vetë dëshirat e tyre, mund t’i bëjnë ata që ta vënë në dyshim të vërtetën. Ne duhet të bëjmë gjithçka që mundemi për t’i ndihmuar ata që të ndiejnë si dashurinë e Shpëtimtarit, ashtu dhe dashurinë tonë. Më kujtohet një varg i shkrimit të shenjtë që është bërë himni ynë i dashur “Doni Njëri-Tjetrin”, i cili na mëson: “T’gjith’ do ta din’ se jeni dishepuj t’mi, prej dashurisë’ njëri për tjetrin”¹³.

Nga dashuria jonë për ata që po e vënë në dyshim të vërtetën, armiku i të gjithë gëzimit mund të përpiqet të na bëjë të ndiejmë se i tradhetojmë ata që duam nëse ne vetë vazhdojmë ta jetojmë plotësinë e ungjillit dhe t’i japim mësim të vërtetë e tij.

Aftësia jonë për t’i ndihmuar të tjerët që të vijnë te Krishti ose të kthehen te Krishti do të përcaktohet

kryesisht nga shembulli që japim nëpërmjet zotimit tonë vetjak për të qëndruar në shtegun e besëlidhjes.

Nëse dëshira jonë e vërtetë është që t’i shpëtojmë njerëzit që duam, ne vetë duhet të qëndrojmë të palëkundur me Krishtin duke e përqaftuar Kishën e Tij dhe plotësinë e ungjillit të Tij.

Duke u kthyer te historia e Nefit, ne e dimë se prirja e Nefit për t’i mirëbesuar Zotit u ndikua nga tendenca e prindërve të tij për t’i mirëbesuar Zotit dhe nga shembulli i tyre për mbajtjen e besëlidhjeve. Kjo ilustron shumë bukur në vegimin e Lehit të pemës së jetës. Pasi e hëngri frutën e ëmbël dhe të gëzueshëm të pemës, Lehi “hodh[i] sytë rreth e qark se ndoshta mund të zbulonte gjithashtu familjen [e tij]”¹⁴. Ai pa Sarian, Samin dhe Nefin duke qëndruar “sikur nuk dinin nga duhej të shkonin”¹⁵. Lehi më pas shpalli: “U bëra shenjë të afroreshin; dhe u thashë me një zë të lartë, se ata duhej të vinin tek unë dhe të hanin frutin që ishte më i dëshirueshëm mbi çdo frut tjetër”¹⁶. Ju lutem, vini re se Lehi nuk u largua nga pema e jetës. Ai qëndroi shpirtërisht me Zotin dhe e ftoi familjen e tij që të vinte aty ku ishte ai për të ngrënë frutën.

Kundërshtari do t’i joshë disa që të largohen nga gëzimi i ungjillit duke i ndarë mësimet e Krishtit nga Kisha e Tij. Kundërshtari do të donte që ne të besonim se mund të qëndrojmë vetë të palëkundur në shtegun e besëlidhjes, nëpërmjet vetë natyrës sonë shpirtërore, të pavarur nga Kisha e Krishtit.

Në këto ditë të mëvonshme, Kisha e Krishtit u rivendos me qëllim që t’i ndihmojë fëmijët besëlidhës të Krishtit që të qëndrojnë në shtegun e Tij të besëlidhjeve.

Te Doktrina e Besëlidhje ne lexojmë: “Vër re, kjo është doktrina ime – kushdo që pendohet dhe *vjen tek unë*, ai është kisha ime”¹⁷.



Nga Peshkopi Zherald Kosé,
Peshkopi Kryesues

Nëpërmjet Kishës së Krishtit, ne forcohem gjatë përvojave tona si një komunitet shenjtorësh. E dëgjojmë zërin e tij nëpërmjet profetëve, shikuesve dhe zbuluesve të Tij. Më e rëndësishmja, nëpërmjet Kishës së Tij neve na sigurohen të gjitha bekimet thelbësore të Shlyerjes së Krishtit, të cilat mund të përmbushen vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në ordinancat e shenjta.

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është Kisha e Krishtit në tokë, e rivendosur në këto ditë të mëvonshme për dobinë e të gjithë fëmijëve të Perëndisë.

Jap dëshmi që teksta vijmë te Krishti dhe jetojmë si shenjtore të ditëve të mëvonshme, ne do të bekohemi me një shkallë më të madhe të dashurisë së Tij, të gëzimit të Tij dhe të paqes së Tij. Ashtu si Nefi, ne mund të bëjmë gjëra të vështira dhe mund t'i ndihmojmë të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë, sepse e dimë se kujt mund t'i mirëbesojmë.¹⁸ Krishti është drita jonë, jeta jonë dhe shpëtimi ynë.¹⁹ Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. 1 Nefi 3:7.
2. Faqja e titullit të Librit të Mormonit; shih edhe parathënia e Librit të Mormonit.
3. Shih 2 Nefi 4:19.
4. 2 Nefi 4:17.
5. 2 Nefi 4:20.
6. Mateu 11:28.
7. Rasëll M. Nelson, "Gëzimi dhe Mbijetesa Shpirtërore", *Liahona*, nëntor 2016, f. 82.
8. 2 Nefi 4:17.
9. Shih Mateu 11:28–30.
10. Rasëll M. Nelson, "Punës Le t'i Vihemi", *Liahona*, maj 2018, f. 118–119; theksimi i shtuar.
11. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:59.
12. Shih Mosia 5:7.
13. Gjoni 13:35; shih edhe "Doni Njëri-Tjetrin", *Himne*, nr. 203.
14. 1 Nefi 8:13.
15. 1 Nefi 8:14.
16. 1 Nefi 8:15.
17. Doktrina e Besëlidhje 10:67; theksimi i shtuar.
18. Shih 2 Nefi 4:19.
19. Shih Psalmeve 27:1.

Një Dëshmitar i Gjallë i Krishtit të Gjallë

Mesazhi qendror i Librit të Mormonit është të rivendosë njohurinë e vërtetë mbi rolin thelbësor të Jezu Krishtit për shpëtimin dhe ekzaltimin e njerëzimit.

Në një ditë pranvere me diell në vitin 2017, shtëpia e hapur për Tempullin e Parisit në Francë kishte kohë që ishte në dispozicion kur njërit prej udhërrëfyesve të vizitorëve iu afrua një burrë me një pamje të trishtuar në fytyrë. Ai tha se banonte ngjitur me tempullin dhe e pranoi se kishte qenë një kundërshtues aktiv për ndërtimin e tij. Ai

tregoi se një ditë, ndërsa po kundronte nga dritarja e banesës së tij, pa një vinç të madh që po e ulte një statujë të Jezusit nga qielli dhe e vendosi atë ngadalë në territorin e tempullit. Burri deklaroi se kjo përvojë ia ndryshoi tërësisht ndjenjat kundrejt Kishës. Ai e kuptoi se ishim ndjekës të Jezu Krishtit dhe na kërkoi shumë ndjesë për dëmin që mund të kishte shkaktuar më parë.

Statuja *Christus*, e cila i jep hijeshi territoreve të Tempullit të Parisit dhe pronave të tjera të Kishës, dëshmon rreth dashurisë sonë për Shpëtimtarin. Statuja origjinale, e mermertë është vepra e artistit danez Bertel Thorvaldsen, i cili e gdhendi në vitin 1820 – në të njëjtin vit me Vegimin e Parë. Statuja mbetet në kontrast të plotë me shumicën e punimeve artistike të asaj periudhe, të cilat portretizojnë kryesisht Krishtin që po vuan në kryq. Vepra e Thorvaldsenit paraqet Krishtin e gjallë, i cili korri fitore mbi vdekjen dhe krahëhapur i fton të gjithë që të vijnë tek Ai. Vetëm gjurmët e gozhdëve në duart e këmbët e Tij dhe plaga në ijën e Tij dëshmojnë për agoninë e papërshtueshme që duroi Ai për të shpëtuar gjithë njerëzimin.



Sendi, Jutë, SHBA



Ndoshta një arsye pse neve si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme na pëlqen shumë kjo statujë, është se na kujton përshkrimin që jepet në Librin e Mormonit për shfaqjen e Shpëtimtarit në kontinentin amerikan:

“Dhe vini re, panë një Njeri duke zbritur nga qielli; dhe ishte veshur me një rrobë të bardhë; dhe zbriti poshtë dhe qëndroi mes tyre; . . .

Dhe ndodhi që ai e shtriu dorën e tij dhe i foli popullit, duke thënë:

Vini re, unë jam Jezu Krishti, . . .
. . . unë kam pirë nga ajo kupë e hidhur që Ati më dha dhe kam lartësuar Atin, duke marrë përsipër mëkatet e botës.”¹

Pastaj ai e ftoi secilin burrë, grua e fëmijë që të afrohej dhe të vinte duart në ijën e Tij, dhe të ndiente gjurmët e gozhdëve në duart dhe këmbët e Tij, duke marrë kështu një dëshmi vetjake se Ai ishte njëmend Mesia i shumëpritur².

Kjo ngjarje sublime është pika kulmore në Librin e Mormonit. I gjithë “lajmi i mirë” i ungjillit përmbahet

në këtë imazh të Shpëtimtarit, që i zgjat përzemërsisht “krahët e [Tij] mëshirës”³ për ta ftuar çdo individ që të vijë tek Ai dhe të marrë bekimet e Shlyerjes së Tij.

Mesazhi qendror i Librit të Mormonit është të rivendosë njohurinë e vërtetë mbi rolin thelbësor të Jezu Krishtit për shpëtimin dhe ekzaltimin e njerëzimit. Kjo temë pasqyrohet që nga parathënia e deri te fjalët e fundit të kapitullit të fundit. Gjatë shekujve të braktisjes dhe pështjellimit shpirtëror, kuptimi më i thellë mbi atë që Krishti bëri në Gjetseman dhe në Golgotë, humbi ose pësoi zvetënim. Sa i emocionuar duhet të jetë ndier Jozef Smithi kur, ndërkohë që po përktente librin 1 Nefi, zbuloi këtë premtim të mrekullueshëm: “Këto anale të fundit [Libri i Mormonit] . . . do të vendosin të vërtetën e të parit [Biblës] . . . dhe ato do të bëjnë të ditur gjërat e qarta dhe të çmueshme që janë hequr prej tyre; dhe do t’u bëjnë të njohur të gjitha racave, gjuhëve dhe njerëzve, se Qengji i Perëndisë është Biri i Atit të Amshuar dhe Shpëtimtari i botës; dhe se të gjithë njerëzit duhet

të vijnë tek ai ose ata nuk mund të shpëtohen”⁴.

Të vërteta të qarta dhe të çmueshme rreth Shlyerjes së Shpëtimtarit jehojnë gjatë gjithë Librit të Mormonit. Ndërsa i rendit disa nga këto të vërteta, unë ju ftoj që të reflektoni mbi mënyrën se si ato e kanë ndryshuar ose mund ta ndryshojnë jetën tuaj.

1. Shlyerja e Jezu Krishtit është një dhuratë që u jepet lirisht të *gjithë njerëzve* që kanë jetuar, që jetojnë *aktualisht* dhe që *do të* jetojnë në tokë⁵.
2. Përveçse mbajti barrët e mëkateve tona, Krishti mori mbi Vete bregat, dobësitë, vuajtjet e sëmundjet dhe të gjitha hidhërimet tona, që janë të pandara nga gjendja tokësore e njeriut. Nuk ka vuajtje, dhembje apo trishtim që Ai nuk e kaloi për ne⁶.
3. Flijimi shlyes i Shpëtimtarit na lejon t’i mposhtim pasojat negative të Rënies së Adamit, përfshirë vdekjen fizike. Për shkak të Krishtit, të gjithë fëmijët e Perëndisë të lindur mbi këtë tokë, pavarësisht drejtësisë së tyre, do të përjetojnë ribashkimin e shpirtave dhe trupave të tyre, nëpërmjet fuqisë së Ringjalljes⁷ dhe do të kthehen tek Ai për t’u “gjyk[uar] . . . sipas veprave të [tyre]”⁸.
4. Ndryshe nga kjo, marrja e bekimeve të plota të Shlyerjes së Shpëtimtarit është e kushtëzuar nga zelli ynë⁹ për ta jetuar “doktrin[ën] e Krishtit”¹⁰. Në ëndrrën e tij, Lehi pa “shteg[un e] ngushtë dhe të ngushtuar”¹¹ që të çon drejt pemës së jetës. Fruti i saj, i cili përfaqëson dashurinë e Perëndisë siç shprehet nëpërmjet bekimeve të mrekullueshme të Shlyerjes së Krishtit, “është më i çmuesh[mi] dhe më i dëshiruesh[mi] . . . [dhe] më i madhi nga të gjitha dhuratat e Perëndisë”¹². Me qëllim që ta marrim këtë frutë, ne duhet të ushtrojmë



besim në Jezu Krisht, të pendohemi, “ta dëgj[im] fjalën e Perëndisë”¹³, të marrim ordinancat thelbësore dhe t’i mbajmë besëlidhjet e shenjta deri në fund të jetës sonë¹⁴.

5. Nëpërmjet Shlyerjes së Tij, Jezu Krishti jo vetëm që na i pastron mëkatet, por Ai na siguron edhe fuqinë *aftësuese* nëpërmjet së cilës dishepujt e Tij mund të “zhvesh[in] njeriun e natyrshëm”¹⁵, të përparojnë “rresht pas rreshti”¹⁶ dhe të rriten në shenjtëri¹⁷, që një ditë ata të mund të bëhen qenie të përkryera sipas imazhit të Krishtit¹⁸, të kualifikuar për të jetuar sërish me Perëndinë¹⁹ dhe të trashëgojnë të gjitha bekimet e mbretërisë së qiellit²⁰.

Një e vërtetë tjetër ngushëlluese që përmbahet në Librin e Mormonit, është që, ndonëse e pafundme dhe universale në shtrirjen e saj, Shlyerja e Zotit është një dhuratë jashtëzakonisht vetjake dhe e brendshme, e përshtatur për secilin prej nesh individualisht²¹. Ashtu sikurse Jezusi e ftoi secilin dishepull neftit që t’ia prekte plagët e Tij, ashtu Ai vdiq për secilin prej nesh, personalisht, sikur ju dhe unë të ishim njerëzit e vetëm mbi tokë. Ai na bën një ftesë vetjake që të vijmë tek Ai dhe t’i vëmë në përdorim të gjitha bekimet e mrekullueshme të Shlyerjes së Tij²².

Natyrë vetjake e Shlyerjes së Krishtit bëhet edhe më reale ndërsa i mbajmë parasysh shembujt mbresëlënës të

burrave e grave në Librin e Mormonit. Ndër ta janë Enosi, Alma, Zizromi, Mbreti Lamon e bashkëshortja e tij dhe populli i Mbretit Beniamin. Historitë e tyre për kthimin në besim dhe dëshmitë e tyre të fuqishme japin një dëshmi të gjallë për mënyrën se si zemra jonë mund të ndryshohet dhe jeta jonë të tjetërsohet nëpërmjet mirësisë dhe mëshirës së pafundme të Zotit²³.

Porfeti Alma i bëri popullit të tij këtë pyetje reflektuese. Ai tha: “Në qoftë se keni provuar një ndryshim të zemrës dhe në qoftë se ju keni ndier të këndonit këngën e dashurisë shëlbuese, unë do t’ju pyesja, a ndiheni kështu *tan?*”²⁴ Kjo pyetje është jetike sot, sepse si dishepujt të Zotit, ne kemi nevojë që fuqia e Tij shëlbuese të na shoqërojë, të na japë shtysë dhe të na ndryshojë ditë pas dite.

Pyetja e Almës mund të riformulohet edhe kështu: Kur e keni ndier për herë të fundit ndikimin e ëmbël të Shlyerjes së Shpëtimtarit në jetën tuaj? Kjo ndodh kur ju ndieni një gëzim “të mrekulluesh[ëm] dhe . . . të ëmbël”²⁵ që ju pushton, i cili i jep dëshmi shpirtit tuaj se mëkatet tuaja janë falur; ose kur sprovat e rënda papritur bëhen më të lehta për t’u duruar; ose kur ju zbutet zemra dhe jeni në gjendje t’i jepni falje dikujt që ju ka lënduar. Ose mund të ndodhë sa herë që vëreni se aftësia juaj për t’i dashur e për t’u shërbyer të tjerëve është rritur ose që procesi i shenjtërimit po ju bën tjetër

njeri, të modeluar sipas shembullit të Shpëtimtarit²⁶.

Jap dëshmi se të gjitha këto përvoja janë të vërteta dhe janë prova që jeta mund të ndryshohet nëpërmjet besimit në Jezu Krisht dhe Shlyerjes së Tij. Libri i Mormonit e qartëson dhe e zgjeron njohurinë tonë për këtë dhuratë hyjnore. Ndërsa e studioni këtë libër, do ta dëgjoni zërin e Krishtit të gjallë që ju fton të vini tek Ai. Ju premtoj se, nëse e pranoni këtë ftesë dhe e modeloni jetën tuaj sipas shembullit të Tij, ndikimi i Tij shëlbues do të vijë në jetën tuaj. Nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, Shpëtimtari do t’ju shndërrojë ditë pas dite “derisa dita është e plotë”²⁷ kur ju, siç Ai shpalli, “ta sh[ihni] fytyrën time dhe do të di[ni] se unë jam”²⁸. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

- 3 Nefi 11:8–11.
- Shih 3 Nefi 11:14–15.
- Alma 5:33.
- 1 Nefi 13:40.
- Shih 2 Nefi 9:21; 26:24–27; Mosia 3:13.
- Shih Alma 7:11–12.
- Shih 2 Nefi 10:25.
- Mosia 3:24; shih edhe 2 Nefi 2:4, 10, 26; 9:6–7, 12–13, 15, 22; Mosia 3:12; 16:7–8; Alma 11:41–44; 42:6–8, 23; Helamani 14:16; Mormoni 9:12.
- Shih 2 Nefi 9:21; Mosia 3:12; Helamani 5:11; 14:18.
- 2 Nefi 31:21; shih edhe 3 Nefi 27:20–21.
- 1 Nefi 8:20.
- 1 Nefi 15:36.
- 1 Nefi 15:24.
- Shih 2 Nefi 31.
- Mosia 3:19.
- 2 Nefi 28:30.
- Shih Mosia 3:19.
- Shih 3 Nefi 27:27; Moroni 10:32–33.
- Shih 2 Nefi 2:8; Mosia 2:41.
- Shih Alma 11:37.
- Shih 2 Nefi 9:21.
- Shih Omni 1:26; Alma 5:33; Moroni 10:32–33.
- Shih Enosi 1; Mosia 5; Alma 12; 18–19; 36.
- Alma 5:26; theksimi i shtuar.
- Alma 36:21.
- Shih Mosia 3:19.
- Doktrina e Besëlidhje 50:24.
- Doktrina e Besëlidhje 93:1.



Nga Plaku Dejl G. Renland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Kini Parasysh Mirësinë dhe Madhështinë e Perëndisë

Ju ftoj ta kujtoni çdo ditë madhështinë e Atit Qiellor dhe të Jezu Krishtit, si dhe atë që Ata kanë bërë për ju.

Gjatë gjithë kohës, madje gjatë kohëve të vështira dhe veçanërisht gjatë tyre, profetët na kanë nxitur ta kujtojmë madhështinë e Perëndisë dhe të kemi parasysh atë që Ai ka bërë për ne si individë, si familje dhe si popull.¹ Ky udhëzim gjendet gjatë gjithë shkrimeve të shenjta, por është veçanërisht i spikatur në Librin e Mormonit. Faqja e titullit shpjegon se një nga qëllimet e Librit të Mormonit është “për t’u treguar atyre që mbetën nga shtëpia e Izraelit çfarë gjërash të mëdha kishte bërë Zoti për etërit e tyre”². Përfundimi i Librit të Mormonit përfshin thirrjen e Moronit: “Vini re, unë do t’ju këshilloj që kur t’i lexoni këto gjëra, . . . të kujtoni sa i mëshirshëm ka qenë Zoti ndaj fëmijëve të njerëzve . . . dhe t’i meditonin në zemrat tuaja”³.

Vazhdueshmëria e thirrjeve nga profetët që të reflektojmë mbi mirësinë e Perëndisë, është mbresëlënëse.⁴ Ati ynë Qiellor dëshiron që ne ta sjellim ndër mend mirësinë e Tij dhe të Birit të Tij të Dashur, jo për vetëkënaqjen e Tyre, por për ndikimin që ka mbi ne një kujtim i tillë. Duke e marrë parasysh mirësinë e Tyre, këndvështrimi ynë dhe kuptueshmëria jonë zgjerohen. Duke reflektuar mbi dhembshurinë e Tyre, ne

bëhemi më të përlurur, plot lutje dhe të palëkundur.

Një përvojë prekëse me një ish-pacient tregon se si mund të na shndërrojë mirënjohja për bujarinë dhe dhembshurinë. Në vitin 1987 u njoha me Tomas Nilsonin, një burrë i mrekullueshëm që kishte nevojë për një transplant zemre. Ai ishte 63 vjeç dhe jetonte në Logan të Jutës në Shtetet e Bashkuara. Pas shërbimit ushtarak gjatë Luftës II Botërore, ai u martua me Dona Uillsin në Tempullin e Loganit në Jutë. Ai u bë një murator energjik dhe i suksesshëm. Në vitet e mëvonshme, ai kënaqej posaçërisht duke punuar me nipin e tij më të madh, Xhonatanin, gjatë pushimeve të shkollës. Ata të dy krijuan një lidhje të veçantë, pjesërisht ngaqë te Xhonatani Tomi shihte shumë gjëra të ngjashme me veten.

Tomi kuptoi se pritja për një zemër të dhuruar po e bezdiste.


Ai nuk qe një burrë veçanërisht i durueshëm. Gjithmonë kishte qenë në gjendje të vendoste dhe të arrinte synime nëpërmjet punës së palodhur dhe vendosmërisë së plotë. Duke u ndeshur me problemin e zemrës, me jetën e vënë në pritje, Tomi nganjëherë më pyeste se çfarë po bëja që ta shpejtoja procesin. Me shaka, ai sugjeronte mënyra që mund t’i ndiqja, të cilat do ta vinin më shpejt në dispozicion të tij një zemër të dhuruar.

Një ditë të gëzueshme, por prapëseprapë të tmerrshme, një zemër ideale dhuruesi u vu në dispozicion për Tomin. Madhësia dhe lloji i gjakut përputheshin dhe dhuruesi ishte i ri, vetëm 16 vjeç. Zemra e dhuruar i përkiste Xhonatanit, nipit të dashur të Tomit. Më herët atë ditë, Xhonatani ishte dëmtuar për vdekje kur makina në të cilën udhëtonte, u godit nga një tren që po kalonte.

Kur i vizitova Tomin dhe Donën në spital, ata ishin të dërrmuar. Është e vështirë të përfytyroni se çfarë po përjetonin ata, duke e ditur që jeta e Tomit mund të zgjatej duke përdorur zemrën e nipit të tyre. Në fillim, as nuk pranuan që ta merrnin parasysh zemrën e ofruar nga prindërit e



Prova, Jutë, SHBA



mëdha ka bërë [Perëndia] për ta”⁹. Nga të gjitha këshillat e mundshme, kjo ishte ajo që theksoi engjëlli.

Alma u pendua dhe kujtoi. Më vonë ai ia tregoi këshillimin e engjëllit të birit, Helamanit. Alma këshilloi: “Unë doja që ti të bësh sikurse kam bërë unë, duke kujtuar robërinë e etërve tanë, pasi ata qenë në robëri dhe askush nuk mund t’i çlironte përveçse të ishte Perëndia i Abrahamit, . . . Isakut dhe . . . Jakobit; dhe ai me siguri i çliroi ata nga fatkeqësitë e tyre”¹⁰.

Alma thjesht tha: “Unë vë besimin tim në të”¹¹. Alma e kuptoi se duke kujtuar çlirimin nga robëria dhe përkrahjen në “sprova dhe në shqetësime të çdo lloji”, ne arrijmë ta njohim Perëndinë dhe sigurinë e premtimeve të Tij.¹²

Pak prej nesh kanë një përvojë aq dramatike sa ajo e Almës, prapëseprapë shndërrimi ynë mund të jetë po aq i thellë. Shpëtimtari na premtoi që nga lashtësia:

“Do t’ju jap një zemër të re dhe do të shtie brenda jush një shpirt të ri; do të heq . . . zemrën prej guri dhe do t’ju jap zemër prej mishi.

Do të vë brenda jush Shpirtin tim. . . .

. . . Ju do të jeni populli im, dhe unë do të jem Perëndia juaj.”¹³

Shpëtimtari i ringjallur u tregoi neftëve se si fillon ky shndërrim. Ai

pikëlluar të Xhonatanit, nga bija dhe dhëndri i tyre. Sidoqoftë, Tomi dhe Dona e dinin se truri i Xhonatanit nuk funksiononte më dhe arritën ta kuptonin se lutjet e tyre për një zemër të dhuruar për Tomin nuk e kishin shkaktuar aksidentin e Xhonatanit. Jo, zemra e Xhonatanit ishte një dhuratë që mund ta bekonte Tomin në kohën e vet të nevojës. E kuptuan se diçka e mirë mund të rridhte nga kjo tragjedi dhe vendosën ta bënin transplantin.

Procedurat e transplantit shkuan mirë. Më pas, Tomi ishte një njeri tjetër. Ndryshimi shkoi përtej shëndetit të përmirësuar ose madje mirënjohjes. Më tha se çdo mëngjes mendonte për Xhonatanin, të bijën dhe të dhëndrin, për dhuratën që kishte marrë, dhe se çfarë ishte dashur për atë dhuratë. Ndonëse humori i mirë dhe vendosmëria e brendshme ishin ende të dukshme, unë vëzhgova se Tomi ishte më solemn, më i matur dhe më zemërmirë.

Tomi jetoi edhe 13 vjet të tjerë pas transplantit, vite që përndryshe nuk do t’i kishte pasur. Nekrologjia e tij përmendi se këto vite lejuan që ai ta prekte me bujari e dashuri jetën e pjesëtarëve të familjes së vet dhe të të tjerëve. Ai ishte një bamirës i fshehtë dhe një shembull optimizmi e vendosmërie.

Sikurse Tomi, secili prej nesh ka marrë dhurata të cilat nuk mund t’i

siguronim vetë, dhurata nga Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij i Dashur, përfshirë shëlbimin nëpërmjet flijimit shlyes të Jezu Krishtit.⁵ Ne kemi marrë jetë në këtë botë; ne do të marrim jetë fizike në jetën pas kësaj dhe shpëtim të përjetshëm dhe ekzaltim – nëse e zgjedhim atë – të gjitha këto për shkak të Atit Qiellor dhe Jezu Krishtit.

Sa herë që i përdorim këto dhurata, përfitojmë prej tyre ose madje parasysh sakrificën, bujarinë dhe dhembshurinë e Atyre që i dhanë dhuratat. Nderimi për Ata që i japin dhuratat, bën për ne më shumë sesa thjesht të na bëjë mirënjohës. Të menduarit mbi dhuratat e Tyre mund dhe duhet të na shndërrorë.

Një shndërrim mbresëlënës ishte ai i Alma të Riut. Ndërkohë që Alma “po përpiqej] të ngrin[te] krye kundër Perëndisë”⁶, një engjëll u shfaq. Me “një zë rrufeje”⁷ engjëlli e qortoi Almën për përndjekjen e Kishës dhe “grabit[jen e] zemra[ve të] njerëzve”⁸. Engjëlli shtoi këtë këshillim: “Shko dhe kujto robërinë e etërve të tu . . . dhe kujto sa gjëra të



San Bernardo, Santiago, Kili

përcaktoi një tipar thelbësor në planin e Atit Qiellor kur tha:

“Dhe, Ati im më dërgoi që të mund të ngrihesha në kryq; dhe pasi u ngrita në kryq, që t’i *tërheq* të gjithë njerëzit tek unë. . . .

Dhe për këtë shkak unë jam ngritur; prandaj, sipas fuqisë së Atit, unë do t’i *tërheq* të gjithë njerëzit tek unë.”¹⁴

Çfarë është e mjaftueshme për ju që të tërhiqeni te Shpëtimtari? Merreni parasysh nënshtrimin e Jezu Krishtit ndaj vullnetit të Atit të Tij, fitoren e Tij mbi vdekjen, marrjen mbi vete prej Tij të mëkateve dhe gabimeve tona, marrjen prej Tij të fuqisë nga Ati për të bërë ndërmjetësimin për ju dhe shëlbimin e Tij përfundimtar për ju.¹⁵ A nuk janë këto gjëra të mjaftueshme për t’ju tërhequr tek Ai? Për mua janë. Jezu Krishti “qëndron krahëhapur, duke shpresuar dhe i gatshëm të na shërojë, falë, pastrojë, forcojë, të na bëjë të kulluar dhe të na shenjtërojë [ju dhe mua]”¹⁶.

Këto të vërteta duhet të na japin një zemër të re dhe të na nxitin që të zgjedhim për ta ndjekur Atin Qiellor dhe Jezu Krishtin. Por edhe zemrat e reja mund të “prirën për t’u endur, . . . prirën për t’u larguar nga Perëndia që e duam”¹⁷. Për ta luftuar këtë prirje, na nevojitet që të mendojmë çdo ditë për dhuratat që kemi marrë dhe se çfarë është dashur për to. Mbreti Benjamin këshilloi: “Unë do të doja që ju të kujtoni dhe gjithmonë të mbani në kujtesë, madhështinë e Perëndisë dhe . . . mirësinë dhe keqardhjen e tij ndaj jush”¹⁸. Teksa e bëjmë këtë, ne kualifikohemi për bekime të mrekullueshme qiellore.

Të menduarit për mirësinë dhe mëshirën e Perëndisë na ndihmon të bëhemi më perceptues nga ana shpirtërore. Si rrjedhojë, ndjeshmëria më e madhe shpirtërore do të na lejojë ta dimë të vërtetën e të gjitha gjërave nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë.¹⁹



Kjo përfshin një dëshmi për vërtetësinë e Librit të Mormonit, duke e ditur që Jezusi është Krishti, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë vetjak, dhe duke pranuar që ungjilli i Tij është rivendosur në këto ditë të mëvonshme.²⁰


Kur e kujtojmë madhështinë e Atit tonë Qiellor dhe Jezu Krishtit dhe atë që Ata kanë bërë për ne, ne nuk do t’i marrim Ata si të mirëqenë, ashtu sikurse Tomi nuk e mori si të mirëqenë zemrën e Xhonatanit. Në një mënyrë të gëzueshme dhe nderuese, Tomi e kujtoi çdo ditë tragjedinë që i solli atij jetë më të gjatë. Gjatë lumturisë së madhe nga dijenia se mund të shpëtohem dhe ekzaltohem, ne kemi nevojë të kujtojmë se shpëtimi dhe ekzaltimi erdhën me një çmim të shtrenjtë.²¹ Në mënyrë nderuese ne mund të jemi plot gëzim kur kuptojmë se pa Jezu Krishtin ne jemi të pashpresë, por me Të ne mund të marrim dhuratën më të madhe që mund të japë Ati Qiellor.²² Vërtet, ky nderim na lejon të marrim premtimin “e jetës së përjetshme në këtë botë” dhe përfundimisht të marrim “jetën e përjetshme . . . madje lavdi të pavdekshme” në botën që vjen.²³

Kur e kemi parasysh mirësinë e Atit tonë Qiellor dhe Jezu Krishtit, mirëbesimi ynë tek Ata rritet. Lutjet tona ndryshojnë ngaqë e dimë se Perëndia

është Ati ynë dhe ne jemi fëmijët e Tij. Ne nuk kërkojmë ta ndryshojmë vullnetin e Tij, por që ta përputhim vullnetin tonë me vullnetin e Tij dhe të sigurojmë për veten tonë bekimet që Ai dëshiron të na i japë, me kushtin që ne t’i kërkojmë ato.²⁴ Ne përpiqemi të jemi më të përlulur, më të pastër, më të palëkundur, më shumë si Krishti.²⁵ Këto ndryshime na kualifikojnë për bekime të tjera qiellore.

Duke e ditur se çdo gjë e mirë vjen nga Jezu Krishti, ne do t’ua komunikojmë besimin tonë në mënyrë më të efektshme të tjerëve.²⁶ Ne do të kemi guxim kur përballemi me detyra dhe rrethana të pamundura në dukje.²⁷ Ne do ta forcojmë vendosmërinë tonë për t’i mbajtur besëlidhjet që i kemi bërë për ta ndjekur Shpëtimtarin.²⁸ Ne do të mbushemi me dashurinë e Perëndisë, do të duam t’i ndihmojmë njerëzit nevojtarë pa qenë gjykues, do t’i duam fëmijët tanë e do t’i rritim ata në drejtësi, do të mbajmë një heqje të mëkateve tona dhe do të gëzohemi gjithmonë.²⁹ Këto janë frytet e mrekullueshme nga që kujtojmë mirësinë dhe mëshirën e Perëndisë.

Në dallim, Shpëtimtari paralajmëroi: “Dhe në asgjë nuk e fyen njeriu Perëndinë apo kundër askujt nuk ndizet zemërimi i tij, përveç atyre që nuk e pohojnë dorën e tij në gjithçka”³⁰.



Nuk mendoj se Perëndia preket në sedër kur ne e harrojmë Atë. Në të kundërt, mendoj se Ai zhgënjehet thellësisht. Ai e di se ne i kemi hequr vetes mundësinë që të afrohemi më pranë Tij kur nuk e kujtojmë Atë dhe as mirësinë e Tij. Atëherë ne nuk e kemi mundësinë që Ai të na afrohet më pranë dhe nuk i marrim bekimet e veçanta që Ai ka premtuar.³¹

Ju ftoj ta kujtoni çdo ditë madhësitë e Atit Qiellor dhe të Jezu Krishtit, si dhe atë që Ata kanë bërë për ju. Lejoheni vlerësimin tuaj për mirësinë e Tyre ta lidhë më fort zemrën tuaj endacake me Ta.³² Përsiatni për dhembshurinë e Tyre dhe ju do të bekoheni me ndjeshmëri më të madhe shpirtërore dhe do të bëheni më shumë si Krishti. Të menduarit për dashamirësinë e Tyre do t'ju ndihmojë të "qëndro[ni] besnikë deri në fund", derisa ju të jeni "marrë në qiell" që të "jeto[ni] me Perëndinë, në një gjendje lumturie të pafund"³³.

Ati ynë Qiellor, duke iu drejtuar Birit të Tij të Dashur, tha: "Dëgjoje Atë!"³⁴ Kur veproni sipas këtyre fjalëve dhe e dëgjoni Atë, mbani mend, me gëzim e nderim, se Shpëtimtari dëshiron shumë që të rivendosë atë që ju nuk mund ta rivendosni; Ai dëshiron shumë të shërojë plagë që ju nuk mund t'i shëroni; Ai dëshiron shumë që të ndreqë atë që është thyer në mënyrë të riparueshme³⁵; Ai dëmshpërblen për cilëndo padrejtësi të shkaktuar mbi ju³⁶ dhe Ai dëshiron shumë që t'i shërojë përgjithmonë edhe zemrat e thyer³⁷.

Teksa kam menduar për dhuratat nga Ati ynë Qiellor dhe nga Jezu Krishti, unë kam arritur të njoh dashurinë e Tyre të pafundme dhe dhembshurinë e Tyre të cilën nuk arrijmë dot ta kuptojmë, për të gjithë fëmijët e Atit Qiellor.³⁸ Kjo njohuri më ka ndryshuar mua dhe do t'ju ndryshojë edhe ju. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih, për shembull, Abraham 2:16; Eksodi 13:3; Jozueut 4:6–9; 1 Samuelit 7:11–12.
2. Faqja e titullit e Librit të Mormonit.
3. Moroni 10:3.
4. Shih, për shembull, Ligji i Përtërirë 6:12; 11:18; Jozueut 4:21–24; 1 Samuelit 7:12; Romakëve 2:4; 11:22; 2 Nefi 9:10; 33:14; Jakobi [LiM] 1:7; Mosia 5:3; 25:10; 27:22; Alma 34:4; Helamani 12:2; 3 Nefi 4:33; 18:11–12; Mormoni 2:13; Doktrina e Besëlidhje 133:52; 138:2.
5. Shih Isaia 53:3–12; Lluca 22:44; Gjoni 3:16; Galatasve 2:20; Mosia 3:5–11; Alma 7:10–13; Doktrina e Besëlidhje 19:16–19.
6. Mosia 27:11.
7. Mosia 27:11.
8. Mosia 27:9; shih edhe vargun 13.
9. Mosia 27:16.
10. Alma 36:2.
11. Alma 36:27.
12. Shih Alma 36:27–29.
13. Ezekiel 36:26–28.
14. 3 Nefi 27:14–15; theksimi i shtuar. Shih edhe Gjoni 12:32; 2 Nefi 26:24.
15. Shih Mosia 15:7–9; Zbulesa 21:4.
16. Rasëll M. Nelson, "Ne Mund të Bëjmë më Mirë dhe të Jemi më të Mirë", *Liahona*, maj 2019, f. 67.
17. "Come, Thou Fount of Every Blessing", ["Eja, Ti Burim i Çdo Bekimi"], *Hymns* (1948), nr. 70.
18. Mosia 4:11; shih edhe Alma 36:2, 28–29; Ethëri 7:27; 10:2; Moroni 9:25.
19. Shih Moroni 10:4–5.
20. Shih faqen e titullit dhe parathënien e Librit të Mormonit.
21. Shih Doktrina e Besëlidhje 19:18–19.
22. Shih Doktrina e Besëlidhje 14:7.
23. Moisiu 6:59; shih edhe Alma 36:28.
24. Shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, "Lutje".
25. Shih "Më Shumë Shenjtëri m'Jep", *Himne*, nr. 69.
26. Shih Filemonit 1:6.
27. Shih 1 Samuelit 17:37; 1 Nefi 4:2.
28. Shih Alma 5:6, 13, 26–28.
29. Shih Mosia 4:11–26.
30. Doktrina e Besëlidhje 59:21.
31. Shih Doktrina e Besëlidhje 88:63–64.
32. Shih "Come, Thou Fount of Every Blessing".
33. Mosia 2:41.
34. Shih Mateu 17:5; Marku 9:7; Lluca 9:35; 3 Nefi 11:7; Joseph Smith – Historia 1:17.
35. Shih Boyd K. Packer, "The Brilliant Morning of Forgiveness", *Ensign*, nëntor 1995, f. 19–20.
36. Shih Zbulesa 21:4.
37. Shih Psalmeve 147:3.
38. Shih 2 Nefi 26:33.



Nga Plaku Benxhamin M. Z. Tai,
i Të Shtatëdhjetëve

Fuqia e Librit të Mormonit për Kthimin në Besim

Libri i Mormonit siguron ushqim shpirtëror, jep një plan veprimi dhe na lidh me Shpirtin e Shenjtë.

Pasi rishikova raportin nga një vizitë mjekësore e kohëve të fundit, mësova se më duhej të bëja disa ndryshime në stilin e jetesës. Për të më ndihmuar, mjeku im më dha një plan ushqimor dhe stërvitor që nëse zgjidhja ta ndiqja, do të më shndërronte në një njeri më të shëndetshëm.

Nëse secili prej nesh do të bënte një kontroll shpirtëror, çfarë do të mësonim rreth vetes sonë? Çfarë përshtatjesh do të na jepte mjeku ynë shpirtëror? Në mënyrë që ne të bëhemi ata të cilët kemi nevojë të jemi, është thelbësore që të dimë se çfarë të bëjmë dhe të bëjmë atë që dimë.

Jezu Krishti është Kryemjeku.¹ Nëpërmjet Shlyerjes së Tij, Ai i lidh plagët tona, i merr mbi vete dobësitë tona dhe e shëron zemrën tonë të thyer.² Nëpërmjet hirit të Tij, dobësia jonë mund të bëhet e fortë.³ Ai na fton ta ndjekim Atë⁴ duke mësuar për Të, duke i dëgjuar fjalët e Tij dhe duke ecur në butësinë e Shpirtit të Tij.⁵ Ai ka premtuar të na ndihmojë⁶ në këtë proces të kthimit në besim që zgjat gjithë jetën, i cili na shndërron dhe na sjell gëzim të përherëshëm.⁷

Shpëtimtari na ka dhënë Librin e Mormonit si një mjet të fuqishëm për të ndihmuar për kthimin në besim.

Libri i Mormonit siguron ushqim shpirtëror, jep një plan veprimi dhe na lidh me Shpirtin e Shenjtë. I shkruar për ne⁸, ai e përmban fjalën e Perëndisë me thjeshtësi⁹ dhe na tregon rreth identitetit, qëllimit dhe fatit tonë.¹⁰ Bashkë me Biblën, Libri i Mormonit dëshmon për Jezu Krishtin¹¹ dhe jep mësim se si mund ta dimë të vërtetën dhe të bëhemi si Ai.

Vëllai Sau Polo ishte 58 vjeç kur u njoh me ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit. Kur u takova më të, ai kishte qenë duke shërbyer si president dege për disa vite, por mësova se ai nuk e kishte lexuar kurrë Librin e Mormonit sepse nuk ishte ende në dispozicion në gjuhën e tij amtare, birmanisht. Kur e pyeta se si e dinte që libri ishte i vërtetë pa e lexuar atë, ai u përgjigj duke thënë se e kishte studiuar çdo ditë librin me figura *Ngjarjet e Librit të Mormonit* çdo ditë duke parë ilustrimet,

duke përdorur një fjalor për të përkthyer fjalët nga anglishtja dhe duke mbajtur shënime me kujdes atë që mësonte. Ai shpjegoi: “Sa herë që studioja, unë lutesha rreth asaj që mësoja dhe ndieja paqe e gëzim, mendja ime kthjellohej dhe zemra ime ishte e butë. E ndjeva Frymën e Shenjtë të më dëshmonte se ai ishte i vërtetë. Unë e di se Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë.”

Ashtu si vëllai Sau Polo, secili prej nesh mund ta studiojë Librin e Mormonit sipas rrethanave tona. Teksa dëshirojmë të besojmë dhe përsiatim mësimet e tij në zemrën tonë, ne mund ta pyetim Perëndinë me besim nëse mësimet janë të vërteta.¹² Nëse jemi të sinqertë në dëshirën tonë për të ditur dhe kemi qëllim të vërtetë për të vepruar, Ai do të na përgjigjet në zemrën tonë nëpërmjet Frymës së Shenjtë. Është me anë të fuqisë së



Baunifull, Jutë, SHBA

Frymës së Shenjtë që ne do të dimë të vërtetën e të gjitha gjërave.¹³ Kur marrim një dëshmi hyjnore për Librin e Mormonit, ne do të dimë me anë të po të njëjtës fuqi se Jezu Krishti është Shpëtimtari i botës, se Jozef Smithi është profeti i Tij dhe se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është kisha e Tij e rivendosur.¹⁴

Kur isha një i ri që po filloja shërbimin tim misionar, unë i hipa një aeroplani për në Australi. Duke u ndier shumë i vetmuar, në ankth dhe i papërshtatshëm, por duke qenë i zotuar për të shërbyer, mua më duhej dëshpërimisht një siguri se ajo që besoja ishte e vërtetë. U luta dhe i lexova me zell shkrimet e mia të shenjta, por teksa fluturimi vazhdonte dyshimi për veten u shtua dhe gjendja ime fizike u përkeqësua. Pasi kisha qenë duke u përpjekur për disa orë, një shoqëruës fluturimi eci nëpër rruginë dhe ndaloi pranë ndenjësës sime. Ai e mori Librin



e Mormonit që po lexoja nga duart e mia. E pa kapakun dhe tha: “Ai është një libër i mrekullueshëm!” pastaj ma dha prapë librin dhe vazhdoi të ecte. Nuk e pashë më kurrë atë.

Ndërkohë që fjalët e tij bënë jehonë në veshët e mi, unë dëgjova dallueshëm dhe ndjeva në zemrën time fjalët: “Unë jam këtu dhe e di se ku je ti. Vetëm bëj më të mirën tënde sepse unë do të kujdesem për pjesën tjetër.” Në atë aeroplan mbi Oqeanin Paqësor, unë mora një dëshmi vetjake nëpërmjet studimit tim të Librit të Mormonit dhe nxitjeve të Shpirtit të Shenjtë se Shpëtimtari im e dinte se kush isha dhe se ungjilli ishte i vërtetë.

Plaku Dejvid A. Bednar dha mësim: “Të diturit se ungjilli është i vërtetë është thelbi i një dëshmie. Të qenit vazhdimisht i vërtetë ndaj ungjillit është thelbi i kthimit në besim.”¹⁵ Kthimi në besim kërkon që ne të jemi “bërës të fjalës dhe jo vetëm dëgjues”¹⁶. Plani i veprimit i Zotit për ne – doktrina e Krishtit – jepet mësim më qartësisht në Librin e Mormonit.¹⁷ Ai përfshin:

- Së pari, *ushtrimin* e besimit të Jezu Krishti duke i mirëbesuar Atij, duke i zbatuar urdhërimet e Tij dhe duke e ditur se Ai do të na ndihmojë.¹⁸
- Së dyti, *pendimin* e përditshëm për mangësitë tona dhe *përjetimin* e gëzimit dhe të paqes kur Ai na fal.¹⁹ Pendimi kërkon që ne t'i *falim* të tjerët²⁰ dhe na ndihmon të shkojmë përpara. Shpëtimtari ka premtuar të na falë sa herë që pendohemi.²¹

- Së treti, *bërjen dhe mbajtjen* e besëlidhjeve me Perëndinë nëpërmjet ordinancave të tilla si pagëzimi. Kjo do të na mbajë në shtegun e besëlidhjeve që të çon tek Ai.²²
- Së katërti, *marrjen* e dhuratës së Frymës së Shenjtë. Kjo dhuratë na lejon shoqërimin e vazhdueshëm të atij që na shenjtëron, ngushëllon dhe udhërrëfen.²³
- Dhe së pesti, *durimin* deri në fund duke *shkuar përpara* me vendosmëri ndërkohë që *ushqehemi me bollëk* çdo ditë me fjalën e Krishtit.²⁴ Duke u ushqyer me bollëk nga Libri i Mormonit dhe duke u kapur fort pas mësimëve të tij, ne mund t'i mposhtim tundimet dhe të marrim udhërrëfim e mbrojtje gjatë gjithë jetës sonë.²⁵

Duke e zbatuar vazhdimisht doktrinën e Krishtit në jetën tonë, ne do të mposhtim inercinë që pengon ndryshimin, dhe frikën që zbraps veprimin. Ne do të marrim zbulesë vetjake, sepse Fryma e Shenjtë “do t’ju *tregojë* të gjitha gjërat që duhet të bëni”²⁶, dhe “fjalët e Krishtit do t’ju *tregojnë* të gjitha gjërat që ju duhet të bëni”²⁷.

Për 20 vjet, vëllai Huang Junkong pati vështirësi me alkoolin, cigaret dhe me varësinë nga bixhozi. Kur u njoh me Jezu Krishtin dhe ungjillin e Tij të rivendosur, vëllai Huang dëshironte që të ndryshonte për hir të familjes së tij të re. Sfidat e tij më e madhe ishte duhanpirja. Si një duhanpirës i rregullt, ai ishte munduar disa herë që ta

linte duhanin, por pa sukses. Një ditë këto fjalë nga Libri i Mormonit u ngulitën në mendjen e tij: “Me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë”²⁸. Edhe pse përpjekjet e tij të mëparshme kishin dështuar, ai ndjeu se ndoshta mund të ndryshonte me ndihmë nga Ati Qiellor dhe Jezu Krishti.

Misionarët kohëplotë e bashkuan besimin e tyre me të tijn dhe siguruan një plan veprimi ndërhyrjesh praktike, së bashku me doza të mëdha lutjeje dhe studimi të fjalës së Perëndisë. Me sinqeritet dhe qëllim të vërtetë, vëllai Huang veproi me vendosmëri besimplotë dhe zbuloi se kur ai përqendrohej më shumë te zakonet e reja të cilat donte të zhvillonte, të tilla si studimi i Librit të Mormonit, ai përqendrohej më pak te zakonet që donte të hiqte.

Duke kujtuar përvojën e tij të 15 vjetëve më parë, ai vërejti: “Unë nuk e mbaj mend saktësisht se kur e lashë duhanin, por teksa përpiqesha fort çdo ditë për të bërë gjërat që e dija se duhet t’i bëja për të ftuar Shpirtin e Zotit në jetën time dhe vazhdoja t’i bëja ato, unë nuk isha më i tërhequr ndaj cigareve dhe nuk kam qenë që nga ajo kohë”. Nëpërmjet zbatimit të mësimëve të Librit të Mormonit, jeta e vëllait Huang është shndërruar dhe ai është bërë një bashkëshort e baba më i mirë.

Presidenti Rasëll M. Nelson ka premtuar: “Kur e studioni me lutje Librin e Mormonit *çdo ditë*, ju do të merrni vendime më të mira – *çdo ditë*. Ju premtoj se, teksa e përsiatni atë që studioni, dritaret e qiellit do të hapen dhe ju do të merrni përgjigje për vetë pyetjet tuaja dhe drejtim për vetë jetën tuaj. Ju premtoj se, ndërsa e zhytni veten përditë në Librin e Mormonit, ju mund të fitoni imunitet kundër të ligave të ditës, përfshirë edhe murtagjën dërrmuese të pornografisë



Nju Jork Siti, Nju Jork, SHBA

dhe varësive të tjera që na mpijnë mendjen”.²⁹

Të dashur miq, Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë dhe ne do t’i afrohem më shumë Atij nëse e studiojmë atë.³⁰ Teksa eksperimentojmë mbi fjalët e tij, ne do të marrim një dëshmi të vërtetësisë së tij.³¹ Teksa jetojmë vazhdimisht sipas mësimëve të tij, ne “nuk do të kemi më dëshirë për të bërë keq”³². Zemra, pamja dhe natyra jonë do të shndërrohen për t’u bërë më shumë si Shpëtimtari.³³ Ju jap dëshminë time të sigurt që Jezusi është Krishti, Shpëtimtari, Shëlbuesi dhe Miku ynë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Marku 2:17.
2. Shih Psalmeve 147:3; Isaia 53:4; Mateu 8:17.
3. Shih 2 Nefi 25:23; Jakobi [LiM] 4:7; Ethëri 12:27.
4. Shih Mateu 19:21; Marku 10:21; Lluka 18:22; 2 Nefi 31:10.
5. Shih Doktrina e Besëlidhje 19:23.
6. Shih Isaia 41:10.
7. Shih Mosia 2:41; 3:19; 5:2.
8. Shih 2 Nefi 25:8, 21–22; Mormoni 7:1; 8:35.
9. Shih 2 Nefi 25:7; 31:2–3.
10. Shih 2 Nefi 2:25; Alma 40.

11. Shih Isaia 29:4, 11–18; Ezekiel 37:16–21; 2 Korintasve 13:1; 1 Nefi 13:38–42; 2 Nefi 3:12; 25:26.
12. Shih Alma 32:26–43.
13. Shih Moroni 10:3–5.
14. Shih parathënien në Librin e Mormonit.
15. Deivid A. Bednar, “Të Kthyer në Besim të Zoti”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 109.
16. Jakob [Bibël] 1:22.
17. Shih 2 Nefi 31; 3 Nefi 11:31–40; 27:13–22.
18. Shih 1 Nefi 3:7; Moroni 7:33.
19. Shih Mosia 4:3.
20. Shih Mateu 18:21–35; Marku 11:25–26; Lluka 6:37; 3 Nefi 13:14–15; Doktrina e Besëlidhje 64:10; 82:1.
21. Shih Mosia 26:30; Moroni 6:8.
22. Shih 2 Nefi 31:17–18.
23. Shih 1 Nefi 10:19; 2 Nefi 33:1; 3 Nefi 11:32; 28:11; Moroni 6:4.
24. Shih 2 Nefi 31:20.
25. Shih 1 Nefi 15:24.
26. 2 Nefi 32:5; theksimi i shtuar.
27. 2 Nefi 32:3; theksimi i shtuar.
28. Moroni 10:4.
29. Rasëll M. Nelson, “Libri i Mormonit: Si do të Ishte Jeta Juaj pa Të?” *Liahona*, nëntor 2017, f. 62–63.
30. Profeti Jozef Smith tha për Librin e Mormonit, se “një njeri do t’i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porosive të tij, se nga ndonjë libër tjetër” (parathënia e Librit të Mormonit).
31. Shih Jakobi [LiM] 6:7; Alma 32:26–43.
32. Alma 19:33.
33. Shih 2 Korintasve 5:17; Mosia 3:19; 5:2; Alma 5:14, 19.



Nga Plaku Geri E. Stivenson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Një Themel të Mirë për të Ardhmen

Gjatë viteve të ardhshme, i lejojmë përmirësimet e bëra Tempullit të Solt-Lejkut që të na nxitin e frymëzojnë shpirtërisht.

Historia e Tempullit të Solt-Lejkut

Le të kthehemi pas te një pasdite e nxehtë e 24 korrikut 1847, rreth orës 14:00. Pas një udhëtimi të lodhshëm 111-ditor me 148 anëtarë të Kishës, të cilët përbënin grupin e parë që u nis drejt perëndimit, Brigam Jangu, në atë kohë President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, i sëmure dhe i pafuqishëm nga ethet, hyri në luginën e Solt-Lejkut.

Dy ditë më vonë, ndërkohë që po shërohej nga sëmundja, Brigam Jangu i udhëhoqi disa anëtarë të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve dhe të tjerë në një ekspeditë eksploruese. Uilliam Klejtoni shënoi: “Rreth 1,2 kilometra në veri të kampit, ne mbërritëm në një pllajë të bukur, të niveluar dhe që zbriste këndshëm drejt perëndimit”¹.

Ndërkohë që po e këqyrte vendin me grupin, Brigam Jangu papritur ndaloi dhe goditi tokën me bastunin e tij, duke thirrur: “Këtu do të qëndrojë Tempulli i Perëndisë tonë”. Njëri prej shoqëruesve të tij ishte Plaku Uillford Udraf, i cili tha se kjo thënie “e përshkoi [atë] si vetëtimë” dhe ai vendosi një shkop në tokë që të shënonte shenjën e bërë nga bastuni i Presidentit

Jang. Gjashtëmbëdhjetë hektarë u përzgjedhën për tempullin dhe u vendos që qyteti duhej të shtrihej “përsosurisht në formë katrore drejt veriu e jugut, lindjes e perëndimit” ku tempulli do të ishte pika qendrore.²

Në konferencën e përgjithshme në prill 1851, anëtarët e Kishës votuan njëzëri për të mbështetur një propozim për të ndërtuar një tempull “në emër të Zotit”³. Dy vjet më vonë, më 14 shkurt 1853, vendi u përkushtua nga Hibër C. Kimballi në një ceremoni publike ku morën pjesë disa mijëra shenjtorë dhe ku filluan punimet për themelin e Tempullit të Solt-Lejkut. Pak muaj më vonë, më 6 prill, gurët masivë të qosheve të tempullit u vendosën dhe u përkushtuan me ceremoni të përgatitura mirë, që përfshinin një truporë flamurtarësh, grupe muzikore dhe një vargan të drejtuar nga udhëheqës të Kishës të cilët shkuan prej tabernakullit të vjetër drejt vendit të tempullit, ku u mbajtën fjalime dhe u bënë lutje te secili prej katër gurëve të qosheve.⁴

Në ceremoninë e fillimit të punimeve, Presidenti Jang kujtoi se ai kishte parë një vegim kur fillimisht vuri

këmbë në atë tokë, teksa ata këqyrnin shtratin e luginës, duke thënë: “E dija [atëherë], po aq mirë sa e di tani, se kjo ishte toka në të cilën do të ndërtohej një tempull – ishte përpara meje”⁵.

Dhjetë vjet më vonë, Brigam Jangu dha idenë profetike që vijon, në konferencën e përgjithshme në tetor 1863: “Dëshiroj ta shoh tempullin të ndërtuar në një mënyrë që ai do të durojë gjatë mijëvjeçarit. Ky nuk është i vetmi tempull që do të ndërtojmë; do të ketë qindra prej tyre të ndërtuar e të përkushtuar për Zotin. Ky tempull do të njihet si tempulli i parë i ndërtuar në malet nga shenjtorët e ditëve të mëvonshme. . . . Dëshiroj që ai tempull . . . të qëndrojë si një monument krenar i besimit, këmbënguljes dhe punës së zellshme të shenjtorëve të Perëndisë në këto male.”⁶

Kur e shqyrtoj këtë histori të shkurtër, mahnitem për rolin e Brigam Jangu si shikues – së pari, sigurinë e tij se, për aq sa ishte e mundur dhe duke përdorur metoda ndërtimi që ishin në dispozicion në atë kohë dhe vend,



Tempulli i Solt-Lejkut do të ndërtohej në një mënyrë që të duronte gjatë Mijëvjeçarit dhe, së dyti, profetizimin e tij për shtimin e tempujve të ardhshëm anembanë botës, *madje që të numërohen me qindra.*

Restaurimi i Tempullit të Solt-Lejkut

Sikurse Brigam Jangu, profeti ynë i sotëm tregon kujdes të madh për Tempullin e Solt-Lejkut dhe gjithë tempujt e tjerë. Gjatë viteve, Presidencia e Parë, herë pas here, e ka këshilluar Peshkopatën Kryesuese për t'u siguruar që themeli i Tempullit të Solt-Lejkut të jetë i fortë. Kur shërbeva si Peshkopi Kryesues, me kërkesën e Presidencës së Parë, ne bëmë një rishikim të plotë të godinës së Tempullit të Solt-Lejkut, përfshirë një vlerësim të përparimeve më të fundit në teknikat e projektimit dhe ndërtimit sizmik.

Ja disa pjesë të rishikimit të dhënë për Presidencën e Parë në atë kohë: "Në projektimin dhe ndërtimin e Tempullit të Solt-Lejkut u përdorën inxhinieria, krahu i aftë për punë, materialet ndërtuese, mobilet dhe burime të tjera më të mirat të asaj periudhe që ishin në dispozicion. Që nga përkushtimi i tij në vitin 1893,



"Këtu do të qëndrojë Tempulli i Perëndisë tonë", shpalli Presidenti Brigam Jang.



Restaurimet e Tempullit të Solt Lejkut do të kontribuojnë për përbushjen e dëshirës së Brigam Jangut që tempulli të durojë gjatë Mijëvjeçarit.

tempulli ka qëndruar i palëkundur dhe ka shërbyer si një fener besimi [e] shprese dhe si një dritë për njerëzit. Kujdes i madh është treguar për ta pasur në funksionim, për ta pastruar e mirëmbajtur tempullin në gjendje të mirë. Struktura e jashtme prej graniti, lidhjet që mbajnë dyshemetë e brendshme dhe trarët mbështetës janë në gjendje të mirë. Studimet e kohëve të fundit vërtetojnë se vendi i zgjedhur nga Brigam Jangu për tempullin ka tokë shumë të mirë dhe cilësi të shkëlqyera ngjeshjeje.⁷

Rishikimi arriti në përfundimin se riparime dhe përmirësime të zakonshme nevojiteshin për ta restauruar dhe përditësuar tempullin, përfshirë

sheshin e jashtëm dhe hapësirat përreth tempullit, sistemet e vjetruara hidraulike dhe elektrike, si dhe mjediset e pagëzimores. Megjithatë, u rekomandua edhe marrja parasysh e një përmirësimi të veçantë e më tërësor sizmik duke filluar nga themeli i tempullit deri në majë të ndërtesës.

Themeli i Tempullit

Siç mund ta mbani mend, vetë Presidenti Brigam Jang u përfshi shumë në ndërtimin e themelit fillestar të tempullit, themel që i ka shërbyer mirë tempullit që nga përfundimi i tij 127 vjet më parë. Plani i sapopropozuar i përmirësimit sizmik për tempullin do të përdorë teknologjinë e veçimit të themelit nga godina, e cila as që mund të përfytyrohej në kohën e ndërtimit të tij. Kjo konsiderohet si inxhinieria më e fundit, më e përparuar për mbrojtjen nga tërmeti.

Kjo teknologji, e zhvilluar kohët e fundit, fillon pikërisht tek themeli i tempullit, duke siguruar një mbrojtje të fuqishme kundër dëmtimit nga një tërmet. Në thelb, ajo e forcon tempullin nga ana strukturore që të qëndrojë i palëkundur, madje ndërkohë që toka dhe mjedisi përreth tij i nënshtrohen një ngjarjeje sizmike tronditëse.




Punimet për Tempullin e Solt Lejkut filluan në vitin 1853.

Restaurimi i tempullit që do ta përfshinte këtë teknologji, u njoftua nga Presidenca e Parë vitin e kaluar. Nën drejtimin e Peshkopatës Kryesuese, ndërtimi filloi disa muaj më parë, në janar 2020. Ai është vlerësuar se do të përfundohet përafërsisht brenda katër vjetësh.

Sigurimi i Themelit Tuaj Vetjak

Kur mendoj për katër vitet e ardhshme të jetës së këtij Tempulli të bukur, fisnik, të nderuar dhe mahnitës të Solt-Lejkut, unë e përfytyroj atë më shumë si një kohë *ripërtëritjeje* sesa një kohë mbylljeje! Në mënyrë të ngjashme, ne mund të pyesim veten: “Si mund të na frymëzojë kjo ripërtëritje gjithëpërfshirëse e Tempullit të Solt-Lejkut që t’i nënshtrohem vetë *ripërtëritjes, rindërtimit, rilindjes, rigjallërimit ose rivendosjes* sonë shpirtërore?”

Një vështrim reflektues mund të zbulojë se ne dhe familjet tona mund të përfitojmë nga bërja e njëfarë pune të nevojshme mirëmbajtjeje dhe restaurimi, madje një përmirësim sizmik! Ne mund ta fillojmë një proces të tillë duke bërë pyetjen:



Përmirësimi sizmik i propozuar për Tempullin e Solt Lejkut konsiderohet si inxhinieria më e fundit, më e përparuar për mbrojtjen nga tërmeti.



“Në ç’gjendje është themeli im?”

“Cilat gjëra përbëjnë gurët e mëdhenj, të qëndrueshëm, të fortë të qosheve, që janë pjesë e themelit tim vetjak mbi të cilin mbështetet dëshmia ime?”

“Cilët janë elementet themelore të karakterit tim shpirtëror dhe emocional, që do të më lejonin mua dhe familjen time që të mbetemi të palëkundur dhe të qëndrueshëm, madje që t’u bëjmë ballë ngjarjeve tronditëse dhe të trazuara sizmike, të cilat sigurisht do të ndodhin në jetën tonë?”

Këto ngjarje, të ngjashme me një tërmet, shpesh janë të vështira për t’u parashikuar dhe vijnë në nivele të ndryshme intensiteti – ndeshja me pyetjet apo dyshimin, përballja me vuajtjet apo fatkeqësitë, zgjidhja me sukses e fyerjeve personale që lidhen me udhëheqësit, anëtarët, doktrinën ose rregulloren e Kishës. Mbrojtja më e mirë ndaj këtyre situatave gjendet brenda themelit tonë shpirtëror.

Cilët mund të jenë gurët shpirtërorë të qosheve për jetën tonë vetjake dhe familjare? Ata mund të jenë parimet e thjeshta, të qarta dhe të çmuara të të jetuarit të ungjillit – lutja familjare; studimi i shkrimeve të shenjta, përfshirë Librin e Mormonit; frekuentimi i tempullit; dhe të mësuarit e ungjillit nëpërmjet programit *Eja, Më Ndiq* dhe mbrëmjes së shtëpisë. Burime të tjera të dobishme për ta forcuar themelin tuaj

shpirtëror mund të përfshijnë Nenet e Besimit, proklamatën për familjen dhe dokumentin “Krishti i Gjallë”.

Për mua, parimet e përfshira në pyetjet që diskutohen si pjesë e marrjes së një rekomandimi tempulli shërbejnë si një bazë e fortë për një themel shpirtëror – veçanërisht katër pyetjet e para. I konsideroj ato si gurë shpirtërorë të qosheve.

Sigurisht, ne i dimë këto pyetje, pasi Presidenti Rasëll M. Nelson na i lexoi një e nga një në konferencën e përgjithshme më të fundit.

1. A keni besim dhe një dëshmi për Perëndinë, Atin e Përjetshëm; Birin e Tij, Jezu Krishtin; dhe Frymën e Shenjtë?
2. A keni një dëshmi për Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe për rolin e Tij si Shpëtimtari dhe Shëlbuesi juaj?
3. A keni një dëshmi për Rivendosjen e ungjillit të Jezu Krishtit?
4. A e mbështetni Presidentin e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme si profet, shikues dhe zbulues dhe si të vetmin njeri në tokë të autorizuar që t’i ushtrojë të gjithë çelësat e priftërisë?²⁸

A e kuptoni se si mund t’i konsideroni këto pyetje si elemente me vlerë në themelin tuaj vetjak për t’ju ndihmuar që ta ndërtoni e përforconi atë? Pali u mësoi efesianëve rreth një

kishe që ishte “ndërtuar mbi themelin e apostujve dhe të profetëve, duke qenë Jezu Krishti vetë guri i qoshes, mbi të cilin gjithë ndërtesa, e lidhur mirë, rritet për të qenë një tempull i shenjtë në Zotin”⁹.

Njëri nga gëzimet më të mëdha në jetën time është që të njihem me anëtarë të Kishës anembanë botës dhe të frymëzohem prej tyre, të cilët janë shembuj të gjallë të besimit të Jezu Krishti dhe ungjilli i Tij. Ata kanë themele të forta vetjake, të cilat i lejojnë që t’u bëjnë ballë ngjarjeve sizmike me një të kuptuar të qëndrueshëm, pavarësisht nga vuajtja dhe dhembja e tyre.

Për t’ua paraqitur këtë në një nivel më personal, kohët e fundit unë fola në shërbesën mortore të një bashkëshorteje dhe nëne të bukur, energjike dhe të re (gjithashtu një mikeshë e familjes sonë). Ajo ishte një lojtare energjike futbollit në kategorinë e parë të skuadrave universitare, kur u takua dhe u martua me bashkëshortin e saj që studioje për dentist. Ata u bekuan me një bijë të bukur, tepër të zhvilluar për moshën e saj. Ajo u ndesh plot guxim me forma të ndryshme të kancerit për gjashtë vite sfiduese. Pavarësisht nga ankthi gjithmonë i pranishëm emocional e fizik që përjetoi, ajo i mirëbesoi Atit të saj të dashur Qiellor dhe shpesh përmendej gjerësisht nga njerëzit që e ndiqnin në mjetet shoqërore të komunikimit për thënien e saj të famshme: “Perëndia është në çdo detaj të jetës”.

Në një nga publikimet e saj në mjetet shoqërore të komunikimit, ajo shkroi se dikush e kishte pyetur: “Si ke akoma besim me gjithë dhembjen që të rrethon?” Ajo u përgjigj vendosmërisht me këto fjalë: “Sepse është besimi që më bën të kaloj përmes këtyre kohëve të zymta. Të kesh besim nuk do të thotë që asgjë e keqe

nuk do të ndodhë. Pasja e besimit më lejon të besoj se do të ketë dritë përsëri. Dhe ajo dritë do të jetë edhe më e shkëlqyeshme ngaqë kam ecur përmes errësirës. Sado errësirë që kam dëshmuar përgjatë viteve, unë kam dëshmuar shumë më tepër dritë. Kam parë mrekulli. Kam ndier engjëj. E kam ditur që Ati im Qiellor po më mbështeste. Asnjë prej këtyre gjërave nuk do të ishte përjetuar, në qoftë se jeta do të ishte e lehtë. E ardhmja e kësaj jete mund të jetë e panjohur, por besimi im nuk është. Nëse zgjedh të mos kem besim, atëherë zgjedh të eci vetëm në errësirë. Sepse pa besim, gjithçka që mbetet është errësira.”¹⁰

Dëshmia e saj e patundur për besimin të Zoti Jezu Krisht – e shprehur në fjalët e saj dhe në veprimet e saj – ishte frymëzim për të tjerët. Dhe pse trupi i saj ishte *i dobët*, ajo i lartësoi të tjerët që të ishin *më të fortë*.

Po ashtu mendoj për anëtarë të tjerë të panumërt të Kishës, trima si kjo motër, të cilët ecin çdo ditë me besim, duke u përpjekur fort që të jenë dishepuj të vërtetë dhe të patrembur të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Ata mësojnë për Krishtin. Ata predikojnë për Krishtin. Ata përpiqen fort që të bëhen si Ai. Qoftë nëse ditët e jetës së tyre ndeshen me një tokë të qëndrueshme apo të paqëndrueshme, themeli i tyre shpirtëror është i fortë dhe i patundshëm.

Këta janë shpirtat e përkushtuar që e kuptojnë domethënien e thellë të vargut “që të Shpëtimtari kanë gjetur strehim”¹¹. Jam mirënjohës jashtë mase që të eci mes atyre që kanë përgatitur një themel shpirtëror, të denjë për emrin e *shenjtoreve* dhe të cilët janë të fortë e të sigurt aq sa t’u bëjnë ballë trazirave të shumta të jetës.

Nuk mendoj se mund ta theksojmë më shumë se ç’duhet rëndësinë e një



themeli të tillë të fortë në jetën tonë vetjake. Madje që në moshë të vogël, fëmijëve tanë të Fillores u mësohet të këndojnë pikërisht për këtë të vërtetë:

*Burri i urt' ngriti shtëpi mbi shkëmb,
Dhe shirat zbritën gjith' zhurm'. . . .
Shirat zbritën dhe u përmyt kudo,
Dhe shtëpia mbi shkëmb s'u tund.*¹²

Shkrimi i shenjtë e përforcon këtë doktrinë themelore. Shpëtimtari i dha mësim popullit në kontinentin amerikan:

“Dhe në qoftë se do t’i bëni gjithnjë këto gjëra, të bekuar jeni ju, pasi ju jeni *ndërtuar mbi shkëmbin tim*.

Por, të gjithë ata që do të bëjnë më pak ose më shumë se këto, *nuk janë ndërtuar mbi shkëmbin tim*, por janë ndërtuar mbi një themel prej rëre; dhe kur shiu të bjerë dhe përmytjet të vijnë, dhe erërat të fryjnë dhe të përplasen mbi ta, ata do të bien.”¹³

Është shpresa e sinqertë e udhëheqësve të Kishës që restaurimet e rëndësishme të Tempullit të Solt-Lejkut do të kontribuojnë në përmbushjen e dëshirës së Brigam Jangut që ta shihte “tempullin të ndërtuar në një mënyrë që ai do të durojë gjatë mijëvjeçarit”. Gjatë viteve të ardhshme, i lejofshim këto përmirësime të bëra Tempullit të Solt-Lejkut që të na nxitin e frymëzojnë shpirtërisht, si individë e si familje, kështu që edhe ne – në mënyrë metaforike – do të “ndërt[ohemi] në



Nga Plaku Gerit W. Gong,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

një mënyrë që [do] të durojë gjatë mijëvjeçarit”.

Ne do ta bëjmë këtë gjë kur përmbushim porosinë e Apostullit Pal që të “mbledh[im] si thesar [për veten tonë] *një themel të mirë për të ardhmen*, për të arritur jetën e përjetshme”¹⁴. Është lutja ime e zjarrtë që themeli ynë shpirtëror do të jetë i sigurt dhe i qëndrueshëm, që dëshmia jonë për Shlyerjen e Jezu Krishtit dhe rolin e Tij si Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë do të bëhet për ne guri ynë kryesor i qoshes, për të cilin unë dëshmoj në emrin e Tij, madje Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Ditar i Uilliam Klejtonit, 26 korrik 1847, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejck-Siti.
2. Shih “At the Tabernacle, Presidents Woodruff and Smith Address the Saints Yesterday Afternoon”, *Deseret Evening News*, 30 gusht 1897, f. 5; “Pioneers’ Day”, *Deseret Evening News*, 26 korrik 1880, f. 2; ditar i Uillford Udrait, 28 korrik 1847, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejck-Siti.
3. “Minutes of the General Conference of the Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, held at Great Salt Lake City, State of Deseret, April 6, 1851”, *Deseret News*, 19 gusht 1851, f. 241.
4. Shih “The Temple”, *Deseret News*, 19 shkurt 1853, f. 130; “Minutes of the General Conference”, *Deseret News*, 16 prill 1853, f. 146; “Minutes of the General Conference”, *Deseret News*, 30 prill 1853, f. 150.
5. “Address by President Brigham Young”, *Millennial Star*, 22 prill 1854, f. 241.
6. “Remarks by President Brigham Young”, *Deseret News*, 14 tetor 1863, f. 97.
7. Paraqitje nga Peshkopata Kryesuese mbi Tempullin e Solt-Lejckut për Presidencën e Parë, tetor 2015.
8. Shih Rasëll M. Nelson, “Fjalët e Hapjes”, *Liahona*, nëntor 2019, f. 121.
9. Efesianëve 2:20–21.
10. Publikim në mjetet e komunikimit shoqëror nga Kim Olsen White-i.
11. “Sa i Fort’ një Themel”, *Himne*, nr. 41.
12. “Burri i Urt’ dhe Burri Pa Mend”, *Libri i Këngëve të Fëmijëve*, f. 132; theksimet në origjinal u hoqën në këtë rast.
13. 3 Nefi 18:12–13; theksimi i shtuar.
14. 1 Timoteut 6:19; theksimi i shtuar.

Hosana dhe Aleluja – Jezu Krishti i Gjallë: Zemra e Rivendosjes dhe e Pashkës

Në këtë periudhë me hosana dhe aleluja, këndoni aleluja – sepse Ai do të mbretërojë përherë e përgjithmonë!

Të dashur vëllezër dhe motra: Me hosana dhe aleluja e kremtojmë Jezu Krishtin e gjallë në këtë periudhë Rivendosjeje të vazhdueshme dhe Pashke. Me dashuri të përsosur, Shpëtimtari ynë na siguron: “[Mund] ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!”¹

Disa vjet më parë, ndërsa Motra Gong dhe unë takuam një familje të dashur, vajza e tyre e vogël, Ivi, me druajtje e nxori violinën e saj nga çanta. Ajo nxori harkun e violinës, e tendosi dhe e leu me rrëshirë. Pastaj e vendosi harkun sërish në çantë, u përkul me nderim dhe u ul. Fare fillestare, ajo sapo na kishte treguar gjithçka që dinte rreth violinës. Tani, vite më vonë, Ivi luan në violinë shumë bukur.

Në këtë periudhë në vdekshmëri,

të gjithë ne jemi nga pak si Ivi dhe violina e saj. Ne e nisim nga fillimi. Me ushtrim dhe këmbëngulje, rritemi dhe përmirësohemi. Me kalimin e kohës, liria morale e zgjedhjes dhe përvojat në vdekshmëri na ndihmojnë të bëhemi më shumë si Shpëtimtari ynë, teksa punojmë me Të në vreshtin e Tij² dhe e ndjekim shtegun e Tij të besëlidhjes.

Përvjetorët, përfshirë këtë dyqindvjetor, i theksojnë modelet e rivendosjes³. Gjatë kremtimit të Rivendosjes në vazhdim e sipër të ungjillit të Jezu Krishtit, ne përgatitemi edhe për Pashkën. Tek



Oslo, Norvegji

të dyja, ne gëzojmë për kthimin e Jezu Krishtit. Ai jeton – jo vetëm atëherë, por tani; jo vetëm për disa, por për të gjithë. Ai erdhi dhe vjen për të shëruar zemërthyerit, për të çliruar robërit, për t'u kthyer shikimin të verbërve dhe për të çliruar të shtypurit⁴. Kështu është edhe për ne. Premtimet e Tij shëlbuese gjejnë zbatim, pavarësisht nga e kaluara jonë, e tashmja jonë, ose nga shqetësimet për të ardhmen tonë.

Nesër është e Diela e Palmave. Sipas traditës, palmat janë një simbol i shenjtë për të shprehur gëzimin në Zotin tonë, ashtu si në *Hyrjen Ngadhënjimtare të Krishtit në Jerusalem* ku “një turmë e madhe . . . mori degë palmash dhe i doli para”⁵. (Mund t’ju interesojë të dini se piktura origjinale nga Herri Andersoni, rri varur në zyrën e Presidentit Rasëll M. Nelson, pikërisht prapa tavolinës së tij të punës.) Te Libri i Zbulesës, ata që i japin lavdërimet Perëndisë dhe Qengjit, e bëjnë këtë “të veshur me rroba të bardha dhe me palma në duart e tyre”⁶. Bashkë me “rrobën e drejtësisë” dhe “kurora[t e] lavdi[së]” palmat përfshihen në lutjen e përkushtimit të Tempullit të Kirtlandit⁷.

Sigurisht, domethënia e të Dielës së Palmave shkon përtej turmave që e përshëndetin Jezusin me palma. Të Dielën e Palmave, Jezusi hyri në Jerusalem në mënyra që besimtarët i shihnin si përmbushje të profecisë. Ashtu siç parashikuan në mënyrë profetike Zakaria⁸ dhe Psalmisti, Zoti ynë hyri në Jerusalem hipur mbi një kërric, ndërsa turmat me dijeni të plotë brohoritnin: “Hosana në vendet shumë të larta!”⁹ Hosana do të thotë “të lutemi na shpëto [tani]”¹⁰. Në atë kohë, si dhe tani, ne ngazëllehemi: “I bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit”¹¹.

Një javë pas të Dielës së Palmave është e Diela e Pashkës. Presidenti

Rasëll M. Nelson na mëson se Jezu Krishti “erdhi të shlyente një borxh që s’e kishte, për shkak se ne kishim një borxh që nuk mund ta shlyenim”¹². Në të vërtetë, nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, të gjithë fëmijët e Perëndisë “mund të shpëtohe[n], me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit”¹³. Për Pashkë, ne këndojmë aleluja. Aleluja do të thotë “lavdi thuri Zotit Jehova”¹⁴. “Hallelujah Chorus” [“Refreni Aleluja”] në pjesën muzikore *Messiah [Mesia]* i Handelit, është një deklaratë Pashke shumë e dashur se Ai është “Mbret i mbretërve dhe Zot i zotërve”¹⁵.

Ngjarjet e shenjta ndërmjet të Dielës së Palmave dhe të Dielës së Pashkës janë histori me hosana dhe aleluja. Hosana është përgjërimi ynë që Perëndia të na shpëtojë. Aleluja shpreh lavdërimin tonë ndaj Zotit për shpresën e shpëtimit dhe ekzaltimit. Me hosana dhe aleluja ne e pranojmë Jezu Krishtin e gjallë si zemrën e Pashkës dhe të rivendosjes në ditët e mëvonshme.

Rivendosja në ditët e mëvonshme fillon me teofani – shfaqjen e njëmendtë të Perëndisë, Atit, dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, ndaj profetit të ri në moshë, Jozef Smithit. Profeti Jozef tha: “Nëse do të mund t’ia ngulnit sytë qiellit pesë minuta, do të dinit më shumë nga sa do të dinit duke lexuar gjithçka që është shkruar ndonjëherë mbi këtë temë”¹⁶. Për shkak se qiejt janë hapur sërish, ne e dimë dhe “besojmë në Perëndinë, Atin e Përrjetshëm, dhe në Birin e Tij, Jezu Krishtin, dhe në Frymën e Shenjtë”¹⁷ – Kreun-Perëndi hyjnor.

Të Dielën e Pashkës, më 3 prill 1836, në ditët e hershme të Rivendosjes, Jezu Krishti i gjallë u shfaq pasi u përkushtua Tempulli i Kirtlandit. Ata që e panë Atë atje, dëshmuar për Të në kontraste plotësuese si zjarri dhe uji: “Sytë e tij ishin si flakë zjarri; dhe



HYPJA NGADHËNJIMTARE E KRISHTIT NË JERUSALEM, NGA HARRY ANDERSON

flokët e kokës së tij ishin të bardhë si *dëborë e pastër*; fytyra e tij shkëlqente më shumë se *ndriçimi i diellit*; dhe zëri i tij ishte si tingulli i *rrjedhjes së shumë ujërave*, madje zëri i Jehovës”¹⁸.

Në atë rast, Shpëtimtari ynë shpalli: “Unë jam i pari dhe i fundit; unë jam ai që jeton, unë jam ai që u vra; unë jam avokati juaj me Atin”¹⁹. Përsëri, kontraste plotësuese – i pari dhe i fundit, jeton dhe u vra. Ai është Alfa dhe Omega, fillimi dhe mbarimi²⁰, autori dhe plotësonjësi i besimit tonë²¹.

Pas shfaqjes së Jezu Krishtit, erdhën edhe Moisiu, Eliasi dhe Elija. Me anë të drejtimit hyjnor, këta profetë të mëdhenj të lashtësisë i rivendosën çelësat dhe autoritetin e priftërisë. Në këtë mënyrë, “çelësat e kësaj periudhe të kujdestarisë [janë dhënë]”²² brenda Kishës së Tij të rivendosur për t’i bekuar të gjithë fëmijët e Perëndisë.

Ardhja e Elias në Tempullin e Kirtlandit përmbushi gjithashtu profecinë e Malakias në Dhiatën e Vjetër që Elija do të kthehej “para se të vijë dita e madhe dhe e llahtarshme e Zotit”²³. Duke e bërë këtë, shfaqja e Elias përkoi, ndonëse jo rastësisht, me periudhën e Pashkës judease, ku sipas traditës pritet me nderim kthimi i Elias.

Shumë familje të përkushtuara judease bëjnë një vend për Elijan në tryezën e tyre gjatë Pashkës judease.



Uest-Xhordan, Jutë, SHBA

Shumë njerëz mbushin një gotë plot për ta ftuar dhe mirëpritur atë. Dhe disa njerëz, gjatë gostisë rituale tradicionale Seder të Pashkës judease, çojnë një fëmijë te dera, që ndonjëherë lihet pak hapur, për të parë nëse Elija është jashtë duke pritur që ta ftojë brenda²⁴.

Në përmbushje të profecisë dhe si pjesë të rivendosjes së premtuar të të gjitha gjërave²⁵, Elija erdhi vërtet siç qe premtuar, në Pashkë dhe në vigilje të Pashkës judease. Ai solli autoritetin vulosës për t'i lidhur familjet në tokë dhe në qiell. Siç i mësoi Moroni Profetit Jozef, Elija “do të mbjellë në zemrat e fëmijëve premtimet e bëra etërve dhe zemrat e fëmijëve do të kthehen tek etërit e tyre. Në qoftë se nuk do të ishte kështu”, vijoi Moroni, “e tërë toka do të shkatërrohej plotësisht në ardhjen e [Zotit]”²⁶. Shpirti i Elijas, një shpërfaqje e Frymës së Shenjtë, na afron me brezat tanë – të kaluar, të tanishëm dhe të ardhshëm – me anë të gjenealogjive, historive dhe shërbimit tonë në tempull.

Le të kujtojmë shkurtimisht atë që shpreh Pashka judease. Pashka judease përkujton çlirimin e fëmijëve të Izraelit nga 400 vjet skllavëri. Libri i Eksodit tregon se si erdhi ky çlirim pas plagëve të bretkosave, mushkonjave, mizave, ngordhjes së bagëtisë, ulcerës, puçrrave, breshrit dhe zjarrit, karkalecave dhe errësirës së madhe. Plaga e fundit kanosi vdekjen e të parëlindurve në vend, por jo në

shtëpinë e Izraelit – në qoftë se ato vatra shtëpiake e vendosnin gjakun e qengjit motak pa të meta, tek arkitrau dhe shtalkat e dyerve²⁷.

Engjëlli i vdekjes kaloi pranë shtëpive të shenjura me gjakun simbolik të qengjit²⁸. Ai kalim pranë, ose kalimi tutje [si fjala Pashkë judease në anglisht], përfaqëson Jezu Krishtin që e mposht vdekjen përfundimisht. Në të vërtetë, gjaku shlyes i Qengjit të Perëndisë i jep fuqi Bariut tonë të Mirë që ta mbledhë popullin e Tij në të gjitha vendet dhe rrethanat, në vendin e sigurt të vathës së Tij, nga të dyja anët e velit.

Në mënyrë kuptimplote, Libri i Mormonit përshkruan “fuqin[në] dhe ringjallje[n e] Krishtit”²⁹ – thelbin e Pashkës – në kuadër të dy rivendosjeve.

Fillimisht, ringjallja përfshin rivendosjen fizike të “formës sonë” të përshtatshme dhe të përkryer; të “çdo gjymtyr[e] dhe nyj[e]”, “madje asnjë fije floku i kokës nuk do të humbasë”³⁰. Ky premtim u jep shpresë atyre të cilët kanë humbur gjymtyrë, atyre të cilëve e kanë humbur aftësinë për të parë, dëgjuar, ose ecur, apo atyre që konsiderohen si të shkatërruar nga sëmundjet e ashpra, sëmundjet mendore apo dobësimet e tjera të zotësive. Ai na gjen. Ai na shëron plotësisht.

Një premtim i dytë i Pashkës dhe i Shlyerjes së Zotit tonë është se, shpirtërisht “të gjitha gjërat do të

rivendosen në vendin e tyre të përshtatshëm”³¹. Kjo rivendosje shpirtërore pasqyron veprat dhe dëshirat tona. Ashtu si buka mbi ujin³², ajo rivendos “atë që është e mirë”, “e drejtë”, “që ka drejtësi” dhe [është] e “mëshirsh[me]”³³. Nuk është çudi që profeti Alma përdor fjalën *rivendos* 22 herë³⁴ teksa na shtyn të “veprojmë me drejtësi, gjykojmë drejt dhe [të] bëjmë” të mira vazhdimisht³⁵.

Për shkak se “Perëndia vetë shlyen për mëkatet e botës”³⁶, Shlyerja e Zotit mund të shërojë plotësisht jo vetëm atë që ishte, por edhe atë që mund të jetë. Për shkak se Ai na i njëj dhembjet, hidhërimet, sëmundjet, “tundime[t] tona” të çdo lloji³⁷, Ai mundet që, me mëshirë, të na ndihmojë sipas dobësive tona³⁸. Për shkak se Perëndia është “i përsosur, i drejtë dhe gjithashtu një Perëndi i mëshirshëm”, plani i mëshirës mund të “plotësojë” kërkesat e drejtësisë³⁹. Ne pendohe mi dhe bëjmë gjithçka mundemi. Ai na rrethon përjetësisht “në krahët e dashurisë së tij”⁴⁰.

Sot ne kremtojmë rivendosjen dhe ringjalljen. Bashkë me ju, gëzohem për Rivendosjen në vazhdim e sipër të plotësisë së ungjillit të Jezu Krishtit. Sikurse filloi 200 vjet më parë nga kjo pranverë, drita dhe zbulesa vazhdojnë të vijnë nëpërmjet profetit të gjallë të Zotit dhe Kishës së Tij, që mban emrin e Tij – Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme – dhe nëpërmjet zbulesës dhe frymëzimit vetjak me anë të dhuratës hyjnore të Frymës së Shenjtë.

Bashkë me ju, në këtë periudhë Pashke, unë dëshmoj për Perëndinë, Atin tonë të Amshuar, dhe Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin e gjallë. Njerëz të vdekshëm u kryqëzuan mizorisht dhe më vonë u ringjallën. Por vetëm Jezu Krishti i gjallë në formën

e Tij të përsosur, të ringjallur, i mbart ende vurratat e kryqëzimit në duart, këmbët dhe ijën e Tij. Vetëm Ai mund të thotë: “Unë të kam gdhendur në pëllëmbët e duarve të mia”⁴¹. Vetëm Ai mund të thotë: “Unë jam ai që u ngrit lart. Unë jam Jezusi që u kryqëzua. Unë jam Biri i Perëndisë.”⁴²

Ashtu si e vogla Ivi dhe violina e saj, ne, në disa mënyra jemi ende në fillim. Vërtet, “syri nuk i ka parë dhe veshi nuk i ka dëgjuar dhe nuk kanë hyrë në zemër të njeriut, . . . ato që Perëndia ka përgatitur për ata që e duan atë”⁴³. Në këto kohë, ne mund të mësojmë shumë për mirësinë e Perëndisë dhe potencialin tonë hyjnor që dashuria e Perëndisë të rritet brenda nesh ndërsa e kërkojmë Atë dhe i vijmë në ndihmë njëri-tjetrit. Në mënyra të reja dhe vende të reja ne mund të veprojmë dhe të bëhemi [bekim], rregull pas rregulli, dashamirësi pas dashamirësie, individualisht dhe së bashku.

Të dashur vëllezër dhe motra kudo ku jeni, teksa takohemi dhe mësojmë së bashku, besimi dhe mirësia juaj më mbush me një ndjenjë emocioni dhe mirënjohjeje për aventurën në ungjill. Dëshmia dhe rrugëtimi juaj në ungjill e pasurojnë dëshminë dhe rrugëtimin tim në ungjill. Shqetësimet dhe gëzimet tuaja, dashuria juaj për shtëpinë e Perëndisë dhe komunitetin e shenjtoreve, si dhe kuptueshmëria e marrë gjatë jetës për të vërtetën dhe dritën e rivendosur, e rritin kuptueshmërinë time për ungjillin e rivendosur, me Jezu Krishtin e gjallë në zemër të tij. Së bashku ne mirëbesojmë: “N’qoft shi a diell, Zot, me mua rri!”⁴⁴ Të bashkuar e dimë se, mes barrëve dhe shqetësimeve, ne mund t’i numërojmë bekimet tona të shumta⁴⁵. Në gjërat e hollësishme, të vogla dhe të thjeshta të jetës së përditshme, ne mund



të shohim se gjëra të mëdha do të ndodhin në jetën tonë⁴⁶.


“Dhe do të ndodhë që të drejtët do të mbledhen prej gjithë kombeve dhe do të vijnë në Sion, duke kënduar këngë gëzimi të përhershëm.”⁴⁷ Në këtë periudhë me hosana dhe aleluja, këndon aleluja – sepse Ai do të mbretërojë përherë e përgjithmonë! Me brohori, hosana Perëndisë dhe Qengjit! Në emrin e shenjtëruar dhe të shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Gjoni 16:33.
2. Shih Jakobi [LiM] 5.
3. Siç profetizohet në shkrimet e shenja, historia njëzëzore tregon periudha apo cikle të rënies shpirtërore që i quajmë braktisje ose rënie, dhe periudha drite të përtërirë që i quajmë rivendosje shpirtërore; shih, për shembull, 2 Thesalonikasve 2:3.
4. Shih Lluca 4:18.
5. Gjoni 12:12–13; shih edhe Mateu 21:8–9; Marku 11:8–10.
6. Zbulesa 7:9.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 109:76.
8. Shih Zakaria 9:9.
9. Mateu 21:9.
10. Shih tek Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta “Hosana”. Që nga kohët e Dhiatës së Vjetër, valëvitja e degëve të palmës shoqëronte përsëritjen e frazës: “O Zot, na ndihmo tani.” Psalmi 118:25 është shprehja e plotë e lutjes mesianike tradicionale: “O Zot, na ndihmo tani; o Zot, bëj që tani të kemi mbarësi”.
11. Psalmeve 118:26; shih edhe 3 Nefi 11:17.
12. Russell M. Nelson, në *Handel’s Messiah: Debtor’s Prison* (material filmik), ChurchofJesusChrist.org/media-library.
13. Nenet e Besimit 1:3.
14. Shih Bible Dictionary, “Hallelujah”.
15. George Frideric Handel, *Messiah*, red.

T. Tertius Noble (1912), viii; shih edhe Zbulesa 17:14.

16. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 447.
17. Nenet e Besimit 1:1.
18. Doktrina e Besëlidhje 110:3; theksimi i shtuar.
19. Doktrina e Besëlidhje 110:4.
20. Shih Zbulesa 1:8; 3 Nefi 9:18; Doktrina e Besëlidhje 19:1; 38:1; 45:7.
21. Shih Hebrejve 12:2; Moroni 6:4.
22. Doktrina e Besëlidhje 110:16.
23. Malakia 4:5
24. Shih Stephen D. Ricks, “The Appearance of Elijah and Moses in the Kirtland Temple and the Jewish Passover”, *BYU Studies*, vëll. 23, nr. 4 (1986), f. 483–486, byustudies.byu.edu.
25. Shih Doktrina e Besëlidhje 86:10; shih edhe Veprat e Apostujve 3:19–21.
26. Joseph Smith – Historia 1:39; vitet e fundit, shumë njerëz kanë menduar se është domethënës përdorimi i përemrit të posaçëm pronor “i tyre”.
27. Shih Eksodi 7–12.
28. Shih Eksodi 12:23.
29. Alma 41:2.
30. Alma 40:23.
31. Alma 41:4.
32. Shih Predikuesit 11:1.
33. Alma 41:13.
34. Fjalët *rivendos*, *rivendoset*, *rivendosje*, ose variante të tjera, paraqiten 22 herë tek Alma 40:22–24 dhe tek Alma 41, theksohet si rivendosja fizike, ashtu edhe ajo shpirtërore.
35. Alma 41:14.
36. Alma 42:15.
37. Alma 7:11.
38. Shih Alma 7:12.
39. Alma 42:15.
40. 2 Nefi 1:15.
41. Isaia 49:16; 1 Nefi 21:16.
42. Doktrina e Besëlidhje 45:52.
43. 1 Korintasve 2:9.
44. “Me Mua Rri!” *Himne*, nr. 94.
45. Shih “Numëro Bekimet”, *Himne*, nr. 152.
46. Shih Alma 37:6.
47. Doktrina e Besëlidhje 45:71.



Nga Laudi Ruth Kouk,
Anëtare e Lagjes së 14-të, Slejt Keniën (Spanjisht),
i Kunjtit Provo, Juta:

Mënyra se si Priftëria e Bekon Rininë

*Nëpërmjet priftërisë ne mund të lartësohemi.
Priftëria sjell dritë në botën tonë.*

Jam mirënjohëse që jam këtu. Kur zbulova për herë të parë se do të kisha mundësinë për t'ju folur sot, u ndjeva shumë e emocionuar, por në të njëjtën kohë shumë e përrallur. Kam shpenzuar shumë kohë duke menduar rreth asaj që mund të thoja dhe shpresoj që Shpirti t'ju flasë drejtpërdrejt nëpërmjet mesazhit tim.

Në Librin e Mormonit, Lehi i jep një bekim secilit prej djemve të tij përpara se ai të ndërronte jetë, gjë e cila i ndihmon ata të shohin pikat e tyre të forta dhe potencialin e tyre të përjetshëm. Unë jam më e vogla e tetë fëmijëve dhe vitin e kaluar kam qenë fëmija i vetëm në shtëpi për herë të parë. Mospasja pranë e vëllezërve dhe motrave të mia dhe mospasja gjithmonë e dikujt me të cilin të flisja ka qenë e vështirë për mua. Ka pasur net kur jam ndier shumë e vetmuar. Jam mirënjohëse për prindërit e mi, të cilët kanë bërë më të mirën e tyre për të më ndihmuar. Një shembull i kësaj është kur babi im u ofrua për të më dhënë një bekim priftërie për ngushëllim gjatë një kohe veçanërisht sfiduese. Pas bekimit të tij, gjërat nuk ndryshuan menjëherë, por unë isha në gjendje të ndieja paqe e dashuri nga Ati Qiellor dhe nga babi im.

Ndihem e bekuar që kam një baba të denjë i cili mund të më japë bekime priftërie kurdoherë që kam nevojë për to dhe i cili më ndihmon të shoh pikat e mia të forta dhe potencialin tim të përjetshëm, njësoj siç bëri Lehi kur i bekoji fëmijët e tij.

Pavarësisht nga rrethanat tuaja, ju mund të keni gjithmonë qasje ndaj bekimeve të priftërisë. Nëpërmjet anëtarëve të familjes, miqve, vëllezërve shërbëtarë, udhëheqësve të priftërisë dhe një Ati Qiellor i cili nuk do t'ju lërë kurrë në baltë, ju mund të merrni bekimet e priftërisë. Plaku Nil L. Andersen tha: "Bekimet e priftërisë janë pambarimisht më të mëdha se ai

të cilit i kërkohet të administrojë dhuratën. . . . Kur jemi të denjë, ordinancat e priftërisë e pasurojnë jetën tonë."¹

Mos ngurroni të kërkoni një bekim kur keni nevojë për udhërrëfim shtesë. Është në çastet tona të vështira që kemi nevojë që Shpirti të na ndihmojë më së shumti. Askush nuk është i përsosur dhe të gjithë ne përjetojmë vështirësi. Disa prej nesh mund të vuajnë nga ankthi, depresioni, varësitë apo nga ndjenja se nuk jemi mjaftueshëm të mirë. Bekimet e priftërisë mund të na ndihmojnë t'i kapërcejmë këto sfida dhe të marrim paqe teksa shkojmë përpara në të ardhmen. Shpresoj se po përpiqemi fort të jetojmë me denjësi për t'i marrë këto bekime.

Një mënyrë tjetër se si na bekon priftëria është nëpërmjet bekimeve patriarkale. Unë kam mësuar që t'i drejtohem bekimit tim patriarkal kurdoherë që ndihem e trishtuar ose e vetmuar. Bekimi im më ndihmon të shoh potencialin tim dhe planin e posaçëm që Perëndia ka për mua. Ai më ngushëllon dhe me ndihmon të shoh përtej këndvështrimit tim tokësor. Ai më kujton për dhuratat e mia dhe për bekimet që do të marr nëse jetoj me denjësi. Ai gjithashtu më ndihmon të kujtoj dhe të ndihem në paqe se Perëndia do të



San Paolo, Brazil

sigurojë përgjigje dhe do të m'i hapë dyert pikërisht në çastin e duhur kur do të më nevojitet më shumë.

Bekimet patriarkale na ndihmojnë të përgatitemi për t'u kthyer e për të jetuar me Atin tonë Qiellor. Unë e di se bekimet patriarkale vijnë nga Perëndia dhe mund të na ndihmojnë për t'i kthyer dobësitë tona në pika të forta. Këto nuk janë mesazhe nga parashikuesi fati; këto bekime na thonë atë që duhet të dëgjojmë. Ato janë si një Liahona për secilin prej nesh. Kur ne e vendosim Perëndinë të parin dhe kemi besim në Të, Ai do të na udhëheqë përmes vetë vendit tonë të shkretët.

Ashtu si Perëndia e bekoji Jozef Smithin me priftërinë në mënyrë që bekimet e ungjillit të mund të rivendoseshin, kështu ne mund t'i marrin bekimet e ungjillit në jetën tonë nëpërmjet priftërisë. Çdo javë na jepet privilegji dhe mundësia për të marrë sakramentin. Nëpërmjet kësaj ordinance të priftërisë, mund të kemi gjithmonë Shpirtin me vete, i cili mund të na pastrojë dhe të na bëjë të dëlirë. Nëse ndieni nevojën për të hequr diçka nga jeta juaj, kërkonin ndihmën e një udhëheqësi të besuar i cili mund t'ju ndihmojë që të futeni në shtegun e duhur. Udhëheqësit tuaj mund t'ju ndihmojnë për të përdorur fuqinë e plotë të Shlyerjes së Jezu Krishtit.

Falë priftërisë, ne gjithashtu mund të marrim bekimet e ordinancave të tempullit. Që nga koha që kam qenë në gjendje të hyj në tempull, e kam bërë një synim dhe përparësi që të marr pjesë rregullisht. Duke gjetur kohën dhe duke bërë sakrificat e nevojshme për të qenë më pranë Atit tim Qiellor në shtëpinë e Tij të shenjtë, unë jam bekuar me marrjen e zbulësës dhe nxitjeve që vërtet më kanë ndihmuar gjatë gjithë jetës sime.

Nëpërmjet priftërisë ne mund të lartësohemi. Priftëria sjell dritë në botën tonë. Plaku Robert D. Hejls tha: "Pa fuqinë e priftërisë, 'e gjithë toka do të shkatërrohej tërësisht' (shih D&E B 2:1–3). Nuk do të kishte dritë, as shpresë – vetëm errësirë."²

Perëndia po brohoret për ne. Ai dëshiron që ne të kthehemi tek Ai. Ai na njeh personalisht. Ai ju njeh. Ai na do. Ai është gjithmonë i vetëdijshëm për ne dhe na bekon edhe kur mendojmë se nuk e meritojmë. Ai e di se për çfarë kemi nevojë dhe kur kemi nevojë për të.

"Lypni dhe do t'ju jepet; kërkonin dhe do të gjeni; trokitni dhe do t'ju çelet.

Sepse kush lyp merr, kush kërkon gjen dhe do t'i çelet atij që troket" (Mateu 7:7–8).

Nëse nuk e keni tashmë një dëshmi rreth priftërisë, unë ju nxit të luteni dhe të kërkonin që të dini vetë mbi fuqinë e saj dhe më pas t'i lexoni




shkrimet e shenjta për të dëgjuar fjalët e Perëndisë. E di që nëse bëjmë një përpjekje për të përjetuar fuqinë e priftërisë së Perëndisë në jetën tonë, ne do të bekohemi. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Nil L. Andersen, "Fuqi në Priftëri", *Liahona*, nëntor 2013, f. 92.
2. Robert D. Hales, "Blessings of the Priesthood", *Ensign*, nëntor. 1995.



MBILU, BASHKËSHËRBËTORET E MI, LINDA CURLEY CHRISTENSEN DHE MICHAEL MALM



Nga Enco Serhe Petelo,
Anëtar i Lagjes Midou Ud, Kunji i Exhmontit,
Provo, Jutë

Mënyra se si Priftëria e Bekon Rininë

Na jepet mundësia të japim shërbesë si të engjëjve, ta predikojmë ungjillin në të gjitha kontinentet e tokës dhe t'i ndihmojmë shpirtrat që të vijnë te Krishti.

Vëllezër dhe motra, jam vërtet mirënjohës që ju flas në këtë mbrëmje historike rreth dhuratës së shenjtë të priftërisë dhe fuqisë së mrekullueshme që ajo ka, për ta bekuar rininë në këtë periudhë ungjillore. Lutem që, pavarësisht nga papërsosuritë e mia, Shpirti të më vijë në ndihmë për ta dhënë mësim të vërtetën.

Presidenca e Parë u ka kujtuar mbajtësve të Priftërisë Aarone: “Ju jetoni në një kohë të mundësive dhe sfidave të mëdha – një kohë në të cilën priftëria është rivendosur. Ju keni autoritetin për të administruar ordinancat e Priftërisë Aarone. Kur e ushtroni me lutje e me denjësi atë autoritet, do të beconi së tepërmi jetën e atyre që janë përreth jush.”¹ Si të rinjtë e Kishës, edhe ne na kujtojnë që jemi “bilj të] dashur [të] Perëndisë dhe Ai ka një punë për [ne] që ta bëjmë”² dhe i vijnë në ndihmë për veprën e Tij që “të bëjë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39).

Priftëria është autoriteti për t’ua administruar ordinancat dhe besëlidhjet e ungjillit të Shpëtimtarit atyre që janë të denjë për t’i marrë ato. Nëpërmjet këtyre ordinancave dhe besëlidhjeve

të shenjta të priftërisë vijnë bekimet e plota të Shlyerjes së Shpëtimtarit, e cila na ndihmon ta arrijmë fatin tonë hyjnor.

Jozef Smithi ishte një i ri që u thirr nga Perëndia për ta rivendosur ungjillin e Jezu Krishtit dhe, për atë qëllim, iu dha priftëria, të cilën ai e përdori për të bekuar gjithë njerëzimin. Doktrina e Besëlidhje 135 citon shumë prej bekimeve që Jozefi i ka dhënë rinisë së kësaj periudhe ungjillore. Lexojmë: “Joseph Smith-i . . . ka bërë më shumë, përveç Jezusit vetëm, për shpëtimin e njerëzve në këtë botë, sesa çdo njeri

tjetër që jetoi ndonjëherë në të. . . . Ai ka sjellë Librin e Mormonit . . . u ka dërguar plotësinë e ungjillit të përjetshëm . . . katër anëve të dheut; ka sjellë zbulesat dhe urdhërimet që përbëjnë . . . “Doktrina e Besëlidhje[t]”. . . , mblodhi me mijëra Shenjtorë të Ditëve të Mëvonshme, . . . dhe la një famë e një emër që nuk mund të vritet”(Doktrina e Besëlidhje 135:3).

Për të shërbyer me efektshmëri sikurse Jozefi, ne duhet të kualifikohemi denjësisht për ta përdorur fuqinë e priftërisë së Zotit. Ndërkohë që përkthenin Librin e Mormonit, Jozefi dhe Oliver Kauderi dëshironin të pagëzoheshin, por iu mungonte autoriteti i duhur. Më 15 maj 1829, ata u gjunjëzuan në lutje dhe u vizituan nga Gjon Pagëzori, i cili u dha atyre çelësat dhe autoritetin e Priftërisë Aarone, duke thënë: “Mbi ju, bashkëshërbëtorët e mi, në emër të Mesias, unë jap Priftërinë e Aaronit, e cila mban çelësat e shërbesës së engjëjve dhe të ungjillit të pendimit e të pagëzimit me zhytje për heqjen e mëkateve” (Doktrina e Besëlidhje 13:1).

Na jepet mundësia të japim shërbesë si të engjëjve, ta predikojmë ungjillin në të gjitha kontinentet e



Igëll-Mauntin, Jutë, SHBA

tokës dhe t'i ndihmojmë shpirtat që të vijnë te Krishti. Ky shërbim na vë në bashkëpunim me Gjon Pagëzorin, Moronin, Jozef Smithin, Presidentin Rasëll M Nelson dhe shërbëtorë të tjerë të zellshëm të Perëndisë.

Shërbimi ynë në dhe me priftërinë e Tij i bën bashkë ata që i përkushtohen ndjekjes dhe të jetuarit të mësimëve të Zotit me përpikëri, të cilat e di vetë se mund të jenë të vështira teksa përballemi me sfidat e rinisë. Por bashkimi me këta bashkëshërbëtorë të Zotit për përmbushjen e veprës së Tij do të ndihmojë për të na forcuar kundër tundimeve dhe mashtrimeve të kundërshtarit. Ju mund të jeni një fener drite për të gjithë ata që janë të pasigurt për veten. Drita brenda jush do të ndriçojë aq fort sa gjithkush me të cilin do të ndërveproni, do të bekohet thjesht ngaqë do të jetë në shoqërinë tuaj. Mund të jetë e vështirë nganjëherë ta dallojmë praninë e shoqëruesve tanë shpirtërorë, por jam mirënjohës që e di se jam anëtar i një kuorumi besnik të priftërisë, me të cilin mund të punoj për t'u afruar më shumë me Krishtin.

Së bashku me miqtë dhe familjen tonë, Fryma e Shenjtë është një nga shoqëruesit tanë më të besës e më të besuar. Por në mënyrë që ta ftojme shoqërimin e Tij të vazhdueshëm, duhet ta vëmë veten në situata dhe vende ku Ai do të dëshirojë të jetë i pranishëm. Kjo mund të fillojë nga vetë shtëpitë tona, teksa punojmë për t'i bërë ato vende të shenjta duke marrë pjesë në studim të përditshëm të shkrimeve të shenjta e lutje si familje dhe, më e rëndësishmja, teksa ne i studiojmë vetë shkrimet e shenjta dhe lutemi më vete.

Më herët gjatë këtij viti, m'u dha një mundësi emocionuese por prapëse-prapë përulëse që të ndihmoja motrën

time të vogël, Oshëninë, të përparonte në shtegun e besëlidhjes duke e pranuar ftesën për t'u pagëzuar e për të përmbushur një nga kërkesat e rekomanduara për të hyrë në mbretërinë çelestiale. Ajo e shtyu pagëzimin e saj një muaj, derisa unë u shugurova prift, për të më dhënë privilegjin që ta kryeja ordinancën ndërkohë që motrat e tjera tonat patën gjithashtu privilegjin për të punuar sipas caktimit nga priftëria dhe të qëndronin si dëshmitare. Teksa qëndronim në dy anë të kundërta të pagëzores dhe përgatitshim për të hyrë në ujë, unë e vura re emocionin e saj tek përputhej me timin. Dhe u ndjeva i bashkuar me të tek shihja se ajo po merrte vendimin e duhur. Kjo mundësi për ta ushtruar priftërinë, kërkonte nga unë që të isha më i kujdesshëm dhe më pak i shkujdesur në të jetuarit e ungjillit. Në mënyrë që të përgatitesha, shkova në tempull çdo ditë atë javë, i përkrahur nga mamaja, gjyshja dhe motra ime për të kryer pagëzime për të vdekurit.

Kjo përvojë më mësoi shumë rreth priftërisë dhe mënyrës se si mund ta ushtrroja atë me denjësi. E di se të gjithë mbajtësit e priftërisë mund t'i ndiejnë të njëjtat gjëra që ndjeva unë nëse e ndjekin shembullin e Nefit duke "shk[uar e duke] bë[rë]"(shih 1 Nefi 3:7). Ne nuk mund të rrimë ulur me përtaci dhe të presim që Zoti të na përdorë në veprën e Tij të madhërishe. Ne nuk duhet të presim që të na kërkojnë ata të cilët kanë nevojë për ndihmën tonë; është detyra jonë si mbajtës të priftërisë që të japim shembull e të qëndrojmë si dëshmitarë të Perëndisë. Nëse jemi duke marrë vendime që na e pengojnë përparimin tonë të përjetshëm, duhet të ndryshojmë tani. Satani do të përpiqet me gjithë forcën për të na mbajtur në një gjendje të mishit duke



kërkuar kënaqësi të thjeshta. Por unë e di se, po ta bëjmë përpjekjen, t'i gjejmë ata që do të na përkrahin dhe të pendohe mi çdo ditë, bekimet që do të rrjedhin nga këto do të jenë të jashtëzakonshme dhe jeta jonë do të ndryshojë përgjithmonë teksa çajmë përpara në shtegun e besëlidhjes.

E di se kjo është Kisha e vërtetë e Jezu Krishtit, i cili është Shpëtimtari ynë dhe ua ka deleguar çelësat e priftërisë Apostujve të Tij, të cilët i përdorin ata për të na udhërrëfyer, veçanërisht në këto ditë sfiduese dhe për ta përgatitur botën për kthimin e Tij.

Unë e di se Jozef Smithi ishte profeti i Rivendosjes dhe se Presidenti Nelson është profeti ynë i gjallë sot. Unë e ftoj secilin prej nesh që ta studiojë jetën e këtyre mbajtësve të mëdhenj të priftërisë dhe të kërkojë ta përmirësojë veten çdo ditë që të mund të jetë gati për t'u takuar me Krijuesin e vet. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Presidenca e Parë, në *Plotësoj një Detyrë ndaj Perëndisë* (broshurë, 2010), f. 5.
2. Tema e kuorumeve të Priftërisë Aarone, në *General Handbook: Serving in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints*, 10.1.2, [Biblioteka e ungjillit në internet, në pjesën "Rinia"], ChurchofJesusChrist.org.



Nga Xhin B. Bingham,
Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës

Të Bashkuar në Përmbushjen e Punës së Perëndisë

Mënyra më e efektshme për ta përmbushur potencialin tonë hyjnor është që të punojmë së bashku, të bekuar nga fuqia dhe autoriteti i priftërisë.

Të dashura motra dhe vëllezër të mrekullueshëm, është kënaqësi që të jem me ju. Kudo që po na dëgjoni, unë ju jap një përqaftim motrave të mia dhe një shtrëngim duarsh të përzemërt vëllezërve të mi. Ne jemi të bashkuar në veprën e Zotit.

Kur mendojmë për Adamin dhe Evën, shpesh mendimi ynë i parë është për jetën e tyre idilike në Kopshtin e Edenit. Përfytyroj sikur moti ishte gjithmonë i përsosur – as shumë i nxehtë dhe as shumë i ftohtë – dhe ato fruta e perime me bollëk e të shijshme rriteshin mjaft pranë tyre, sa që ata mund të hanin sa herë që dëshironin. Duke qenë se kjo ishte një botë e re për ta, kishte shumë gjëra për të zbuluar, kështu që çdo ditë ishte interesante teksa ndërvepronin me jetën shtazore dhe eksploronin mjediset e tyre të bukura rrethuese. Atyre gjithashtu iu dhanë urdhërime të cilave duhej t'u bindeshin dhe ata kishin mënyra të ndryshme për t'iu qasur atyre udhëzimeve, gjë që fillimisht shkaktoi njëfarë ankthi e pështjellimi.¹

Por ndërsa morën vendime që e ndryshuan jetën e tyre përgjithmonë, ata mësuan të punojnë së bashku dhe u bashkuan në përmbushjen e qëllimeve që Perëndia kishte për ta – dhe për të gjithë fëmijët e Tij.

Tani përfytyrojeni po të njëjtin çift në vdekshmëri. Ata duhej të punonin për ushqimin e tyre, disa nga kafshët i konsideronin *ata* si ushqim dhe kishte sfida të vështira që mund të kapërceheshin vetëm kur këshilloheshin dhe luteshin së bashku. Përfytyroj që të paktën disa herë ata kishin mendime



të ndryshme rreth mënyrës se si t'iu qaseshin atyre sfidave. Sidoqoftë, nëpërmjet Rënies, ata kishin mësuar se ishte thelbësore që të vepronin në unitet dhe dashuri. Në mësimet që morën nga burime hyjnore, atyre iu mësuan plani i shpëtimit dhe parimet e ungjillit të Jezu Krishtit të cilat e bëjnë planin veprues. Ngaqë e kuptuan se qëllimi tokësor dhe synimi i tyre i përjetshëm ishin të njëjtë, ata gjetën kënaqësi dhe patën sukses kur mësuan të punonin në dashuri e drejtësi së bashku.

Kur lindën fëmijë, Adami dhe Eva i mësuan familjes së tyre atë që kishin mësuar nga lajmëtarë qiellorë. Ata ishin të përqendruar për t'i ndihmuar fëmijët e tyre që gjithashtu t'i kuptonin dhe përqaftonin ato parime të cilat do t'i bënin të lumtur në këtë jetë, si dhe të ishin të përgatitur për t'u kthyer te prindërit e tyre qiellorë pasi t'i kishin shtuar aftësitë e tyre dhe ta vinin në provë bindjen e tyre ndaj Perëndisë. Gjatë procesit, Adami dhe Eva mësuan t'i vlerësonin pikat e tyre të forta e të ndryshme dhe e përkrahën njëri-tjetrin në punën e tyre me domethënie të përjetshme.²

Ndërkohë që shekuj, e më pas mijëvjeçarë, shkuan e ikën, qartësia e kontributeve të frymëzuara dhe të ndërvarura të burrave e grave u mjegullua nga keqinformimi dhe keqkuptimet. Gjatë kohës midis atij fillimi të mrekullueshëm në Kopshtin e Edenit dhe deri tani, kundërshtari ka qenë mjaft i suksesshëm në synimin e vet për t'i përçarë burrat e gratë, në orvatjet e tij për t'i mposhtur shpirtat tanë. Luciferi e di që, po qe se mund ta dëmtojë unitetin që ndiejnë burrat e gratë, po qe se ai mund të na pështjellojë rreth vlerës sonë hyjnore dhe përgjegjësi të besëlidhjeve tona, ai do të arrijë t'i shkatërrojë familjet, të cilat janë njësitë themelore të përjetësisë.

Satani e stimulon përdorimin e krahasimit si një mjet për të krijuar ndjenja të të qenit më lart ose më poshtë, duke e fshehur të vërtetën e përjetshme se dallimet që nga lindja të burrave dhe grave janë dhënë nga Perëndia dhe vlerësohen njëllë nga Ai. Ai është orvatur t'i zhvlerësojë kontributet e grave si në familje ashtu edhe në shoqëri civile, duke e zvogëluar në këtë mënyrë ndikimin e tyre lartësues për mirë. Synimi i tij ka qenë të inkurajojë një luftë për pushtet në vend që të kremtohet për kontributet e pashoqe të burrave dhe grave që e plotësojnë njëri-tjetrin dhe kontribuojnë në unitet.

Pra, me kalimin e viteve dhe në mbarë globin, u zhduk në masë të madhe një kuptim i plotë i kontributeve dhe përgjegjësive të ndërvarura në mënyrë hyjnore dhe prapëseprapë të ndryshme të grave e burrave. Femrat në shumë shoqëri u bënë të nënshtruara ndaj meshkujve në vend që të ishin partnere krahu për krahu, ku veprimtaritë e tyre u kufizuan në një fushë të ngushtë veprimi. Përparimi shpirtëror u ngadalësua shumë gjatë atyre kohëve të errëta; me të vërtetë, pak dritë shpirtërore mund të depërtonte në mendjet dhe zemrat e rrënjësura në traditat e sundimit mbi tjetrin.

Dhe më pas drita e ungujillit të rivendosur u bë "më e shkëlqyeshme se dielli"³, kur Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, iu shfaqën djalit Jozef Smith në fillim të pranverës së vitit 1820, në atë zonë pyjore të shenjtë në pjesën veriore të shtetit të Nju-Jorkut. Kjo ngjarje filloi një derdhje të zbulesës bashkëkohore nga qielli. Një nga elementët e parë të Kishës fillestare të Krishtit që u rivendos, ishte autoriteti i priftërisë së Perëndisë. Ndërsa Rivendosja vazhdoi të shpalosej, burrat dhe gratë filluan ta kuptojnë përsëri rëndësinë dhe potencialin e të punuarit si

partnerë, të autorizuar e të drejtuar në këtë punë të shenjtë nga Ai.

Në vitin 1842, kur gratë e Kishës, e cila sapo ishte formuar, donin të krijonin një grup zyrtar për të ndihmuar në këtë punë, Presidenti Jozef Smith u ndje i frymëzuar që t'i organizonte ato "nën priftërinë dhe sipas modelit të priftërisë"⁴. Ai tha: "Tani, jua jap juve çelësin në emrin e Perëndisë . . . – ky është fillimi i ditëve më të mira"⁵. Dhe që kur u dha ky çelës, mundësitë arsimore, politike dhe ekonomike për gratë kanë filluar të zgjerohen gradualisht kudo në botë.⁶

Kjo organizatë e re e Kishës për gratë, e quajtur Shoqata e Ndihmës, ishte ndryshe nga shoqëritë e tjera të grave të asaj kohe, sepse ajo u themelua nga një profet, i cili vepronte me autoritetin e priftërisë për t'iu dhënë grave autoritet, përgjegjësi të shenjtë dhe pozicione drejtuese brenda strukturës së Kishës, jo të veçuara prej saj.⁷

Që nga koha e Profetit Jozef Smith deri në kohën tonë, rivendosja e vazhdueshme e të gjitha gjërave ka sjellë qartësim mbi domosdoshmërinë e autoritetit dhe fuqisë së priftërisë, duke i ndihmuar burrat e gratë të përmbushin përgjegjësitë e tyre të caktuara në mënyrë hyjnore. Kohët e fundit na është mësuar se gratë që veçohen nën drejtimin e dikujt i cili mban çelësat e priftërisë, veprojnë me *autoritetin e priftërisë* në thirrjet e tyre.⁸

Në tetor të vitit 2019, Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim se gratë që kanë marrë dhurimin [indaumentin] në tempull, kanë *fuqinë e priftërisë* në jetën e tyre dhe në shtëpitë e tyre, kur i mbajnë ato besëlidhje të shenjtë që bënë me Perëndinë⁹. Ai shpjegoi se "qiejt janë thjesht po aq të hapur për *gratë* që e kanë marrë dhurimin me fuqinë e Perëndisë që rrjedh prej besëlidhjeve të tyre të priftërisë,

sa janë të hapur për burrat që mbajnë priftërinë". Dhe ai e nxiti çdo motër: "Mbështet[uni] lirisht te fuqia e Shpëtimtarit për ta ndihmuar familjen tuaj dhe njerëzit e tjerë që i doni"¹⁰.

Pra, çfarë do të thotë kjo për ju dhe mua? Si e ndryshon jetën tonë të kuptuarit e autoritetit dhe fuqisë së priftërisë? Njëri nga çelësat është të kuptojmë se kur gratë dhe burrat punojnë së bashku, ne përmbushim shumë më tepër gjëra sesa kur punojmë veçmas.¹¹ Rolet tona janë bashkëplotësuese dhe jo konkurruese. Edhe pse gratë nuk shugurohen në një detyrë të priftërisë, siç u përmend më parë, gratë bekohen me fuqinë e priftërisë kur i mbajnë besëlidhjet e tyre, dhe veprojnë me autoritetin e priftërisë kur veçohen në një thirrje.

Një ditë të bukur gushti, pata privilegjin të ulesha me Presidentin Rasëll M. Nelson në shtëpinë e rikonstruktuar të Jozef dhe Ema Smithit në Harmoni të Pensilvanisë, pranë vendit ku u rivendos Priftëria Aarone në këto ditë të mëvonshme. Në bashkëbisedimin tonë, Presidenti Nelson foli për rolin e rëndësishëm që luajtën gratë në Rivendosje.



Sirakuzë, Jutë, SHBA

Presidenti Nelson: “Një nga aspektet më të rëndësishme që më vjen në mendje kur vij te ky vend i rivendosjes së priftërisë, është roli i rëndësishëm që luajtën gratë në Rivendosje.

Kur Jozefi filloi të përkthente fillimisht Librin e Mormonit, kush ishte personi që shkroi për të? Epo, ai bëri pak, por jo shumë. Ema ishte ajo që e ndihmoi.

Dhe pastaj mendoj se si Jozefi hyri në pyll për t’u lutur, pranë shtëpisë së tyre në Palmira të Nju-Jorkut. Ku shkoi ai? Ai shkoi te Korija e Shenjtë. Përse shkoi atje? Sepse ky ishte vendi ku shkonte nëna [e tij] kur donte të lutej.

Këto janë vetëm dy nga gratë që patën role kyç në rivendosjen e priftërisë dhe në Rivendosjen e Kishës. Pa dyshim, ne mund të themi se bashkëshortet tona janë po aq të rëndësishme sot saç ishin atëherë. Sigurisht që ato janë.”

Ashtu si Ema, Lusi e Jozefi, ne jemi më të efektshëm kur jemi të gatshëm të mësojmë nga njëri-tjetri dhe jemi të bashkuar në synimin tonë për t’u bërë dishepuj të Jezu Krishtit e për t’i ndihmuar të tjerët përgjatë atij shtegu.

Na është mësuar se “priftëria e bekon jetën e fëmijëve të Perëndisë në mënyra të panumërta. . . . Në thirrjet [në Kishë], ordinancat e tempullit, marrëdhëniet familjare dhe shërbesën e qetë dhe individuale, gratë dhe burrat shenjtorë të ditëve të mëvonshme, veprojnë me fuqinë dhe autoritetin e priftërisë. Kjo varësi e ndërsjellë e burrave dhe grave për përmbushjen e punës së Perëndisë nëpërmjet fuqisë së Tij, është qendrore në ungjillin e Jezu Krishtit, të rivendosur nëpërmjet Profetit Jozef Smith”¹².

Uniteti është thelbësor për punën hyjnore që ne jemi të privilegjuar dhe të thirrur ta bëjmë, por ai nuk ndodh vetvetiu. Kërkon përpjekje dhe kohë

për t’u këshilluar me të vërtetë së bashku – për ta dëgjuar njëri-tjetrin, për t’i kuptuar pikëpamjet e të tjerëve dhe për të shkëmbyer përvoja – por procesi rezulton në vendime më të frymëzuara. Qoftë në shtëpi apo në përgjegjësitë tona në Kishë, mënyra më e efektshme për ta përmbushur potencialin tonë hyjnor është që të punojmë së bashku, të bekuar nga fuqia dhe autoriteti i priftërisë në rolet tona të ndryshme, por plotësuese.

Ç’pamje ka ai partneritet në jetën e grave të besëlidhjes sot? Më lejoni të tregoj një shembull.

Alisoni dhe Xhoni kishin një partneritet që ishte i pashoq. Ata ngisnin një biçikletë dyshe në gara të shkurtra e të gjata. Për të konkurruar me sukses në atë mjet lëvizës, të dy çiklistët duhet të jenë në harmoni. Ata duhet të anohen në të njëjtin drejtim, në kohën e duhur. Askush nuk mund të sundojë mbi tjetrin, por ata duhet të komunikojnë qartë dhe secili të bëjë pjesën e tij ose të saj. Kapiteni, përpara, ka kontrollin se kur duhet të frenojë dhe kur duhet të qëndrojë. Nxitësi, në pjesën e prapme, duhet t’i kushtojë vëmendje asaj që po ndodh dhe të jetë gati për të dhënë fuqi shtesë nëse

ata mbeten paksa mbrapa ose për të ngadalësuar nëse afrohen shumë me çiklistët e tjerë. Ata duhet ta përkrahin njëri-tjetrin për të përparuar dhe për ta arritur synimin e tyre.

Alisoni shpjegoi: “Në fillimet e veta, personi në pozicionin e kapitenit do të thoshte ‘Qëndrim’ kur duhej të qëndronim dhe ‘Frenim’ kur duhej të ndalonim pedalimin. Pas njëfarë kohe, personi që ishte nxitësi mësoi ta dallonte kohën kur kapiteni ishte gati të qëndronte ose të frenonte, dhe nuk kishte nevojë të thoshte asnjë fjalë. Mësuam të jemi në harmoni me mënyrën se si po vepron secili prej nesh dhe mund ta dallonim kur njëri po haste vështirësi, dhe [atëherë] tjetri përpiquej të vepronte për të dy. Në fakt e gjitha ka të bëjë me mirëbesimin dhe të punuarit së bashku.”¹³

Xhoni dhe Alisoni ishin të bashkuar jo vetëm teksa ngisnin biçikletën, por ata ishin të bashkuar edhe në martesën e tyre. Secili dëshironte lumturinë e tjetrit më shumë sesa të vetën; secili kërkonte të mirën tek njëri-tjetri dhe punonte për t’i mposhtur dobësitë e veta. Ata udhëhiqnin me radhë dhe e bënë me radhë të jepnin më shumë kur një partner po haste



Prova, Jutë, SHBA



vështirësi. Secili i vlerësonte kontributet e tjetrit dhe gjetën përgjigje më të mira për sfidat e tyre kur i ndërthurën talentet dhe burimet e tyre. Ata janë vërtet të lidhur me njëri-tjetrin nëpërmjet dashurisë si të Krishtit.

Të vihesh më në harmoni me modelin hyjnor të të punuarit së bashku në unitet, është kritike në këtë kohë të mesazheve “vetja ime në fillim”, të cilat na rrethojnë. Gratë zotërojnë dhunti të veçanta, hyjnore¹⁴ dhe u janë dhënë përgjegjësi të pasqyrore, por ato nuk janë më shumë – ose më pak – të rëndësishme se dhuntitë dhe përgjegjësitë e burrave. *Të gjitha* janë krijuar dhe janë të nevojshme që të realizohet plani hyjnor i Atit Qielor për t'i dhënë secilit prej fëmijëve të Tij mundësinë më të mirë që të përmbushë potencialin e tij ose të saj hyjnor.

Sot, “na duhen gra të cilat kanë guxim dhe largpamësinë e Nënës [sonë] Evë”¹⁵, që të bashkohen me vëllezërit e tyre për të sjellë shpirtin e Krishtit.¹⁶ Burrat kanë nevojë të bëhen partnerë të vërtetë në vend që të hamendësojnë se ata janë përgjegjës të vetëm ose në vend që të veprojnë si partnerë “të shtirur” ndërkohë që gratë kryejnë pjesën më të madhe të punës. Gratë kanë nevojë të jenë të gatshme të “bëjnë një hap përpara [dhe të] zëjnë vendin [e tyre] të ligjshëm dhe të nevojshëm”¹⁷ si partnere, në vend që të mendojnë se kanë nevojë ta bëjnë gjithçka vetë apo të presin që t'u thuhet ajo çfarë duhet të bëjnë.¹⁸

T'i shohësh gratë si pjesëmarrëse jetike nuk ka të bëjë me krijimin

e barazisë, por me të kuptuarit e të vërtetës doktrinale. Në vend që të krijojmë një program për ta realizuar atë, ne mund të punojmë në mënyrë aktive për t'i vlerësuar gratë ashtu siç i vlerëson Perëndia: si partnere thelbësore në punën e shpëtimit dhe të ekzaltimit.

A jemi gati? A do të përpiqemi fort që t'i kapërcejmë paragjykimet kulturore dhe në vend të kësaj të përqafojmë modele dhe praktika hyjnore, të bazuara në doktrinën themelore? Presidenti Rasëll M. Nelson na fton të “ecim krah për krah në këtë punë të shenjtë . . . [që] të ndihmojmë [për] ta përgatit[ur] botën për Ardhjen e Dytë të Zotit”¹⁹. Kur e bëjmë këtë, ne do të mësojmë t'i vlerësojmë kontributet e secilit individ dhe ta rritim efektshmërinë me të cilën i përmbushim rolet tona hyjnore. Do të ndiejmë gëzim më të madh nga sa kemi përjetuar ndonjëherë.

Zgjedhtë secili prej nesh që të bashkohet në udhën e frymëzuar të Zotit për ta ndihmuar punën e Tij të shkojë përpara! Në emrin e Shpëtimtarit tonë të dashur, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Zanafilla 3:1–18; Moisiu 4:1–19.
2. Shih Moisiu 5:1–12. Këto vargje na mësojnë për partneritetin e vërtetë të Adamit dhe Evës: ata kishin fëmijë së bashku (vargu 2); ata punuan së bashku për të siguruar për veten dhe familjen e tyre (vargu 1); ata u lutën së bashku (vargu 4); ata iu bindën urdhërimeve të Perëndisë dhe ofruan flijime së bashku (vargu 5); ata e mësuan vetë (vargjet 4, 6–11) dhe ua dhanë mësim ungjillin e Jezu Krishtit fëmijëve të tyre së bashku (vargu 12).
3. Joseph Smith – Historia 1:16.
4. Joseph Smith, në Sarah M. Kimball, “Auto-Biography”, *Woman's Exponent*, 1 shtator 1883, f. 51; shih edhe *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 481.
5. Joseph Smith, në “Nauvoo Relief Society Minute Book”, f. 40, josephsmithpapers.org.
6. Shih George Albert Smith, “Address to the Members of the Relief Society”, *Relief*

- Society Magazine*, dhjetor 1945, f. 717.
7. Shih John Taylor, in Nauvoo Relief Society Minutes, 17 mars 1842, në dispozicion të churchhistorianspress.org. Sipas Eliza R. Snout, Jozef Smithi dhe gjithashtu mësim se gratë ishin organizuar zyrtarisht në periudha të mëparshme ungjillore (Shih Eliza R. Snow, “Female Relief Society”, *Deseret News*, 22 prill 1868, f. 81; dhe *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* [2011], f. 1–7).
 8. Shih Dallin H. Oaks, “Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Liahona*, maj 2014, f. 49–52.
 9. Shih Rasëll M. Nelson, “Thesaret Shpirtërore”, *Liahona*, nëntor 2019, f. 78, 79.
 10. Rasëll M. Nelson, “Thesaret Shpirtërore”, f. 77.
 11. “Por ungjilli i rivendosur na mëson idenë e përvetshme se burrat dhe gratë janë të ndërvuarur nga njëri-tjetri. Ata janë të barabartë. Ata janë partnerë” (Bruce R. Hafen dhe Marie K. Hafen, “Crossing Thresholds and Becoming Equal Partners”, *Liahona*, gusht 2007, f. 28).
 12. Ese mbi Temat e Ungjillit, “Mësimet e Dhëna nga Jozef Smithi rreth Priftërisë, Tempullit dhe Grave”, topics.ChurchofJesusChrist.org.
 13. Letërkëmbim vetjak.
 14. Shih Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, *Liahona*, nëntor 2015, f. 95–97.
 15. Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, f. 97.
 16. Shih *General Handbook: Serving in The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints [Manual i Përgjithshëm: Shërbimi në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme]*, 1.4, ChurchofJesusChrist.org.
 17. Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, f. 97.
 18. “Motrat e mia të dashura, cilado qoftë thirrja juaj, cilatdo qofshin rrethanat tuaja, ne kemi nevojë për mbresat tuaja, pikëpamjet tuaja dhe frymëzimin tuaj. Ne kemi nevojë që ju të flisni me guxim dhe haptazi në këshillat e lagjeve dhe të kunjeve. Ne kemi nevojë që çdo motër e martuar të flasë si ‘një bashkëpjesëmarrëse frytdhënëse dhe e plotë’ tekta bashkoheni me bashkëshortin tuaj në qeverisjen e familjes suaj. Të martuara ose të pamartuara, ju motra zotëroni aftësi të dallueshme dhe intuitë të veçantë që i keni marrë si dhunti nga Perëndia. Ne, vëllezërit, nuk mund ta kopjojmë ndikimin tuaj të pasqyrore . . .
. . . Na duhet forca juaj!” (Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, f. 97).
 19. Rasëll M. Nelson, “Një Lutje drejtuar Motrave të Mia”, f. 97.

PRESIDENCA E PARË



Dallin H. Oaks
Këshilltar i Parë



Rasëll M. Nelson
President



Henri B. Ajring
Këshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMBËDHJETË APOSTUJVE



M. Rasëll Ballard



Xhefri R. Holland



Diter F. Uhtdorf



Dejvid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nil L. Andersen



Ronald A. Rasband



Geri E. Stivenson



Dejll G. Renland



Gerit W. Gong



Ulises Soares

PRESIDENCA E TË SHTATËDHJETËVE



L. Ujtni Klejton



Patrik Kleron



Karl B. Kuk



Robert C. Gei



Terens M. Vinson



Zhozé A. Teisheira



Karlos A. Godoi

AUTORITETET E PËRGJITHSHME TË SHTATËDHJETËT (sipas rendit alfabetik në anglisht)

--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--


PESHKOPATA KRYESUESE

Këshilltari i Parë	Peshkopi Kryesues	Këshilltari i Dytë

DREJTUESIT E PËRGJITHSHËM

SHKOLLA E SË DIEJËS		TË REJAT		SHOQATA E NDIHMËS	
Këshilltari i Parë	President	Këshilltari e Parë	Presidente	Këshilltari e Parë	Presidente
Këshilltari i Dytë	Këshilltari i Dytë	Këshilltari e Parë	Këshilltari e Parë	Këshilltari e Dytë	Këshilltari e Dytë

FILLORIA		TË RINITË	
Këshilltare e Parë	Presidente	Këshilltare e Dytë	Presidente
Këshilltari e Parë	Këshilltari e Parë	Këshilltari i Parë	Këshilltari i Parë
President	President	Këshilltari i Dytë	Këshilltari i Dytë



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Ai Ecën përpara Nesh

Zoti po e udhëheq Rivendosjen e ungjillit të Tij dhe të Kishës së Tij. Ai e njuh të ardhmen përsosurisht. Ai ju fton në punë.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, jam mirënjohës që jam me ju në këtë konferencë të përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Në ftesën e tij për të reflektuar mbi mënyrën se si na ka bekuar ne dhe njerëzit tanë të dashur Rivendosja e Kishës së Zotit prej Tij në këtë periudhë të fundit ungjillore, Presidenti Rasëll M. Nelson premtoi se përvoja jonë do të ishte jo vetëm e shënuar, por e paharrueshme.

Përvoja ime ka qenë e shënuar, siç jam i sigurt se ka qenë e juaja. Nëse

ajo do të jetë e paharrueshme, kjo varet nga secili prej nesh. Kjo është e rëndësishme për mua sepse përvoja e përgatitjes për këtë konferencë më ka ndryshuar në një mënyrë që do të doja të zgjaste. Më lini ta shpjegoj.

Përgatitja ime më çoi tek anali i një ngjarjeje në Rivendosje. Kisha lexuar për atë ngjarje shumë herë, por për mua kishte qenë gjithmonë një raportim për një mbledhje të rëndësishme që përfshinte Jozef Smithin, profetin e Rivendosjes. Por këtë herë, në rrëfim pashë mënyrën se si na udhëheq

Zoti ne, dishepujt e Tij, në Kishën e Tij. Pashë se çfarë do të thotë për ne të vdekshmit që të udhëhiqemi nga Shpëtimtari i botës, Krijuesi – i cili i di të gjitha gjërat, të kaluara, të tanishme dhe të ardhshme. Ai na jep mësim hap pas hapi dhe na udhërrëfen, duke mos na detyruar kurrë.

Mbledhja që po përshkruaj, ishte një çast kryesor në Rivendosje. Ishte një mbledhje e ditës së Shabatit, e mbajtur më 3 prill 1836, në Tempullin e Kirtlandit në Ohajo, shtatë ditë pasi ai u përkushtua. Jozef Smithi e përshkroi këtë çast të madhërishtëm në historinë e botës në një mënyrë të thjeshtë. Pjesa më e madhe e rrëfimit të tij është shënuar te Doktrina e Besëlidhje, seksioni 110:

“Pasdite, unë ndihmova presidentët e tjerë në shpërndarjen e Darkës së Zotit Kishës, duke e marrë atë nga të Dymbëdhjetët, privilegji i të cilëve ishte të vepronin te tavolina e shenjtë këtë ditë. Pasi ua kisha kryer këtë shërbim vëllezërve të mi, unë u tërhoqa te katedra, velat duke qenë të lëshuara, dhe unë u përkula, me Oliver Cowdery-n, në lutje solemne dhe të heshtur. Pasi u ngritëm nga lutja, vegimi që pason u hap përpara nesh.”¹

“Veli u hoq nga mendjet tona dhe sytë e të kuptuarit tonë u hapën.

Ne pamë Zotin duke qëndruar mbi pjesën e sipërme të katedrës, përpara nesh; dhe nën këmbët e tij ishte një dysheme e punuar prej ari të pastër, me ngjyrë qelibari.

Sytë e tij ishin si flakë zjarri; dhe flokët e kokës së tij ishin të bardhë si dëborë e pastër; fytyra e tij shkëlqente më shumë se ndriçimi i diellit; dhe zëri i tij ishte si tingulli i rrjedhjes së shumë ujërave, madje zëri i Jehovës, duke thënë:

Unë jam i pari dhe i fundit; unë jam ai që jeton, unë jam ai që u vra;



JEZU KRISHTI / SHFAQET PROFETIT JOZEF SMITHI DHE OLIVER KAUDERIT, NGA WALTER RANE



unë jam avokati juaj me Atin.

Vini re, mëkatet tuaja ju janë falur; ju jeni të pastër përpara meje; si rrjedhim, ngrini kokat tuaja dhe gëzohuni.

Zemrat e vëllezërve tuaj duhet të gëzohen dhe zemrat e gjithë njerëzve të mi duhet të gëzohen, të cilët, me fuqinë e tyre, kanë ndërtuar këtë shtëpi për emrin tim.

Sepse, vini re, unë e kam pranuar këtë shtëpi dhe emri im do të jetë këtu; dhe unë do t'i manifestohem popullit tim në mëshirë në këtë shtëpi.

Po, unë do t'u shfaqem shërbëtorëve të mi dhe do t'u flas me zërin tim, në qoftë se populli im do t'i zbatojë urdhërimet e mia dhe nuk do ta ndotë këtë shtëpi të shenjtë.

Po, zemrat e mijërave dhe qindra mijërave do të gëzohen së tepërmi si pasojë e bekimeve që do të derdhen dhe e dhurimit me të cilin shërbëtorët e mi janë dhuruar në këtë shtëpi.

Dhe fama e kësaj shtëpie do të përhapet në toka të huaja; dhe ky është fillimi i bekimit që do të derdhet mbi kokat e popullit tim. Madje kështu. Amen.

Pasi ky vegim u mbyll, qiejt u hapën përsëri mbi ne; dhe Moisiu u shfaq përpara nesh dhe na dorëzoi çelësat e mbledhjes së Izraelit nga të katër cepat e tokës dhe të udhëheqjes së dhjetë fiseve nga toka e veriut.

Pas kësaj, Eliasi u shfaq dhe dorëzoi periudhën e kujdestarisë së ungjillit të Abrahamit, duke thënë se në ne dhe në farën tonë gjithë brezat pas nesh do të bekoheshin.

Pasi ishte mbyllur ky vegim, një tjetër vegim i madh e i lavdishëm u derdh mbi ne; sepse Elija profeti, i cili ishte marrë në qiell pa shijuar vdekjen, qëndroi përpara nesh dhe tha:

“Vini re, ka ardhur plotësisht koha, që ishte folur nga goja e Malakias, duke dëshmuar që ai [Elija] do të derdhej, përpara se dita e madhe dhe e tmerrshme e Zotit të vinte –

Për t'i kthyer zemrat e etërve tek fëmijët dhe të fëmijëve tek etërit, përndryshe tërë toka do të goditej me një mallkim –

Si rrjedhim, çelësat e kësaj periudhe të kujdestarisë jepen në duart tuaja; dhe me anë të kësaj ju mund të dini se dita e madhe dhe e tmerrshme e Zotit është pranë, madje te dyert.”²


Tani, unë e kisha lexuar atë rrëfim shumë herë. Fryma e Shenjtë më kishte pohuar se rrëfimi ishte i vërtetë. Por teksa studiova dhe u përgatita për këtë konferencë, arrita ta shoh më qartë fuqinë e Zotit për t'i udhëhequr me hollësi dishepujt e Tij në punën e Tij.

Shtatë vjet përpara se Moisiu t'i dorëzonte Jozefit çelësat e mbledhjes së Izraelit në Tempullin e Kirtlandit, “Jozefi mësoi nga faqja e titullit e Librit të Mormonit se qëllimi i tij ishte për t'u 'treguar atyre që mbetën nga shtëpia e Izraelit . . . që ata të mund të dinë besëlidhjet e Zotit, që ata nuk janë braktisur përgjithmonë'. Në vitin

1831, Zoti i tha Jozefit se mbledhja e Izraelit do të fillonte në Kirtland: ‘Dhe që atje [Kirtlandi], kushdo që unë dëshiroj, do të shkojë mes gjithë kombeve . . . sepse Izraeli do të shpëtohet e unë do t'i udhëheq ata.’³

Ndonëse për ta mbledhur Izraelin nevojitej puna misionare, Zoti i frymëzoi udhëheqësit e Tij që t'u jepnin mësim Të Dymbëdhjetëve, të cilët u bënë disa nga misionarët tanë të hershëm: “Mbajeni mend, ju nuk do të shkoni në kombe të tjera derisa të merrni dhurimin [indaumentin] tuaj”⁴.

Duket sikur Tempulli i Kirtlandit ishte i rëndësishëm në planin hap pas hapi të Zotit për të paktën dy arsye: Së pari, Moisiu priti derisa tempulli të përfundonte për t'i rivendosur çelësat e mbledhjes së Izraelit. Dhe së dyti, Presidenti Jozef Filding Smith dha mësim se “Zoti i urdhëroi shenjtoret të ndërtonin një tempull [Tempullin e Kirtlandit], në të cilin ai mund të zbulonte çelësat e autoritetit dhe ku apostujt mund të merrnin dhurimin dhe të përgatiteshin për të krasitur vreshtin e tij për herë të fundit”⁵. Megjithëse dhurimi në tempull siç e njohim sot nuk u administrua në Tempullin e Kirtlandit, në përmbushje të profecisë, ordinancat përgatitore të tempullit filluan të paraqiteshin atje, së bashku me një derdhje të shfaqjeve shpirtërore, të cilat i armatosën ata që u thirrën në mision, me dhurimin e



San-Paola, Brazil



premtuar të “fuq[is]ë nga lart”⁶, e cila çoi në një mbledhje të madhe nëpërmjet shërbimit misionar.

Pasi çelësat e mbledhjes së Izraelit iu dorëzuan Jozefit, Zoti e frymëzoi Profetin që t’i dërgonte në misione anëtarët e Të Dymbëdhjetëve. Ndërsa studioja, u bë e qartë për mua se Zoti e kishte përgatitur me hollësi udhën që Të Dymbëdhjetët të shkonin në misione jashtë vendit, ku ishin përgatitur njerëz që t’i besonin dhe mbështetnin ata. Me kalimin e kohës, nëpërmjet tyre do të sillëshin mijëra njerëz në Kishën e rivendosur të Zotit.

Sipas analeve tona, përlogaritet se gjatë dy misionëve të Të Dymbëdhjetëve në Ishujt Britanikë u pagëzuan nga 7 500 deri në 8 000 njerëz. Kjo hodhi themelin për punën misionare në Europë. Deri në fund të shekullit të 19-të, në Amerikë ishin mbledhur rreth 90 000 njerëz, ku pjesa më e madhe e tyre vinin nga Ishujt Britanikë dhe Gadishulli Skandinav.⁷ Zoti e kishte frymëzuar Jozefin dhe ata misionarë besnikë që shkuan të punonin, që të arrinin një korje e cila duhet të jetë dukur, në atë kohë, përtej aftësisë së tyre. Por Zoti, me largpamësinë dhe përgatitjen e Tij të përsosur, e bëri atë të mundur.

Ju kujtohet gjuha në dukje e thjeshtë dhe pothuajse poetike nga seksioni 110 të Doktrina e Besëlidhje:

“Vini re, ka ardhur plotësisht koha, që ishte folur nga goja e Malakias, duke dëshmuar që ai [Elija] do të dërgohej, përpara se dita e madhe dhe e tmerrshme e Zotit të vinte –

Për t’i kthyer zemrat e etërve tek fëmijët dhe të fëmijëve tek etërit, përndryshe tërë toka do të goditej me një mallkim –

Si rrjedhim, çelësat e kësaj periudhe të kujdestarisë jepen në duart tuaja; dhe me anë të kësaj ju mund të dini se dita e madhe dhe e tmerrshme e Zotit është pranë, madje te dyert”⁸.

Dëshmoj se Zoti pa larg në të ardhmen dhe e pa mënyrën se si do të na udhëhiqte Ai, për ta ndihmuar Atë që të përmbushte qëllimet e Tij në ditët e fundit.

Ndërkohë që po shërbeja në Peshkopatën Kryesuese shumë vjet më parë, unë u ngarkova të mbikëqyrja grupin e projektimit dhe të zhvillimit, i cili krijoi atë që ne e quajmë FamilySearch. Jam i kujdesshëm të them që e “mbikëqyra” krijimin e tij, në vend që të them se e “drejtova” atë. Shumë njerëz të shkëlqyer i lanë karrierat dhe erdhën për të ndërtuar atë që donte Zoti.

Presidenca e Parë kishte vendosur një synim që të zvogëlonte dublimin e ordinancave. Shqetësimi i tyre i madh ishte se ne nuk ishim në gjendje të dinim a ishin kryer tashmë ordinancat e një personi. Për vite me radhë – ose për një kohë që m’u duk si vite të tëra – Presidenca e Parë më pyeste: “Kur do ta mbaroni?”

Me lutje, zell dhe sakrificë vetjake të njerëzve me aftësi të mëdha, detyra u krye. Erdhi hap pas hapi. Detyra e parë ishte që ta bënte të lehtë përdorimin e programit FamilySearch për ata që nuk ndiheshin rehat me

kompjuterat. Erdhën ndryshime të tjera dhe unë e di se ato do të vazhdojnë të vijnë, sepse kurdoherë që vazhdojmë të zgjidhim një problem të frymëzuar, ne i hapim derën zbulësës së mëtejshme drejt përparimeve, të paktën po aq të rëndësishme, por që ende nuk shihen në horizont. Edhe sot, programi FamilySearch po bëhet ai që i nevojitet Zotit për një pjesë të Rivendosjes së Tij – dhe jo vetëm për të shmangur dublimin e ordinancave.

Zoti na lejon të bëjmë përmirësime për t’i ndihmuar njerëzit që të fitojnë një ndjenjë afërsie madje edhe dashurie për paraardhësit e tyre dhe që të përfundojnë ordinancat e tyre në tempull. Tani, ashtu sikurse Zoti e dinte me siguri se do të ndodhte, të rinjtë dhe të rejtat po bëhen këshillues kompjuterash për prindërit e tyre dhe anëtarët e lagjes. Të gjithë kanë gjetur gëzim të madh në këtë shërbim.

Shpirti i Elias po i ndryshon zemrat e të rinjve, të rejave dhe të të moshuarve, të fëmijëve dhe të prindërve, të nipërve e të mbesave dhe të gjyshërve e gjysheve. Tempujt së shpejti do të planifikojnë përsëri me lumturi mundësi për pagëzime dhe ordinancat të tjera të shenjta. Dëshira për t’u shërbyer paraardhësve tanë dhe lidhja e prindërve dhe fëmijëve po shtohen.

Zoti i pa se do të ndodhnin. Ai planifikoi për to, hap pas hapi, ashtu siç Ai ka bërë me ndryshime të tjera në Kishën e Tij. Ai ka ngritur dhe përgatitur njerëz besnikë që zgjedhin t’i bëjnë mirë gjërat e vështira. Ai gjithmonë ka duruar me dashuri që të na ndihmojë të mësojmë “rresht pas rreshti, parim pas parimi, pak këtu dhe pak atje”⁹. Ai është i patundur për kohën e duhur dhe rendin e synimeve të Tij, megjithatë Ai na siguron se sakrificat shpesh sjell bekime të vazhdueshme që ne nuk i parashihnim.



Nga Presidenti Dallin H. Oaks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

E mbyll duke i shprehur mirënjohjen time Zotit – Ai që e frymëzoi Presidentin Nelson të më ftonte të bëja një sakrificë për t’u përgatitur për këtë konferencë. Çdo orë dhe çdo lutje gjatë përgatitjes sime solli një bekim.

I ftoj të gjithë ata që e dëgjojnë këtë mesazh ose i lexojnë këto fjalë, që të kenë besim se Zoti po e udhëheq Rivendosjen e Ungjillit të Tij dhe Kishës së Tij. Ai ecën përpara nesh. Ai e njeh të ardhmen përsosurisht. Ai ju fton në punë. Ai bashkohet me ju në të. Ai ka hartuar një plan për shërbimin tuaj. Dhe madje ndërsa sakrifikoni, ju do të ndieni gëzim tekta i ndihmoni të tjerët të ngrihen që të jenë gati për ardhjen e Tij.

Ju dëshmoj se Perëndia, Ati, jeton. Jezusi është Krishti. Kjo është Kisha e Tij. Ai ju njeh dhe ju do. Ai ju udhërrëfen. Ai e ka përgatitur udhën për ju! Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 110, kreu i seksionit; shih edhe Joseph Smith, “History, 1838–1856, volume B-1 [1 September 1834–2 November 1838]”, 3 prill 1836, f. 727, josephsmithpapers.org.
2. Doktrina e Besëlidhje 110:1–16.
3. Karl Ricks Anderson, *The Savior in Kirtland: Personal Accounts of Divine Manifestations* (2012), f. 276; Doktrina e Besëlidhje 38:33.
4. U dha në një detyrë apostolike të administruar nga Oliver Kauderi, në “Minute Book 1”, 21 shkurt 1835, f. 162, josephsmithpapers.org.
5. Joseph Fielding Smith, *Doctrines of Salvation*, përmb. Bruce R. McConkie (1955), 2:234.
6. Doktrina e Besëlidhje 38:32.
7. Shih James B. Allen, Ronald K. Esplin dhe David J. Whittaker, *Men With a Mission: The Quorum of the Twelve Apostles in the British Isles, 1837–1841* (1992), f. 53, 302; Brandon S. Plewe, red., *Mapping Mormonism: An Atlas of Latter-day Saint History* (2012), f. 104.
8. Doktrina e Besëlidhje 110:14–16.
9. 2 Nefi 28:30.

Priftëria Melkizedeke dhe Çelësat

Në Kishë, autoriteti i priftërisë ushtrohet nën drejtimin e një udhëheqësi të priftërisë, i cili mban çelësat e asaj priftërie.

Unë kam zgjedhur të flas më tej rreth priftërisë së Perëndisë, temë e trajtuar tashmë nga tre folës të mëparshëm, të cilët na mësuhan rreth mënyrës se si priftëria e bekon jetën e grave, të rejave dhe të rinjve.

Priftëria është një fuqi dhe autoritet hyjnor i mbajtur në mirëbesim, për t’u përdorur për punën e Perëndisë në dobi të të gjithë fëmijëve të Tij. *Priftëria* nuk janë ata që janë shuguruar në një detyrë priftërie apo ata që ushtrojnë autoritetin e saj. Burrat që mbajnë priftërinë, nuk janë priftëria. Ndërkohë që nuk duhet t’u referohemi burrave të shuguruar si *priftëria*, është e përshtatshme t’u referohemi atyre si *mbajtës* të priftërisë.

Fuqia e priftërisë ekziston si në Kishë, ashtu edhe në organizmin e familjes. Por fuqia e priftërisë dhe autoriteti i priftërisë funksionojnë ndryshe në Kishë nga mënyra se si funksionojnë në familje. E gjithë kjo është sipas parimeve që Zoti ka vendosur. Qëllimi i planit të Perëndisë është që t’i udhëheqë fëmijët e Tij drejt jetës së përjetshme. Familjet në vdekshmëri janë thelbësore për atë plan. Kisha ekziston për të siguruar

doktrinën, autoritetin dhe ordinancat e nevojshme për t’i ruajtur marrëdhëniet familjare në përjetësi. Pra, organizimi familjar dhe Kisha e Jezu Krishtit kanë një marrëdhënie reciprokisht



Provo, Jutë, SHBA

përforcuese. Bekimet e priftërisë – të tilla si plotësia e ungjillit, dhe ordinancat si pagëzimi, konfirmimi dhe marrja e dhuratës së Frymës së Shenjtë, dhurimi në tempull dhe martesë e përjetshme – janë në dispozicion të burrave dhe të grave njëloj.¹

Priftëria për të cilën flasim këtu, është Priftëria Melkizedeke, e rivendosur në fillim të Rivendosjes së ungjillit. Jozef Smithi dhe Oliver Kaudëri u shuguruan nga Pjetri, Jakobi dhe Gjoni, që shpallën për veten “se zotëronin çelësat e mbretërisë dhe të periudhës së plotësisë së kohëve” (Doktrina e Besëlidhje 128:20). Këta Apostuj të rëndësishëm e morën atë autoritet nga Vetë Shpëtimtari. Të gjitha autoritetet apo detyrat e tjera në priftëri janë shtojca të Priftërisë Melkizedeke (shih Doktrina e Besëlidhje 107:5), sepse ajo “mban të drejtën e kryesimit dhe ka fuqi e autoritet mbi gjithë detyrat në kishë, në të gjitha epokat e botës” (Doktrina e Besëlidhje 107:8).

Në Kishë, autoriteti i priftërisë më të lartë, Priftërisë Melkizedeke, dhe ai i më të ultës ose Priftërisë Aarone ushtrohet nën drejtimin e një udhëheqësi të priftërisë, si peshkop apo president, i cili mban çelësat e asaj priftërie. Për të kuptuar ushtrimin e autoritetit të priftërisë në Kishë, ne duhet të kuptojmë parimin e çelësve të priftërisë.

Çelësat e priftërisë Melkizedeke të mbretërisë u dhanë nga Pjetri, Jakobi dhe Gjoni, por ajo nuk e plotësoi rivendosjen e çelësve të priftërisë. Disa çelësa të priftërisë erdhën më vonë. Pas përkushtimit të tempullit të parë të kësaj periudhe ungjillore në Kirtland, Ohajo, tre profetë – Moisiu, Eliasi dhe Elija – rivendosën “çelësat e kësaj periudhe të kujdestarisë”, përfshirë çelësat që lidhen me mbledhjen e Izraelit dhe punën në tempujt e Zotit (shih Doktrina e Besëlidhje 110),

sikurse Presidenti Ajring sapo e përshkroi në mënyrë aq bindëse.

Shembulli më i njohur i funksionit të çelësve është te kryerja e ordinancave të priftërisë. Një ordinancë është një akt solemn që nënkupton bërjen e besëlidhjeve dhe premtimin e bekimeve. Në Kishë të gjitha ordinancat kryhen me autorizimin e udhëheqësit të priftërisë që mban çelësat për atë ordinancë.

Ordinanca më së shumti kryhet nga persona që janë shuguruar në një detyrë në priftëri, të cilët veprojnë nën drejtimin e atij që mban çelësa të priftërisë. Për shembull, mbajtësit e detyrave të ndryshme të priftërisë Aarone veprojnë në ordinancën e sakramentit nën çelësat dhe drejtimin e peshkopit, i cili mban çelësat e priftërisë Aarone. I njëjti parim zbatohet tek ordinancat e priftërisë në të cilat gratë veprojnë në tempull. Ndonëse gratë nuk mbajnë detyrë në priftëri, ato kryejnë ordinancat të shenjta të tempullit nën autorizimin e presidentit të tempullit, i cili mban çelësat për ordinancat e tempullit.

Një tjetër shembull i autoritetit të priftërisë nën drejtimin e atij që i mban çelësat, është mësimdhënia nga burra dhe gra të thirrura për ta dhënë mësim ungjillin, qoftë në orët mësimore të lagjeve të tyre apo në fushën

e misionit. Shembuj të tjerë janë ata të cilët mbajnë pozita udhëheqëje në lagje dhe ushtrojnë autoritet priftërie në udhëheqjen e tyre për shkak të thirrjeve të tyre dhe nën veçimin dhe drejtimin e udhëheqësit të priftërisë i cili mban çelësat në lagje apo në kunj. Kjo është mënyra se si autoriteti dhe fuqia e priftërisë ushtrohen dhe gëzohen në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.²

Autoriteti i priftërisë ushtrohet e bekimet e saj përjetohen edhe në familjet e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme. Me familje kam parasysh një burrë mbajtës priftërie dhe një grua, të cilët janë të martuar, dhe fëmijët e tyre. Përfshij gjithashtu ndryshimet nga marrëdhëniet ideale të tilla si ato që shkaktohen nga vdekja apo shkurorëzimi.

Parimi se autoriteti i priftërisë mund të ushtrohet vetëm nën drejtimin e atij që mban çelësat për atë funksion, është thelbësor në Kishë, por kjo nuk gjen zbatim në familje. Për shembull, një baba kryeson dhe ushtron priftërinë në familjen e tij me anë të autoritetit të priftërisë që ai mban. Ai nuk ka nevojë të ketë drejtimin apo miratimin e dikujt që mban çelësa priftërie, me qëllim që t'i kryejë funksionet e tij të ndryshme



familjare. Këto përfshijnë këshillimin e anëtarëve të familjes së tij, zhvillimin e mbledhjeve familjare, dhënien e bekimeve të priftërisë bashkëshortes e fëmijëve të tij, apo dhënien e bekimeve të shërimit pjesëtarëve të familjes apo të tjerëve.³ Autoritetet e Kishës u japin mësim pjesëtarëve të familjes por nuk drejtojnë ushtrimin e autoritetit të priftërisë në familje.

I njëjti parim zbatohet kur babai mungon dhe nëna është udhëheqësja e familjes. Ajo kryeson në shtëpinë e saj dhe është mjet për sjelljen e fuqisë dhe bekimeve të priftërisë në familjen e vet nëpërmjet dhurimit dhe vulosjes së saj në tempull. Ndërsa nuk është e autorizuar të japë bekime priftërie që mund të jepen vetëm nga një person që mban një detyrë të caktuar në priftëri, ajo mund t'i kryejë të gjitha funksionet e tjera të udhëheqjes familjare. Duke e bërë këtë, ajo e ushtron fuqinë e priftërisë në dobi të fëmijëve mbi të cilët kryeson në pozicionin e saj të udhëheqjes në familje.⁴

Nëse etërit do ta lartësonin priftërinë e tyre në vetë familjen e vet, kjo do ta çonte përpara misionin e Kishës po aq sa çdo gjë tjetër që mund të bëjnë. Etërit që mbajnë Priftërinë Melkize-deke, duhet ta ushtrojnë autoritetin e tyre “nëpërmjet bindjes, nëpërmjet durimit, nëpërmjet mirësjelljes e zemërbutësisë dhe nëpërmjet dashurisë së pashtirur” (Doktrina e Besëlidhje 121:41). Ai standard i lartë për ushtrimin e gjithë autoritetit të priftërisë është tejet i rëndësishëm në familje. Mbjatësit e priftërisë duhet edhe t'i mbajnë urdhërimet në mënyrë që të kenë fuqinë e priftërisë për t'u dhënë bekime pjesëtarëve të familjes së tyre. Ata duhet të kultivojnë marrëdhënie të dashura familjare në mënyrë që pjesëtarët e familjes do të duan t'u kërkojnë bekime. Dhe prindërit duhet



të nxitin më shumë bekime të priftërisë në familje.⁵

Në këto mbledhje të konferencave, teksa kërkojmë strehë për pak kohë nga shqetësimet tona tokësore prej një pandemie rrënuese, neve na janë mësuar parime të madhërishme të përjetësisë. Unë e inkurajoj secilin prej nesh që ta mbajë syrin të “shëndoshë” për t'i marrë këto të vërteta të përjetësisë që trupi ynë “të jetë plot dritë” (3 Nefi 13:22).

Në predikimin e Tij për turmat të shënuar në Bibël dhe në Librin e Mormonit, Shpëtimtari dha mësim se trupat e vdekshëm mund të jenë plot dritë ose plot errësirë. Ne, sigurisht, duam të jemi mbushur me dritë dhe Shpëtimtari ynë na mësoi se si të bëjmë që kjo të ndodhë. Ne duhet t'i dëgjojmë mesazhet rreth të vërtetave të përjetësisë. Ai përdori shembullin e syrit tonë, me të cilin mund të futim dritë në trupin tonë. Nëse syri ynë do të jetë “i shëndoshë” – me fjalë të tjera, nëse jemi të përqendruar te marrja e dritës dhe e kuptimit të përjetësisë – Ai shpjegoi: “i tërë trupi yt do të jetë plot dritë” (Mateu 6:22; 3 Nefi 13:22). Por nëse “syri y[në] është i lig” – pra, nëse e kërkojmë ligësinë dhe e futim atë në trupin tonë – paralajmëroi Ai, “i tërë trupi yt do të jetë plot errësirë” (vargu 23). Me fjalë të tjera, drita ose errësira në trupin tonë varet nga mënyra se si i shohim – apo i marrim – të vërtetat e përjetshme që na mësohen.

Ne duhet të ndjekim ftesën e Shpëtimtarit për të synuar e kërkuar që t'i kuptojmë të vërtetat e përjetshme. Ai premton se Ati ynë në Qiell është i gatshëm t'ia mësojë gjithsecilit të vërtetat që kërkon (shih 3 Nefi 14:8). Nëse e dëshirojmë këtë dhe e kemi syrin të shëndoshë për të marrë, Shpëtimtari premton se të vërtetat e përjetësisë “do [të na] hap[e]n” (shih 3 Nefi 14:7–8).

Përkundrazi, Satani është në ankth për të na ngatërruar mënyrën e të menduarit apo për të na çuar në udhë të shtrembër mbi çështje të rëndësishme si veprimet e priftërisë së Perëndisë. Shpëtimtari paralajmëroi mbi “profetët e [tillë të] remë që vijnë te ju të veshur si dele, por që përbrenda janë ujë të uritur” (3 Nefi 14:15). Ai na dha këtë provë për të na ndihmuar të zgjedhim të vërtetën ndër mësimet e ndryshme që mund të na ngatërojnë: “Ju do t'i njihni ata nga frytet e tyre”, dha mësim Ai (3 Nefi 14:16). “Një pemë e mirë nuk mund të japë frut të lig, as një pemë e prishur të japë frut të mirë” (vargu 18). Prandaj, ne duhet të shohim rezultatet – “frytet” – e parimeve që jepen mësim, dhe personat që i japin mësim. Kjo është përgjigjja më e mirë për shumë nga kundërshtimet që dëgjojmë kundër Kishës dhe doktrina-ve, dhe rregulloreve, dhe udhëheqjes së saj. Ndiqni provën që Shpëtimtari dha mësim. Shihni frytet – rezultatet.

Kur mendojmë për frytet e ungujllit dhe Kishën e rivendosur të Jezu



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson,
President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve
të Ditëve të Mëvonshme

Krishtit, ne gëzohemi nga mënyra se si Kisha, në gjithë jetën e anëtarëve të saj të gjallë, është zgjeruar nga bashkësi lokale në Intermauntën Uest në situatën ku shumica e mbi 16 milionë anëtarëve të saj banojnë në kombe të tjera jashtë Shteteve të Bashkuara. Me atë rritje, ne kemi ndier zhvillim të aftësisë së Kishës për t'u ardhur në ndihmë anëtarëve të saj. Ne ndihmojmë për mbajtjen e urdhërimeve, për plotësimin e përgjegjësi për të predikuar ungjillin e rivendosur, për mbledhjen e Izraelit dhe për ndërtimin e tempujve kudo në botë.

Ne udhëhiqemi nga një profet, Presidenti Rasëll M. Nelson, udhëheqjen e të cilit Zoti e ka përdorur për të arritur përparimin që kemi ndier gjatë gjithë udhëheqjes së tij prej më shumë se dy vjetësh. Tani ne do të bekohemi të dëgjojmë Presidentin Nelson, që do të na mësojë si ta çojmë më tej përparimin tonë në këtë Kishë të rivendosur të Jezu Krishtit në këto kohë sfiduese.

Unë dëshmoj për të vërtetën e këtyre gjërave dhe bashkohem me ju në lutjen për profetin tonë nga i cili do të dëgjojmë më pas, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Dallin H. Oaks, "Autoriteti i Priftërisë në Familje dhe në Kishë", *Liahona*, nëntor 2005, f. 24–27.
2. Shih Rasëll M. Nelson, "Thesaret Shpirtërore", *Liahona*, nëntor 2019, f. 76–79; Dallin H. Oaks, "Autoriteti i Priftërisë në Familje dhe në Kishë" f. 24–27; Dallin H. Oaks, "Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë", *Liahona*, maj 2014, f. 49–52.
3. Shih Dallin H. Oaks, "Fuqitë e Priftërisë", *Liahona*, maj 2018, f. 65–68.
4. Rasëll M. Nelson, "Thesaret Shpirtërore", f. 76–79.
5. Shih Rasëll M. Nelson, "Dhënia e Shërbesës me Fuqinë dhe Autoritetin e Perëndisë", *Liahona*, maj 2018, f. 68–75; Dallin H. Oaks, "Fuqitë e Priftërisë", f. 65–68.

Hapja e Qiejve për Ndhimë

Le ta vëmë në veprim besimin tonë te Zoti Jezu Krisht!

Çfarë sesioni i pashoq dhe i mreku-llueshëm ka qenë ky! Faleminderit, të shtrenjtët Laudi dhe Enco. Ju i përfaqësuar shumë mirë të rinjtë dhe të rejtat e mrekuillueshme të Kishës.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ne kemi dëgjuar shumë sot rreth Rivendosjes së Kishës – të njëjtës Kishë që Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, e themeloi gjatë shërbesës së Tij tokësore. Ajo Rivendosje filloi në pranverën e 200 vjetëve më parë kur Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, iu shfaqën të riut Jozef Smith.

Dhjetë vjet pas këtij vegimi të jashtëzakonshëm, Profeti Jozef Smith dhe pesë të tjerë u thirrën si anëtarët themelues të Kishës së rivendosur të Zotit.

Nga ai grup i vogël, i mbledhur më 6 prill 1830, ka ardhur një organizatë mbarëbotërore me më shumë se 16 milionë anëtarë. Njihet gjerësisht e mira që përmbush kjo Kishë nëpër botë për ta lehtësuar vuajtjen njerëzore dhe për ta lartësuar shpirtërisht e moralisht njerëzimin. Por qëllimi i saj më i rëndësishëm është t'i ndihmojë burrat, gratë dhe fëmijët që ta ndjekin Zotin Jezu Krisht, t'i zbatojnë urdhërimet e Tij dhe të kualifikohen për më të madhin e të gjitha bekimeve – atë të jetës së përjetshme me Perëndinë dhe njerëzit e tyre të dashur.¹

Ndërsa kremtojmë ngjarjen që filloi në vitin 1820, është e rëndësishme të kujtojmë se, ndërkohë që e nderojmë Jozef Smithin si një profet të Perëndisë, kjo nuk është kisha e Jozef Smithit, as nuk është kisha e Mormonit. Kjo është Kisha e Jezu Krishtit. Ai e dekretoi saktësisht se me çfarë emri duhej të quhej Kisha e Tij: "Sepse kështu do të quhet kisha ime në ditët e fundit, madje Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme"².

Unë kam folur më parë rreth një korrigjimi të nevojshëm të drejtimit lidhur me mënyrën se si e përmendim emrin e Kishës.³ Që nga ajo kohë, shumë është bërë për ta përmbushur këtë korrigjim. U jam shumë mirënjohës Presidentit M. Rasëll Ballard dhe tërë Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, të cilët kanë bërë kaq shumë për t'i udhëhequr këto përpjekje, si edhe ato që lidhen me një nismë tjetër të cilën do ta shpall këtë mbrëmje.

Udhëheqësit dhe sektorët e Kishës, njësitë që lidhet me ta, si dhe miliona anëtarë – e të tjerë – tani përdorin emrin e saktë të Kishës. Është përshtatur udhëzuesi i stilit zyrtar të Kishës. Faqja kryesore e Kishës në internet tani është ChurchofJesusChrist.org. Janë përditësuar adresat për postën elektronike, emrat e faqeve në internet dhe kanalet e mjeteve të komunikimit shoqëror.

Kori ynë i dashur tani është Tabernacle Choir at Temple Square [Kori i Tabernakullit në Sheshin e Tempullit].

Ne i kemi ndërmarrë këto përpjekje të jashtëzakonshme, sepse kur e heqim emrin e Zotit nga emri i Kishës së *Tij*, ne pa dashje e heqim *Atë* prej të qenit përqendrimi kryesor i adhurimit tonë dhe i jetës sonë. Kur e marrim mbi vete emrin e Shpëtimtarit në pagëzim, ne zotohemi të dëshmojmë, me anë të fjalëve, mendimeve dhe veprimeve tona, se Jezusi është Krishti.⁴

Më parë, unë premtova se, në qoftë se do të “bëjmë më të mirën tonë për ta rivendosur emrin e saktë të Kishës së Zotit”, Ai do të “derdhë fuqinë dhe bekimet e Tij mbi kokat e shenjtorëve

të ditëve të mëvonshme, në mënyra të cilat ne nuk i kemi parë kurrë”⁵.

E përsëris atë premtim sot.

Për të na ndihmuar ta kujtojmë Atë dhe ta përcaktojmë Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme si *Kishën e Zotit*, ne jemi të lumtur të paraqitim një simbol që do të bëjë të ditur vendin qendror të Jezu Krishtit në Kishën e Tij.

Ky simbol përmban emrin e Kishës që përfshihet brenda një guri të qoshes. Jezu Krishti është guri kryesor i qoshes.⁶

Në qendër të simbolit është një figurë e statujës së mermertë të Thorvaldsenit, *Kristusi*. Portretizon Zotin e *gjallë*, të ringjallur me duar të shtrira

për t’i përqaftuar të gjithë ata që do të vijnë tek Ai.

Në mënyrë simbolike, Jezu Krishti po qëndron nën një hark. Harku na sjell ndërmend Shpëtimtarin e ringjallur duke dalë nga varri ditën e tretë pas Kryqëzimit të Tij.

Ky simbol duhet të jetë i mirënjohur për shumë veta, sepse ne e kemi identifikuar ungjillin e rivendosur me Krishtin e *gjallë*, të ringjallur.

Simboli tani do të përdoret si një identifikues pamor për literaturën, lajmet dhe ngjarjet zyrtare të Kishës.⁷ Ai do t’u sjellë ndërmend të gjithëve se kjo është Kisha e Shpëtimtarit dhe se gjithçka që ne bëjmë, si anëtarë të Kishës së Tij, përqendrohet te Jezu Krishti dhe ungjilli i Tij.

Tani, të dashur vëllezërit dhe motrat e mia, nesër është e Diela e Palmave, për të cilën na dha mësim kaq bukur Plaku Gong. Më pas ne fillojmë javën e veçantë që e arrin kulmin me Pashkën. Si pasues të Jezu Krishtit, duke jetuar në një kohë kur pandemia e virusit COVID-19 e ka vënë tërë botën në rrëmujë, thjesht le të mos flasim për Krishtin apo të predikojmë për Krishtin, ose të përdorim një simbol që përfaqëson Krishtin.

Le ta vëmë në veprim besimin tonë te Zoti Jezu Krisht!

Siç e dini, anëtarët e Kishës e zbatojnë ligjin e agjërimit një ditë çdo muaj.

Doktrina e agjërimit është një doktrinë e lashtë. Ajo është ushtruar nga heronj biblikë që nga kohët më të hershme. Moisiu, Davidi, Ezra, Nehemia, Esteri, Isaia, Danieli, Joeli dhe shumë të tjerë agjëruan dhe predikuan për agjërimin.⁸ Njëpërmjet shkrimeve të Isaia, Zoti tha: “Agjërimi që më pëlqen a *nuk* është vallë ky: të thyesh zinxhirët e ligësisë, të zgjidhësh verigat e zgjedhës, t’i lësh të lirë të shtypurit, të dërrmsh çdo zgjedhë?”⁹



Apostulli Pal u kujtoi shenjtoreve në Korint që t'i "kushtoheshin] agjërimit dhe lutjes"¹⁰. Shpëtimtari Vetë shpalli se gjëra të caktuara "nuk d[alin] veçse me anë të lutjes dhe të agjërimit"¹¹.

Kohët e fundit thashë në një material filmik në mjetet shoqërore të komunikimit se "si mjek dhe kirurg, i admiroj shumë profesionistët e mjekësisë, shkencëtarët dhe të gjithë ata që punojnë natë e ditë për t'i vënë fre përhapjes së virusit COVID-19"¹².

Tani, si President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme dhe si Apostull i Jezu Krishtit, unë e di se Perëndia "ka gjithë fuqinë, gjithë diturinë dhe gjithë zgjuarsinë; ai kupton të gjitha gjërat dhe është një Qenie e mëshirshme, derisa të shpëtojë ata që do të pendohen dhe do të besojnë në emrin e Tij"¹³.

Prandaj, gjatë kohëve të shqetësimit të thellë, si në rastet kur sëmundja arrin përmasa pandemie, gjëja më e natyrshme për t'u bërë prej nesh është t'u bëjmë thirrje Atit tonë Qiellor dhe Birit të Tij – Shëruesit Mjeshtër – që ta shfaqin fuqinë e Tyre të mrekullueshme për t'i bekuar njerëzit e tokës.

Në mesazhin tim filmik, unë i ftova të gjithë të bashkoheshin në agjërim të dielën më 29 mars 2020. Shumë

nga ju mund ta kenë parë materialin filmik dhe u bashkuan me agjërimin. Disa mund të mos e kenë parë. Tani ne ende kemi nevojë për ndihmë nga qielli.

Prandaj sonte, vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, në frymën e bijve të Mosias, të cilët ishin dhënë pas lutjeve të shumta dhe agjërimit¹⁴, dhe si pjesë e konferencës sonë të përgjithshme të prillit 2020, unë po bëj thirrje për një agjërim tjetër mbarëbotëror. Për të gjithë ata që mund t'ua lejojë shëndeti, le të agjërojmë, të lutemi dhe ta bashkojmë besimin tonë edhe një herë. Le të përgjërohemi plot lutje për lehtësim prej kësaj pandemie botërore.

Unë i ftoj të gjithë, përfshirë ata që nuk janë të besimit tonë, që të agjërojnë dhe të luten të Premten e Mirë, më 10 prill, që pandemia e tanishme të mund të kontrollohet, që përkujdesësit për të sëmurët të mbrohen, ekonomia të forcohet dhe jeta të normalizohet.

Si agjërojmë ne? Dy vakte ushqimi ose një periudhë prej 24-orësh është mënyra e zakonshme. Por vendosni vetë se çfarë do të konsiderohej një sakrificë për ju, ndërkohë që kujtoni sakrificën supreme që bëri Shpëtimtari për ju. Le të bashkohemi në përgjërimin për shërim

anëmbanë botës.

E Premtja e Mirë do të ishte *dita* e përsosur që Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij i na dëgjojnë!

Vëllezër dhe motra të dashura, unë shpreh dashurinë time të thellë për ju, së bashku me dëshminë time për natyrën hyjnore të veprës në të cilën jemi përfshirë.



Kjo është Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme. Ai qëndron në krye të saj dhe drejton gjithçka që bëjmë. E di që Ai do t'u përgjigjet përgjërimeve të njerëzve të Tij. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 14:7.
2. Doktrina e Besëlidhje 115:4.
3. Shih Rasëll M. Nelson, "Emri i Saktë i Kishës", *Liahona*, nëntor 2018, f. 87–89.
4. Shih Rasëll M. Nelson, "Emri i Saktë i Kishës", f. 88.
5. Rasëll M. Nelson, "Emri i Saktë i Kishës", f. 89.
6. Shih Efesianëve 2:20.
7. Për ta respektuar natyrën e shenjtë të simbolit të Kishës dhe për ta ruajtur mbrojtjen ligjore, simboli zyrtar i Kishës duhet të përdoret vetëm siç miratohet nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve. Më shumë informacion mund të merret duke u vënë në kontakt me Intellectual Property Office [Zyrën e Kishës për Pronën Intelektuale] te cor-intellectualproperty@ChurchofJesusChrist.org.
8. Shih Eksodi 34:28; 2 Samuelit 12:16; Ezdras 10:6; Nehemias 1:4; Esterit 4:16; Isaia 58:3; Daniel 9:3; Joel 2:12.
9. Isaia 58:6; theksimi i shtuar.
10. 1 Korintasve 7:5.
11. Mateu 17:21; theksimi i shtuar.
12. Rasëll M. Nelson në "Profeti na Fton të Gjithë Ne të Bashkohemi në një Agjërim", 26 mars 2020, newsroom.ChurchofJesusChrist.org.
13. Alma 26:35.
14. Shih Alma 17:3.



Londër, Angli



Nga Plaku Ronald A. Rasband,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Përmbushja e Profecisë

Profecitë që janë përmbushur nga Rivendosja e plotësisë së ungjillit të Jezu Krishtit janë të shumta.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, jam i nderuar të flas në këtë konferencë të përgjithshme historike, që përkujton Vegimin e Parë të Jozef Smithit për Perëndinë, Atin, dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin, në atë që është, pa diskutim, një Korije e Shenjtë. Ai vegim ishte një fillim madhështor për Rivendosjen e ungjillit dhe gjithçka që u shpalo, nga Libri i Mormonit deri te kthimi i autoritetit dhe çelësave të priftërisë, organizimi i Kishës së vërtetë të Zotit, tempujt e Perëndisë dhe profetët e apostujt që e udhëheqin punën në këto ditë të mëvonshme.

Sipas qëllimit hyjnor, profetët e lashtë të Perëndisë, kur u nxitën nga Fryma e Shenjtë, profetizuan për Rivendosjen dhe atë që do të vinte në kohën tonë, në periudhën e fundit ungjillore dhe plotësinë e kohëve. Vetë vepra “frymëz[oi] shpirtin” e shikuesve të hershëm¹. Përgjatë brezave të kohës, ata parathanë, ëndërruan, përfytyruan dhe profetizuan për të ardhmen e mbretërisë së Perëndisë në tokë, atë që Isaia e quajti “mrekulli dhe çudi”².

Profecitë që janë përmbushur nga Rivendosja e plotësisë së ungjillit të Jezu Krishtit, përfshirë Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, janë të shumta. Sidoqoftë, sot do të theksoj vetëm disa nga të parapëlqyerat e mia. Këto m’u mësuuan nga mësueset e mia të dashura të

Fillores dhe në gjunjët e nënës sime engjëllore.

Danieli, i cili i largoi luanët me anë të besimit të tij në Zotin Jezu Krisht dhe ndërmjetësimin të engjëjve shërbëtarë të Perëndisë, ishte ai që e pa kohën tonë në vegim. Duke interpretuar një ëndërr për mbretin babilonas, Nebukadnetsarin, Danieli profetizoi se Kisha e Zotit do të ngrihej në ditët e fundit si një gur i vogël i “shkëput[ur] nga mali, jo nga dora e njeriut”³. “Jo nga dora e njeriut”, do të thotë që me anë të ndërhyrjes hyjnore, Kisha e Zotit do të rritet në madhësi derisa të mbushë gjithë tokën dhe “nuk do të shkatërrohet kurrë . . . [por] do të ekzistojë përjetë”⁴.

Është një dëshmi e thellë se fjalët e Danielit po përmbushen teksa anëtarët të Kishës, nga e gjithë bota, po e shikojnë dhe dëgjojnë konferencën sot.

Apostulli i përkushtuar Pjetër përshkroi “kohën e ripërtëritjes të të gjitha gjërave . . . që nga fillimi i botës”⁵. Apostulli Pal shkroi se në plotësinë e kohëve, Perëndia do të “sille në një krye të vetëm, në Krishtin, të gjitha gjërat”⁶, “duke qenë Jezu Krishti vetë guri kryesor i qoshes”⁷. I ndjeva ato profeci shumë fort kur mora pjesë në përkushtimin e Tempullit të Romës në Itali. Të gjithë profetët dhe apostujt ishin atje duke dhënë dëshmi për Jezu Krishtin, Shëlbuesin e botës, ashtu si Pjetri dhe Pali. Kisha është një shembull i gjallë i asaj ripërtëritjeje, vëllezër e motra, dhe anëtarët tanë janë dëshmitarë të atyre profecive hyjnore që u bënë shumë kohë më parë.

Jozefi i Egjiptit profetizoi se në ditët e mëvonshme “një shikues do të ngrejë Zoti, Perëndia im, i cili do të jetë një shikues i zgjedhur prej frytit të ijeve të mia”⁸. “Pasi ai do të bëjë punën [e Zotit].”⁹ Jozef Smithi, profeti i Rivendosjes, ishte ai shikues.

Gjon Zbuluesi profetizoi për një engjell të të Plotfuqishmit duke i sjellë së bashku elementët e rëndësishëm të Rivendosjes me këto fjalë: “Pastaj pashe një engjell tjetër që fluturonte në mes të qiellit dhe që kishte ungjillin e përjetshëm, që t’ua predikojë banorëve të dheut dhe çdo kombi, dhe fisi,



Solt Lejku Verior, Jutë, SHBA



dhe gjuhe, dhe populli¹⁰. Ai engjëll ishte Moroni. Ai e pa kohën tonë ashtu siç u shënuar në Librin e Mormonit. Në shfaqjet e përsëritura, ai e përgatiti Jozef Smithin për shërbesën e tij, përfshirë përkthimin e Librit të Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit.

Profetë të tjerë e parathanë kohën tonë. Malakia foli për Elijan që do t'ua kthente "zemra[t] e etërve . . . bijve dhe zemra[t] e bijve etërve"¹¹. Elija ka ardhur dhe si rrjedhojë, sot, ne kemi 168 tempuj që ndodhen kudo në tokë. Çdo tempull u shërben anëtarëve të denjë, që bëjnë besëlidhje të shenjta dhe marrin ordinancë të bekuara në emër të vetes së tyre dhe të paraardhësve të tyre të vdekur. Kjo punë e shenjtë, e përshkruar nga Malakia është "thelbësore në planin e Krijuesit për destinacionin e përjetshëm të fëmijëve të Tij"¹².

Ne jetojmë në atë kohë të profetizuar; ne jemi njerëzit e ngarkuar për të mirëpritur fillimin e Ardhjes së Dytë të Jezu Krishtit; ne duhet të mbledhim fëmijët e Perëndisë, ata që do t'i dëgjojnë e përqafojnë të vërtetat, besëlidhjet dhe premtimet e ungjillit të përjetshëm. Presidenti Nelson e quan atë "sfid[a] më [e] madhe, kauz[a] më [e] madhe dhe pun[a] më [e] madhe në tokë sot"¹³. Për atë mrekulli unë jap dëshminë time.

I caktuar nga Presidenti Rasëll M. Nelson, në shkurt të këtij viti, unë përkushtova Tempullin e Durbanit në Afrikën e Jugut. Ishte një ditë që do ta kujtoj gjithë jetën time. Unë isha

me anëtarë që kanë ardhur në ungjill ashtu siç profetizoi Jeremia shumë kohë më parë – "një në çdo qytet dhe dy nga çdo familje"¹⁴. Doktrina e Jezu Krishtit na bashkon të gjithëve ne – në mbarë botën – si bij dhe bija të Perëndisë, si vëllezër e motra në ungjill. Pavarësisht se si dukemi apo vishemi, ne jemi një popull me një Atë në Qiell, plani i të cilit që nga fillimi ishte dhe është që familja e Tij të ribashkohet duke bërë dhe duke mbajtur besëlidhjet e shenjta të tempullit.

Një grupi të vogël mbajtësish të priftërisë në një shtëpi që ishte edhe shkollë, në Kirtland të Ohajos, në vitin 1834, Profeti Jozef u profetizoi: "Është vetëm një grusht njerëzish që e mbajnë Priftërinë këtu sonte, por kjo Kishë do të mbushë Amerikën e Veriut dhe të Jugut – ajo do të mbushë botën"¹⁵.

Vitet e fundit kam udhëtuar anëmbanë botës për t'u takuar me anëtarë të Kishës. Vëllezërit e mi të Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve kanë pasur detyra të ngjashme. Megjithatë, kush mund të matet me programin e profetit tonë të dashur, Presidentit Nelson, udhëtimi i të cilit në dy vitet e tij të para si President i Kishës e ka çuar atë për t'u takuar me shenjtorët në 32 vende dhe territore të SHBA-së¹⁶ për të dëshmuar për Krishtin e gjallë.

Më kujtohet kur mora thirrjen time të misionit si një i ri. Doja të shërbeja në Gjermani, ashtu si babai, vëllai dhe kunati im. Duke mos pritur për

asnjë që të vinte në shtëpi, nxitova për te kutia postare dhe e hapa thirrjen. Lexova se isha thirrur në Misionin e Shteteve Lindore, me zyrën qendrore në Nju-Jork-Siti. U zhgënjeva, kështu që u ktheva brenda dhe hapa shkrimet e mia të shenjta për ngushëllim. Fillova të lexoja te Doktrina e Besëlidhje: "Vini re dhe shihni, unë kam shumë njerëz në këtë vend, në krahinat përreth; dhe një derë frytdhënëse do të hapet në krahinat përreth në këtë tokë të lindjes"¹⁷. Ajo profeci, që iu dha Profetit Jozef Smith në vitin 1833, ishte një zbulues për mua. E dija atëherë, se isha thirrur në misionin e duhur në të cilin Zoti donte që unë të shërbeja. Dhashë mësim Rivendosjen dhe fillimin e saj dramatik kur Ati ynë në Qiell foli me Jozef Smithin dhe i tha: "Ky është Biri im i Dashur. Dëgjoje Atë!"¹⁸

Me rëndësi të madhe për të gjithë Kishën është profecia e Isaia, që u dha më shumë se 700 vjet përpara lindjes së Jezu Krishtit: "Në ditët e fundit do të vij që mali ku ndodhet shtëpia e Zotit do të vendoset në majën e maleve . . . dhe këtu do të vërshojnë tërë kombet"¹⁹.

Në mendjen time sot, përfytyroj miliona prej anëtarëve dhe miqve tanë të lidhur në mënyrë elektronike me këto transmetime, nëpërmjet televizionit, internetit apo mjeteve të tjera. Ne jemi ulur sikur të ishim së bashku "në majën e maleve"²⁰. Ishte Brigam Jangu që tha fjalët profetike: "Ky është vendi i

duhur”²¹. Shenjtorët, disa prej tyre vetë paraardhësit e mi pionierë, punuan për të themeluar Sionin në Malet Shkëmbore “nëpërmjet vullnetit dhe kënaqësisë së atij që i dikton kombet e tokës”²².

Unë qëndroj sot në tokën e shenjtë që ka tërhequr miliona vizitorë. Në vitin 2002, Solt-Lejk-Siti organizoi Lojërat Olimpikë Dimërore. Kori i Tabernakullit këndoi në ceremonitë e hapjes dhe Kisha ofroi koncerte dhe programe për të ftuarit dhe pjesëmarrësit nga shumë e shumë kombe. Do ta kujtoj gjithmonë që e shihja tempullin në sfondin e lajmeve të mbrëmjes të cilat transmetoheshin në mbarë botën.

Me kalimin e viteve, presidentë të Shteteve të Bashkuara, mbretër, gjyqtarë, kryeministra, ambasadorë dhe zyrtarë nga shumë vende kanë ardhur në Solt-Lejk-Siti dhe janë takuar me

udhëheqësit tanë. Presidenti Nelson u takua me udhëheqësit e Shoqatës Kombëtare për Përparimin e Njerëzve me Ngjyrë, një organizatë në Shtetet e Bashkuara e angazhuar për të drejta të barabarta pa diskriminim në bazë të racës. Më kujtohet që qëndroja krah për krah me këta miq dhe udhëheqës teksa Presidenti Nelson u bashkua me ta, duke bërë thirrje për një mirësjellje dhe harmoni racore më të madhe në botë.²³

Shumë më tepër njerëz kanë ardhur në Sheshin e Tempullit dhe janë takuar për këshillim me udhëheqësit e Kishës. Për shembull, vitin që shkoi, për të përmendur vetëm disa, ne mirëpritëm Konferencën e 68-të të Shoqërisë Civile të Kombeve të Bashkuara, një mbledhje botërore dhe e para në llojin e saj jashtë Nju-Jork-Sitit. Jemi takuar me Komitetin për Çështjet Fetare

të Vietnamit, me ambasadorë nga Kuba, Filipinet, Argjentina, Rumania, Sudani, Katari dhe Arabia Saudite. Ne gjithashtu mirëpritëm sekretarin e përgjithshëm të Lidhjes Botërore të Myslimanëve.

Ajo që po përshkruaj është një përmbushje e profecisë së Isaias, se në ditët e fundit, kombet do të vërshojnë në “malin ku ndodhet shtëpia e Zotit”²⁴. Tempulli i madh i Solt-Lejkut qëndron në qendër të asaj madhështie dhe lavdie.

Nuk është peizazhi që i ka tërhequr njerëzit, edhe pse ambienti ynë është i mrekullueshëm; është

thelbi i fesë së kulluar që shfaqet në frymën, rritjen, mirësinë dhe bujarinë e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe njerëzve të saj; është dashuria jonë ashtu siç do Perëndia; dhe zotimi ynë ndaj një kauze më të lartë, atë që Jozef Smithi e quajti, “kauz[a] e Krishtit”²⁵.

Ne nuk e dimë se kur do të kthehet Shpëtimtari, por kaq gjë e dimë. Ne duhet të jemi të përgatitur në zemër e mendje, të denjë për ta pranuar Atë dhe të nderuar që jemi pjesë e gjithçkaje që ishte profetizuar shumë kohë më parë.

Dëshmoj se Presidenti Rasëll M. Nelson është profeti i Zotit në tokë dhe se në krah të tij janë Apostuj të thirrur nga Perëndia, të mbështetur si profetë, shikues e zbulues. Dhe, vëllezërit e motrat e mia të dashura, Rivendosja vazhdon.

E mbyll me profecinë e Jozef Smithit, fjalë për të cilat unë dëshmoj se janë të vërteta: “Asnjë dorë mëkatore nuk mund ta ndalojë përparimin e punës; përndjekjet mund të tërbohen, turmat mund të bashkohen, [ushtritë] mund të mblidhen, shpifja mund të përgojojë, por e vërteta e Perëndisë do të shkojë përpara me guxim, me fisnikëri dhe e pavarur derisa ajo të ketë përshkuar çdo kontinent, të ketë vizituar çdo rajon, të ketë përfshirë çdo vend dhe të jetë dëgjuar nga çdo vesh, derisa qëllimet e Perëndisë [do] të përmbushen dhe Jehovai i Madh të thotë [se] puna u krye”²⁶. Dëshmoj kështu se këto profeci të Jozef Smithit po përmbushen.

Ju premtoj se ndërsa ndiqni këshillat e frymëzuara të profetit tonë të dashur, Presidentit Rasëll M. Nelson, të këshilltarëve të tij, të Apostujve dhe të udhëheqësve të tjerë të Kishës, dhe ndërsa u kushtoni vëmendje profetëve të lashtë që e parathanë kohën tonë,



Provo, Jutë, SHBA



Nga Boni H. Kordën,
Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

ju do të mbusheni, thellë në zemrën e shpirtin tuaj, me frymën dhe veprën e Rivendosjes. Premtoj se ju do ta shihni dorën e Perëndisë në jetën tuaj, do t'i dëgjoni nxitjet e Tij dhe do ta ndieni dashurinë e Tij. Në emër të Jezu Krishtit, me mirënjohje për Rivendosjen e ungjillit të Tij dhe të Kishës së Tij, si provë e dashurisë së Tij të pakrahasueshme, amen. ■

SHËNIME

1. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 549.
2. Isaia 29:14.
3. Daniel 2:45; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 65:2.
4. Daniel 2:44.
5. Veprat e Apostujve 3:21.
6. Efesianëve 1:10.
7. Efesianëve 2:20.
8. 2 Nefi 3:6.
9. 2 Nefi 3:8.
10. Zbulesa 14:6.
11. Malakia 4:6.
12. "Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës", *Liahona*, maj 2017, f. 145.
13. Rasëll M. Nelson, "Shpresa e Izraelit" (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), HopeofIsrael.ChurchofJesusChrist.org.
14. Jeremia 3:14.
15. Joseph Smith, në *Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* (2004), f. 26.
16. Shih Valerie Johnson, "President Nelson Became the Prophet 2 Years Ago. What Has Happened Since Then?" *Church News*, 13 janar 2020, thechurchnews.com.
17. Doktrina e Besëlidhje 100:3.
18. Joseph Smith – Historia 1:17.
19. Isaia 2:2; shih edhe Mikea 4:1–2.
20. Isaia 2:2.
21. Faza "ky është vendi i duhur" u quajt fillimisht si e Brigam Jangut Uillford Udrafi ndërkohë që fliste në një festë të Ditës së Pionierëve në korrik 1880 (shih "Pioneers' Day", *Deseret Evening News*, 26 korrik 1880, f. 2).
22. Brigham Young, 31 mars 1861, raporte të fjalimeve prej Historian's Office, 1845–1885, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti.
23. Shih "First Presidency and NAACP Leaders Call for Greater Civility, Racial Harmony", 17 maj 2018, newsroom.ChurchofJesusChrist.org.
24. Isaia 2:2; shih edhe Mikea 4:1–2.
25. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 377.
26. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 473–474.

Që Ata të Shohin

Kërkoni dhe lutuni për mundësi që ta lini dritën tuaj të shkëlqejë, që të tjerët të mund të shohin udhën për te Jezu Krishti.

Vëllezër dhe motra, zemra jonë është bekuar dhe është përtërirë nga Shpirti që kemi ndier në këtë konferencë.

Dyqind vjet më parë, një shtyllë drite qëndroi mbi një djalosh në një korije. Në atë dritë, Jozef Smithi pa Perëndinë, Atin dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin. Drita e tyre e sprapsi errësirën shpirtërore që e mbulonte tokën dhe ia tregoi udhën përpara Jozef Smithit – dhe të gjithëve ne. Për shkak të dritës që u shpalos atë ditë, ne mund të marrim plotësinë e bekimeve të mundësuaru nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.

Në saje të Rivendosjes së ungjillit të Tij, ne mund të mbushemi me dritën e Shpëtimtarit tonë. Sidoqoftë, ajo dritë nuk është synuar vetëm për ju dhe për mua. Jezu Krishti na ka bërë thirrjen: "Le të shkëlqejë drita juaj para këtyre njerëzve, që ata të shohin veprat tuaja të mira dhe të lëvdojnë Atin tuaj që është në qiell"¹. Kam arri tur ta pëlqej shumë frazën "që ata të shohin". Ajo është

një ftesë e zjarrtë nga Zoti që të jemi më të qëllimshëm rreth ndihmës ndaj të tjerëve që ta shohin shtegun dhe si rrjedhim të vijnë te Krishti.

Kur isha 10 vjeçe, familja jonë pati nderin të priste në shtëpi Plakun L Tom Peri, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ndërkohë që ishte me detyrë në qytetin tim të lindjes.

Në fund të ditës, familja jonë dhe familja Peri u ulëm në dhomën e ndenjes për të shijuar ëmbëlsirën e shijshme me mollë të nënës sime, ndërkohë që Plaku Peri tregonte histori rreth shenjtoreve anëmbanë botës. U magjepsa.

Po shkonte vonë, kur, nëna më thirri në kuzhinë dhe më bëri një pyetje të thjeshtë: "Boni, a i ushqeve pulat?"



Provo, Jutë, SHBA



Brigam-Sit, Jutë, SHBA

Më ngriu zemra; nuk e kisha bërë. Duke mos dashur që të largohesha nga prania e një Apostulli të Zotit, thashë me mendje se pulat mund të agjëronin deri në mëngjes.

Nëna më dha një përgjigje të prerë “jo”. Pikërisht në atë çast, Plaku Peri hyri në kuzhinë dhe me zërin e tij kumbues e entuziast pyeti: “Mos dëgjova vallë se dikush duhet të ushqejë pulat?” A mund të vijmë im bir dhe unë me ty?”

O, çfarë gëzimi i madh u bë tani të ushqeja pulat! Vrapova për të marrë elektrikun tonë të madh të dorës me ngjyrë të verdhë. E emocionuar, para-privat, duke kapërcyer përgjatë shtegut të prishur për te koteci i pulave. Me elektrikun që e vërtitja në dorë, kaluam ngastrën me misër dhe ecëm përmes fushës me grurë.

Kur arritëm te kanali i vogël vaditës që ndërpriste shtegun, në mënyrë instiktive e kapërceva siç kisha bërë shumë net më parë. Nuk u kushtova vëmendje përpjekjeve të Plakut Peri për të më ndjekur përgjatë një shtegu të errët e të panjohur. Drita e papërqendruar që bëja unë nuk e ndihmoi

atë që ta shihte kanalin. Pa një dritë të qëndrueshme që të shihte, ai shkeli direkt në ujë dhe lëshoi një rënkim të fortë. E zënë nga paniku, ktheva kokën të shihja mikun tim të ri duke nxjerrë këmbën e qullur nga kanali dhe duke shkundur ujin nga këpuca e tij e rëndë prej lëkure.

Me një këpucë të qullur e me baltë, Plaku Peri më ndihmoi të ushqeja pulat. Kur mbaruam, ai më udhëzoi me shumë dashuri: “Boni kam nevojë ta shoh shtegun. Kam nevojë që drita të ndriçojë aty ku po eci.”

Unë po bëja dritë por jo në një mënyrë që do ta ndihmonte Plakun Peri. Tani, duke e ditur se atij i nevojitej drita ime për ta përshkuar i sigurt shtegun, ia drejtova elektrikun e dorës pikërisht përpara hapave dhe qemë në gjendje të ktheheshim në shtëpi me vetësiguri.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, për vite me radhë e kam përsiatuar parimin që mësova nga Plaku Peri. Ftesa e Zotit që drita jonë të shkëlqejë, nuk ka të bëjë vetëm me vërtitjen kuturu të rrezes së dritës dhe që ta bëjmë botën më të shndritshme në përgjithësi. Ajo ka të bëjë

me përqendrimin e dritës sonë, që të tjerët të mund të shohin udhën për te Krishti. Ka të bëjë me mbledhjen e Izraelit nga të dyja anët e velit – duke i ndihmuar të tjerët që ta shohin hapin e radhës drejt bërjes dhe mbajtjes së besëlidhjeve të shenjta me Perëndinë².

Shpëtimtari dëshmoi: “Vini re, unë jam drita; unë kam vendosur një shembull për ju”³. Le të shohim një nga shembujt e Tij.

Gruaja te pusi ishte samaritane, e cila nuk e njohte Jezu Krishtin dhe shihej nga shumë njerëz si e dëbuar nga shoqëria e vet. Jezusi e takoi dhe filloi të bisedonte. Ai i foli asaj për ujin. Më pas Ai i hodhi një dritë të shtuar ndër- sa Ai e shpalli Vetën si “ujli i gjallë”⁴.

Krishti ishte i vëmendshëm në mënyrë të dhembshur ndaj saj dhe nevojave të saj. Ai e takoi gruan atje ku ishte dhe filloi të fliste rreth diçkaje që njihje dhe që e zakonshme. Nëse Ai do ta ndalte aty bisedën, ai do të kish qenë një takim pozitiv. Por nuk do ta kishte shtyrë atë që të shkonte në qytet për të shpallur: “Ejani, të shikoni . . . ; vallë mos është ky Krishti?”⁵ Gradualisht, gjatë bisedës, ajo zbuloi Jezu Krishtin dhe pavarësisht të kaluarës së saj, ajo u bë një mjet drite, duke e ndriçuar rrugën që ta shihnin të tjerët⁶.

Tani, le të vërejmë dy njerëz që e ndoqën shembullin e Shpëtimtarit për dritën që shkëlqen. Kohët e fundit miku im Kevini, ishte ulur në krah të një drejtori kompanie gjatë darkës. Shqetësohej se për çfarë do të fliste për dy orë. Duke ndjekur një nxitje, Kevini i bëri pyetjen: “Më trego rreth familjes sate. Nga e kanë origjinën?”

Zotëria nuk dinte shumë për trashëgiminë e tij, kështu që Kevini nxori celularin, dhe tha: “Kam një program që i lidh njerëzit me familjarët e tyre. Le të shohim se ç’mund të gjejmë!”



Pas një bisede të gjatë, miku i ri i Kevinit i bëri pyetjen: “Përse familja është kaq e rëndësishme për kishën tuaj?”

Kevini u përgjigj thjesht: “Ne besojmë se vazhdojmë të jetojmë pasi vdesim.” Nëse i gjejmë paraardhësit tanë dhe ua çojmë emrat në një vend të shenjtë që e quajmë tempull, ne mund të kryejmë ordianca martesore që do t’i mbajnë familjet tona përgjithmonë bashkë, edhe pas vdekjes”⁷.

Kevini e nisi me diçka që ai dhe miku i tij i ri kishin të përbashkët. Më pas ai gjeti një mënyrë për të dëshmuar për dritën dhe dashurinë e Shpëtimtarit.

Historia e dytë është rreth Elës, një lojtare basketbollit në kolegji. Shembulli i saj filloi kur ajo mori thirrjen e saj për mision ndërkohë që ndodhej në shkollë. Ajo zgjodhi ta hapte zarfin e thirrjes së saj përpara skuadrës. Ata nuk dinin thujtë asgjë rreth Kishës së Jezu Krishtit dhe nuk e kuptonin dëshirën e Elës për të shërbyer. Ajo

u lut vazhdimisht për të ditur se si ta shpjegonte thirrjen e saj të misionit në një mënyrë që skuadra e saj të mund ta ndiente Shpirtin. Përgjigja e saj?

“Bëra një paraqitje me PowerPoint”, tha Ela, “nga që jam e hatashme”. Ajo u tregoi atyre rreth mundësisë për të shërbyer në një nga 400 a më shumë misione dhe me gjasë për të mësuar një gjuhë. Ajo nxori në pah mijëra misionarë që ishin duke shërbyer tashmë. Ela e mbylli me një pikturë të Shpëtimtarit dhe me këtë dëshmi të shkurtër: “Basketbollit është një nga gjërat më të rëndësishme në jetën time. U shpërngula në skajin tjetër të vendit dhe e lashë familjen time për të luajtur për këtë trajner dhe këtë skuadër. Dy gjërat e vetme që janë më të rëndësishme për mua se basketbollit janë besimi dhe familja ime.”⁸

Tani, në rast se po mendoni: “Këto janë shembuj llambash prej 1 000 vatësh, kurse unë jam llambë prej 20 vatësh” kujtoni se Shpëtimtari dëshmoi: “Unë jam drita që ju duhet të mbani lart”⁹. Ai na kujton se Ai do të na e sjellë dritën nëse ne thjesht do t’i drejtojmë të tjerët për tek Ai.

Ju dhe unë kemi mjaftueshëm dritë për të dhënë *pikërisht tani*. Ne mund ta ndriçojmë hapin e radhës për ta ndihmuar dikë të vijë më pranë Jezu Krishtit dhe më pas, hapin tjetër e me radhë.

Pyeteni veten: “Kush ka nevojë për dritën që keni ju për të gjetur shtegun që i nevojitet, por që nuk e sheh dot?”

Miqhtë e mi të dashur, përse është kaq e rëndësishme që drita jonë të shkëlqejë? Zoti na ka thënë se, “ka shumë vetë akoma mbi tokë . . . të cilët mbahen larg nga e vërteta vetëm ngaqë nuk dinë se ku ta gjejnë atë”¹⁰. Ne mund të ndihmojmë. Ne mund ta lëmë dritën tonë të shkëlqejë qëllimisht që të tjerët të mund të shohin.

Ne mund të bëjmë një ftesë¹¹. Mund ta bëjmë rrugëtimin me ata që po e hedhin një hap drejt Shpëtimtarit, s’ka rëndësi nëse është një hap i pavendosur. Ne mundemi ta mbledhim Izraelin.

Unë dëshmoj se Zoti do ta lartësojë çdo përpjekje të vogël. Fryma e Shenjtë do të na nxitë të dimë se çfarë të themi e të bëjmë. Përpjekje të tilla mund të na kërkojnë që të dalim nga zona jonë e rehatisë, por mund të jemi të sigurt se Zoti do të na ndihmojë që drita jonë të shkëlqejë.

Sa mirënjohëse jam për dritën e Shpëtimtarit, e cila vazhdon ta udhëheqë këtë Kishë me anë të zbulësës!

E ftoj secilin prej nesh që ta ndjekë shembullin e Jezu Krishtit dhe të jetë i vëmendshëm plot përdëllim ndaj atyre rreth nesh. Kërkoni dhe lutuni për mundësi që ta lini dritën tuaj të shkëlqejë, që të tjerët të mund të shohin udhën për te Jezu Krishti. Premtimi i tij është i madhërishtëm: “Kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës”¹². Unë dëshmoj se Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti, është udha, e vërteta, jeta, drita dhe dashuria e botës. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. 3 Nefi 12:16.
2. Shih Rasëll M. Nelson, “Shpresa e Izraelit” (takim shpirtëror mbarëbotëror për rininë, 3 qershor 2018), HopeofIsrael. ChurchofJesusChrist.org.
3. 3 Nefi 18:16.
4. Shih Gjoni 4:9–30.
5. Gjoni 4:29.
6. Shih Robert and Marie Lund, “The Savior’s Respect for Women”, *Liahona*, mars 2015, f. 32–36.
7. Letërkëmbim vetjak.
8. Letërkëmbim vetjak.
9. 3 Nefi 18:24.
10. Doktrina e Besëlidhje 123:12.
11. Shih Diter F. Uhtdorf, “Puna Misionare: Shprehja e Asaj që Keni në Zemër”, *Liahona*, maj 2019, f. 15–18.
12. Gjoni 8:12.



Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Një Ndriçim i Përkryer i Shpresës

Për shkak se Rivendosja e ripohoi të vërtetën themelore që Perëndia punon njëmend në këtë botë, ne mund të shpresojmë, ne duhet të shpresojmë, edhe kur përballemi me gjasa shumë të pakta që diçka e mirë të ndodhë.

Tetorin e shkuar, Presidenti Rasëll M. Nelson na ftoi të shihnim *përpara* drejt kësaj konference të prillit 2020 duke vështruar secili nga ne *prapa* në mënyrën e tij për të parë madhësitë e dorës së Perëndisë në rivendosjen e ungjillit të Jezu Krishtit. Motra Holland dhe unë e morëm seriozisht atë ftesë profetike. E përfytyruam veten duke jetuar në fillim të viteve 1800 duke parë bindjet fetare të asaj kohe. Në atë mjedis të përfytyruar, e pyetëm

veten: “Çfarë mungon këtu? Çfarë do të donim të kishim? Çfarë *shpresojmë* njëmend se Perëndia do të na japë në përgjigje të dëshirimit tonë shpirtëror?”

Epo, si fillim, kuptuam se dy shekuj më parë do të kishim shpresuar fort për rivendosjen e një koncepti më të vërtetë të Perëndisë nga sa kishin shumica e njerëzve në atë kohë, i fshehur siç dukej shpesh se ishte Ai prapa shekujsh të tërë gabimesh dhe keqkuptimesh. Duke marrë hua një frazë nga Uilliam Ellëri Çeningu, një figurë e spikatur fetare e kohës, do të kishim kërkuar “karakterin prindëror të Perëndisë”, të cilin Çeningu e konsideronte “doktrinën e parë të madhe të krishterimit”¹. Një doktrinë e tillë do ta kishte pranuar Hyjninë si një Atë përkujdesës në Qiell, në vend që ta njihje si një gjykatës të ashpër që ushtron një drejtësi të sertë ose si një pronar jo të pranishëm që dikur qe përfshirë në çështjet e tokës, por tani ishte i zënë diku tjetër në univers.

Po, shpresa jonë në vitin 1820 do të kishte qenë ta gjenim Perëndinë duke folur e duke udhërrëfyer aq

hapur në të tashmen sa e kishte bërë në të shkuarën, një Atë të vërtetë në kuptimin më të dashur të asaj fjale. Ai me siguri që *nuk* do të kishte qenë një autokrat i ftohtë, arbitrar i cili paracaktoi pak njerëz të zgjedhur për shpëtim dhe më pas e la pjesën tjetër të familjes njerëzore në dënim. Jo, Ai do të ishte Dikush, çdo veprim i të cilit, sipas shpalljes hyjnore, do të ishte “për të mirën e botës; pasi ai e do botën”² dhe çdo banor të saj. Ajo dashuri do të ishte arsyeja madhore e Tij për dërgimin e Jezu Krishtit, Birit të Tij të Vetëmlindur, në tokë.³

Duke folur për Jezusin, po të kishim jetuar në ato vitet e para të shekullit të 19-të, do ta kishim kuptuar duke u alarmuar shumë se dyshimet rreth vërtetësisë së jetës dhe Ringjalljes së Shpëtimtarit po fillonin të zinin një vend domethënës brenda botës së krishterë. Prandaj, do të kishim shpresuar që të gjithë botës t’i vinin fakte që do ta vërtetonin dëshminë biblike se Jezusi *është* Krishti, Biri i mirëfilltë i Perëndisë, Alfa dhe Omega dhe i vetmi Shpëtimtar që do të njohë kjo botë. Do të kishte qenë një nga shpresat tona më të mëdha që të nxirrej një shkrim tjetër i shenjtë si fakt, diçka që mund të përbente një dëshmi tjetër të Jezu Krishtit, duke e zmadhuar e zgjeruar njohurinë tonë për lindjen e Tij mrekullibërëse, shërbesën e mahnitshme, flijimin shlyes dhe Ringjalljen e lavdishme. Vërtet, një dokument i tillë do të ishte “drejtësi [e] dërg[uar] nga qiejt; [e] vërtetë [e] dërg[uar] nga toka”⁴.

Nga vëzhgimi i botës së krishterë në atë kohë, do të kishim shpresuar të gjenim dikë të autorizuar nga Perëndia me autoritet të vërtetë priftërie që të mund të na pagëzonte, të na jepte dhuratën e Frymës së Shenjtë dhe të na administronte të gjitha ordinancat e ungjillit të nevojshme për ekzaltim.



Provo, Jutë, SHBA



Në vitin 1820, do të kishim shpresuar t'i shihnim të përmbushura premtimet shprehëse të Isaia, Mikeas dhe profetëve të tjerë të lashtë në lidhje me rikthimin e shtëpisë madhështore të Zotit.⁵ Do të ishim ngazëllyer po të shihnim lavdinë e tempujve të shenjtë të ngrihej sërish, me Shpirtin, ordinarcat, fuqinë dhe autoritetin për të dhënë mësim të vërteta të përjetshme, për të shëruar plagë vetjake e për t'i lidhur familjet së bashku përgjithmonë. Do të kisha kërkuar kudo dhe gjithkund për të gjetur dikë të autorizuar për të më thënë mua dhe Patrishës sime të shtrenjtë që martesë jonë në një mjedis të tillë që vulosur për kohën dhe të gjithë përjetësinë, që kurrë të mos e dëgjonim ose të na ngarkohej mallkimi i pandashëm “derisa vdekja t’ju ndajë”. E di se “në shtëpinë e Atit [tonë] ka shumë banesa”⁶ por, duke folur për veten, nëse do të isha aq fatlum sa të trashëgoja njërin prej tyre, për mua ajo nuk do të mund të ishte më shumë se një kasolle e kalbur nëse Pati dhe fëmijët tanë nuk do të ishin me mua për ta ndarë bashkë atë trashëgimi. Dhe për paraardhësit tanë, disa prej të cilëve jetuan dhe vdiqën në lashtësi pa ia dëgjuar as emrin Jezus Krishtit, do të kishim shpresuar që të rivendoseshin konceptet më të drejta e më mëshirplota biblike – praktika e


të gjallëve që ofrojnë ordinarca shpëtuuese në emër të të afërmeve të tyre të vdekur.⁷ Asnjë praktikë që mundem ta përfytyroj, nuk do ta demonstronte me më tepër shkëlqim shqetësimin e një Perëndie të dashur për secilin nga fëmijët e Tij tokësorë pavarësisht se kur jetuan apo ku vdiqën ata.

Mirë, lista jonë e gjërave që do të shpresonim në 1820-ën, mund të vazhdojë, por ndoshta mesazhi më i rëndësishëm i Rivendosjes është që shpresa të tilla të *mos* kishin qenë më kot. Duke filluar nga Korija e Shenjtë e duke vazhduar në këtë ditë, këto dëshira filluan të vishen me realitet dhe u bënë, sikurse dhanë mësim Apostulli Pal e të tjerë, spiranca të vërteta për shpirtin, të sigurtat e të pa-tundura.⁸ Ajo për të cilën dikur veçse shpresohej, tani është bërë histori.

Ky ishte vështrimi ynë prapa te 200 vjet mirësi e Perëndisë ndaj botës. Po për sa i përket vështrimit tonë përpara? Ne përsëri kemi shpresa që *nuk* janë përmbushur ende. Edhe tani ndërsa flasim, po zhvillojmë një luftë “me të gjitha forcat e bashkuara” me virusin COVID-19, një kujtues solemn që një virus⁹ 1000 herë më i vogël sesa një grimcë rëre¹⁰ mund të bëjë që popullata të tëra dhe ekonomitë botërore të gjunjëzohen. Ne lutemi për ata që kanë humbur njerëz

të dashur në këtë plagë moderne, si dhe për ata që janë aktualisht të infektuar ose të rrezikuar. Ne sigurisht lutemi për ata që po japin një kujdes kaq të mahnitshëm shëndetësor. Kur ta kemi mposhtur këtë – dhe do ta mposhtim – qofshim po kaq të zotuar për ta çliruar botën nga virusi i urisë, për t'i çliruar lagjet e kombet nga virusi i varfërisë. Shpresofshim për shkolla ku nxënësit marrin mësim – pa pasur tmerr se mbi ta do të qëllohet me armë – dhe për dhuratën e dinjitetit vetjak për çdo fëmijë të Perëndisë, të padëmtuar nga *asnjë* lloj forme paragjykimi racor, etnik ose fetar. Mbi të gjitha këto është shpresa jonë e pareshtur për përkushtim më të madh ndaj dy urdhërimeve më të mëdha prej të gjithave: ta duam Perëndinë duke e zbatuar këshillën e Tij dhe t'i duam të afërmit tanë duke treguar dashamirësi e dhembshuri, durim e falje.¹¹ Këto dy direktiva hyjnore janë ende – dhe do të jenë gjithmonë – e vetmja shpresë reale që kemi për t'u dhënë fëmijëve tanë një botë më të mirë nga ajo që njohin tani.¹²

Përveç pasjes së këtyre dëshirave për të gjithë globin, shumë nga ata që po dëgjojnë sot, kanë shpresa thellësisht vetjake: shpresë që një martesë të përmirësohet ose nganjëherë thjesht shpresë për një martesë; shpresë që të mposhtet një varësi; shpresë



Tabau de Serra, San-Paolo, Brazil

që një fëmijë i pabindur të kthehet në udhën e duhur; shpresë që të ndalojë dhembja fizike ose emocionale prej qindra lloje shkaqesh. Për shkak se Rivendosja e ripohoi të vërtetën themelore që Perëndia punon njëmend në këtë botë, ne *mund* të shpresojmë, ne *duhet* të shpresojmë, edhe kur përballemi me gjasë shumë të pakta që diçka e mirë të ndodhë. Kjo është ajo që nënkuptonte shkrimi i shenjtë me frazën që Abrahami që në gjendje të shpresonte kundër çdo shprese¹³ – kjo do të thotë se ai që në gjendje të besonte pavarësisht nga çdo arsye për të mos besuar – se ai dhe Sara mund të ngjiznin një fëmijë kur ajo gjë dukej krejtësisht e pamundur. Ndaj, unë bëj pyetjen: “Nëse kaq shumë prej gjërave që shpresonim në vitin 1820, mundën të fillonin të përmbusheshin me një çast të shkurtër drite hyjnore ndaj një djali të thjeshtë që u gjunjëzua në një pyllishtë në rrethinat në veri të Nju-Jorkut, pse të mos shpresojmë ne që dëshirat e drejta dhe dëshirimet si të Krishtit mundën ende të marrin përgjigje në mënyrë të mahnitshme e mrekullibërëse nga Perëndia i çdo shprese?” Të gjithë kemi nevojë të besojmë se ajo që dëshirojmë me drejtësi, mundet një ditë, në njëfarë mënyre, disi, të jetë e jona.

Vëllezër dhe motra, ne e dimë se cilat ishin disa prej mangësive fetare në fillim të shekullit të 19-të. Për më tepër, ne dimë diçka për të metat e sotme fetare që ende e nuk e ngijnë urinë dhe shpresën e disave. Ne e dimë se një larmi e atyre pakënaqësive të tilla po i shtyjnë disa të largohen nga institucionet tradicionale kishtarë. Ne gjithashtu dimë, sikurse shkroi një herë një shkrimtar i zhgënjyer, se “shumë udhëheqës fetarë [të kohës] duken sikur nuk ia kanë idenë fare” si ta trajtojnë këtë lloj dobësimi, duke



ofruar si përgjigje “një deizëm të qullët si terapi, aktivizëm simbolik të pavlerë, herezi të shprehur me kujdes, [ose nganjëherë vetëm] doktra që nuk të frymëzojnë”¹⁴ – dhe të gjitha në një kohë kur botës i nevojitet shumë më tepër se kaq, kur brezi që po rritet meriton shumë më tepër dhe kur Jezusi në kohën e Vet ofroi shumë më tepër. Si dishepuj të Krishtit, ne mundemi në kohën tonë të ngrihemi më lart se ata izraelitë të lashtësisë të cilët u ankuan: “Kockat tona janë të thata, shpresa jonë është zhdukur”¹⁵. Njëmend, nëse ne përfundimisht e humbasim shpresën, humbasim zotërimin e fundit që na mban të fortë. Ishte pikërisht mbi vetë portën e ferrit që Dante shkroi një paralajmërim për të gjithë ata që do të udhëtonin nëpër veprën e tij *Komedia Hyjnore*: “Braktisini të gjitha shpresat”, tha ai, “o ju që hyni këtu”¹⁶. Vërtet, kur zhduket shpresa, ajo që na mbetet është flaka e ferrit që përhapet furishëm nga çdo anë.

Ndaj, kur të jemi me shpatulla pas murit dhe, sikurse thotë himni “kur tjetër ndihm’ s’ka dhe shkon çdo ngush’lirim”¹⁷, një nga virtytet tona më të domosdoshme do të jetë kjo dhuratë e çmuar e shpresës së lidhur pazgjidhshmërisht me besimin tonë në Perëndi dhe me dashurinë tonë hyjnore për të tjerët.

Në këtë vit që shënon dyqindvjetorin, kur vështrojmë prapa për të parë gjithçka na është dhënë dhe gëzohemi ngaqë kuptojmë se shumë shpresa na janë përmbushur, unë përsërit mendimin që një motër e re dhe e shkëlqyer misionare e kthyer na e tha në Johaneshburg vetëm pak muaj

më parë: “[Ne] nuk arritëm deri këtu vetëm për të ardhur deri këtu”¹⁸.

Duke parafrazuar një nga fjalimet më frymëzuese të lamtumirës që është shënuar ndonjëherë në shkrimet e shenjta, unë them bashkë me Nefin dhe atë motër të re:

“Vëllezërit e mi të dashur [dhe motra], pasi ju të keni [marrë këto frytet e para të Rivendosjes], unë do t’ju pyesja nëse gjithçka është bërë? Vër re, unë [ju] them [juve], Jo. . . .

. . . Ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, *duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës* dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit. . . . Në qoftë se [e bëni], . . . thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme.”¹⁹

U jap falënderime vëllezërve e motrave të mia për gjithçka që na është dhënë në këtë periudhë të fundit ungjillore e më të madhërishmen, periudhën ungjillore të ungjillit të rivendosur të Jezu Krishtit. Dhuratat dhe bekimet që rrjedhin nga ai ungjill, janë gjithçka për mua – gjithçka – ndaj në një përpjekje për ta falënderuar Atin tim në Qiell për to, kam “premtime për të mbajtur dhe kilometra për të bërë përpara se të shkoj për të fjetur dhe kilometra për të bërë përpara se të shkoj për të fjetur”²⁰. Shkofshim përpara me dashuri në zemër, duke ecur në “ndriçim të . . . shpresës”²¹ që e ndrit shtegun e pritjes së shenjtë në të cilën kemi qenë për 200 vjet. Dëshmoj se e ardhmja do të jetë po aq e mbushur me mrekulli dhe e bekuar me begati sikurse e kaluara. Ne i kemi të gjitha arsyet për të shpresuar për bekime edhe më të mëdha sesa ato që kemi marrë tashmë, sepse



Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

kjo është puna e Perëndisë të Plotfuqishëm, kjo është Kisha e zbuluesës së vazhdueshme, ky është ungjilli i hirit dhe mirëdashjes së pakufizuar të Krishtit. Unë jap dëshmi për të gjitha këto të vërteta e për shumë të tjera, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. “The Essence of the Christian Religion”, në *The Works of William E. Channing* (1888), f. 1004.
2. 2 Nefi 26:24.
3. Shih Gjoni 3:16–17.
4. Moisiu 7:62.
5. Shih Isaia 2:1–3; Ezekiel 37:26; Mikea 4:1–3; Malakia 3:1.
6. Gjoni 14:2.
7. Shih 1 Korintasve 15:29; Doktrina e Besëlidhje 128:15–17.
8. Shih Hebrenjve 6:19; Ethëri 12:4.
9. Shih Na Zhu e të tjerë, “A Novel Coronavirus from Patients with Pneumonia in China, 2019”, *New England Journal of Medicine*, 20 shkurt 2020, f. 727–733.
10. Shih “Examination and Description of Soil Profiles”, në *Soil Survey Manual*, red. C. Ditzler, K. Scheffe dhe H. C. Monger (2017), nrcs.usda.gov.
11. Shih Mateu 22:36–40; Marku 12:29–33; shih edhe Levitiku 19:18; Ligji i Përtërirë 6:1–6.
12. Shih Ethëri 12:4.
13. Shih Romakëve 4:18.
14. R. J. Snell, “Quiet Hope: A New Year’s Resolution”, *Public Discourse: The Journal of the Witherspoon Institute*, 31 dhjetor 2019, thepublicdiscourse.com.
15. Ezekiel 37:11.
16. Kjo është fraza ashtu sikurse është përkthyer gjerësisht. Megjithatë, përkthimi më i fjalëpërfjalshëm është “Çdo shpresë braktiseni, ju që hyni këtu” (Dante Alighieri, “The Vision of Hell”, në *Divine Comedy*, përkth. Henry Francis Cary [1892], kënga III, rreshti 9).
17. “Me Mua Rri!” *Himne*, nr. 94.
18. Judith Mahlangu (konferencë shumëkunjëshe pranë Johannesburgut, Afrikë e Jugut, 10 nëntor 2019), në Sydney Walker, “Elder Holland Visits Southeast Africa during ‘Remarkable Time of Growth’”, *Church News*, 27 nëntor 2019, thechurchnews.com.
19. 2 Nefi 31:19–20; theksimi i shtuar.
20. “Stopping by Woods on a Snowy Evening”, rreshtat 14–16, në *The Poetry of Robert Frost: The Collected Poems*, red. Edward Connery Lathem (1969), f. 225.
21. 2 Nefi 31:20.

“Kjo Shtëpi Duhet të Ndërtohet për Emrin Tim” (Doktrina e Besëlidhje 124:40)

Besëlidhjet e marra dhe ordinancat e kryera në tempuj janë thelbësore për shenjtërimin e zemrave tona dhe për ekzaltimin përfundimtar të bijve dhe bijave të Perëndisë.

Në Korijen e Shenjtë 200 vjet më parë, i riu Jozef Smith i pa dhe foli me Perëndinë, Atin e Përjetshëm, dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin. Prej Tyre Jozefi mësoi rreth natyrës së vërtetë të Kreut-Perëndi dhe zbuluesës së vazhdueshme, teksa ky vegim hyjnor hapi udhën që “të plotësoheshin kohërat”¹ në periudhën e ditëve të mëvonshme.

Afërsisht tre vjet më vonë, në përgjigje të lutjes së sinqertë në mbremjen e 21 shtatorit 1823, dhoma e fjetjes e Jozefit u mbush me dritë derisa “ishte më e shndritshme se në mesditë”². Një personazh iu shfaq në anë të shtratit, e thirri djaloshin me emër dhe tha se “ishte një lajmëtar i dërguar nga prania e Perëndisë . . . dhe se emri i tij ishte Moroni”³. Ai e udhëzoi Jozefin lidhur me daljen në dritë të Librit të Mormonit.

E më pas Moroni citoi nga libri i Malakias në Dhiatën e Vjetër, me pak ndryshim në gjuhën që përdoret tek Varianti i Mbretit Xhejms:

“Vini re, unë do t’ju zbuloj Priftërinë, nëpërmjet dorës së Elija profetit, përpara ardhjes së ditës së madhe dhe të tmerrshme të Zotit. . . .

Dhe ai do të mbjellë në zemrat e fëmijëve premtimet e bëra etërve dhe zemrat e fëmijëve do të kthehen tek etërit e tyre. Në qoftë se nuk do të ishte kështu, e tërë toka do të shkatërrrohej plotësisht në ardhjen e tij.”⁴



Reksburg, Ajdaho, SHBA

Me rëndësi është që udhëzimi i Moronit dhënë Jozef Smithit rreth misionit të Elijas nisi punën në tempull dhe për historinë familjare në ditët e mëvonshme dhe ishte një element kyç në rivendosjen e “të gjitha gjërave, për të cilën Perëndia ka folur nëpërmjet gojës së gjithë profetëve të tij të shenjtë, që nga fillimi i botës”⁵.

Lutem për ndihmën e Frymës së Shenjtë teksa mësojmë së bashku rreth besëlidhjeve, ordinancave dhe beki-meve që janë në dispozicion për ne në tempujt e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Kthimi i Elijas

Po filloj duke bërë një pyetje themelore: Përse ishte i rëndësishëm kthimi i Elijas?

“Ne mësojmë nga zbuluesi i ditëve të mëvonshme se Elija mbajti fuqinë vulosëse të Priftërisë Melkizedeke”⁶ dhe “ishte profeti i fundit që e bëri këtë përpara kohës së Jezu Krishtit”⁷.

Profeti Jozef Smith shpjegoi: “Shpirti, fuqia dhe thirrja e Elijas është që ju keni fuqi të mbani çelësin . . . [e] plotësisë së Priftërisë Melkizedeke . . . ; dhe për të . . . siguruar . . . të gjitha ordinancat që i përkasin mbretërisë së Perëndisë, madje në kthimin e zemrave të etërve tek fëmijët dhe të fëmijëve tek etërit, madje atyre që janë në qiell”⁸.

Ky autoritet i shenjtë vulosës është i nevojshëm që “gjihtëçka që të kesh lidhur mbi tokë, do të jetë lidhur në qiej, dhe gjihtëçka që të kesh zgjidhur mbi tokë, do të jetë zgjidhur në qiej”⁹.

Jozefi më tej sqaroi: “Si do ta sjellë Perëndia shpëtimin e këtij brezi? Ai do të dërgojë Elijan, profetin. . . Elija do të zbulojë besëlidhjet për të vulosur zemrat e etërve me bijtë dhe të bijve me etërit.”¹⁰

Elija u shfaq bashkë me Moisiun në Malin e Shpërftyrimin dhe ia dha këtë



ELIJA DUKE RIVENDOSUR ÇELËSAT E FRIJËSë VULOSËSë TË PRIFTËRISË, NGA ROBERT T. BARRETT

autoritet Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit.¹¹ Elija gjithashtu u shfaq me Moisiun dhe Eliasin më 3 prill 1836 në Tempullin e Kirtlandit dhe u dha të njëjtat çelësa të priftërisë Jozef Smithit dhe Oliver Kaudërit.¹²

Rivendosja e autoritetit vulosës nga Elija në vitin 1836, ishte e domosdoshme për të përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të Shpëtimtarit dhe filloi një interesim mjaft të shtuar e mbarëbotëror në kërkimin e historisë familjare.

Ndryshimi, Kthimi dhe Dëlirja e Zemrave

Fjala *zemër* përdoret mbi 1 000 herë në veprat standarde. Kjo fjalë e thjeshtë, por kuptimplotë, shpesh simbolizon ndjenjat më të brendshme të një individi. Zemrat tona – shumë e përgjithshme e dëshirave, ndjenjave, qëllimeve, synimeve dhe sjelljeve tona – përkufizojnë se kush jemi dhe përcaktojnë atë që vërtet do të bëhemi. Dhe thelbi i punës së Zotit është

ndryshimi, kthimi dhe dëlirja e zemrave nëpërmjet besëlidhjeve të ungjillit dhe ordinancave të priftërisë.

Ne nuk ndërtojmë ose hyjmë në tempujt të shenjtë vetëm që të kemi një përvojë të paharrueshme vetjake apo familjare. Përkundrazi, besëlidhjet e marrë dhe ordinancat e kryera në tempuj janë thelbësore për shenjtërimin e zemrave tona dhe për ekzaltimin përfundimtar të bijve dhe bijave të Perëndisë.

Mbjellja në zemrat e fëmijëve e premtimeve të bëra etërve – madje Abrahamit, Isakut dhe Jakobit – kthimi i zemrave të fëmijëve tek etërit e tyre, bërja e kërkimit të historisë familjare dhe kryerja e ordinancave mëkëmbëse në tempull janë vepra që i bekojnë individët në të dyja anët e velit. Teksa përfshihemi me zell në këtë punë të shenjtë, ne po u bindemi urdhërimeve për t’i dashur dhe për t’u shërbyer Perëndisë dhe të afërmve tanë.¹³ Dhe një shërbim i tillë vetëmohues



na ndihmon vërtet që ta “Dëgjoj[më] Atë!”¹⁴ dhe të vijmë te Shpëtimtari.¹⁵

Besëlidhjet dhe ordinancat më të shenjta të priftërisë merren vetëm në tempull – në shtëpinë e Zotit. Çdo gjë që mësohet dhe gjithçka që bëhet në tempull, theksojnë hyjninë e Jezu Krishtit dhe rolin e Tij në planin e madhërisëm të Atit Qiellor për lumturinë.

Nga Brenda Jashtë

Presidenti Ezra Taft Benson përshkroi një model të rëndësishëm të cilin e vë në përdorim Shëlbuesi që të bëjë “të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”¹⁶. Ai tha: “Zoti vepron nga brenda jashtë. Bota vepron nga jashtë brenda. Bota synon t’i nxjerrë njerëzit prej skamjes që i rrethon. Krishti e nxjerr skamjen shpirtërore nga njerëzit dhe pastaj ata e nxjerrin veten nga skamja që i rrethon. Bota synon t’i brumosë njerëzit duke ndryshuar mjedisin e tyre. Krishti i ndryshon njerëzit, të cilët më pas e ndryshojnë mjedisin e tyre. Bota synon t’i japë formë sjelljes njerëzore, por Krishti mundet ta ndryshojë natyrën njerëzore.”¹⁷

Besëlidhjet dhe ordinancat e priftërisë janë qendrore në procesin e vazhdueshëm të rilindjes dhe shndërrimit shpirtëror; ato janë mjetet nëpërmjet të cilave Zoti vepron me secilin prej nesh *nga brenda jashtë*. Besëlidhjet që nderohen me

vendosmëri, që kujtohen gjithmonë dhe shkruhen “me Frymën e Perëndisë së gjallë . . . mbi rrasa të një zemre mishi”¹⁸, japin qëllim dhe siguri për bekime në vdekshmëri dhe në përjetësi. Ordinancat që merren denjësisht dhe kujtohen vazhdimisht, hapin kanalet e qiellit nëpërmjet të cilave fuqia e perëndishmërisë mund të vërshojë në jetën tonë.

Ne nuk vijmë në tempull që të fshihemi prej ligësive të botës apo që t’u largohemi atyre. Përkundrazi, ne vijmë në tempull që ta mposhtim botën e ligësisë. Kur e ftojmë në jetën tonë “fuqi[në] e perëndishmërisë”¹⁹ nëpërmjet marrjes së ordinancave të priftërisë dhe mbajtjes së besëlidhjeve të shenjta, ne bekohemi me forcë përtej vetvetes²⁰ për t’i kapërcyer tundimet dhe sfidat e vdekshmërisë, për të bërë mirë dhe për t’u bërë të mirë.

Fama e Kësaj Shtëpie do të Përhapet

Tempulli i parë i kësaj periudhe ungjillore u ndërtua në Kirtland të Ohajos dhe u përkushtua më 27 mars 1836.

Në një zbulësë dhënë Profetit Jozef Smith një javë pas përkushtimit, Zoti shpalli:

“Zemrat e gjithë njerëzve të mi duhet të gëzohen, të cilët, me fuqinë e tyre, kanë ndërtuar këtë shtëpi për emrin tim. . . .

Po, zemrat e mijërave dhe qindra mijërave do të gëzohen së tepërmi si pasojë e bekimeve që do të derdhen dhe e dhurimit me të cilin shërbëtorët e mi janë dhuruar në këtë shtëpi.

Dhe fama e kësaj shtëpie do të përhapet në toka të huaja; dhe ky është fillimi i bekimit që do të derdhet mbi kokat e popullit tim.”²¹

Ju lutem, vërimi re frazat *zemrat e mijërave dhe qindra mijërave do të gëzohen së tepërmi* dhe *fama e kësaj shtëpie do të përhapet në toka të huaja*. Këto ishin deklaratime hutuese në prillin e vitit 1836, kur Kisha kishte vetëm një grusht relativisht të vogël anëtarësh dhe një tempull.

Sot në vitin 2020, ne kemi 168 tempuj në funksionim. Dyzet e nëntë tempuj të tjerë janë nën ndërtim ose janë njoftuar. Shtëpitë e Zotit po ndërtohen në “ishujt e detit”²² dhe në shtete e vende që më parë konsideroheshin nga shumë veta si të pamundura për të miratuar një tempull.

Ceremonia e dhurimit aktualisht kryhet në 88 gjuhë dhe do të vihet në dispozicion në shumë gjuhë të tjera shtesë ndërkohë që tempuj ndërtohen për të bekuar edhe më shumë fëmijë të Perëndisë. Në 15 vitet e ardhshme ka të ngjarë që të dyfishohet numri i gjuhëve në të cilat ordinancat e tempullit do të jenë në dispozicion.

Sivjet do të hapim themelin dhe do të fillojmë ndërtimin për 18 tempuj. Në dallim nga kjo, u deshën 150 vjet për të ndërtuar 18 tempujt e parë, nga organizimi i Kishës në vitin 1830 deri në përkushtimin e Tempullit të Tokios në Japoni nga Presidenti Spenser W. Kimball në vitin 1980.

Merreni parasysh përshpejtimin e punës në tempull që ka ndodhur vetëm gjatë jetës së Presidentit Rasëll M. Nelson. Kur Presidenti Nelson lindi më 9 shtator 1924, Kisha kishte

gjashtë tempuj në funksionim.

Kur ai u shugurua Apostull më 7 prill 1984, 60 vjet më vonë, 26 tempuj po funksiononin, një rritje me 20 tempuj brenda 60 vjetëve.

Kur Presidenti Nelson u mbështet si President i Kishës, po funksiononin 159 tempuj, një rritje me 133 tempuj në 34 vjet, gjatë të cilave ai shërbeu si anëtar i Kuoromit të Të Dymbëdhjetëve.

Që kur u bë Presidenti i Kishës më 14 janar 2018, Presidenti Nelson ka njoftuar 35 tempuj të rinj.

Nëntëdhjetë e gjashtë përqind e tempujve ekzistues janë përkushtuar gjatë jetës së Presidentit Nelson; 84 përqind janë përkushtuar që nga koha kur ai u shugurua Apostull.

Gjithmonë Përqendrohuni te Gjërat që Janë më të Rëndësishmet

Si anëtarë të Kishës së rivendosur të Zotit, ne qëndrojmë plot habi te ritmi gjithnjë e në rritje i veprës së Tij në ditët e mëvonshme. Dhe më shumë tempuj po vijnë.

Brigam Jangu profetizoi: “Që të përmbushet kjo vepër, do të duhet të ketë jo vetëm një tempull, por mijëra prej tyre dhe mijëra e dhjetëra mijëra burra e gra do të shkojnë në këta tempuj dhe do të veprojnë për njerëz që kanë jetuar aq kohë më parë sa Zoti do ta zbulojë.”²³

Në mënyrë të kuptueshme, njoftimi i secilit tempull të ri është burim gëzimi të madh dhe arsye për t’i dhënë falënderime Zotit. Sidoqoftë, përqendrimi ynë kryesor duhet të jetë te besëlidhjet dhe ordinancat që mund të na e ndryshojnë zemrën dhe ta thellojnë përkushtimin tonë ndaj Shpëtimtarit, dhe jo thjesht te vendndodhja apo bukuria e godinës.

Detyrimet themelore që qëndrojnë mbi ne si anëtarë të Kishës



së rivendosur të Zotit, janë: 1) ta “Dëgjojmë] Atë!”²⁴ dhe t’i ndryshojmë zemrat tona nëpërmjet besëlidhjeve dhe ordinancave, dhe 2) ta plotësojmë me gëzim përgjegjësinë e caktuar në mënyrë hyjnore, që t’ia ofrojmë bekimet e tempullit tërë familjes njerëzore në të dyja anët e velit. Me udhëzimin dhe ndihmën e Zotit, ne vërtet do t’i përmbushim këto detyra të shenja.

Ndërtimi i Sionit

Profeti Jozef Smith shpalli:

“Ndërtimi i Sionit është një kauzë që u ka interesuar njerëzve të Perëndisë në çdo kohë; është një temë mbi të cilën profetët, priftërinjtë dhe mbretërit janë ndalur me ëndje të veçantë; ata e kanë shprehur me pritje të gëzuar ditën në të cilën jetojmë ne; dhe të frymëzuar me parashikime qiellore e të gëzueshme, ata kanë kënduar dhe shkruar, dhe profetizuar për këtë ditën tonë; por ata vdiqën pa e parë; . . . na është lënë neve që ta shohim, të marrim pjesë dhe të ndihmojmë për ta çuar përpara lavdinë e ditëve të mëvonshme”²⁵.

“Priftëria qiellore do të bashkohet me tokësoren, për të sjellë ato qëllime të shkëlqyera; . . . një punë që Perëndia dhe engjëjt e kanë kundruar me kënaqësi për brezat e kaluar; që frymëzuan shpirtin e patriarkëve dhe profetëve të lashtë; një punë që është e destinuar të sjellë shkatërrimin e forcave të errësirës, ripërtëritjen e tokës, lavdinë e Perëndisë dhe shpëtimin e familjes njerëzore.”²⁶

Unë solemnisht dëshmoj se Ati dhe Biri iu shfaqën Jozef Smithit dhe

Elija rivendosi autoritetin vulosës. Besëlidhjet dhe ordinancat e shenja të tempullit mund të na forcojnë ne dhe të na i pastrojnë zemrat tona kur e “Dëgjojmë] Atë!”²⁷ dhe marrim fuqinë e perëndishmërisë në jetën tonë. Dhe unë dëshmoj se kjo vepër e ditëve të mëvonshme do t’i shkatërrojë fuqitë e errësirës dhe do të sjellë shpëtimin e familjes njerëzore. Për këto të vërteta dëshmoj plot gëzim, në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Efesianëve 1:10.
2. Joseph Smith – Historia 1:30.
3. Joseph Smith – Historia 1:33.
4. Joseph Smith – Historia 1:38–39.
5. Vepër e Apostujve 3:21.
6. Bible Dictionary në variantin SHDM anglisht të Biblës, “Elijah”.
7. Udhëzuesi për Shkrimet e Shenja, “Elija”.
8. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 331; theksimi i shtuar.
9. Mateu 16:19; shih edhe Mateu 18:18; Helamani 10:7; Doktrina e Besëlidhje 124:93; 132:46.
10. *Teachings: Joseph Smith*, f. 333.
11. Shih Mateu 17:3.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:13–16.
13. Shih Mateu 22:34–40.
14. Joseph Smith – Historia 1:17.
15. Shih Omni 1:26; Moroni 10:30, 32.
16. Moisiu 1:39.
17. Ezra Taft Benson, “Born of God”, *Ensign*, nëntor 1985, f. 6.
18. 2 Korintasve 3:3.
19. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:20–21.
20. Shih “Zot, Un’ Ty do të t’Ndjek”, *Himne*, nr. 137.
21. Doktrina e Besëlidhje 110:6, 9–10.
22. 2 Nefi 29:7.
23. *Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* (1997), f. 310.
24. Joseph Smith – Historia 1:17.
25. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 194.
26. *Mësimet: Jozef Smith*, f. 548–549.
27. Joseph Smith – Historia 1:17.



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson,
President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve
të Ditëve të Mëvonshme

Dëgjojeni Atë

Ati ynë e di se, kur jemi të rrethuar nga pasiguria dhe frika, ajo që do të na ndihmojë më tepër se çdo gjë tjetër, është ta dëgjojmë Birin e Tij.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, sa mirënjohës jam që, me anë të përdorimit të teknologjisë, kemi qenë në gjendje të mblidhemi së bashku dhe të adhurojmë këtë mëngjes të diele! Sa të bekuar jemi që e dimë se ungjilli i Jezu Krishtit është rivendosur në tokë!

Në disa nga javët e kaluara, shumica prej nesh kemi përjetuar ndërprerje në jetën tonë vetjake. Tërmete, zjarre, përmbajtje, epidemi dhe situatat pas tyre e kanë ndërprerë rutinën dhe kanë shkaktuar mangësi në ushqime, artikuj të rëndësishëm konsumi dhe kursime.

Mes gjithë kësaj, ne ju lavdërojmë dhe ju falënderojmë që keni zgjedhur ta dëgjoni fjalën e Zotit gjatë kësaj kohe trazire duke u bashkuar me ne për konferencën e përgjithshme. Errësira në rritje që e shoqëron fatkeqësinë, bën që drita e Jezu Krishtit të ndriçojë përherë më e shkëlqyeshme. Thjesht mendoni për të mirën që secili prej nesh mund të bëjë gjatë kësaj kohe të rrëmujës mbarëbotërore. Dashuria juaj për Shpëtimtarin dhe besimi tek Ai fare mirë mund të jenë katalizatori që dikush ta zbulojë Rivendosjen e plotësisë së ungjillit të Jezu Krishtit.

Gjatë dy viteve të shkuara, Motra Nelson dhe unë kemi takuar mijëra prej jush anekënd botës. Jemi mbledhur me ju në arena të hapura dhe në

salla vallëzimi të hoteleve. Në secilën vendndodhje, kam ndier që kam qenë në praninë e të zgjedhurve të Zotit dhe se po e shihja mbledhjen e Izraelit të ndodhte përpara syve të mi.

Ne jetojmë në kohën që “baballarët tanë e kanë pritur me një shpresë të dëshiruar”¹. Ne jemi të ulur në rreshtin e parë që ta *dëshmojmë drejtpërsë-drejti* atë që profeti Nefi e pa *vetëm në vegim*, që “fuqi[a] e Qengjit të Perëndisë” do të zbriste mbi “njerëzit e besëlidhjes së Zotit që ishin shpërndarë mbi të gjithë faqen e tokës; dhe ata ishin armatosur me drejtësi dhe me fuqinë e Perëndisë në lavdi të madhe”².

Ju, vëllezërit dhe motrat e mia, jeni mes atyre burrave, grave dhe fëmijëve që pa Nefi. Mendoni për këtë!

Pavarësisht se ku jetoni apo se cilat janë rrethanat tuaja, Zoti Jezu Krisht është Shpëtimtari *juaj* dhe profeti i Perëndisë Jozef Smithi është profeti *juaj*. Ai u parashugurua përpara themelimit të tokës që të ishte profeti i kësaj periudhe të fundit ungjillore, kur “asgjë nuk do të mbahet”³ prej shenjtorëve. Zbulesa vazhdon të rrjedhë nga Zoti gjatë këtij procesi të vazhdueshëm të rivendosjes.

Çfarë do të thotë për ju që ungjilli i Jezu Krishtit është rivendosur në tokë?

Do të thotë që ju dhe familja juaj mund të vuloseni së bashku përgjithmonë! Do të thotë që, për shkak se jeni pagëzuar nga dikush që ka autoritet nga Jezu Krishti, dhe jeni konfirmuar anëtar/e i/e Kishës së Tij, ju mund të gëzoni shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë. Ai do t’ju udhërrëfejë dhe mbrojë. Do të thotë që nuk do të mbeteni kurrë pa ngushëllim apo pa të drejtën e përdorimit të fuqisë së Perëndisë për t’ju ndihmuar. Do të thotë që fuqia e priftërisë mund t’ju bekojë kur i merrni ordinancat thelbësore dhe bëni besëlidhje me Perëndinë e i mbani



Nju-Jork-Siti, Nju-Jork, SHBA

ato. Çfarë spirance janë këto të vërteta për shpirtin tonë, veçanërisht në këto kohë kur furtuna vazhdon plot fur!

Libri i Mormonit bën kronikën për ngritjen dhe rënien klasike të dy qytetërimeve të mëdha. Historia e tyre demonstroi se sa e lehtë është që një shumicë njerëzish ta harrojë Perëndinë, të mos i pranojë paralajmërimet e profetëve të Zotit dhe të kërkojë pushtet, famë dhe kënaqësi të mishit.⁴ Në mënyrë të përsëritur, profetët e së shkuarës kanë shpallur “gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme mes popullit të cilat [njerëzit] nuk i besuan”⁵.

Nuk është ndryshe në kohën tonë. Nëpër vite, gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme janë dëgjuar nga foltore të përkushtuara anekënd tokës. Megjithatë, shumica e njerëzve *nuk* i përqafojnë këto të vërteta – ose ngaqë nuk dinë se ku t’i gjejnë ato⁶ ose sepse po ua vënë veshin atyre që nuk e kanë të vërtetën e plotë, ose sepse nuk e kanë pranuar të vërtetën dhe kanë zgjedhur në favor të veprimtarive të botës.

Kundërshtari është i zgjuar. Për mijëvjeçarë ai ka bërë që e mira të duket e keqe dhe e keqja të duket e mirë⁷. Mesazhet e tij priren të jenë të zhurmshme, të guximshme dhe mburracake.

Mirëpo, mesazhet nga Ati ynë Qiellor janë qartësisht të ndryshme. Ai komunikoi me thjeshtësi, qetësi dhe me një qartësi të tillë mahnitëse sa që ne nuk mund ta keqkuptojmë Atë.⁸

Për shembull, kurdoherë që Ai e ka paraqitur Birin e Tij të Vetëmlindur ndaj njerëzve mbi tokë, Ai e ka bërë atë me pak fjalë mbesëlënëse. Në Malin e Shpërfytyrimit, Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit, Perëndia u tha: “Ky është Biri im i dashur; dëgjojeni [Atë]!”⁹ Fjalët e Tij drejtuar nefitëve në qytetin e lashtë të Begatisë ishin: “Vini re Birin tim të Dashur, në të cilin unë jam shumë i kënaqur, në të cilin unë kam



SHFAQJA E KRISHTIT NË HEMISFERË PERËNDIMORE, NGA ARNOLD FRIBERG

lartësuar emrin tim – dëgjojeni atë”¹⁰. Dhe Jozef Smithit, në atë shpallje të thellë që e hapi këtë periudhë ungjillore, Perëndia i tha thjesht: “Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!”¹¹

Tani, vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, merreni parasysh faktin që në këta tre shembuj që sapo u përmendën, pikërisht përpara se Ati ta paraqiste Birin, njerëzit e përfshirë ishin në një gjendje frike dhe, deri në njëfarë mase, dëshpërimi.

Apostujt ishin të frikësuar kur e panë Jezu Krishtin të rrethuar nga një re në Malin e Shpërfytyrimit.

Nefitët ishin të frikësuar pasi kishin qenë mes shkatërrimit dhe errësirës për disa ditë.

Jozef Smithin e kishte mbërthyer një forcë e errësirës pikërisht përpara se qiejt të hapeshin.

Ati ynë e di se, kur jemi të rrethuar nga pasiguria dhe frika, ajo që do të na ndihmojë më tepër se çdo gjë tjetër, është ta dëgjojmë Birin e Tij.

Sepse kur kërkojmë ta dëgjojmë – ta dëgjojmë vërtet – Birin e Tij, ne do të udhërrëfëhemi për ta ditur se çfarë të bëjmë në çfarëdo rrethanë.

Në vetë vargun e parë të Doktrina e Besëlidhje është fraza *mbani vesh*.¹² Do të thotë “t’ia vini veshin me qëllimin që të bindeni”¹³. Të mbajmë vesh do të thotë ta “dëgjojmë Atë” – ta dëgjojmë atë që thotë Shpëtimtari dhe pastaj t’i kushtojmë vëmendje këshillës së Tij. Në këto dy fjalë – “Dëgjojeni Atë” – Perëndia na jep modelin për sukses, lumturi dhe gëzim në këtë jetë. Ne duhet t’i dëgjojmë fjalët e Zotit, t’i mbajmë vesh ato dhe t’i kushtojmë vëmendje asaj që Ai na ka thënë!

Teksa kërkojmë të jemi dishepuj të Jezu Krishtit, përpjekjet tona që ta dëgjojmë Atë nevojitet të jenë përherë e më të qëllimshme. Kërkon përpjekje të ndërgjegjshme dhe të vazhdueshme që ta mbushim jetën tonë të përditshme me fjalët e Tij, mësimet e Tij, të vërtetat e Tij.

Ne thjesht nuk mund të mbështemi tek informacioni që e ndeshim rastësisht në mjetet shoqërore të komunikimit. Me miliarda fjalë në internet dhe në një botë të mbingopur nga reklamat, të depërtuar vazhdimisht nga përpjekjet e zhurmshme, shumë të liga të kundërshtarit, ku *mund* të shkojmë që ta dëgjojmë Atë?

Ne mund të shkojmë te shkrimet e shenjta. Ato na japin mësim rreth Jezu Krishtit dhe ungjillit të Tij, madhësisë së Shlyerjes së Tij dhe planit të madhërishtëm të Atit tonë për lumturi dhe shëlbim. Zhytja e përditshme në fjalën e Perëndisë është jetike për mbijetesën tonë shpirtërore, veçanërisht në këto ditë të rrëmujës në rritje. Teksa ushqehemi me bollëk përditë me fjalët e Krishtit, fjalët e Krishtit do të na thonë se si të reagojmë ndaj vështirësive me të cilat kurrë nuk menduam se do të përballeshim.

Ne gjithashtu mund ta *dëgjojmë Atë* në tempull. Shtëpia e Zotit është një shtëpi mësimi. Atje Zoti jep mësim në vetë mënyrën e Tij. Atje çdo ordinancë jep mësim për Shpëtimtarin. Atje ne mësojmë se si ta hapim velin dhe të komunikojmë më qartë me qiellin. Atje ne mësojmë se si ta qortojmë kundërshtarin dhe të marrim fuqinë e priftërisë së Zotit për të na forcuar ne dhe ata që i duam. Sa i etur duhet të jetë secili prej nesh që të kërkojë strehim atje!

Kur të hiqen këto kufizime të përkohshme prej virusit COVID-19, ju lutem, planifikoni kohë të rregullt që të adhuroni dhe shërbeni në tempull. Secila minutë e asaj kohe do t'ju bekojë ju dhe familjen tuaj në mënyra si *asgjë* tjetër nuk mund ta bëjë. Gjeneri kohë për të përsiatuar për atë që dëgjoni dhe ndieni kur jeni atje. Kërkojini Zotit t'ju mësojë se si t'i hapni qiejt që ta bekoni jetën tuaj dhe jetën e atyre që i doni dhe u shërbeni.

Ndërkohë që adhurimi në tempull tani për tani nuk është i mundur, unë ju ftoj ta shtoni pjesëmarrjen tuaj në historinë familjare, duke përfshirë kërkimin dhe indeksimin për historinë familjare. Ju premtoj që, teksa e shtoni kohën që kaloni në tempull dhe për historinë familjare, ju do ta shtoni dhe përmirësoni aftësinë tuaj që ta dëgjoni Atë.

Ne gjithashtu e *dëgjojmë Atë* më qartë teksa e përpunojmë aftësinë tonë për t'i dalluar pëshpëritjet e Frymës së Shenjtë. Asnjëherë nuk ka qenë më e domosdoshme ta dini se si ju flet Shpirti sesa është pikërisht tani. Në Kreun-Perëndi, Fryma e Shenjtë është lajmëtar. Ai do t'ju sjellë në mendje mendime që Ati dhe Biri dëshirojnë që ju t'i merrni. Ai është Ngushëlluesi. Ai do t'ju sjellë në zemër një ndjenjë paqeje. Ai dëshmon për të vërtetën dhe do t'ju pohojë se çfarë është e vërtetë teksa e dëgjoni dhe e lexoni fjalën e Zotit.

E përsërit përgjërimit tim ndaj jush që të bëni *çfarëdo* që të duhet që ta rritni aftësinë tuaj shpirtërore për të marrë zbuluesë vetjake.

Bërja e kësaj do t'ju ndihmojë ta dini se si të shkoni përpara në jetën tuaj, çfarë të bëni në kohë krizash dhe se si t'i dalloni e shmangni tundimet dhe mashtrimet e kundërshtarit.

Dhe, së fundi, ne e *dëgjojmë Atë* kur u kushtojmë vëmendje fjalëve të profetëve, shikuesve dhe zbuluesve. Apostujt e shuguruar të Jezu Krishtit gjithmonë dëshmojnë për Të. Ata tregojnë udhën teksa ne çajmë udhën tonë nëpër labirintin zemërdrydhës të përvojave tona në vdekshmëri.

Çfarë do të ndodhë teksa ju në mënyrë më të qëllimshme e dëgjoni, ia vini veshin dhe i kushtoni vëmendje asaj që Shpëtimtari ka thënë dhe asaj që Ai po thotë tani nëpërmjet profetëve të Tij? Ju premtoj se do të bekoheni me fuqi shtesë për t'u përballur me tundimet, vështirësitë dhe dobësitë. Unë premtoj mrekulli në martesën tuaj, në marrëdhëniet tuaja familjare dhe në punën tuaj të përditshme. Dhe ju premtoj se aftësia juaj për të ndier gëzim, do të rritet edhe në qoftë se shtohet trazimi në jetën tuaj.

Kjo konferencë e përgjithshme e prillit 2020 është koha jonë për të

përkujtuar një ngjarje që e ndryshoi botën. Teksa e prisnim këtë 200-vjetor të Vegimit të Parë të Jozef Smithit, ne si Presidencë e Parë dhe Këshill i Dymbëdhjetë Apostujve pyetnim veten për atë që *ne* mund të bëjmë për ta përkujtuar siç duhet këtë ngjarje të vetme.

Ajo teofani [shfaqje e Hyjnisë] filloi Rivendosjen e plotësisë së ungjillit të Jezu Krishtit dhe hapi periudhën ungjillore të plotësisë së kohëve.

Vramë mendjen a duhej të ndërtohej një monument. Por teksa e morëm parasysh ndikimin e pashoq historik dhe ndërkombëtar të atij Vegimi të Parë, ndiem përshtypjen që të krijojmë një monument jo prej graniti apo guri, por prej fjalësh – fjalë të proklamates solemne dhe të shenjta – shkruar, jo që të skaliten mbi “rrasa guri”, por më tepër që të gdhenden mbi “rrasa . . . mishi” të zemrës sonë.¹⁴

Qëkurse është organizuar Kisha, janë nxjerrë vetëm pesë proklamata, ku e fundit është “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, e paraqitur nga Presidenti Gordon B. Hinkli në vitin 1995.



Tani, teksa e kundrojmë këtë kohë domethënëse në historinë e botës dhe detyrën nga Zoti që të mblidhet Izraeli i shpërndarë në përgatitje për Ardhjen e Dytë të Jezu Krishtit, ne, Presidenca e Parë dhe Këshilli i Dymbëdhjetë Apostujve, nxjerrim proklamaten që vijon. Titulli i saj është: “Rivendosja e Plotësisë së Ungjillit të Jezu Krishtit: Një Proklamata në Dyqindvjetor drejtuar Botës”. Autorët e saj janë Presidenca e Parë dhe Këshilli i Dymbëdhjetë Apostujve të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Mban datën prill 2020. Për t’u përgatitur për ditën e sotme, unë e regjistrova më parë këtë proklamata në Korijen e Shenjtë, atje ku Jozef Smithi pa së pari Atin dhe Birin.

“Ne shpallim solemnisht se Perëndia i do fëmijët e Tij në çdo komb të botës. Perëndia, Ati, na ka dhënë lindjen hyjnore, jetën e pakrahasueshme dhe flijimin e pafundmë shlyes të Birit të Tij të Dashur, Jezu Krishtit. Me anë të fuqisë së Atit, Jezusi u ngrit përsëri dhe korri fitore mbi vdekjen. Ai është Shpëtimtari ynë, Shembulli ynë dhe Shëlbuesi ynë.

Dyqind vjet më parë, në një mëngjes të bukur pranvere në vitin 1820, i riu Jozef Smith, duke kërkuar ta dinte se me cilën kishë të bashkohej, shkoi që të lutej në pyllin pranë shtëpisë së tij, në rrethinat në veri të Nju-Jorkut në SHBA. Ai kishte pyetje lidhur me shpëtimin e shpirtit të tij dhe mirëbesoi se Perëndia do ta drejtonte.

Me përlulësi, ne shpallim se në përgjigje ndaj lutjes së tij, Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, iu shfaqën Jozefit dhe përuruan ‘ripërtëritje[n] e të gjithë gjërave’ (Veprat e Apostujve 3:21) siç u paratha në Bibël. Në këtë vegim, ai mësoi se pas vdekjes së Apostujve të parë, Kisha e Krishtit e Dhiatës së Re, humbi nga toka. Jozefi do të ishte mjet vendimtar për kthimin e saj.



Elk-Rixh, Jutë, SHBA

Ne pohojmë se, nën drejtimin e Atit dhe të Birit, lajmëtarë qiellorë erdhën për ta udhëzuar Jozefin dhe për ta rithemeluar Kishën e Jezu Krishtit. Gjon Pagëzori, i ringjallur, rivendosi autoritetin për të pagëzuar me anë të zhytjes për heqjen e mëkateve. Tre nga dymbëdhjetë Apostujt e parë – Pjetri, Jakobi dhe Gjoni – rivendosën detyrën e Apostullit dhe çelësat e autoritetit të priftërisë. Erdhën edhe të tjerë, përfshirë Elijan, i cili rivendosi autoritetin për t’i bashkuar familjet së bashku përgjithmonë në marrëdhënie të përjetshme që e kapërcejnë vdekjen.

Ne dëshmojmë më tej se Jozef Smithit iu dha dhurata dhe fuqia e Perëndisë për të përkthyer një anal të lashtë: Librin e Mormonit – Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit. Faqet e këtij teksti të shenjtë përfshijnë një rrëfim të shërbesës vetjake të Jezu Krishtit mes njerëzve në Hemisferën Perëndimore pak kohë pas Ringjalljes së Tij. Ai jep mësim për qëllimin e jetës dhe shpjegon doktrinën e Krishtit, që është qendrore për atë qëllim. Si shkrim i shenjtë shoqëruar për Biblën, Libri i Mormonit dëshmon që të gjitha qeniet njerëzore janë bij e bija të një Ati të dashur në Qiell, që Ai ka një plan hyjnor për jetën tonë dhe që Biri i Tij, Jezu Krishti, flet sot ashtu si në kohët e vjetra.

Ne shpallim se Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, e organizuar më 6 prill 1830, është Kisha e Krishtit e Dhiatës së Re që është rivendosur. Kjo Kishë

është e ankoruar në jetën e përkryer të gurit të saj kryesor të qoshes, Jezu Krishtit, dhe në Shlyerjen e Tij të pafundme dhe Ringjalljen e mirëfilltë. Jezu Krishti edhe një herë ka thirrur Apostuj dhe u ka dhënë atyre autoritetin e priftërisë. Ai na fton që të gjithëve ne që të vijmë tek Ai dhe Kisha e Tij, të marrim Frymën e Shenjtë, ordinancat e shpëtimit dhe të fitojmë gëzim të qëndrueshëm.

Dyqind vjet kanë kaluar tani që kur kjo Rivendosje u fillua nga Perëndia, Ati, dhe Biri i Tij i Dashur, Jezu Krishti. Miliona njerëz kudo në botë kanë përqaftuar një njohuri për këto ngjarje të profetizuara.

Ne me gëzim shpallim se Rivendosja e premtuar shkon përpara nëpërmjet zbulësës së vazhdueshme. Toka kurrë më nuk do të jetë e njëjta, teksa Perëndia do t’i sjellë në një krye të vetëm, në Krishtin, të gjitha gjërat’ (Efesianëve 1:10).

Me nderim dhe mirënjohje, ne si Apostujt e Tij, i fitojmë të gjithë që ta dinë – ashtu siç e dimë ne – që qiejt janë hapur. Ne pohojmë se Perëndia po e bën të njohur vullnetin e Tij për bijtë dhe bijat e Tij të dashura. Ne dëshmojmë se ata që me lutje e studiojnë mesazhin e Rivendosjes dhe veprojnë me besim, do të bekohen të fitojnë vetë dëshminë e tyre për hyjninë e saj dhe qëllimin e saj për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të premtuar të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.”¹⁵

Vëllezër dhe motra të shtrenjta, ajo ishte proklamata jonë në dyqindvjetor drejtuar botës lidhur me Rivendosjen e ungjillit të Jezu Krishtit në plotësinë e tij. Ajo është përkthyer në 12 gjuhë. Gjuhë të tjera do të vijojnë së shpejti. Do të jetë menjëherë në dispozicion në faqen e Kishës në internet, nga e cila mund të merrni një kopje. Studiojeni atë më vete dhe me pjesëtarët e familjes suaj dhe miqtë tuaj. Përsiatni për të vërtetat dhe mendoni për ndikimin që këto të vërteta do të kenë në jetën tuaj nëse ju i dëgjoni ato, i mbani vesh ato dhe u kushtoni vëmendje urdhërimeve dhe besëlidhjeve që i shoqërojnë ato.

E di se Jozef Smithi është profeti i parachuguruar të cilin Zoti e zgjodhi për ta hapur këtë periudhë të fundit ungjillore. Nëpërmjet tij, Kisha e Zotit u rivendos në tokë. Jozefi e vulosi dëshminë e tij me gjakun e tij. Sa shumë e dua dhe e nderoj atë!


Perëndia jeton! Jezusi është Krishti! Kisha e Tij është rivendosur! Ai dhe Ati i Tij, Ati ynë Qiellor, po vëzhgojnë mbi ne. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 121:27.
2. 1 Nefi 14:14.
3. Doktrina e Besëlidhje 121:28.
4. Shih 1 Nefi 22:23.
5. Ethëri 12:5.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 123:12.
7. Shih Isaia 5:20; 2 Nefi 15:20.
8. Shih 2 Nefi 25:4; Alma 5:43.
9. Marku 9:7; Lluca 9:35.
10. 3 Nefi 11:7.
11. Joseph Smith – Historia 1:17.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:1.
13. Në Dhiatën e Vjetër, fjala *mbani vesh* përkthehet nga fjala hebraisht *shama*, që është një folje e fortë që do të thotë: “i vë veshin me qëllimin që të bindem”. *Mbani vesh* është një frazë në shkrimet e shenjta që gjendet në 40 seksione të Doktrinës e Besëlidhjeve.
14. Shih 2 Korintasve 3:3.
15. Ky është një përkthim paraprak. Përkthimi zyrtar i proklamatës do të jetë në dispozicion në muajt e ardhshëm.

Thirrja Hosana

E drejtuar nga
Presidenti Rasëll M. Nelson,
*President i Kishës së Jezu Krishtit të
Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme*



Baunifull, Jutë, SHBA

Tani, vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, teksa përkujtojmë Vegimin e Parë të Jozef Smithit për Atin dhe Birin, ne ndiem se do të ishte me vend të gëzohemi së bashku duke marrë pjesë në Thirrjen Hosana.

Kjo thirrje e shenjtë u bë së pari në këtë periudhë ungjillore në përkushtimin e Tempullit të Kirtlandit më 27 mars 1836. Tani ajo bëhet në përkushtimin e çdo tempulli. Është një nderim i shenjtë ndaj Atit dhe Birit, që simbolizon reagimin e turmës kur Shpëtimtari bëri hyrjen e Tij ngadhënjimtare në Jerusalem. Ajo ripohon gjithashtu atë që i riu Jozef përjetoi atë ditë në Korijen e Shenjtë – domethënë, që Ati dhe Biri janë dy Qenie të përlëvduara që ne i adhurojmë dhe lavdërojmë.

Tani do t’ju tregoj se si bëhet Thirrja Hosana. Ndërkohë që e bëj, unë i ftoj kolegët tanë në media që ta trajtojnë këtë rit shumë të shenjtë me dinjitet dhe respekt.

Secili që merr pjesë, merr një shami të pastër, të bardhë, duke e mbajtur në njërin cep, dhe e valëvit ndërsa thotë njëzëri me të tjerët: “Hosana, Hosana, Hosana, Perëndisë dhe Qengjit”, të përsëritur tri herë, që ndiqet nga “Amen, Amen dhe Amen”. Nëse nuk keni një shami të bardhë, ju thjesht mund të valëvitni dorën.

Vëllezër dhe motra, ju ftoj tani që të ngriheni në këmbë dhe të merrni pjesë në Thirrjen Hosana, pas së cilës do të këndohen “Himni Hosana” dhe “Shpirti i Per’ndis”¹.

Në sinjalin e drejtuesit, ju lutem, bashkohuni me ne për të kënduar “Shpirti i Per’ndis”.

*Hosana, Hosana, Hosana Perëndisë dhe Qengjit!
Hosana, Hosana, Hosana Perëndisë dhe Qengjit!
Hosana, Hosana, Hosana Perëndisë dhe Qengjit!
Amen, Amen dhe Amen. ■*

SHËNIM

1. *Himne*, nr. 2.



Nga Presidenti Dallin H. Oaks,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Plani i Madh

Ne që e dimë planin e Perëndisë dhe që kemi bërë besëlidhje për të marrë pjesë, kemi një përgjegjësi të qartë për t'i dhënë mësim këto të vërteta.

Edhe në mes të sprovave dhe sfidave të pashoqe, ne jemi vërtet të bekuar! Kjo konferencë e përgjithshme na ka dhënë një shtrirje të bollëkut dhe gëzimit të Rivendosjes së ungjillit të Jezu Krishtit. Jemi gëzuar me vegimin e Atit dhe të Birit që e filloi Rivendosjen. Na kanë sjellje në mendje daljen në dritë në mënyrë të mrekullueshme të Librit të Mormonit, qëllimi qendror i të cilit është të dëshmojë për Jezu Krishtin dhe doktrinën e Tij. Ne jemi përtërirë nga realiteti i gëzueshëm të zbulësës – të dhënë profetëve dhe neve personalisht. Kemi dëgjuar dëshmi të çmuara për Shlyerjen e pafundme të Jezu Krishtit dhe Ringjalljen e Tij të mirëfilltë. Dhe na janë mësuar të vërteta të tjera për plotësinë e ungjillit të Tij, që iu zbuluan Jozef Smithit pasi Perëndia,

Ati, i shpalli atij profeti të sapothirur: “Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!” (Joseph Smith – Historia 1:17).

Ne jemi forcuar në njohurinë tonë për rivendosjen e priftërisë dhe të çelësave të saj. Ne jemi ripërtërirë në vendosmërinë tonë që ta bëjmë të njohur Kishën e rivendosur të Zotit me emrin e saj të duhur, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Dhe jemi ftuar të bashkohemi në agjërime e lutje për t'i zvogëluar efektet e tanishme dhe të ardhshme të një pandemie shkatërruese mbarëbotërore. Sot në mëngjes ne u frymëzuam nga profeti i gjallë i Zotit që paraqiti një proklamata historike të Rivendosjes. Ne e pohojmë deklaratën e tij se “ata që me lutje e studiojnë mesazhin e Rivendosjes dhe vepronë me besim,

do të bekohen të fitojnë vetë dëshminë e tyre për hyjninë e saj dhe qëllimin e saj për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të premtuar të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit”¹.



Provo, Jutë, SHBA

Plani

Kjo e gjitha është pjesë e një plani hyjnor, qëllimi i të cilit është t'i aftësojë fëmijët e Perëndisë që të ekzaltohen dhe të bëhen si Ai. I përmendur në shkrimet e shenjta si “plani [i] madh [i] lumturisë”, “plani [i] shëlbimit” dhe “plani . . . i shpëtimit” (Alma 42:8, 11, 5), ai plan – i zbuluar në Rivendosje – filloi me një Këshill në Qiell. Si shpirtra, ne dëshironim të arrinim jetën e përjetshme që e gëzonin prindërit tanë qiellorë. Deri në atë pikë ne kishim përparuar aq sa mundeshim pa një përvojë në vdekshmëri, brenda një trupi fizik. Për ta siguruar atë përvojë, Perëndia, Ati, planifikoi të krijonte këtë tokë. Në jetën e planifikuar në vdekshmëri, ne do të ndoteshim nga mëkati kur të përballëshim me kundërshtimin e domosdoshëm për rritjen tonë shpirtërore. Ne gjithashtu do të bëheshim të prekshëm nga vdekja fizike. Që të na shpëtonte nga vdekja e mëkati, plani i Atit tonë Qiellor do të siguronte një Shpëtimtar. Ringjallja e Tij do t'i shëlbonte të gjithë njerëzit nga vdekja dhe flijimi i Tij shlyes do të paguante çmimin e nevojshëm që të gjithë të pastrohen nga mëkati me kushtet e përsëkrutuara për të nxitur rritjen tonë. Kjo Shlyerje e Jezu Krishtit është në qendër të planit të Atit.

Në Këshillin në Qiell, të gjithë fëmijëve shpirtërorë të Perëndisë iu paraqit plani i Atit, përfshirë pasojat dhe sprovat e tij në vdekshmëri, ndihmat e tij qiellore dhe fatin e tij të lavdishëm. Ne e kuptuam mbarimin që nga fillimi. E gjithë moria e njerëzve të vdekshëm që kanë lindur në këtë tokë, e zgjodhën planin e Atit dhe luftuan për të në ndeshjen qiellore që pasoi. Shumë veta bënë gjithashtu besëlidhje me Atin për sa i përket asaj që do të bënin në vdekshmëri. Në mënyra që nuk janë zbuluar, veprimet tona në



botën e shpirtave kanë ndikuar te rrethanat tona në vdekshmëri.

Vdekshmëria dhe Bota e Shpirtave

Tani do të përmbledh disa prej elementeve kryesore të planit të Atit, ngaqë ndikojnë te ne gjatë udhëtimeve tona në vdekshmëri dhe në botën e shpirtave që pason.

Qëllimi i jetës në vdekshmëri dhe i rritjes në jetën pas vdekshmërisë që mund ta pasojë atë, është që pasardhësit e Perëndisë të bëhen siç është Ai. Kjo është dëshira e Atit Qiellor për të gjithë fëmijët e Tij. Për ta arritur këtë fat të gëzueshëm, ligjet e përjetshme kërkojnë që ne duhet të bëhemi qenie të pastruara nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, kështu që ne të mund të banojmë në praninë e Atit dhe Birit dhe të gëzojmë bekimet e ekzaltimit. Siç na mëson Libri i Mormonit, Ai i fton “të gjithë të vijnë tek ai dhe të marrin pjesë në mirësinë e tij; dhe ai nuk ia mohon askujt që shkon tek ai, të zinj dhe të bardhë, skllevër dhe të lirë, burra dhe gra; dhe ai nuk harron idhujtarët; dhe të gjithë janë njësoj para Perëndisë” (2 Nefi 26:33; shih edhe Alma 5:49).

Plani hyjnor që ne të bëhemi ata që kemi fatin të bëhemi, kërkon nga ne që të bëjmë zgjedhje për ta mohuar kundërshtimin e lig që i tundon njerëzit për të vepruar në kundërshtim me urdhërimet e Perëndisë dhe planin e Tij. Gjithashtu kërkon që ne t'i nënshtrohemi një kundërshtimi tjetër në vdekshmëri, të tillë si mëkatet e të tjerëve ose disa defekte me të cilat lindim. Nganjëherë rritja jonë e nevojshme arrihet më mirë nëpërmjet vuajtjes dhe kundërshtimit sesa nëpërmjet rehatisë dhe qetësisë. Dhe asnjëri prej këtyre kundërshtimeve në vdekshmëri nuk mund të arrijë qëllimin e tij të përjetshëm, në qoftë se ndërhyrja hyjnore do të na lehtësonte nga gjithë pasojat e dëmshme në vdekshmëri.

Plani zbulon fatin tonë në përjetësi, qëllimin dhe kushtet e udhëtimit tonë në vdekshmëri, si dhe ndihmat qiellore që do të marrim. Urdhërimet e Perëndisë na paralajmërojnë kundër endjes nëpër rrethana të rrezikshme. Mësimet e udhëheqësve të frymëzuar e udhërrëfejnë shtegun tonë dhe na japin siguritë që e nxitin udhëtimin tonë të përjetshëm.

Plani i Perëndisë na jep katër siguri të mëdha për ta ndihmuar udhëtimin tonë nëpër vdekshmëri. Të gjitha këto na jepen nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, pjesës qendrore të planit. *E para* na siguron që nëpërmjet vuajtjes së Tij për mëkatet për të cilat pendohemi, ne mund të pastrohemi prej atyre mëkateve. Më pas gjykatësi i mëshirshëm përfundimtar “nuk i kujto[n] më ato” (Doktrina e Besëlidhje 58:42).

E dyta, si pjesë e Shlyerjes së Shpëtimtarit tonë, Ai mori mbi veten e Tij të gjitha dobësitë e tjera njerëzore. Kjo na lejon të marrim ndihmë hyjnore dhe na forcon për të mbajtur barrët e pashmangshme të vdekshmërisë, qoftë vetjake dhe të përgjithshme, të tilla si lufta dhe epidemia. Libri i Mormonit na jep përshkrimin më të qartë në shkrimet e shenjta për këtë fuqi thelbësore të Shlyerjes. Shpëtimtari mori mbi veten e Tij “dhembjet dhe sëmundjet [dhe dobësitë] e popullit të tij. . . . Ai do të marrë përsipër dobësitë e tyre, që zemra e tij të mund të mbushet me mëshirë, sipas mishit, që ai të mund të dijë, sipas mishit, se si të ndihmojë popullin e tij sipas dobësive të tyre” (Alma 7:11–12).

E treta, Shpëtimtari, nëpërmjet Shlyerjes së Tij të pafundme, e heq kushtin që vdekja është përfundimtare, dhe na jep sigurinë e gëzueshme se ne të gjithë do të ringjallemi. Libri i Mormonit na mëson: “Ky ribashkim do të vijë te të gjithë, si pleq dhe të rinj, si robër dhe të lirë, si meshkuj dhe femra, si për të këqijtë ashtu dhe për të drejtët; dhe madje nuk do të ketë humbur asnjë flok i kokave të tyre; por çdo gjë do të ribashkohet në vendin e vet të përkryer” (Alma 11:44).

Ne krentojmë realitetin e Ringjalljes në këtë periudhë Pashke. Kjo na jep perspektivën dhe forcën për t'i duruar sfidat e vdekshmërisë, me të cilat përballen secili prej nesh dhe njerëzit

që i duam, gjëra të tilla si mangësitë fizike, mendore ose emocionale që i marrim në lindje ose që i përjetojmë gjatë jetës sonë në vdekshmëri. Për shkak të Ringjalljes, ne e dimë se këto mangësi të vdekshmërisë janë vetëm të përkohshme!

Ungjilli i rivendosur na siguron se Ringjallja mund të përfshijë mundësinë që të jemi me pjesëtarët e familjes sonë – bashkëshortin, bashkëshorten, fëmijët dhe prindërit. Kjo është një nxitje e fuqishme që ne t'i përmbushim përgjegjësitë tona familjare në vdekshmëri. Na ndihmon të jetojmë së bashku në dashuri në këtë jetë, në pritje për bashkimet dhe shoqërimet e gëzueshme në jetën që vjen.

E katërta dhe më së fundi, zbuluesat moderne na mëson se përparimi ynë nuk nevojitet të përfundojë me mbarimin e vdekshmërisë. Pak është zbuluar rreth kësaj sigurie të rëndësishme. Na është thënë se kjo jetë është koha që të përgatitemi për t'u



takuar me Perëndinë dhe që nuk duhet ta shtyjmë pendimin tonë (shih Alma 34:32–33). Prapë, na mësohet se në botën e shpirtave ungjilli u predikohet edhe “të ligjve dhe të pabindurave që e kishin mohuar të vërtetën” (Doktrina e Besëlidhje 138:29) dhe ata që marrin mësim atje, janë të aftë të pendohen përpara Gjyqimit Përfundimtar (shih vargjet 31–34, 57–59).

Ja disa gjëra të tjera themelore të planit të Atit tonë Qiellor:

Ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit na jep një perspektivë të pasqyrore mbi çështjet e dëlirësisë, martesës dhe lindjes së fëmijëve. Na mëson se sipas planit të Perëndisë martesë është e domosdoshme për të përmbushur qëllimin e planit të Perëndisë, për të siguruar mjedisin e caktuar në mënyrë hyjnore të lindjes në vdekshmëri dhe për t'i përgatitur pjesëtarët e familjes për jetën e përjetshme. “Martesa shpëtohet nga Perëndia për njeriun”, tha Zoti, “. . . që toka të mund të përmbushë qëllimin e krijimit të saj” (Doktrina e Besëlidhje 49:15–16). Në këtë, sigurisht, plani i Tij bie në kundërshtim me disa nga forcat e fuqishme botërore të ligjit e traditës.

Fuqia për të krijuar jetë në vdekshmëri është fuqia më e lartë që Perëndia u ka dhënë fëmijëve të Tij. Përdorimi i saj u kërkua në urdhërimin e parë të dhënë Adamit dhe Evës, por një urdhërim tjetër i rëndësishëm u dha për ta ndaluar keqpërdorimin e saj. Jashtë lidhjeve të martesës, të gjitha përdorimet e fuqisë krijuese janë në një shkallë apo në një tjetër një zvetënim dhe shtrembërim mëkatar i tiparit më hyjnor të burrave dhe grave. Theksi që ungjilli i rivendosur e vendos mbi këtë lig të dëlirësisë, është për shkak të qëllimit të fuqive tona të krijimit të jetës në përmbushjen e planit të Perëndisë.



Olmue, Marga Marga, Kili

Po Çfarë më Tej?

Gjatë këtij përvjetori të 200-të të Vegimit të Parë që e filloi Rivendosjen, ne e dimë planin e Zotit dhe marrim kurajë nga dy shekuj të bekimeve të tij nëpërmjet Kishës së Tij të rivendosur. Këtë vit, në 2020-ën, ne kemi një pamje tërësisht të qartë (gjë që njihet gjerësisht si shikimi 20/20) për ngjarjet e së kaluarës.

Teksa shohim drejt së ardhmes, gjithsesi, pamja jonë është shumë më pak e sigurt. Ne e dimë se dy shekuj pas Rivendosjes, bota e shpirtave tani përfshin shumë punonjës me përvojë nga vdekshmëria për ta përmbushur predikimin që ndodh atje. Ne gjithashtu e dimë se tani kemi shumë më tepër tempuj për t'i kryer ordinancat e përjetësisë për ata që pendohen dhe e përqafojnë ungjillin e Zotit në secilën anë të velit të vdekjes. Kjo e gjitha e çon më tej planin e Atit tonë Qiellor. Dashuria e Perëndisë është kaq e madhe sa, përveç disave që me dëshirë bëhen bij të humbjes, Ai ka siguruar një fat lavdie për të gjithë fëmijët e Tij (shih Doktrina e Besëlidhje 76:43).

Ne e dimë se Shpëtimtari do të kthehet dhe se do të ketë një mijëvjeçar të mbretërimit paqësor për ta përmbullur pjesën e vdekshmërisë të planit të Perëndisë. Gjithashtu e dimë se do të ketë ringjallje të ndryshme, të të drejtëve dhe të padrejtëve, me gjykimin



Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

përfundimtar të secilit person gjithmonë pas ringjalljes së tij ose së saj.

Ne do të gjykohe mi sipas veprimeve tona, dëshirave të zemrave tona dhe llojit të njeriut që jemi bërë. Ky gjykim do të shkaktojë që të gjithë fëmijët e Perëndisë të vazhdojnë drejt një mbretërie të lavdisë për të cilën i ka kualifikuar bindja e tyre dhe ku ata do të gjejnë ngushëllim. Gjykatësi i gjithë kësaj është Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti (shih Gjoni 5:22; 2 Nefi 9:41). Gjithëdijenija e Tij i jep Atij njohuri të përsosur për të gjitha veprimet dhe dëshirat tona, si për ato për të cilat nuk pendohemi ose nuk i ndryshojmë, ashtu edhe ato për të cilat pendohemi ose të cilat janë të drejta. Si rrjedhim, pas gjykimit të Tij ne të gjithë do të rrëfejme “se gjykimet e tij janë të drejta” (Mosia 16:1).

Në përfundim, unë ju shpreh bindjen që më ka ardhur prej shumë letrave dhe nëpërmjet shqyrtimit të shumë kërkesave për t’u kthyer në Kishë pas heqjes së emrit ose braktisjes. Shumë prej anëtarëve tanë nuk e kuptojnë tërësisht këtë plan të shpëtimit, i cili u jep përgjigje shumicës së pyetjeve rreth doktrinës dhe rregulloreve të frymëzuara të Kishës së rivendosur. Ne që e dimë planin e Perëndisë dhe që kemi bërë besëlidhje për të marrë pjesë, kemi një përgjegjësi të qartë për t’i dhënë mësim këto të vërteta dhe për të bërë gjithçka mundemi për t’i çuar ato më tej për të tjerët dhe në vetë rrethanat tona në vdekshmëri. Unë dëshmoj për Jezu Krishtin, Shpëtimtarin dhe Shëlbuesin tonë, që e bën gjithçka të mundur, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. “Rivendosja e Plotësisë së Ungjillit të Jezu Krishtit: Një Proklamata në Dyqindvjetor drejtuar Botës”, në Rasëll M. Nelson, “Dëgjojeni Atë”, *Liahona*, maj 2020, f. 91.

Bekimi i Zbulesës së Vazhdueshme të Dhënë Profetëve dhe i Zbulesës Vetjake për ta Udhërrëfyer Jetën Tonë

Zbulesa e vazhdueshme është marrë dhe po merret nëpërmjet kanaleve që Zoti ka vendosur.

Sot do të flas mbi zbulesën e vazhdueshme të dhënë profetëve dhe mbi zbulesën vetjake për ta udhërrëfyer jetën tonë.

Nganjëherë ne marrim zbulesë edhe kur nuk i njohim qëllimet e Zotit. Pak kohë përpara se Plaku Xhefri R. Holland të thirrej që të ishte Apostull në qershorin e vitit 1994, unë

pata një përvojë të bukur zbulesë që ai do të thirrej. Isha përfaqësues krahinor dhe nuk mund të shihja arsye pse do të më jepej ajo njohuri. Por ne ishim shokë kur ishim misionarë të rinj në moshë në Angli në fillim të viteve 1960 dhe unë kisha dashuri të madhe për të. E konsiderova përvojën si një mëshirë të dhembshur ndaj



San-Bernardo, Santiago, Kili

meje. Vitet e fundit, kam vrarë mendjen nëse Zoti po më përgatiste të isha më i ri në detyrë tek Të Dymbëdhjetët ndaj një shoku të hatashëm misionar që ishte shoku im më i ri në detyrë kur ishim misionarë të rinj në moshë.¹ Nganjëherë i paralajmëroj misionarët e rinj në moshë që të jenë të sjellshëm me shokët e tyre më të rinj në detyrë, sepse nuk i dihet kurrë se kur ata mund të jenë shoku i tyre më i vjetër në detyrë.

Unë kam një dëshmi të palëkundur se kjo Kishë e rivendosur udhëhiqet nga Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti. Ai e di se cilët të thërrasë si Apostujt e Tij dhe sipas cilës radhë t'i thërrasë ata. Ai gjithashtu e di se si ta përgatitë Apostullin e Tij më të vjetër në detyrë që të jetë profeti dhe Presidenti i Kishës.

U bekuam këtë mëngjes kur e dëgjua profetin tonë të dashur, Presidentin Rasëll M. Nelson, të jepte një proklamata të thellë në dyqindvjetor drejtuar botës në lidhje me Rivendosjen e plotësisë së unguillit të Jezu Krishtit.² Kjo deklaratë thelbësore nga Presidenti Nelson e ka bërë të qartë se Kisha e Jezu Krishtit i detyrohet parimit të zbulësës së vazhdueshme për zanafillën, ekzistencën dhe drejtimin e saj. Proklamata e re përfaqëson komunikimin e një Ati të dashur ndaj fëmijëve të Tij.

Në një kohë më të hershme, Presidenti Spenser W. Kimball shprehu ndjenjat që unë kam sot. Ai shpalli: "Nga të gjitha gjërat për të cilat . . . duhet të jemi më mirënjohës, është që qiejt vërtet janë hapur dhe që Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit është theme-luar mbi shkëmbin e zbulësës. Zbulësia e vazhdueshme është vërtet vetë elementi jetësor i unguillit të Zotit dhe Shpëtimtarit të gjallë, Jezu Krishtit."³

Profeti Enok i parashikoi ditët në të cilat ne jetojmë. Zoti ia tregoi Enokut

ligësinë e madhe që do të mbizotëronte, dhe profetizoi për "mundime të mëdha" që do të ndodhnin. Megjithatë, Zoti premtoi: "Por popullin tim unë do ta ruaj"⁴. "Dhe drejtësi do të dërgoj nga qiejt; dhe të vërtetë do të dërgoj nga toka, për të dhënë dëshmi për të Vetëmlindurin tim."⁵

Presidenti Ezra Taft Benson dha mesazh me fuqi të madhe që Libri i Mormonit, guri kyç i besimit tonë, doli nga toka në përmbushje të deklaramit që Zoti ia bëri Enokut. Ati e Biri dhe engjëjt e profetët që iu shfaqën Profetit Jozef Smith, u "drejtuan nga qielli për të rivendosur fuqitë e domosdoshme të mbretërisë"⁶.

Profeti Jozef Smith mori zbulësë pas zbulësë. Disa prej tyre janë përmendur gjatë kësaj konference. Shumë zbulësia të marra nga Profeti Jozef janë ruajtur për ne te Doktrina e Besëlidhje. Të gjitha veprat standarde të Kishës përmbajnë mendjen dhe vullnetin e Zotit për ne në këtë periudhë të fundit unguillorë.⁷

Përveç këtyre shkrimeve të shenjta të shkëlqyera e themelore, ne beko-hemi me zbulësë të vazhdueshme, të dhënë profetëve të gjallë. Profetët janë "agentë të porositur të Zotit, të autorizuar që të flasin për Të"⁸.

Disa zbulësia kanë rëndësi monumentale dhe të tjera e rritin kuptueshmërinë tonë për të vërtetë hyjnore, thelbësore dhe japin udhërrëfim për kohën tonë.⁹

Jemi jashtëzakonisht mirënjohës për zbulësën e dhënë Presidentit Spenser W. Kimball që ua mundësoi priftërinë dhe bekimet e tempullit të



gjithë anëtarëve të denjë meshkuj të Kishës në qershor 1978.¹⁰

Unë kam shërbyer me shumë prej Të Dymbëdhjetëve që ishin të pranishëm dhe morën pjesë kur u mor ajo zbulësia e çmuar. Secili prej tyre, në bashkëbisedime vetjake, pohoi udhërrëfimim shpirtëror, të fuqishëm e bashkues që Presidenti Kimball dhe ata kishin përjetuar. Shumë prej tyre thanë se ishte zbulësia më e fuqishme që ata kishin marrë përpara ose pas asaj kohe.¹¹

Ata prej nesh që po shërbejnë tani në Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve, janë bekuar në kohën tonë teksa zbulësia thelbësore kanë ardhur nëpërmjet profetëve të sotëm.¹² Presidenti Rasëll M. Nelson ka qenë një agent i porositur nga Zoti *veçanërisht* në lidhje me zbulësat për t'i ndihmuar familjet që të ndërtojnë shenjtërore besimi në shtëpitë e tyre, ta mbledhin Izraelin e shpërndarë në të dyja anët e velit dhe t'i bekojnë anëtarët që e kanë marrë dhurimin [indaumentin], në çështjet e ordinancave të shenjta të tempullit.

Kur ndryshime të rëndësishme për t'i bekuar shtëpitë tona u shpallën në konferencën e përgjithshme të tetorit 2018, unë dëshmovava "se në diskutimet e Këshillit të Presidencës së Parë dhe të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve në tempull . . . pasi profeti ynë i



dashur i bëri kërkesë Zotit për zbulesë . . . , u mor një pohim i fuqishëm nga të gjithë¹³.

Në atë kohë, zbulesa të tjera lidhur me ordinancat e shenja të tempullit ishin marrë, por nuk ishin shpallur apo vënë në zbatim.¹⁴ Ky udhërrëfim filloi me zbulesën vetjake, profetike, të dhënë Presidentit Rasëll M. Nelson dhe pohimin e dhembshur e të fuqishëm të dhënë atyre që merrnin pjesë në atë proces. Presidenti Nelson posaçërisht i përfshiu motrat që kryesojnë mbi organizatat e Shoqatës së Ndhimës, Të Rejave dhe Fillores. Udhërrëfimi përfundimtar, në tempull, që iu dha Presidencës së Parë dhe Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, ishte thellësisht shpirtëror dhe i fuqishëm. Secili prej nesh e dinte që kishte marrë mendjen, vullnetin dhe zërin e Zotit.¹⁵

Unë deklaroj gjithë solemnitët se zbulesa e vazhdueshme është marrë dhe po merret nëpërmjet kanaleve që Zoti ka vendosur. Unë dëshmoj se proklamata e re që Presidenti Nelson dha këtë mëngjes, është një zbulesë për të bekuar të gjithë njerëzit.

Ne u Bëjmë të Gjithëve një Ftesë që të Ushqehen me Bollëk në Tryezën e Zotit

Ne gjithashtu shpallim dëshirën tonë të përzemërt që të bashkohemi sërisht me ata që kanë qenë në vështirësi me dëshmitë e tyre, kanë qenë më pak aktivë ose që zgjodhën t'i hiqnin emrat nga dokumentet e Kishës. Ne dëshirojmë që të ushqehemi me bollëk bashkë me ju “me fjalët e Krishtit”, në

tryezën e Zotit, për të mësuar gjërat që ne të gjithë duhet të bëjmë.¹⁶ Ne kemi nevojë për ju! Kisha ka nevojë për ju! Zoti ka nevojë për ju! Lutja jonë e përzemërt është që ju do të bashkoheni me ne në adhurimin e Shpëtimtarit të botës. E dimë se disa prej jush mund të kenë përjetuar fyerje, mungesë dashamirësie ose sjellje tjetër që nuk është si e Krishtit. E dimë gjithashtu se disa kanë pasur sfida lidhur me besimin e tyre që nuk mund të vlerësohen, kup-tohen apo zgjidhen plotësisht.

Disa prej anëtarëve tanë më të paepur dhe besnikë, kanë vuajtur një sfidë lidhur me besimin të tyre për një periudhë. Më pëlqen shumë tregimi i vërtetë për W. W. Felpsin, që e pati braktisur Kishën dhe pati dëshmuar kundër Profetit Jozef Smith në një gjykatë të Misurit. Pasi u pendua, ai i shkroi Jozefit: “E njoh gjendjen time, ju e dini atë dhe Perëndia e di atë, dhe unë dëshiroj të shpëtohem nëse miqtë e mi do të më ndihmojnë¹⁷. Jozefi vërtet e fali atë, e vuri sërisht në punë dhe shkroi me dashuri: “Miqtë e fillimit janë miq përsëri më së fundi¹⁸”.

Vëllezër dhe motra, pavarësisht nga gjendja juaj, ju lutem ta dini se Kisha dhe anëtarët e saj do t'ju mirëpresin kur të ktheheni!

Zbulesa Vetjake për ta Udhërrëfyer Jetën Tonë

Zbulesa vetjake është në dispozicion për të gjithë ata që me përlulësi kërkojnë udhërrëfim nga Zoti. Është po aq e rëndësishme sa zbulesa profetike.

Zbulesa vetjake, shpirtërore, nga Fryma e Shenjtë ka sjellë si rezultat që miliona veta të marrin dëshminë e nevojshme që të pagëzohen dhe konfirmohen si anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Zbulesa vetjake është bekimi i thellë, i marrë pas pagëzimit kur ne “shenjtërohemi nëpërmjet marrjes së Frymës së Shenjtë¹⁹”. Mund të kujtoj një zbulesë shpirtërore të veçantë kur isha 15 vjeç. Vëllai im i shtrenjtë po kërkonte udhërrëfim nga Zoti mbi mënyrën se si t'i përgjigjej atit tonë të dashur që nuk dëshironte që vëllai im të shërbente në një mision. Edhe unë u luta me qëllim të sinqertë dhe mora zbulesë vetjake për vërtetësinë e ungjillit.

Roli i Frymës së Shenjtë

Zbulesa vetjake bazohet mbi të vërtetat shpirtërore të marra nga Fryma e Shenjtë.²⁰ Fryma e Shenjtë është ai që zbulon dhe dëshmon për gjithë të vërtetën, veçanërisht atë për Shpëtimtarin. Pa Frymën e Shenjtë, ne nuk mund ta dimë vërtet se Jezusi është Krishti. Roli i tij thelbësor është që të japë dëshmi për Atin dhe Birin, për titujt e Tyre dhe lavdinë e Tyre.

Fryma e Shenjtë mund të ndikojë te çdo njeri në një mënyrë të fuqishme.²¹ Ky ndikim nuk do të jetë i vazhdueshëm në qoftë se personi nuk pagëzohet dhe nuk e merr dhuratën e Frymës së Shenjtë. Fryma e Shenjtë shërben gjithashtu si një agjent pastrues në procesin e pendimit dhe faljes.

Shpirti komunikon në mënyra të mrekullueshme. Zoti përdori këtë përshkrim të bukur:

“Unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde, me anë të Frymës së Shenjtë, që do të vijë mbi ty dhe që do të banojë në zemrën tënde.

Tani, vër re, ky është shpirti i zbulesës.”²²

Edhe pse efekti i tij mund të jetë jashtëzakonisht i fuqishëm, shumicën e rasteve ai vjen si një zë i qetë, i vogël.²³ Shkrimet e shenjta përmbajnë shumë shembuj të mënyrës se si Shpirti ndikon në mendjen tonë, përfshirë duke i folur paqe mendjes sonë²⁴, duke e pushtuar mendjen tonë²⁵, duke e ndriçuar mendjen tonë²⁶ dhe madje duke na përçuar një zë në mendjen tonë.²⁷

Disa parime që na përgatitin për të marrë zbulesë, përfshijnë:

- Lutjen për udhërrëfim shpirtëror. Me nderim dhe përlulesi neve na nevojitet të kërkojmë dhe të pyesim²⁸, si dhe të jemi të duruar e të nënshtruar.²⁹
- Përgatitjen për frymëzim. Kjo kërkon që të jemi në harmoni me mësimet e Zotit dhe në pajtim me urdhërimet e Tij.
- Marrjen e sakramentit me denjësi. Kur e bëjmë këtë, ne i dëshmojmë Perëndisë dhe besëlidhim me Të se e marrim mbi vete emrin e Birit të Tij të shenjtë, se e kujtojmë Atë dhe i zbatojmë urdhërimet e Tij.



Reksburg, Ajdaho, SHBA

Këto parime na përgatitin t'i marrim, t'i dallojmë dhe t'i ndjekim nxitjen dhe udhërrëfimin e Frymës së Shenjtë. Kjo përfshin "gjërat paqësore . . . që sjellin gëzim [dhe] . . . jetë të përvetshme"³⁰.

Përgatitja jonë shpirtërore shtohet shumë kur ne i studiojmë rregullisht shkrimet e shenjta dhe të vërtetat e ungjillit si dhe përsiatim në mendjen tonë udhërrëfimin që kërkojmë. Por mbani mend të jeni të duruar dhe të mirëbesoni në kohën e Zotit. Udhërrëfimi jepet nga një Zot i gjithëdijshëm kur Ai "e zgjedh qëllimisht të na udhëzojë"³¹.

Zbulesa në Thirrjet dhe Caktimet Tona

Fryma e Shenjtë gjithashtu do të sigurojë zbulesë në thirrjet dhe caktimet tona. Nga përvoja ime, udhërrëfimi thelbësor shpirtëror vjen më së shpeshti kur po përpiqemi t'i bekojmë të tjerët në përmbushje të përgjegjësi-ve tona.

Më kujtohet që kur isha peshkop i ri në moshë, mora një thirrje telefonike të dëshpëruar nga një çift i martuar, pak kohë përpara orës së planifikuar



që të nisja një udhëtim me aeroplan për një angazhim pune. Iu përgjërrova Zotit përpara mbërritjes së tyre që ta dija se si mund t'i bekoja ata. M'u zbulua natyra e problemit dhe përgjigjja që duhej të jepja. Ai udhërrëfim zbulesë më lejoi t'i përmbushja përgjegjësitë e shenjta të thirrjes sime si peshkop pavarësisht nga koha shumë e kufizuar në dispozicion. Peshkopët në mbarë botën gjithashtu kanë të njëjtat lloje përvojash si unë. Si president kunji, jo vetëm që mora zbulesë të rëndësishme, por mora gjithashtu edhe *korrigjim* vetjak që ishte i nevojshëm për të përmbushur qëllimet e Zotit.

Ju siguroj se udhërrëfimi me anë të zbulesës mund të merret nga secili prej nesh tekta punojmë me përlulesi në vreshtin e Zotit. Shumica e udhërrëfimit tonë vjen nga Fryma e Shenjtë. Nganjëherë dhe për disa qëllime, ajo vjen drejtpërsëdrejti nga Zoti. Unë dëshmoj personalisht se kjo është e vërtetë. Udhërrëfimi për Kishën, si një e tërë, i vjen Presidentit dhe profetit të Kishës.

Ne, si Apostuj modernë, kemi pasur privilegjin të punojmë dhe të udhëtojmë me profetin tonë të tanishëm, Presidentin Nelson. Po e parafrazoj atë që Uillford Udrafti tha për Profetin Jozef Smith; është po aq e vërtetë për Presidentin Nelson. Unë kam parë "veprat e Shpirtit të




Perëndisë me të, dhe zbulosat e Jezu Krishtit drejtuar atij, dhe plotësimin e atyre zbulosave³².

Përgjërimi im i përlur sot është që secili prej nesh do të kërkojë zbulosë të vazhdueshme për ta udhërrëfyer jetën tonë dhe për ta ndjekur Shpirtin tekta e adhurojmë Perëndinë, Atin, në emrin e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit, për të cilin unë jap dëshmi, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Në vitin 1960 kur mosha për shërbimin misionar për të rinjtë u ul nga 20 në 19 vjeç, unë isha një nga të fundit e 20-vjeçarëve; Plaku Xhefiri R. Holland ishte një nga të parët e 19-vjeçarëve.
2. Shih "Rivendosja e Plotësisë së Ungjillit të Jezu Krishtit: Një Proklamata në Dyqindvjetor drejtuar Botës", te Rasëll M. Nelson, "Dëgjojeni Atë", *Liahona*, maj 2020, f. 91. Kjo proklamata bashkohet me pesë të tjera që janë dhënë në këtë periudhë ungjillore nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve.
3. *Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* (2006), f. 243; shih edhe Mateu 16:13–19.
4. Moisiu 7:61.
5. Moisiu 7:62. Zoti vazhdoi: "Dhe drejtësi dhe të vërtetë do të bëjë të derdhet mbi tokë si në një përmblytje, për të mbledhur të zgjedhurit e mi nga të katër skajet e tokës" (Moisiu 7:62; shih edhe Psalmeve 85:11).
6. Ezra Taft Benson, "The Gift of Modern Revelation", *Ensign*, nëntor 1986, f. 80.
7. Shih Ezra Taft Benson, "The Gift of Modern Revelation", f. 80.
8. Hugh B. Brown, "Joseph Smith among the Prophets" (Sixteenth Annual Joseph Smith Memorial Sermon, Logan Institute of Religion, 7 dhjetor 1958), f. 7.
9. Shih Hugh B. Brown, "Joseph Smith among the Prophets", f. 7. Në të gjitha rastet, zbulosat janë në harmoni me fjalën e Perëndisë të dhënë profetëve të mëparshëm.
10. Shih Deklarata Zyrtare 2; shih edhe 2 Nefi 26:33. Zbulosa vuri në zbatim doktrinën e paraqitur në Librin e Mormonit që "të gjithë janë njësoj para Perëndisë", përfshirë "të zinj dhe të bardhë, skllavër dhe të lirë, burra dhe gra" (2 Nefi 26:33). Kjo zbulosë e mrekullueshme u mor dhe u pohua në dhomën e shenjtë, të sipërme të Tempullit të Solt-Lejkut nga Këshilli i Presidencës së Parë dhe Kuorumi të Dymbëdhjetë Apostujve.
11. Shumë prej Apostujve treguan se zbulosa ishte kaq e fuqishme dhe kaq e shenjtë sa që çfarëdo fjalësh të përdorura për ta përshkruar atë do të ishin të pamjaftueshme dhe, në disa mënyra, do ta pakësonin natyrën e thellë dhe të fuqishme të zbulosës.
12. Shih "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës", *Liahona*, maj 2017, f. 145. Kjo proklamata u shpall nga Presidenti Gordon B. Hinkli në mbledhjen e përgjithshme të Shoqatës së Ndhimës të mbajtur më 23 shtator 1995, në Solt-Lejk-Siti në Jutë. Shih edhe Tomas S. Monson, "Mirësevini në Konferencë", *Liahona*, nëntor 2012, f. 4–5. Presidenti
13. Kuentin L. Kuk, "Kthim i Thellë dhe Afatgjatë në Besimin tek Ati Qielor dhe Zoti Jezu Krisht", *Liahona*, nëntor 2018, f. 11.
14. Zbulosat lidhur me ordinancat e shenjtë të tempullit u vunë në zbatim në të gjithë tempujt duke filluar nga data 1 janar 2019. Është e rëndësishme të kuptohet se hollësi të veçanta mbi ordinancat e tempullit diskutohen vetëm në tempull. Megjithatë, parimet jepen mësim. Plaku Dejvid A. Bednar dha mësim shumë bukur për rëndësinë e besëlidhjeve dhe ordinancave të tempullit dhe se si nëpërmjet tyre "fuqia e perëndishmërisë mund të vërshojë në jetën tonë" ("Kjo Shtëpi Duhet të Ndërtohet për Emrin Tim", *Liahona*, maj 2020, f. 86).
15. Ky proces dhe mbledhjet e mbajtura ndodhën në Tempullin e Solt-Lejkut në janar, shkurt, mars dhe prill 2018. Zbulosa e fundit e dhënë Presidencës së Parë dhe Kuorumi të Të Dymbëdhjetëve ndodhi më 26 prill 2018.
16. Shih 2 Nefi 32:3.
17. *Saints: The Story of the Church of Jesus Christ in the Latter Days [Shenjtoret: Historia e Kishës së Jezu Krishtit në Ditët e Mëvonshme]*, vëll. 1, *The Standard of Truth [Standardi i së Vërtetës], 1815–1846* (2018), f. 418.
18. *Saints*, 1:418.
19. 3 Nefi 27:20.
20. Fryma e Shenjtë është një anëtar i Kreut-Perëndi (shih 1 Gjon 5:7; Doktrina e Besëlidhje 20:28). Ai ka një trup prej shpirti në formën dhe ngjashmërinë e njeriut (shih Doktrina e Besëlidhje 130:22). Ndikimi i tij mund të jetë kudo. Ai është i bashkuar në qëllim me Atin tonë Qielor dhe Jezu Krishtin, Shpëtimtarin tonë.
21. Për një kuptueshmëri gjithëpërfshirëse të Dritës së Krishtit dhe të dallimit midis Dritës së Krishtit dhe Frymës së Shenjtë, shih 2 Nefi 32; Doktrina e Besëlidhje 88:7, 11–13; "Dritë e Krishtit", Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta. Shih edhe Boyd K. Packer, "The Light of Christ", *Liahona*, prill 2005, f. 8–14.
22. Doktrina e Besëlidhje 8:2–3.
23. Shih Helamani 5:30; Doktrina e Besëlidhje 85:6.
24. Shih Doktrina e Besëlidhje 6:23.
25. Shih Doktrina e Besëlidhje 128:1.
26. Shih Doktrina e Besëlidhje 11:13.
27. Shih Enosi 1:10.
28. Shih Mateu 7:7–8.
29. Shih Mosia 3:19.
30. Doktrina e Besëlidhje 42:61.
31. Neal A. Maxwell, *All These Things Shall Give Thee Experience* (2007), f. 31.
32. Uillford Udraf, në *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 301.



Plaku Rikardo P. Himenez,
i Të Shtatëdhjetëve

Të Gjejmë Strehë nga Stuhitë e Jetës

Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij janë streha që na nevojitet të gjithëve, pavarësisht nga stuhitë që po e godasin jetën tonë.

Dikur në mes të viteve 90, gjatë viteve të mia të kolegjit, isha pjesë e Kompanisë së Katërt të Sektorit të Zjarrfikësve të Santiagos në Kili. Ndërkohë që shërbeja atje, jetoja në repartin e zjarrfikësve si pjesë e rojave të natës. Nga fundi i vitit, më thanë se duhej të isha në repartin e zjarrfikësve në vijilje të Vitit të Ri sepse atë ditë kishte pothuajse gjithnjë ndonjë urgjencë. I befasuar, u përgjigja: “Vërtet?”

Epo, më kujtohet tek prisja me kolegët e mi kur, në mesnatë, filluan të shpërthenin fishekzjarrët në qendër të Santiagos. Filluam ta përqafojmë njëri-tjetrin me urime të mira për vitin e ri. Papritmas filluan të tringëllinin zilet në repartin e zjarrfikësve, që tregonin se kishte një urgjencë. Morëm pajimet tona dhe u hodhëm brenda makinës së zjarrfikësës. Rrugës për tek urgjenca, teksa kalonim turma njerëzish që po festonin vitin e ri, vura re se ata ishin tejet të pashqetësuar e të shkujdesur. Ata ishin të qetë dhe po e shijonin atë natë të ngrohtë vere. Prapëseprapë diku aty afër, njerëzit të cilët po nxitonim t'i ndihmonim ishin në telash të madh.

Kjo përvojë më ndihmoi të kuptoja se, ndonëse jeta jonë ndonjëherë

mund të jetë relativisht e patrazuar, do të vijë koha për secilin prej nesh kur do të përballemi me sfida të papritura dhe stuhi që do ta çojnë në limit aftësinë tonë për të duruar. Sfida fizike, mendore, familjare dhe punësimi; fatkeqësi natyrore dhe çështje të tjera për jetë a vdekje janë vetëm disa nga shembujt e stuhive me të cilat do të përballemi në këtë jetë.

Kur përballemi me këto stuhi, ne shpesh përjetojmë ndjenja dëshpërimi ose frike. Presidenti Rasëll M. Nelson tha: “Besimi është kundërhelmi për frikën” *besimi në Zotin tonë Jezu Krisht* (“Lëreni Besimin Tuaj të Dalë në Pah,” *Liahona*, maj 2014, f. 29). Teksa i kam parë stuhitë që prekin jetën e njerëzve, kam arritur në përfundimin se pavarësisht nga lloji i stuhisë që po na godet – pa marrë parasysh a ka një zgjidhje për të ose a mund ta shohim fundin e saj – ka

vetëm një strehë dhe ajo është e njëjta për të gjitha llojet e stuhive. Kjo strehë e vetme e siguruar nga Ati ynë Qiellor është Zoti ynë, Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij.

Asnjëri prej nesh nuk përjashtohet nga përballja me këto stuhi. Helamani, një profet i Librit të Mormonit, na mësoi atë që vijon: “Mbani mend se është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj; që kur djalli të çojë erërat e tij të fuqishme, po shigjetat e tij në shtjellë të erës, po, kur i gjithë breshëri i tij dhe furtuna e tij e fuqishme do të lëshohen mbi ju, nuk do të ketë fuqi mbi ju, që t’ju tërheqë në humnerën e mjerimit dhe të vuajtjes së pafund, për shkak të shkëmbit mbi të cilin jeni ndërtuar, që është një bazë e sigurt, një bazë mbi të cilën në qoftë se njerëzit ndërtojnë, nuk mund të bien” (Helamani 5:12).

Plaku Robert D. Hejls, i cili pati përvoja të vetat me durimin e stuhive, tha: “Vuajtja është universale; mënyra se si ne reagojmë ndaj vuajtjes është individuale. Vuajtjen mund ta marrim në një nga këto dy mënyra. Ajo mund të jetë një përvojë fuqizuese dhe pastruese e ndërthurur me besim, ose mund të jetë një forcë shkatërruese



Oslo, Norvegji

në jetën tonë nëse nuk kemi besim te sakrifica shlyese e Zotit” (“Your Sorrow Shall Be Turned to Joy”, *Ensign*, nëntor 1983, f. 66).

Në mënyrë që ta gëzojmë strehën që ofron Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij, duhet të kemi besim tek Ai – një besim që do të na lejojë të ngrihemi mbi të gjitha dhembjet e një perspektive të kufizuar e tokësore. Ai ka premtuar se do të na i bëjë barrët të lehta nëse i drejtohem Atij për çdo gjë që bëjmë.

“Ejani tek unë”, tha Ai, “o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje.

Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përulur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj.

Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë” (Mateu 11:28–30; shih edhe Mosia 24:14–15).

Thuhet se “për dikë që ka besim, nuk është e nevojshme të ketë asnjë shpjegim. Për dikë pa besim, asnjë shpjegim nuk është i mundur.” (Kjo thënie thuhet se është e Tomas Akuinasit, por ka më tepër gjasë të jetë një parafrazim jo i fjalëpërfjalshëm i gjërave që ai dha mësim.) Megjithatë, ne kemi kuptueshmëri të kufizuar për gjërat që ndodhin këtu në tokë dhe shpesh nuk kemi përgjigje për pyetjen *pse*. Pse po ndodh kjo? Pse po më ndodh *mua kjo*? Çfarë supozohet të mësoj? Kur përgjigjet na përvidhen, ai është çasti kur gjejnë zbatim të plotë fjalët e shprehura nga Shpëtimtari ynë drejtuar Profetit Jozef Smith në burgun e Libertisë:

“Biri im, paqe i qoftë shpirtit tënd; fatkeqësia jote dhe mjerimet e tua do të jenë veçse një çast i shkurtër;

Dhe atëherë, në qoftë se i duron mirë ato, Perëndia do të të lartësojë nga lart” (Doktrina e Besëlidhje 121:7–8).

Ndonëse shumë njerëz njëmend besojnë në Jezu Krisht, pyetja kyç është a i *besojmë* ne Atij dhe a u *besojmë* gjërave që Ai na mëson e na kërkon të bëjmë. Ndoshta dikush mund të mendojë: “Çfarë di Jezu Krishti rreth asaj që po më ndodh? Nga e di Ai se çfarë më nevojitet për të qenë i/e lumtur? Në të vërtetë, profeti Isaia po i referohej Shëlbuesit dhe Ndërmjetësit kur tha:

“I përçmuar dhe i hedhur poshtë nga njerëzit, njeri i dhembjeve, njohës i vuajtjes. . . .

Megjithatë, ai mbante sëmundjet tona dhe kishte marrë përsipër dhembjet tona. . . .

Por ai u tejshpua për shkak të shkeljeve tona, u shtyp për paudhësitë tona; ndëshkimi për të cilin kemi paqen është mbi të, dhe për shkak të vurratave të tij ne jemi shëruar” (Isaia 53:3–5).

Apostulli Pjetër dha gjithashtu mësim rreth Shpëtimtarit, duke thënë: “Ai vet i barti mëkatet tona në trupin e tij mbi drurin e kryqit që ne, të vdekur për mëkate, të rrojmë për drejtësi; dhe me vurratat e tij ju u shëruat” (1 Pjetër 2:24).

Ndonëse po afrohej koha e martirizimit të vetë Pjetrit, fjalët e tij nuk janë të mbushura me frikë ose pesimizëm, në vend të kësaj, ai u mësoi shenjtorëve të “gëzoh[eshin]”, ndonëse ishin “të trisht[uar] nga prova të ndryshme”. Pjetri na këshilloi ta mbanim mend se “prova e besimit [tonë] . . . edhe pse provohet me zjarr”, do të çonte në “lëvdim, nder e lavdi në zbulesën e Jezu Krishtit” dhe në “shpëtimin e shpirtrave [tanë]” (1 Pjetër 1:6–7, 9).

Pjetri vazhdoi:

“Shumë të dashur, mos ju duket çudi për provën e zjarrit që u bë ndër ju për t’ju provuar, se si ju ndodhi diçka e jashtëzakonshme.



KRISHTI NË GIETSEMAN, NGA MICHAEL T. MALIM

Por gëzohuni, duke qenë pjestarë të mundimeve të Krishtit, që edhe në zbulesën e lavdisë së tij të mund të gëzoheni dhe të ngazëlloheni” (1 Pjetër 4:12–13).

Presidenti Rasëll M. Nelson dha mësim se “shenjtorët mund të jenë të lumtur në çdo rrethanë”. Kur përqendrimi i jetës sonë është te plani i Perëndisë për shpëtim . . . dhe te Jezu Krishti e ungjilli i Tij, ne mund të ndiejmë gëzim pavarësisht nga ajo që po ndodh – apo nuk po ndodh – në jetën tonë. Gëzimi vjen prej Tij dhe për shkak të Tij. Ai është burimi i të gjithë gëzimit” (“Gëzimi dhe Mbijetesa Shpirtërore”, *Liahona*, nëntor 2016, f. 82).

Patjetër, është më e lehtë t’i themi këto gjëra kur nuk jemi në mes të një stuhie sesa t’i jetojmë e t’i zbatojmë gjatë stuhisë. Por si vëllai juaj, shpresoj që ju të mund ta ndieni se dua sinqerisht t’ju tregoj se sa gjë e çmuar është ta dimë se Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij janë streha që na nevojitet të gjithëve, pavarësisht nga stuhitë që po e godasin jetën tonë.

E di se ne jemi të gjithë fëmijët e Perëndisë, se Ai na do dhe se nuk jemi vetëm. Ju ftoj të gjithëve të vini e ta shihni se Ai mund t’ju lehtësojë barrët dhe të jetë streha që po kërkon. Ejani dhe ndihmoni të tjerë të gjejnë strehën për të cilën janë të dëshiruar. Ejani dhe qëndroni me ne në këtë strehë, e cila do t’ju ndihmojë t’u bëni qëndresë stuhive të jetës. Nuk ka asnjë dyshim në zemrën time se po të vini, do të shihni, do të ndihmoni e do të qëndroni.

Profeti Alma i dëshmoi për sa vijon birit të tij Helamanit: “Unë e di se kushdo që vë besimin e tij në Perëndi, do të përkrahet në sprovat e tij dhe në vështirësitë e tij dhe në mjerimet e tij dhe do të ngrihet në ditën e fundit” (Alma 36:3).



Shpëtimtari Vetë tha:
“Zemrat tuaja duhet të ngushëllohen . . . sepse gjithë mishi është në duart e mia; rrii të qetë dhe dijeni se unë jam Perëndi. . . .

Si rrjedhim, mos kini frikë madje deri në vdekje; sepse në këtë botë gëzimi juaj nuk është i plotë, por në mua gëzimi juaj është i plotë” (Doktrina e Besëlidhje 101:16, 36).

Himni “Rri Qet’ o Shpirt”, që ma ka prekur zemrën në raste të shumta, ka një mesazh ngushëllimi për shpirtat tanë. Në tekstin e tij lexojmë sa vijon:

Rri qet’ o shpirt: Koha po afron shpejt, Kur përgjithmon’ do jemi me Zotin, Kur zhgënjim, hidh’rim dhe frik’ më t’mos ket’,

Pik’lirim më s’ka, veç t’dashurisë’ gëzim. Rri qet’ o shpirt: Kur lotët lihen pas, T’sigurt, t’bekuar do mblidhemi prap. (Himne, nr. 64)

Ndërsa përballemi me stuhitë e jetës, e di se po të bëjmë përpjekjen tonë më të mirë e të mbështetemi te Jezu Krishti dhe te Shlyerja e Tij si streha jonë, do të bekohemi me lehtësimin, ngushëllimin, forcën, përmbajtjen dhe paqen që po kërkojmë, me siguri në zemër se në mbarim të kohës sonë në tokë, do të dëgjojmë fjalët e Mësuesit: “Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik; ti u tregove besnik . . . hyr në gëzimin e zotit tënd” (Mateu 25:21). Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Olmue, Marga Marga, Kili



Nga Plaku Diter F. Uhtdorf,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ejani dhe Kini Përkatësi

Ne i ftojmë të gjithë fëmijët e Perëndisë në mbarë botën, që të bashkohen me ne në këtë punë të madhërishtme.

Vëllezërit e motrat e mia të dashura, miqtë e mi të dashur, çdo javë, anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në mbarë globin e adhurorin Atin tonë të dashur Qiellor, Perëndinë dhe Mbretin e universit, dhe Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin. Ne e përsiatim jetën dhe mësimet e Jezu Krishtit – të vetmin shpirt të pamëkatë që ka jetuar ndonjëherë, Qengjin e panjollë të Perëndisë. Sa më shpesh të mundemi, ne e marrim sakramentin në kujtim të flijimit të Tij dhe e pranojmë që Ai është qendra në jetën tonë.

Ne e duam Atë dhe e nderojmë Atë. Për shkak të dashurisë së Tij të thellë dhe të përjetshme, Jezu Krishti vuajti dhe vdiq për ju dhe për mua. Ai i shembi portat e vdekjes, i rrëzoi pengesat që i ndanin miqtë dhe njerëzit e tyre të dashur¹, dhe u solli shpresë të pashpresëve, shërim të sëmurëve dhe çlirim robërve².

Atij ia kushtojmë zemrën tonë, jetën tonë dhe devotshmërinë tonë të përditshme. Për këtë arsye, “ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krishtin [dhe] ne predikojmë për Krishtin, . . . që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t’i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre”³.

Të Ushtruarit e Dishepullimit

Sidoqoftë, të qenit një dishepull i Jezu Krishtit përfshin shumë më tepër gjëra sesa të flasësh dhe të predikosh për Krishtin. Vetë Shpëtimtari e rivendosi Kishën e Tij që të na ndihmojë përgjatë shtegut për t’u bërë më shumë si Ai. Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është e strukturuar që të japë mundësi për të ushtruar bazat e dishepullimit. Nëpërmjet pjesëmarrjes sonë në Kishë, ne mësojmë që t’i dallojmë nxitjet nga Shpirti i Shenjtë dhe të veprojmë sipas tyre. Ne e zhvillojmë prirjen për t’u shkuar në ndihmë të tjerëve me dhembshuri dhe mirësi.



Millkrik, Jutë, SHBA

Kjo është një përpjekje që zgjat gjithë jetën dhe kërkon ushtrim.

Sportistët e arrirë shpenzojnë orë pafund duke i ushtruar bazat e sporteve të tyre. Infermierët, punonjësit e rrjeteve kompjuterike, inxhinierët bërthamorë e madje dhe unë si kuzhinier amator me shpirt konkurrence, në kuzhinën e Herrietës, bëhemi të aftë dhe të zotë vetëm kur e ushtrojmë me zell zanatin tonë.

Si kapiten i linjave ajrore, shpesh kam trajnuar pilotë duke përdorur një simulant fluturimi – një makineri të sofistikuar që imiton përvojën e fluturimit. Simulanti jo vetëm që i ndihmon pilotët të mësojnë bazat e fluturimit; ai i lejon gjithashtu që ata të përjetojnë dhe të reagojnë gjatë ndodhive të paparashikuara që mund të hasin kur marrin komandën e avionit të vërtetë.

Të njëjtat parime gjejnë zbatim edhe për dishepullt e Jezu Krishtit.

Pjesëmarrja aktive në Kishën e Jezu Krishtit dhe shumëllojshmëria e madhe e mundësive të saj, do të na ndihmojnë që të jemi të përgatitur më mirë për rrethanat e ndryshueshme të jetës, cilatdo qofshin ato dhe sado të rënda qofshin. Si anëtarë të Kishës, na nxitin që të thellohemi te fjalët e Perëndisë të thëna nëpërmjet profetëve të Tij, të lashtë dhe të kohës. Nëpërmjet lutjes së sinqertë dhe të përlur ndaj Atit tonë Qiellor, ne mësojmë ta dallojmë zërin e Shpirtit të Shenjtë. Ne pranojmë thirrje që të shërbejmë, të japim mësim, të planifikojmë, të japim shërbesë dhe të administrojmë. Këto mundësi na lejojnë të rritemi në shpirt, mendje dhe në karakter.

Ato do të na ndihmojnë të përgatitemi që t’i bëjmë dhe t’i mbajmë besëlidhjet e shenjta që do të na bekojnë në këtë jetë dhe në jetën që do të vijë.

Ejani, Bashkohuni me Ne!

Ne i ftojmë të gjithë fëmijët e Perëndisë në mbarë botën, që të bashkohen me ne në këtë punë të madhërishtme. Ejani e shihni! Edhe gjatë kësaj kohe sfiduese nga virusi COVID-19, takohuni me ne nëpërmjet internetit. Takohuni me misionarët tanë nëpërmjet internetit. Zbulojeni vetë se cili është qëllimi i kësaj Kishë! Kur kjo kohë e vështirë të ketë kaluar, takohuni me ne në shtëpitë tona dhe në vendet tona të adhurimit!

Ne ju ftojmë që të vini dhe të ndihmoni! Ejani dhe shërbeni me ne, duke u dhënë shërbesë fëmijëve të Perëndisë, duke ndjekur gjurmët e Shpëtimtarit dhe duke e bërë këtë botë një vend më të mirë.


Ejani dhe kini përkatësi! Ju do të na bëni më të fortë. Dhe ju do të bëheni më të mirë, më të sjellshëm dhe më të lumtur gjithashtu. Besimi juaj do të thellohet dhe do të bëhet më i qëndrueshëm – më i aftë për t'u bërë ballë turbullirave dhe sprovave të paparashikuara të jetës.

Dhe si t'ia nisim? Ka shumë mënyra të mundshme.

Ne ju ftojmë që ta lexoni Librin e Mormonit. Nëse nuk keni një kopje, mund ta lexoni te faqja ChurchofJesusChrist.org⁴ ose të shkarkoni programin kompjuterik për Librin e Mormonit. Libri i Mormonit është një dëshmi tjetër e Jezu Krishtit dhe një shoqërues i Dhiatës së Vjetër dhe të Re. Ne i kemi për zemër të gjitha këto shkrime të shenjta dhe mësojmë prej tyre.

Ne ju ftojmë që të kaloni ca kohë te faqja EjaniTeKrishti.org për të zbuluar se çfarë japin mësim dhe besojnë anëtarët e Kishës.

Ftojini misionarët që të bisedojnë me ju në internet ose në privatësinë e shtëpisë suaj, aty ku është e mundur – ata kanë një mesazh shprese dhe



shërimi. Këta misionarë janë bijtë dhe bijat tona të çmuara, të cilët shërbejnë në shumë vende në mbarë botën nga koha dhe paratë e vetë atyre.

Në Kishën e Jezu Krishtit, do të gjeni një familje me njerëz që nuk janë dhe aq të ndryshëm nga ju. Do të gjeni njerëz të cilët kanë nevojë për ndihmën tuaj dhe që duan t'ju ndihmojnë teksa përpiqeni fort të bëheni varianti më i mirë i vetes suaj – personi që Perëndia ju krijoi të bëheni.

Përçafimi i Shpëtimtarit i Mbledh të Gjithë

Mund të jeni duke menduar: “Kam bërë shumë gabime në jetën time. Nuk jam i/e sigurt a mund të ndihem ndonjëherë sikur i përkas Kishës së Jezu Krishtit. Perëndisë nuk mund t'i interesojë dikush si unë.”

Jezu Krishti, edhe pse Ai është “Mbreti i mbretërve”⁵, Mesia, “Biri i Perëndisë të gjallë”⁶, përkujdeset thellësisht për secilin dhe çdonjërin prej fëmijëve të Perëndisë. Ai përkujdeset, pavarësisht nga rrethanat e një personi – se sa i varfër apo i pasur, se sa i papërsosur apo i sprovuar është dikush. Gjatë jetës së Tij në vdekshmëri, Shpëtimtari u dha shërbesë të gjithëve: të lumturve dhe të suksesshmëve, zemërthyerve dhe të humburve dhe atyre pa shpresë. Shpesh, njerëzit që Ai u shërbeu dhe u dha shërbesë nuk ishin individë me famë, me pamje të bukur apo me mirëqenie. Shpesh, njerëzit që Ai i ngriti moralisht nuk kishin çfarë të jepnin në këmbim përveç mirënjohjes,

një zemre të përlurur dhe dëshirës për të pasur besim.

Nëse Jezusi e kaloi jetën e tij në vdekshmëri duke u dhënë shërbesë “këtyre . . . më të vegjël[ve]” [njerëzve më të pavlerësuar], a nuk do t'i dojë Ai ata edhe sot? A nuk ka në Kishën e Tij një vend për të gjithë fëmijët e Perëndisë? Edhe për ata që ndihen të padenjë, të harruar apo të vetmuar?

Nuk ka asnjë nivel përsosurie që ju duhet ta arrini, me qëllim që të kualifikoheni për hirin e Perëndisë. Lutjet tuaja nuk kanë përse të thuhën me zë të lartë apo me fjalë të bukura ose gramatikisht të sakta me qëllim që të arrijnë qiellin.

Në të vërtetë, Perëndia nuk mban anësi⁸ – gjërat që bota i vlerëson, nuk kanë fare rëndësi për Të. Ai jua njeh zemrën dhe Ai ju do pavarësisht nga titulli juaj, nga vlera e pasurive financiare apo numri i ndjekësve në instagram.

Teksa e drejtojmë zemrën tek Ati ynë Qiellor dhe i afrohem më shumë Atij, ne do ta ndiejmë Atë të na afrohet⁹.

Ne jemi fëmijët e Tij të dashur.

Madje edhe ata që nuk e pranojnë Atë.

Madje edhe ata që, si një fëmijë kërkëfortë e i pabindur, zemërohen me Perëndinë dhe Kishën e Tij, mbledhin plaçkat dhe dalin furishëm nga dera duke thënë se po ikin dhe nuk do të kthehen më kurrë.

Kur një fëmijë ia mbath nga shtëpia, ai ose ajo mund të mos i vërë re prindërit e shqetësuar që vështrojnë nga dritarja. Me zemër të brishtë ata e shohin birin apo bijën e tyre të largohet – duke shpresuar që fëmija i tyre i çmuar do të mësojë diçka nga kjo përvojë që të këput shpirtin, dhe ndoshta do ta shohë jetën me sy tjetër – dhe si përfundim të kthehet në shtëpi.

Kështu është edhe me Atin tonë të dashur Qiellor. Ai po e pret kthimin tonë.

Shpëtimtari juaj, me lot dashurie dhe dhembshurie në sytë e Tij, e pret kthimin tuaj. Edhe kur ndiheni shumë larg Perëndisë, Ai do t'ju shohë; Ai do të ketë dhembshuri për ju dhe do të vrapojë që t'ju përqafojë¹⁰.

Ejani dhe kini përkatësi.

Perëndia na Lejon që të Mësojmë nga Gabimet Tona

Ne jemi udhëtarë që e përshkojmë udhën e vdekshmërisë në kërkimin e madh për kuptimin dhe të vërtetën përfundimtare. Shpesh, gjithçka që shohim është shtegu drejt, që kemi përpara – ne nuk mund të shohim se ku do të na shpien kthesat e rrugës. Ati ynë i dashur Qiellor nuk na ka dhënë çdo përgjigje. Ai pret nga ne që t'i zbulojmë vetë shumë gjëra. Ai pret nga ne që të besojmë – edhe kur është e vështirë që ta bëjmë këtë.

Ai pret nga ne që t'i mbajmë shpallullat drejt dhe të zhvillojmë pakëz vendosmëri – pakëz shtyllë kurrizore – dhe të hedhim më tej hapin tjetër.

Kjo është mënyra se si mësojmë dhe rritemi.

A do të donit vërtet që gjithçka të specifikohet deri në hollësi? A do të donit vërtet që të kishte përgjigje për çdo pyetje? Ta kishit të shënuar në hartë çdo vendmbërritje?

Besoj që shumica prej nesh do të lodheshin shumë shpejt nga ky lloj administrimi qiellor deri në hollësitë më të imta. Ne i marrim mësimet e rëndësishme të jetës nëpërmjet përvojës. Nëpërmjet mësimet nga gabimet tona. Nëpërmjet pendimit dhe kur e kuptojmë vetë se “ligësia kurrë nuk ka qenë lumturi”¹¹.

Jezu Krishti, Biri i Perëndisë, vdiq që gabimet tona të mund të mos na

dënojnë dhe të na e ndalojnë përgjithmonë përparimin. Për shkak të Tij, ne mund të pendohemi dhe gabimet tona mund të bëhen gurë kalimi drejt lavdisë më të madhe.

Nuk keni përse ta përshkoni të vetëm këtë udhë. Ati ynë Qiellor nuk na ka lënë të endemi në errësirë.

Kjo është arsyeja pse, në pranverën e vitit 1820, Ai iu shfaq me Birin e Tij, Jezu Krishtin, një të riu, Jozef Smithit.

Mendoni rreth kësaj për një çast! Perëndia i universit iu shfaq një njeriu!

Ky ishte i pari nga takimet e shumta që Jozefi pati me Perëndinë dhe me qenie të tjera qiellore. Shumë nga fjalët që këto qenie hyjnore i thanë atij, janë shënuar te shkrimet e shenjta të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ato mund t'i gjeni lehtësisht. Çdokush mund t'i lexojë ato dhe ta mësojë vetë mesazhin që Perëndia ka për ne në kohën tonë.

Ne ju ftojmë që t'i studioni vetë ato.

Jozef Smithi ishte fare i ri kur i mori këto zbuluesa. Shumica e zbulësive i erdhi përpara moshës 30-vjeçare¹². Atij i mungonte përvoja dhe disa njerëzve ai kishte gjasë t'u dukej i pakualifikuar për të qenë profeti i Zotit.

Dhe megjithatë, Zoti e thirri gjithësi – duke ndjekur një model që e gjejmë gjatë gjithë shkrimeve të shenjta.

Perëndia nuk priti derisa të gjente një njeri të përkryer për ta rivendosur ungjillin e Tij.

Nëse Ai do ta bënte, do të ishte ende duke pritur.

Jozefi ishte shumë i ngjashëm me ju dhe mua. Ndonëse Jozefi bëri gabime, Perëndia e përdori për të përmbushur qëllimet e Tij të madhërishe.

Presidenti Tomas S. Monson i përsëriti shpesh këto fjalë këshille: “Atë që Zoti e thërret, atë Zoti e kualifikon”¹³.

Apostulli Pal u dha këtë arsye shenjtorëve në Korint: “Shikoni në

fakt thirrjen tuaj, vëllezër [dhe motra], sepse ndër ju ka jo shumë të ditur sipas mishit, jo shumë të fuqishëm, jo shumë fisnikë”¹⁴.

Perëndia e përdor njeriun e pafuqishëm dhe të thjeshtë për të përmbushur qëllimet e Tij. Kjo e vërtetë mbetet si dëshmi, se është fuqia e Perëndisë, jo e njeriut, që e përmbush veprën e Tij mbi tokë¹⁵.

Dëgjojeni Atë, Ndiqeni Atë

Kur Perëndia iu shfaq Jozef Smithit, Ai e paraqiti Birin e Tij, Jezu Krishtin dhe tha: “Dëgjoje Atë”¹⁶.

Jozefi e kaloi pjesën e mbetur të jetës duke e dëgjuar Atë dhe duke e ndjekur Atë.

Ashtu si me Jozefin, dishepullimi ynë fillon me vendimin tonë për ta dëgjuar dhe për ta ndjekur Shpëtimtarin Jezu Krishtin.

Nëse dëshironi ta ndiqni Atë, mbli-dheni besimin dhe merrni mbi veten tuaj kryqin e Tij.

Ju do të zbuloni se *vërtet* keni përkatësi në Kishën e Tij – një vend për zemërsie dhe mikpritjeje ku mund të mblidheni në kërkimin e madh të dishepullimit dhe lumturisë.

Është shpresa ime se, në këtë vit të dyqindtë të Vegimit të Parë, tekta meditojmë dhe mësojmë për Rivendosjen e Kishës së Jezu Krishtit, ne do të kuptojmë se kjo nuk është vetëm një



Oslo, Norvegji



Nga Plaku L. Uitni Klejton,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

ngjarje historike. Ju dhe unë luajmë një pjesë thelbësore në këtë histori të madhërishtme e të vazhdueshme.

Atëherë, cila është pjesa juaj dhe e imja?

Ajo është të mësojmë për Jezu Krishtin. T'i studiojmë fjalët e Tij. Ta dëgjojmë Atë dhe ta ndjekim Atë duke marrë pjesë aktivisht në këtë vepër të madhe. Unë ju ftoj që të vini dhe të kini përkatësi!

Nuk keni përse të jeni të përsosur. Ju mjafton të keni vetëm një dëshirë për ta zhvilluar besimin tuaj dhe për t'iu afruar më shumë Atij çdo ditë.

Pjesa jonë është ta duam Perëndinë e t'i shërbejmë Atij dhe t'i duam fëmijët e Perëndisë e t'u shërbejmë atyre.

Teksa bëni kështu, Perëndia do t'ju mbështjellë me dashurinë, gëzimin dhe udhërrëfimin e Tij të sigurt gjatë kësaj jete, madje edhe në rrethanat më të vështira dhe më gjerë madje.

Për këtë unë dëshmoj dhe ju lë bekimin tim me mirënjohje dhe dashuri të thellë për secilin prej jush, në emrin e shenjtë të Shpëtimtarit tonë, Mësuesit tonë – në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Efesianëve 2:13–14.
2. Shih Lluka 4:18.
3. 2 Nefi 25:26.
4. Shih Librin e Mormonit te ChurchofJesus Christ.org/study/scriptures/bofm.
5. 1 Timoteut 6:15.
6. Shih Mateu 16:15–17.
7. Mateu 25:40.
8. Shih Veprat e Apostujve 10:34.
9. Shih Doktrina e Besëlidhje 88:63.
10. Shih reagimin e babait i cili sheh kthimin e djalit të tij plëngprishës te Lluka 15:20.
11. Alma 41:10.
12. Për shembull, nga 138 seksione të librit Doktrina e Besëlidhje, më shumë se 100 janë zbulues që Jozef Smithi i mori përpara se të mbushte 30 vjeç më 23 dhjetor 1835.
13. Thomas S. Monson, "Duty Calls", *Ensign*, maj 1996, f. 44.
14. 1 Korintasve 1:26.
15. Shih 1 Korintasve 1:28–29; 2 Korintasve 4:7.
16. Joseph Smith – Historia 1:17.

Shtëpitë më të Mira

Shpëtimtari është inxhinieri, ndërtuesi dhe mobiluesi i brendshëm i përsosur. Projekti i Tij është përsosja dhe gëzimi i përrjetshëm i shpirtave tanë.

Kohët e fundit një tabelë reklamash në Solt-Lejk-Siti më tërhoqi vëmendjen. Ajo reklamonte një kompani mobiluesh dhe projektimi ambientesh të brendshme. Ajo shpallte thjesht: "U Shërbejmë Shtëpive më të Mira në Solt-Lejk-Siti".

Mesazhi të mbetet në mendje – çfarë është një "shtëpi më e mirë"? E gjeta veten duke u menduar rreth asaj pyetjeje, veçanërisht në lidhje me fëmijët që bashkëshortja ime, Kethi, dhe unë rritëm dhe rreth fëmijëve që ata po rrisin sot. Ashtu si prindërit kudo, ne shqetësoheshim dhe luteshim për familjen tonë. Ne ende vazhdojmë ta bëjmë këtë. Me zell dëshirojmë pikërisht më të mirën për ta. Si mund të

jetojnë ata dhe fëmijët e tyre në shtëpitë më të mira? Kam menduar thellë për shtëpitë e anëtarëve të Kishës që Kethi dhe unë kemi pasur privilegjin të vizitojmë. Na kanë ftuar në shtëpi në Kore dhe Kenia, në Filipine dhe Peru, në Laos dhe në Letoni. Më lejoni të tregoj katër vëzhgime rreth shtëpive më të mira.

Së pari, nga këndvështrimi i Zotit, ngritja e shtëpive më të mira ka të bëjë shumë me cilësitë vetjake të njerëzve që jetojnë aty. Këto shtëpi nuk bëhen të mira në ndonjë mënyrë të rëndësishme apo afatgjatë nëpërmjet mobiluesve, apo nëpërmjet pasurisë monetare, apo pozitës shoqërore të njerëzve që i zotërojnë ato. Karakteristika më e mirë e çfarëdo shtëpie është imazhi i Krishtit i pasqyruar në banorët e shtëpisë. Ajo që ka rëndësi, është mobilimi i brendshëm i shpirtave të banorëve dhe jo vetë struktura.

Tiparet e Krishtit fitohen me "kalimin e kohës"¹ me anë të përparimit të qëllimshëm përgjatë shtegut të besëlidhjeve. Tiparet si të Krishtit e zburrojnë jetën e atyre që përpiqen fort të jetojnë me mirësi. Ato i mbushin shtëpitë me dritën e ungjillit, pavarësisht nëse dyshemeja është prej balte apo mermeri. Edhe nëse jeni i vetmi në vatrën tuaj familjare që ndjek urdhëresën



për t'i "kërk[uar] këto gjëra"², ju mund të kontribuoni për mobilimin shpirtëror të shtëpisë së familjes tuaj.

Ne e ndjekim këshillën e Zotit për ta "organiz[uar] veten [tonë]; përgatit[ur] çdo gjë të nevojshme; dhe ngrit[ur] një shtëpi" duke organizuar, përgatitur dhe ngritur jetën tonë shpirtërore, jo pronën tonë të patundshme. Teksa e ndjekim me durim shtegun e besëlidhjeve të Shpëtimtarit, shtëpia jonë bëhet "një shtëpi lavdie, një shtëpi rregulli [dhe] një shtëpi [e] Perëndisë"³.

Së dyti, banorët e shtëpive më të mira gjejnë kohë çdo ditë për t'i studiuar shkrimet e shenjta dhe fjalët e profetëve të gjallë. Presidenti Rasëll M. Nelson na ka ftuar që t'i "shndërr[ojmë]" dhe "rimodelojmë" shtëpitë tona nëpërmjet studimit të ungjillit.⁴ Ftesa e Tij vëren se në shtëpitë më të mira banon puna e dhembshur, jetike e rritjes vetjake dhe e rimodelimit të dobësive tona. Pendimi i përditshëm është një mjet shndërrues që na mundëson të bëhemi pak më të mirë, më të dashur dhe më të kuptueshëm. Studimi i shkrimeve të shenjta na afron me Shpëtimtarin, dashuria dhe hiri bujar i të cilit na ndihmojnë për rritjen tonë.

Bibla, Libri i Mormonit dhe Perla me Vlerë të Madhe tregojnë historitë e familjeve, prandaj nuk është e habitshme që ato vëllime hyjnore janë manuale të pakrahasueshme për të ndërtuar shtëpitë më të mira. Ato japin një kronikë të shqetësimeve të prindërve, rreziqeve të tundimit, triumfit të drejtësisë, sprovave të zisë së bukës e bollëkut, si dhe të tmerreve të luftës dhe shpërblimeve të paqes. Herë pas here shkrimet e shenjta na tregojnë se si familjet ia dalin me sukses nëpërmjet të jetuarit të drejtë dhe se si dësh-tojnë duke ndjekur shtigje të tjera.

Së treti, shtëpitë më të mira ndjekin projektin e krijuar nga Zoti për

shtëpinë e Tij më të mirë, tempullin. Ndërtimi i një tempulli fillon me hapat bazë – pastrimin e shkurreve dhe she-shimin e tokës. Ato përpjekje fillestare për të përgatitur tokën mund të krahasohen me zbatimin e urdhërimeve bazë. Urdhërimet janë themeli mbi të cilin ndërtohet dishepullimi. Dishepullimi i vazhdueshëm na çon drejt bërjes të vendosur, të qëndrueshëm dhe të patundur⁵, njësoj si skeleti i çeliktë për një tempull. Ky skelet i qëndrueshëm e lejon Zotin që të dërgojë Shpirtin e Tij për të ndryshuar zemrën tonë.⁶ Përditimi i një ndryshimi të madh të zemrës është si shtimi i veçorive të bukura brendësisë së një tempulli.

Ndërsa vazhdojmë me besim, Zoti na ndryshon gradualisht. Ne marrim shëmbëlltërinë e Tij në pamjen tonë dhe fillojmë të pasqyrojmë dashurinë dhe bukurinë e karakterit të Tij.⁷ Teksa bëhemi më shumë si Ai, ne do të ndihemi rehat në shtëpinë e Tij dhe Ai do të ndihet rehat në shtëpinë tonë.

Ne mund ta mbajmë lidhjen e ngushtë midis shtëpisë sonë dhe shtëpisë së Tij duke u kualifikuar për një rekomandim tempulli dhe duke e përdorur atë aq shpesh sa e lejojnë rrethanat. Ndërsa e bëjmë këtë, shenjtëria e Zotit do të qëndrojë edhe në shtëpinë tonë.

Tempulli madhështor i Solt-Lejkut qëndron këtu pranë. I ndërtuar nga pionierët me mjete të thjeshta pune, materiale vendore dhe punë të palodhur e të pafundme, tempulli u ndërtua nga viti 1853 deri në vitin 1893. Më e mira që mund të jepnin anëtarët e hershëm të Kishës në inxhinieri, arkitekturë dhe mobilim të brendshëm krijoi një kryevepër që njihet nga miliona njerëz.

Gati 130 vjet kanë kaluar që kur tempulli u përkushtua. Ashtu si vërejtje dje Plaku Geri E. Stivenson, parimet

inxhinierike që u përdorën për të projektuar tempullin, janë zëvendësuar nga standarde më të reja dhe më të sigurta. Dështimi për të përmirësuar ndërtesën e tempullit dhe për të riparuar dobësitë strukturore do të tradhtonte mirëbesimin e pionierëve, të cilët bënë gjithçka mundën dhe më pas ua lanë përkujdesjen për tempullin brezave pasues.

Kisha ka filluar një projekt restaurimi katërvjeçar për të përmirësuar forcën strukturore dhe sizmike të tempullit.⁸ Themelet, dyshemetë dhe muret do të përforcohen. Njohuria më e mirë inxhinierike në dispozicion sot do ta sjellë tempullin në standarde bashkëkohore. Ne nuk do të jemi në gjendje t'i shohim ndryshimet strukturore, por efektet e tyre do të jenë të vërteta dhe të rëndësishme. Në gjithë këtë punë, veçoritë e bukura të mobilimit të brendshëm të tempullit do të ruhen.

Ne duhet të ndjekim shembullin që po na jepet nga rinovimi i Tempullit të Solt-Lejkut, dhe të gjejmë kohë për të vlerësuar ndërtimin tonë sizmik shpirtëror për t'u siguruar që është i përditësuar. Vetëvlerësimi i herëpashershëm, së bashku me pyetjen drejtuar Zotit: "Çfarë më mungon tjetër?"⁹ mund ta ndihmojnë secilin prej nesh që të japim ndihmesë në ndërtimin e një shtëpie më të mirë.

Së katërti, shtëpitë më të mira janë streha ndaj stuhive të jetës. Zoti ka premtuar se ata që i zbatojnë urdhërimet e Perëndisë, "përparojnë në tokë"¹⁰. Begatia e Perëndisë është fuqia për të shkuar përpara pavarësisht nga problemet e jetës.

Në vitin 2002 unë mësova një mësim të rëndësishëm rreth problemeve. Gjatë kohës që isha në Asunsion të Paragvait, u takova me presidentët e kunjeve të qytetit. Në atë kohë, Paraguai po përballlej me një krizë të tmerrshme

financiare dhe shumë anëtarë të Kishës po vuanin dhe nuk ishin në gjendje të plotësonin nevojat e tyre. Nuk kisha qenë në Amerikën e Jugut që nga misi- oni im dhe nuk kisha qenë kurrë në Pa- raguai. Po shërbeja në atë Presidencë të Zonës vetëm prej disa javësh. I druajtur nga paaftësia ime për të dhënë udhë- rrëfim për ata presidentë të kunjeve, u kërkova atyre që të më tregonin vetëm atë që po shkonte mirë në kunjat e tyre. Presidenti i parë i kunjit më tregoi rreth gjërave që po shkonin mirë. Tjetri për- mendti gjëra që po shkonin mirë dhe pak probleme. Në kohën kur arritëm të presidenti i fundit i kunjit, ai përmendi vetëm një seri sfidash të ndërlikuara. Teksa presidentët e kunjeve shpjegu- an rëndësinë e situatës, u shqetësova gjithnjë e më shumë, gati u dëshpërova rreth asaj se çfarë duhej të thoja.

Pikërisht teksa presidenti i fundit i kunjit po mbaronte komentet e tij, një mendim më erdhi në mendje: “Plaku Klejton, bëju atyre këtë pyetje: ‘Presi- dentë, nga anëtarët në kunjat tuaja të cilët paguajnë një të dhjetë të plotë, paguajnë një ofertë bujare të agjërimit, i lartësojnë thirrjet e tyre në Kishë, me të vërtetë i vizitojnë familjet e tyre si mësues shtëpie apo mësuese vizitore¹¹ çdo muaj, zhvillojnë mbrëmje familja- re, i studiojnë shkrimet e shenja dhe bëjnë lutje familjare çdo ditë, sa prej tyre kanë probleme të cilat nuk mund t’i përballojnë dot vetë pa pasur nevo- jë që Kisha të ndërhyjë dhe t’i zgjidhë problemet e tyre për ta?”

Reagues ndaj nxitjes që kisha marrë, u bëra presidentëve të kunjeve atë pyetje.

Ata vështruan tek unë me një heshtje habitëse dhe më pas thanë: “Pues, *ninguno*” që do të thotë: “Epo, asnjë”. Pastaj më thanë se të gjithë anëtarët që i bënin të gjitha këto gjëra, nuk kishin probleme që nuk ishin të aftë t’i



Olmue, Marga Marga, Kili

zgjidhnin vetë. Përse? Sepse ata jetonin në shtëpitë më të mira. Jetesa e tyre besnike u siguroi atyre forcën, vegimin dhe ndihmën qiellore që u nevojiteshin në trazirën ekonomike që i rrethonte.

Kjo nuk do të thotë që të drejtët nuk do të sëmuren, nuk do të pësojnë aksidente, nuk do të përballen me zhvlerësime të biznesit apo nuk do të përballen me shumë vështirësi të tjera në jetë. Vdekshmëria gjithmonë sjell sfida, por herë pas here kam parë se ata që përpiqen fort t’u binden urdhërimeve, bekohen që të gjejnë një mënyrë për të ecur përpara me paqe dhe shpresë. Ato bekime janë në dispozicion për të gjithë.¹²

Davidi shpalli: “Në qoftë se Zoti nuk e ndërton shtëpinë, më kot lodhen ndërtuesit¹³”. Kudo që jetoni, çfarëdo pamjeje të ketë shtëpia juaj dhe cilado që të jetë përbërja e familjes suaj, ju mund të ndihmoni për të ndërtuar shtëpinë më të mirë për familjen tuaj. Ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit siguron planet për atë shtëpi. Shpëtimtari është inxhinieri, ndërtuesi dhe mobiluesi i brendshëm i përsosur. Projekti i Tij është përsosja dhe gëzimi i përjetshëm i shpirtave tanë. Me ndihmën e Tij të dashur; shpirti juaj mund të jetë gjithçka që Ai do që ai të jetë dhe ju mund të jeni varianti më i mirë i vetes suaj, të përgatitur për të themeluar dhe për të jetuar në një shtëpi më të mirë.

Unë me mirënjohje dëshmoj se Perëndia dhe Ati i ne të gjithëve jeton. Biri i Tij, Zoti Jezu Krisht, është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i të gjithë njerëzimit. Ata na duan përsosurisht. Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është mbretëria e Zotit në tokë. Profetë dhe apostuj të gjallë e udhërrëfejnë atë sot. Libri i Mormonit është i vërtetë. Ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit është projekti i përsosur për ngritjen e shtëpive më të mira. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Moisiu 7:21.
2. Nenet e Besimit 1:13.
3. Doktrina e Besëlidhje 88:119.
4. Shih Rasëll M. Nelson, “Të Bëhemi Shenjtorë Shembullorë të Ditëve të Mëvonshme”, *Liahona*, nëntor 2018, f. 113.
5. Shih 1 Nefi 2:10; Mosia 5:15; 3 Nefi 6:14.
6. Shih Mosia 5:2; Alma 5:7
7. Shih Alma 5:14, 19.
8. Një tërmet më 18 mars 2020 e shfaqti shumë qartë nevojën për të ndërmarrë projektin.
9. Mateu 19:20.
10. Mosia 2:22.
11. Mësimet e shtëpisë dhe vizitat mësimore nuk janë më në fuqi dhe dhënia e shërbesës është vënë në jetë në 2018-ën (shih Rasëll M. Nelson, “Dhënia e Shërbesës”, *Liahona*, maj 2018, f. 100).
12. Kur zgjedhim të mos jetojmë në përputhje me urdhërimet, atëherë bekimet e Zotit tërhiqen në njëfarë mase. Ky model i ripërsëritur, i parë në Librin e Mormonit, ndonjëherë njihet si cikli i drejtësisë dhe ligësisë (shih *Book of Mormon Student Manual [Manuali i Studentit për Librin e Mormonit]* [manuali i Sistemit Arsimit të Kishës, 2009], f. 414, ChurchofJesusChrist.org).
13. Psalmeve 127:1.



Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Shpërndarja e Mesazhit të Rivendosjes dhe Ringjalljes

Rivendosja i përket botës dhe mesazhi i saj është veçanërisht i ngutshëm sot.

Gjatë gjithë kësaj konference të përgjithshme ne kemi folur dhe kënduar me gëzim rreth përmbushjes së “ripërtëritjes së të gjitha gjërave”¹, të profetizuar shumë kohë më parë, rreth sjelljes në “një krye të vetëm, në Krishtin, të [të] gjitha gjëra[ve]”², rreth kthimit të plotësisë së ungjillit, të priftërisë dhe Kishës së Jezu Krishtit në tokë, të cilat të gjitha i përfshijmë në titullin “Rivendosja”.

Por Rivendosja nuk është vetëm për ata prej nesh që gjejnë gëzim në të sot. Zbulesat e Vegimit të Parë nuk ishin vetëm për Jozef Smithin, por i ofrohen si dritë dhe e vërtetë kujtdo që i “mungon urtia”³. Libri i Mormonit është në zotërim të njerëzimit. Ordinanat e priftërisë për shpëtimin dhe ekzaltimin u përgatitën për çdo individ, përfshirë ata që nuk banojnë më në vdekshmëri. Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe bekimet e saj synohen për të gjithë ata që i dëshirojnë ato. Dhurata e Frymës së Shenjtë është caktuar që të jetë për çdo njeri. Rivendosja i përket botës dhe mesazhi i saj është veçanërisht i ngutshëm sot.

“Kështu që, sa e madhe rëndësia që këto gjëra t’u bëhen të njohura banorëve të tokës, që ata të mund

të dinë se nuk ka mish që mund të banojë në prani të Perëndisë, veçse nëpërmjet meritave dhe mëshirës dhe hirit të Mesias së Shenjtë, i cili jep jetën e tij sipas mishit dhe e merr rishtas nëpërmjet fuqisë së Shpirtit, që ai të mund të shkaktojë ringjalljen e të vdekurve.”⁴

Që nga dita kur vëllai i Profetit, Samuel Smithi, e mbushi trastën e tij me kopje të saposhtypura të Librit të Mormonit dhe u nis në këmbë për të shpërndarë shkrimin e ri të shenjtë,

shenjtoret kanë punuar pa reshtur “që këto gjëra t’u[a] bëjnë të njohura banorëve të tokës”.

Në vitin 1920, Plaku Dejvid O. Mek-Kei, në atë kohë anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, filloi një turne njëvjeçar në misionet e Kishës. Në maj të vitit 1921, ai po qëndronte në një varrezë të vogël në Fagali të Samoas, përpara varreve të mbajtura mirë të tre fëmijëve të vegjël, bijës dhe dy djemve të Tomas dhe Sara Hiltonit. Këta vogëlushë – më i madhi ishte dy vjeç – vdiqën gjatë kohës kur Tomasi dhe Sara shërbyen si një çift i ri misionarësh në fund të viteve 1800.

Përpara se të largohej nga Juta, Plaku Mek-Kej i premtoi Sarës, që tani është e ve, se ai do t’i vizitonte varret e fëmijëve të saj në Samoa, pasi ajo kurrë nuk kishte mundur të kthehej atje. Plaku Mek-Kej i shkroi në kthim asaj: “Tre vogëlushët tuaj, Motra Hilton, me ndikim të madh edhe në heshtjen e tyre . . . vazhdojnë punën tuaj fisnike misionare që filloi gati tri-dhjetë vjet më parë”. Pastaj ai shtoi një strofë që e kishte shkruar vetë:



Blafdeil, Jutë, SHBA

*Nga duar të dashura, sytë e tyre të vdekur u mbyllën,
Nga duar të dashura, gjymtyrët e tyre të vogla u rregulluan,
Nga duar të huaja, varret e tyre të thjeshta u zbukuruan,
Nga të panjohurit u nderuan dhe nga të panjohurit u vajtuan.⁵*

Kjo histori është vetëm njëra nga mijëra, qindra mijërat, që flasin për kohën, thesarin dhe jetët që u sakrifkuan gjatë 200 viteve të fundit për të shpërndarë mesazhin e Rivendosjes. Aspirata jonë për të arritur te çdo komb, fis, gjuhë dhe popull nuk është zvogëluar sot, ashtu siç dëshmohe nga dhjetëra mijëra të rinj, të reja dhe çifte të cilët aktualisht shërbejnë në thirrje misioni me kohë të plotë; nga anëtarë të Kishës përgjithësisht, të cilët i bëjnë jehonë ftesës së Filipit për të ardhur dhe për të parë⁶; dhe nga miliona dollarë që shpenzohen çdo vit për ta mbështetur këtë përpjekje anembanë botës.

Ndërkohë që ftesat tona janë jodetyruese, ne shpresojmë se ato do t'u duken bindëse njerëzve. Që kjo të ndodhë, besoj se kërkohen të paktën tri gjëra: së pari, dashuria juaj; së dyti, shembulli juaj; dhe së treti, përdorimi nga ana juaj e Librit të Mormonit.

Ftesat tona nuk mund të jenë një çështje e interesit vetjak; përkundrazi, ato duhet të jenë shprehje e një dashurie vetëmohuese.⁷ Kjo dashuri, e njohur si dashuri hyjnore, dashuria e pastër e Krishtit, është e jona për ta kërkuar. Neve na ftojnë, madje na urdhërojnë, që t'i "lut[emi] Atit me gjithë fuqinë e zemrës [onë], që të mbush[em]i me këtë dashuri"⁸.

Si shembull, po jap një përvojë që tregohet nga Motra Lanet Ho Çing, që aktualisht shërben me bashkëshortin e saj, Presidentin Frensis Ho Çing, i cili



ZËRI I PIETRI, JAKOBIT DHE GJOMIT, NGA LINDA CURLEY CHRISTENSEN DHE MICHAEL T. MALMI

kryeson në Misionin e Samoas, Apia. Motra Ho Çing tregon:


“Vite më parë, familja jonë e re u shpërngul në një shtëpi të vockël në Laie të Havait. Streha e vendpërkimit të makinës në shtëpinë tonë ishte shndërruar në një apartament me vetëm një dhomë kryesore, ku jetonte një burrë me emrin Xhonatan. Xhonatani kishte qenë fqinji ynë në një vend tjetër. Duke menduar se nuk ishte rastësi fakti që Zoti na kishte bashkuar, vendosëm që të ishim më të hapur rreth veprimtarive dhe anëtarësisë sonë në Kishë. Xhonatani kënaqej nga miqësia jonë dhe i pëlqente shumë të kalonte kohë me familjen tonë. Atij i pëlqente që të mësonte për ungjillin, por nuk ishte i interesuar që t'i përkushtohej Kishës.

Me kalimin e kohës, fëmijët filluan ta thërrisnin Xhonatanin me nofkën ‘xhaxhi Xhonatani’. Teksa familja jonë vazhdoi të rritej, kështu u rrit edhe interesi i Xhonatanit për ndodhitë tona. Ftesat tona për festa gjatë ditëve të pushimit, ditëlindje, ngjarje shkollore

dhe veprimtari të Kishës u zgjeruan në ftesa për mbremje familjare dhe pagëzimet e fëmijëve.

Një ditë, mora një telefonatë nga Xhonatani. Kishte nevojë për ndihmë. Ai vuante nga diabeti dhe kjo i kishte krijuar një infeksion të rëndë në këmbë, që kërkonte prerjen e saj. Familja jonë dhe anëtarët e lagjes në Kishë që i kishim fqinjë, qëndruan krahu tij gjatë gjithë kohës së sprovës. Ne shkonim me radhë në spital dhe atij iu dhanë bekime priftërie. Ndërkohë që Xhonatani po rehabilitohej, me ndihmën e motrave të Shoqatës së Ndihmës, ne pastruam apartamentin e tij. Vëllezërit e priftërisë ndërtuan një platformë të tatëpjetë te pragu i derës dhe doreza që të mbahej në banjë. Kur Xhonatani u kthye në shtëpi, u mbush me emocion.

Xhonatani filloi t'i merrte sërish mësimet nga misionarët. Javën përpara Vitit të Ri, ai më telefonoi dhe më pyeti: ‘Çfarë do të bëni për Vit të Ri?’ I kujtova festën tonë të përvitshme. Por në vend të kësaj, ai u përgjigj: ‘Dua që të vini në pagëzimin tim! Dua ta filloj



në mënyrën e duhur këtë vit të ri.’ Pas 20 vjetësh të ftesave ‘eja e shiko’, ‘eja e ndihmo’ dhe ‘eja e qëndro’, ky shpirt i çmuar ishte gati të pagëzohej.

Në vitin 2018, kur u thirrëm të ishim president i misionit dhe shoqërujesja e tij, shëndeti i Xhonatanit po përkeqësohej. Iu përgjyruam që të qëndronte i fortë në pritje të kthimit tonë. Ai vazhdoi për gati një vit, por Zoti po e përgatiste që të kthehej në shtëpi. Ai ndërroi jetë paqësisht në prill 2019. Bijat e mia morën pjesë në varrimin e ‘xhaxhi Xhonatanit’ të tyre dhe kënduan të njëjtën këngë që kënduam në pagëzimin e tij.”

E paraqes kërkesën e dytë për shpërndarjen me sukses të mesazhit të Rivendosjes me këtë pyetje: Çfarë është ajo gjë që do ta bëjë ftesën tuaj tërheqëse për dikë? A nuk është vetja juaj, shembulli i jetës suaj? Shumë njerëz që e kanë dëgjuar dhe pranuar mesazhin e Rivendosjes fillimisht u tërhoqën nga perceptimet e tyre rreth një anëtari ose anëtarëve të Kishës së Jezu Krishtit. Mund të ketë qenë mënyra se si ata i trajtonin të tjerët, gjërat që thanë ose nuk i thanë, qëndrueshmëria që shfaqën në situata të vështira, apo thjesht shprehja e fytyrës së tyre.⁹

Cilado qoftë, ne nuk mund t’i shpëtojmë faktit se kemi nevojë t’i kuptojmë dhe t’i jetojmë parimet e ungjillit të rivendosur sa më mirë që mundemi, në mënyrë që ftesat tona të jenë

tërheqëse. Është diçka që sot përmendet shpesh si vërtetësi. Nëse dashuria e Krishtit banon brenda nesh, të tjerët do ta dinë se dashuria jonë për ta është e çiltër. Nëse drita e Shpirtit të Shenjtë digjet brenda nesh, ajo do të rindezë Dritën e Krishtit brenda tyre.¹⁰ Ajo që ju jeni, do t’i japë vërtetësi ftesës suaj që të vijë për të përjetuar gëzimin e plotësisë së ungjillit të Jezu Krishtit.

Kërkesa e tretë është përdorimi i shpeshtë i mjetit të kthimit në besim, të cilin Perëndia e caktoi për këtë periudhë të fundit ungjillore, Librin e Mormonit. Ajo është një provë konkrete e thirrjes profetike të Jozef Smithit dhe provë bindëse e natyrës hyjnore dhe Ringjalljes së Jezu Krishtit. Shpjegimi në libër i planit të Atit tonë Qiellor për shëlbimin është i pasqor. Kur e shpërndani Librin e Mormonit, ju shpërndani Rivendosjen.

Kur Xheison Olseni ishte adoleshent, ai u paralajmërua vazhdimisht nga pjesëtarët e familjes dhe të tjerët që të mos bëhej i krishterë. Sidoqoftë, ai kishte dy miq të mirë, të cilët ishin anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, dhe ata shpesh diskutonin për fenë. Miqtë e tij, Shea dhe Dejvi, i kundërshtuan me respekt argumentet që të tjerët i kishin dhënë Xheisonit kundër besimit të Jezu Krishti. Më në fund, ata i dhanë një kopje të Librit të Mormonit, duke thënë: “Ky libër do t’u japë

përgjigje pyetjeve të tua. Të lutemi, lexoje atë.” Ai e pranoi me ngurrim librin dhe e futi në çantën e shpinës, ku qëndroi atje për disa muaj. Ai nuk donte ta linte në shtëpi ku familja e tij mund ta shihte dhe nuk donte t’i zhgënjente Shean dhe Dejvin duke ua kthyer atë. Më në fund, ai arriti në zgjidhjen që ta digte librin.

Një natë, me një çakmak në njërin dorë dhe Librin e Mormonit në dorën tjetër, ai qe gati t’i vinte flakën librit kur dëgjoi një zë në mendjen e tij që i tha: “Mos e digj librin tim”. I trembur, ndaloi. Më pas, duke menduar se e kishte përfytyruar zërin, ai u përpoq sërish që të ndizte çakmakun. Sërish, në mendjen e tij erdhi zëri: “Shko në dhomën tënde dhe lexoje librin tim”. Xheisoni e largoi çakmakun, u kthye në dhomën e tij të gjumit, e hapi Librin e Mormonit dhe filloi ta lexonte. Vazhdoi ditë pas dite, shpesh deri në orët e para të mëngjesit. Kur Xheisoni arriti në fund të librit dhe u lut, ai shënoi: “U mbusha me Shpirtin nga maja e kokës deri në fund të këmbëve. . . . U ndjeva plot dritë. . . . Ishte përvoja më e gëzueshme që kisha pasur ndonjëherë në jetën time”. Ai kërkoi të pagëzohej dhe më vonë u bë vetë misionar.

Ndoshta nuk kam nevojë ta them se pavarësisht nga dashuria dhe sinqeriteti i vërtetë, shumë, në mos shumica e ftesave tona për të shpërndarë mesazhin e Rivendosjes, do të refuzohen. Por mbajeni mend këtë: çdo njeri është i denjë për një ftesë të tillë – “të gjithë janë njësoj para Perëndisë”¹¹; Zoti është i kënaqur me çdo përpjekje që bëjmë, pavarësisht nga rezultati; një ftesë e refuzuar nuk është arsye që shoqëria jonë të marrë fund; dhe mungesa e interesit sot shumë mirë mund të kthehet në interes nesër. Pavarësisht nga kjo, dashuria jonë mbetet e pandryshueshme.



Le të mos harrojmë se Rivendosja ka dalë nga prova dhe sakrifica të mëdha. Kjo është një temë për një ditë tjetër. Sot ne gëzohemi në frytet e Rivendosjes, ku njëra nga më të shquarat është fuqia që të lidhemi edhe një herë në tokë e në qiell.¹² Siç u shpreh vite më parë nga Presidenti Gordon B. Hinkli: “Nëse asgjë tjetër nuk do të dilte nga gjithë pikëllimi, puna e rëndë dhe dhembja e rivendosjes përveçse fuqia vulosëse e priftërisë së shenjtë për t’i lidhur së bashku familjet përgjithmonë, do t’ia vlente e gjithë çfarë ajo ka kushtuar”¹³.

Premtimi përfundimtar i Rivendosjes është shëlbimi nëpërmjet Jezu Krishtit. Ringjallja e Jezu Krishtit është prova se Ai, në fakt, zotëron fuqi për t’i shëlbuar të gjithë ata që do të vijnë tek Ai – për t’i shëlbuar ata nga pikëllimi, padrejtësia, keqardhja, mëkati, madje dhe vdekja. Sot është e diela e Palmave; si sot një javë është Pashkë. Ne kujtojmë, gjithmonë e kujtojmë, vuajtjen dhe vdekjen e Krishtit që të shlyente për mëkatet tona, dhe ne kremtojmë të dielën më të mrekullueshme, ditën e

Zotit, në të cilën Ai u ngrit së vdekuri. Për shkak të Ringjalljes së Jezu Krishtit, ka kuptim Rivendosja, ka kuptim jeta jonë e vdekshme dhe përfundimisht ka kuptim vetë ekzistenca jonë.

Jozef Smithi, profeti i madh i Rivendosjes, ofron dëshminë më të rëndësishme të kohës sonë për Krishtin e ringjallur: “Se ai jeton! Sepse ne e pamë atë, madje në të djathtën e Perëndisë.”¹⁴ I shtoj përlësisht dëshminë time asaj të Jozefit dhe të apostujve dhe profetëve para tij dhe të apostujve dhe profetëve që e kanë pasuar atë, se Jezusi i Nazaretit është Mesia i premtuar, Biri i Vetëmlindur i Perëndisë dhe Shëlbuesi i ringjallur i gjithë njerëzimit.

“Ne dëshmojmë se ata që me lutje e studiojnë mesazhin e Rivendosjes dhe veprojnë me besim, do të bekohen të fitojnë vetë dëshminë e tyre

për hyjninë e saj dhe qëllimin e saj për ta përgatitur botën për Ardhjen e Dytë të premtuar të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.”¹⁵ Ringjallja e Krishtit i bën të sigurta premtimet e Tij. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Veprat e Apostujve 3:21.
2. Efesianëve 1:10.
3. Jakob [Bibël] 1:5.
4. 2 Nefi 2:8.
5. Dejvid O. Mek-Kei, letër drejtuar Sara M. Hiltonit, 3 qershor 1921, Biblioteka e Historisë së Kishës, Solt-Lejk-Siti.
6. Gjoni 1:46.
7. Shih 1 Gjoni 4:18.
8. Moroni 7:48.
9. Presidenti Dejvid O. Mek-Kei vërejtje: “Çdo person që jeton në këtë botë zotëron ndikim, qoftë për mirë apo për keq. Nuk është vetëm ajo që ai thotë, nuk është vetëm ajo që ai bën. Është ajo që ai është. Çdo njeri, çdo person e rrezaton atë që ai ose ajo është” (*Teachings of Presidents of the Church: David O. McKay* [2003], f. 227).
10. Shih Gjoni 1:9; Doktrina e Besëlidhje 88:6–13; 93:2.
11. 2 Nefi 26:33.
12. Shih Mateu 16:19; 18:18; Doktrina e Besëlidhje 110:14–16; 132:19, 46.
13. Gordon B. Hinckley, “As One Who Loves the Prophet”, në Susan Easton Black dhe Charles D. Tate, Jr., bot., *Joseph Smith: The Prophet, the Man* (1993), f. 6.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 76:22–24.
15. “Rivendosja e Plotësisë së Ungjillit të Jezu Krishtit: Një Proklamata në Dyqindvjetor drejtuar Botës”, 5 prill 2020, në Rasëll M. Nelson, “Dëgjoje Atë”, *Liahona*, maj 2020, f. 91.



Sendi, Jutë, SHBA



Nga Presidenti Rasëll M. Nelson,
*President i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve
të Ditëve të Mëvonshme*

Shkoni Përpara me Besim

Ju bekoj me paqe dhe shtim të besimit të Zotit.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, ndërsa vijmë në fundin e kësaj konference historike, ne i shprehim mirënjohjen tonë Zotit. Muzika ka qenë madhështore dhe mesazhet frymëzuese.

Gjatë kësaj konference, kemi përjetuar shumë çaste kulmore. Në këtë përvjetor të dyqindvjetorit, kemi paraqitur një proklamim drejtuar botës që shpall realitetin e Rivendosjes së ungjillit të Jezu Krishtit në plotësinë e tij.

E përkujtuam Rivendosjen me Thirrjen Hosana.

I hoqëm velin një simboli të ri që përfaqëson besimin tonë të Zotit Jezu Krisht, dhe për njohjen pamore të informacionit dhe materialeve zyrtare të Kishës.

Kemi bërë thirrje për një ditë botërore agjërimi dhe lutjeje, që pandemia e tanishme të mund të kontrollohet, që kujdestarët e shëndetit të mbrohen, ekonomia të forcohet dhe jeta të normalizohet. Ky agjërimit do të zhvillohet të Premten e Mirë, më 10 prill. Ç'është premtja e madhërishme do të jetë ajo!

Të dielën tjetër është e diela e Pashkës, kur do të përkujtojmë sërish Shlyerjen dhe Ringjalljen e Zotit tonë Jezu Krisht. Për shkak të Shlyerjes së Tij, dhurata e Tij e ringjalljes do t'u vijë të gjithë atyre që kanë jetuar. Dhe dhurata e Tij e jetës së përjetshme do t'u vijë të gjithë atyre që kualifikohen nga besnikëria ndaj ordinancave dhe besëlidhjeve të bëra në tempujt e Tij të shenjtë.

Përbërësit e shumë frymëzues të kësaj konference të përgjithshme të prillit 2020 – dhe java e shenjtë që fillojmë tani – mund të përmbledhen nga dy fjalë të dekretuara hyjnisht: “Dëgjoje Atë”¹. Ne lutemi që nga gjithçka që ka ndodhur, përqendrimi juaj tek Ati Qiejllor, i cili i tha ato fjalë, dhe te Biri i Tij i Dashur, Jezu Krishti, të mbizotërojë më së shumti në kujtesën tuaj. Lutemi që ju do të filloni sërish t'i dëgjoni, t'i mbani vesh e t'u kushtoni vëmendje *vërtet* fjalëve të Shpëtimtarit.² Ju pretoj se kjo do të pasohet nga pakësimi i frikës dhe shtimi i besimit.

Ju faleminderit për dëshirën që keni për t'i bërë shtëpitë tuaja shenjtërore të vërteta besimi, ku Shpirti i Zotit të mund të banojë. Programi ynë mësimor për studimin e ungjillit, *Eja, Më Ndiq*, do të vazhdojë ta bekojë

jetën tuaj. Përpjekjet tuaja të qëndrueshme për këtë sipërmarrje – edhe gjatë atyre çasteve kur ndieni se nuk jeni veçanërisht të suksesshëm – do të ndryshojnë jetën tuaj, atë të familjes suaj dhe të botës. Ne do të forcohem teksa bëhemi dishepuj edhe më trima të Zotit, duke u ngritur e duke folur për Të, kudo qofshim.

Tani le të flasim rreth tempujve. Kemi 168 tempujt të përkushtuar anembanë botës. Të tjerë janë në faza të ndryshme të planifikimit dhe ndërtimit. Kur njoftojmë planet për të ngritur një tempull të ri, ai bëhet pjesë e historisë sonë të shenjtë.

Mund të duket e çuditshme të njoftohen tempujt të rinj kur të gjithë tempujt tanë janë të mbyllur për pak kohë.

Më shumë se një shekull më parë, Presidenti Uillford Udraf i parashikoi kushte të tilla si tonat sot, sikurse shënohet në lutjen e tij përkushtuese të Tempullit të Solt-Lejkut, të bërë në vitin 1893. Disa nga ju mund të kenë parë së fundi disa pjesë të shkoputur nga kjo lutje mbresëlënëse në median shoqërore.

Dëgjojini këto lutje nga një profet i fuqishëm i Perëndisë: “Kur njerëzit e Tu të *mos* e kenë mundësinë për



të hyrë në këtë shtëpi të shenjtë . . . dhe të jenë të shtypur e në telashe, të rrethuar nga vështirësitë . . . dhe ta kthejnë fytyrën drejt kësaj, shtëpisë Sate të shenjtë, dhe të Të kërkojnë Ty çlirim, ndihmë dhe që fuqia Jote të shpaloset në emër të tyre, ne Të përgjrohemi Ty të vështrosh poshtë nga banesa Jote e shenjtë me mëshirë . . . e t'i dëgjosh thirrjet e tyre për ndihmë. Ose kur fëmijët e njerëzve të Tu, në vitet që do të vijnë, të ndahen nga ky vend për çfarëdo arsye, . . . dhe të Të bëjnë thirrje nga thellësia e brengës dhe hidhërimit të tyre për t'u dhënë lehtësim e çlirim, ne Të lutemi përlulesisht Ty që . . . t'i dëgjosh thirrjet e tyre për ndihmë e t'u dhurosh bekimet që do të kërkojnë.”³

Vëllezër dhe motra, gjatë kohëve të ankthit *tonë* kur tempujt *janë* mbyllur, ju mundeni ende të keni qasje te fuqia e besëlidhjeve tuaja të tempullit dhe të dhurimit tuaj teksa i nderoni besëlidhjet tuaja. Ju lutem, përdoreni këtë kohë kur tempujt janë të mbyllur që të vazhdoni të jetoni një jetë me denjësi për në tempull ose që të bëheni të denjë për në tempull.

Flisni rreth tempullit me familjen dhe miqtë tuaj. Për shkak se Jezu Krishti është në qendër të gjithçkaje që bëjmë në tempull, teksa mendoni më shumë rreth tempullit, do të jeni duke menduar më shumë rreth Tij. Studioni dhe lutuni për të mësuar më shumë rreth fuqisë dhe njohurisë që ju është dhuruar – ose që do t’ju dhurohet.

Sot kemi kënaqësinë të njoftojmë planet për të ndërtuar tetë tempuj të rinj në vendndodhjet vijuese: Baia-Blanka, Argjentinë; Tallahesi, Florida; Lubumbashi, Republika Demokratike e Kongos; Pitsburg, Pensilvani; Benin-Siti, Nigeri; Sirakjuz, Jutë; Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe në Shangai, Republika Popullore e Kinës.



FORCAT E DËRITËS DHE TË ERRESËS NGA WARREN LUCH, ME MIRËSINË E MUZEUT TË HISTORËSË KISHËS

Në të teta vendndodhjet, arkitektët e Kishës do të punojnë me drejtues vendorë në mënyrë që tempulli të jetë në harmoni me secilin komunitet dhe të jetë një shtesë e bukur në të.

Plani për një tempull në Dubai vjen në përgjigje të ftesës së tyre dashamirëse, të cilën e përshëndetim me mirënjohje.

Konteksti i planit për Shangain është shumë i rëndësishëm. Për më shumë se dy dekada, anëtarët e denjë për në tempull në Republikën Popullore të Kinës kanë frekuentuar Tempullin e Hong-Kongut në Kinë. Por në korrik 2019, ai tempull u mbyll për restaurimin planifikuar prej kohësh e shumë të nevojshëm.

Në Shangai, një shtëpi mbledhjeje e thjeshtë shumëqëllimshë do të sigurojë një mënyrë që anëtarët kinezë të vazhdojnë të marrin pjesë në ordinancat e tempullit – në Republikën Popullore të Kinës – për ta dhe paraardhësit e tyre.⁴

Në çdo vend, kjo Kishë u mëson anëtarëve të saj që ta nderojnë, t’i binden e ta mbështetin ligjin.⁵ Ne e japim

mësim rëndësishëm e familjes, të të qenit prindër të mirë e qytetarë shembullorë. Për shkak se i respektojmë ligjet dhe rregulloret e Republikës Popullore të Kinës, Kisha *nuk* dërgon misionarë predikues atje; as tani nuk do ta bëjë.

Bashkësitë e emigrantëve dhe ato kineze do të vazhdojnë të mbledhen të shkëputura nga njëra-tjetra. Statusi ligjor i Kishës atje mbetet *i pandryshuar*. Në një fazë fillestare të përdorimit të godinës, hyrja do të bëhet vetëm duke lënë takim. Shtëpia e Zotit në Shanghai *nuk* do të jetë një vend turistik për turistët nga vende të tjera.

Këta tetë tempuj të rinj do t’ua bekojnë jetën shumë njerëzve në të dyja anët e velit të vdekjes. Tempujt janë një pjesë kurorëzuese e Rivendosjes së plotësisë së ungjillit të Jezu Krishtit. Në mirësinë dhe bujarinë e Tij, Perëndia



Taipei-Siti I Ri, Tajvan

po i afron më shumë bekimet e tempullit me fëmijët e Tij *ngado*.

Teksa Rivendosja vazhdon, e di se Perëndia do të vazhdojë të zbulojë shumë gjëra të mëdha e të rëndësishme lidhur me mbretërinë e Tij këtu në tokë.⁶ Ajo mbretëri *është* Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Të dashur vëllezër e motra, shpreh dashurinë time për ju. Gjatë kësaj kohe tensioni e pasigurie dhe duke i bërë thirrje autoritetit që mbaj, do të doja t'ju jepja një bekim apostolik.

Ju bekoj me paqe dhe shtim të besimit të Zotit.⁷

Ju bekoj me dëshirë për t'u përduruar e për t'u bërë pakëz më tepër si Ai çdo ditë.⁸

Ju bekoj që ta dini se Profeti Jozef Smith është profeti i Rivendosjes së ungujllit të Jezu Krishtit në plotësinë e tij.

Nëse do të ketë sëmundje mes jush ose njerëzve tuaj të dashur, ju lë një bekim shërimi, në përputhje me vullnetin e Zotit.

Ju bekoj kështu, duke e shtuar edhe një herë shprehjen e dashurisë sime për çdonjërin prej jush, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Joseph Smith – Historia 1:17; shih edhe Lluca 9:35.
2. Shih Gjoni 10:27; Zbulesa 3:20; Mosia 26:21, 28; Doktrina e Besëlidhje 29:7.
3. Wilford Woodruff, lutja përkushtuese e Tempullit të Solt-Lejkut, 6 prill 1893, ChurchofJesusChrist.org; theksimi i shtuar.
4. Për mijëra vjet, populli kinez i ka mbajtur shënim historinë e klaneve dhe gjenealogjitë. Ceremonitë tradicionale kineze shfaqin respekt për paraardhësit e tyre, të tilla si Festivali i Kingmingut (清明节). Festivali i Kingmingut i këtij viti (清明节) që lënë më 4–5 prill.
5. (Shih Nenet e Besimit 1:12.)
6. Shih Nenet e Besimit 1:9.
7. Shih Gjoni 14:27.
8. Shih 3 Nefi 27:27.

Raporti Statistikor, 2019

Për informimin e anëtarëve të Kishës, Presidenca e Parë ka nxjerrë raportin statistikor që vijon, mbi rritjen dhe gjendjen e Kishës deri më 31 dhjetor 2019.

NJËSI TË KISHËS

Kunje	3 437
Misione	399
Distrikte	542
Lagje dhe Degë	30 940

ANËTARËSIA E KISHËS

Numri i anëtarësisë në total	16 565 036
Fëmijë të vegjël shtuar në dokumente	94 266
Të kthyer në besim të pagëzuar	248 835

MISIONARË

Misionarë Kohëplotë	67 021
Misionarë me Shërbim në Kishë	31 333

TEMPUJ

Tempuj të Përkushtuar gjatë vitit 2019 (Romë, Itali; Kinshasë, Republika Demokratike e Kongos; Fortaleza, Brazil; Port-o-Prens, Haiti; Lisbonë, Portugali; dhe Arekipa, Peru)	6
Tempuj të Ripërkushtuar gjatë vitit 2019 (Memfis, Tenesi; Oklahoma-Siti, Oklahoma; Okland, Kaliforni; Ralei, Karolina e Veriut; Frankfurt, Gjermani; Asunsion, Paraguai; dhe Baton-Ruzh, Luizianë)	7
Tempuj në Funkionim në Fund të Vitit	167



Plaku Horhe T. Besera

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Plaku Horhe T. Besera ishte i turpshëm dhe i ndrojtur teksa rritej, por presidenti i misionit i dha atij mundësi për të udhëhequr. Horheja u kthye në shtëpi nga Misioni i Kalifornisë, Arkadia me një dëshirë që të përfshihej në punën e Zotit për tërë jetën.

Mundësi të tjera udhëheqjeje erdhën edhe më shpejt nga ç'e priste. Në moshën 27 vjeç, ai u thirr në peshkopatë. Në moshën 32 vjeç, u thirr si peshkop. Fillimisht u ndje i papërshtatshëm kur njerëzit i drejtoheshin me sfidat e tyre.

“Nuk e kam idenë se çfarë po bëj”, i tha babait të vet.

Përgjigjja e të atit i dha një mësim të fuqishëm, i kujtoi besimin që kishte pasur tek ai presidenti i tij i misionit dhe e ndihmoi të përgatitej për thirrje të ardhshme udhëheqjeje, përfshirë thirrjen si president kunji në moshën 37-vjeçare.

“Babai më tha: ‘Bir, çfarë moshe ka Fryma e Shenjtë?’” s'oli ndërmend Plaku Besera. “Ky ishte një çast i rëndësishëm mësimdhënieje për mua ngaqë e dija se mund të bëja çdo gjë që Zoti më kërkonte.”

Ai mësim i ka qëndruar parasysh Plakut Besera gjatë shumë viteve të shërbimit me gjithë zemër në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Horhe Eduardo Tores Besera iu lindi Huan C. Beserës dhe Selia T. Beserës, më 18 dhjetor 1962 në Solt-Lejku-Siti të Jutës në SHBA, ku edhe u rrit.

Pasi shërbeu në një mision kohëplotë, Plaku Besera u martua me Debi Ilej Shnebergërin në Tempullin e Solt-Lejkut më 10 gusht 1984. Ata janë prindër të pesë fëmijëve.

Plaku Besera mori një diplomë universitare për studime të përgjithshme në Universitetin e Jutës dhe një diplomë për financë në Kolegjin Komunitar të Solt-Lejkut. Ai gjithashtu studioi për biznes në Universitetin e Feniksit. Në vitin 1998 u bë partner i Allegis Advisor Group, një kompani këshillimore financiare. Në kohën kur mori thirrjen si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë, ai po punonte si këshilltar investimesh për kompaninë Intermountain Financial Partners.

Plaku Besera ka shërbyer si president i Të Rinjve të lagjes, këshilltar në një presidencë misioni, këshilltar në një presidencë dege, mësues seminari, këshilltar në peshkopatë, peshkop, president kunji dhe president i Misionit të Kalifornisë, Arkadia. Në kohën e thirrjes së tij, ai po shërbente si I Shtatëdhjetë Zonal. ■



Plaku Methju S. Holland

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Plaku Methju S. Holland nuk është i panjohur për Autoritetet e Përgjithshme ose për konferencat e përgjithshme.

Shumë shenjtore të ditëve të mëvonshme e njohin atë si birin e Plakut Xhefri R. Holland, të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Të tjerë mund ta mbajnë mend si 17-vjeçari që po fliste gjatë sesionit të priftërisë së konferencës së përgjithshme të prillit 1983.

“Ka qenë një bekim i mrekullueshëm, gjatë gjithë jetës sime, që të shoh se si kanë jetuar mami dhe babi im, gjërat ndaj të cilave janë zotuar dhe gjërat që u janë kërkuar të bëjnë”, tha Plaku Holland, i cili aktualisht kryeson mbi Misionin e Karolinës së Veriut, Ralei.

“Prapëseprapë, për shkak të këtyre vëzhgimeve të drejtpërdrejta, ne dimë shumë për këtë thirrje që të mendojmë se jemi të pajisur siç duhet për të”, shtoi ai. “Për fat të mirë, gjithashtu kemi mësuar se Zoti i kualifikon ata që Ai i thërret dhe ne po marrim shumë besim e ngushëllim nga kjo gjë.”

Plaku Holland mban mend se të folurit në konferencën e përgjithshme ishte i frikshëm. Përgatitja e një mesazhi i cili më së fundi erdhi “rresht pas rreshti, parim pas parimi” (2 Nefi 28:30), u bë “një bekim i hershëm e që i dha siguri për të ditur se kur i pranon caktimet nga Zoti, Ai do të të ndihmojë dhe do të të japë mendime e mbresa për gjëra që nevojitet të thuhet”.

Methju Skot Hollandi lindi më 7 qershor 1966 në Provo të Jutës në SHBA, biri i Xhefri R. dhe Patrishia Hollandit. Ai u martua me Peixh Bejtmanin më 20 maj 1996, në Tempullin e Seint-Xhorxhit në Jutë. Ata janë prindër të katër fëmijëve.

Arritjet arsimore të Plakut Holland përfshijnë tri diploma për shkencat politike – një diplomë universitare nga Universiteti “Brigam Jang” në vitin 1991, një diplomë pasuniversitare dhe doktoratë në filozofi, që të dyja nga Universiteti Djuk përkatësisht në vitet 1997 dhe 2001.

Ndërkohë që punonte si profesor i asociuar për shkencat politike tek UBJ-ja (2001–2009), ai u emërua si president i Universitetit Juta Velli në vitin 2009, duke shërbyer deri në thirrjen e tij në vitin 2018 si president misioni.

Ai ka shërbyer si peshkop, këshilltar i lartë, këshilltar në peshkopatë, këshillues i Të Rinjve të lagjes, udhëheqës i misionit të lagjes, mësues i Shkollës të së Dielës dhe misionar kohëplotë në Misionin e Edinburgut në Skoci. ■



Plaku Uilliam K. Xhekson

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Pas 23 vjetësh si drejtues rajonal mjekësor në Shërbimin e Punëve të Jashtme të SHBA-së, Uilliam K. Xheksonit i kërkuan të tregonte 20 përvojat më të rëndësishme që kishte pasur tekta jetonte dhe punonte në krahinat më të pazhvi-luara të botës.

Ndërkohë që vriste mendjen për atë kërkesë përpara ceremonisë për daljen e tij në pension, ai e kuptoi se “që të gjitha 20 përvojat e [tij] nga 20 përvojat më të rëndësishme ishin të lidhura me Kishën ose familjen”, tha ai.

Uilliam King Xheksoni iu lindi E. Uilliamit dhe Lois Andrei Xheksonit, më 29 mars 1956 në Uashington D.K. të SHBA-së. Ai u rrit në Ohai të Kalifornisë në SHBA, por për shkak të punës vullnetare të prindërve, ai gjithashtu mori shkollim në Honduras, Algjeri dhe Afganistan.

Pasi shërbeu një mision në Misionin e La Pazit në Bolivi, Plaku Xhekson u takua me En Keslerin në verën e vitit 1977.

“Ishte dashuri me shikimin e parë për mua”, tha ai. “E kalova pjesën tjetër të verës duke u përpjekur ta bindja se unë isha i vetmi për të.”

Ata u martuan më 29 dhjetor 1977 në Tempullin e Los Anxhelosit në Kaliforni. Ata janë prindërit e tetë fëmijëve, tre prej të cilëve janë të birësuar – nga India, Nepali dhe Kamboxhia.

Plaku Xhekson ndoqi Universitetin “Brigam Jang”, mori një diplomë universitare nga Universiteti i Kalifornisë në Bërkli dhe mori diplomë si doktor i mjekësisë në Universite- tin e Kalifornisë në San-Fransisko në vitin 1983.

Pas stazhit mjekësor të tij, ata punuan jashtë SHBA-së për 26 vjet. Më së fundi, ai punonte si drejtor mjekësor i organi- zatës Valley Family Health Care, me vendndodhje në Ajdaho dhe Oregon të SHBA-së.

Kur jetonin jashtë Shteteve të Bashkuara, ai dhe Motra Xhekson e kalonin shumicën e kohës së tyre mes anëtarëve të Kishës që ishin brezi i parë i anëtarëve në familjet e tyre.

“Njëra nga pjesët më të mëdha të dëshmisë sime për un- gjillin ka qenë të shoh atë që ungjilli u bën këtyre njerëzve që ne i duam”, tha ai. “I ndryshon ata.”

Plaku Xhekson ka shërbyer si I Shtatëdhjetë Zonal, pre- sident i Misionit të Indisë, Nju-Delhi, president i Të Rinjve të degës, mësues instituti dhe mësues i Doktrinës së Ungjillit. Në kohën e thirrjes së tij për të qenë Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë, ai po shërbente si peshkop. ■



Plaku Xheremi R. Jagi

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Kur Plaku Xheremi R. Jagi ishte adoleshent, motra e tij shtatëvjeçare, Kristeni, u sëmur nga një bakter që ia dëmtoi trurin. Mjekët thanë se ajo nuk do të mbijetonte.

Xheremiu i ri ra në gjuhë pranë shtratit të tij në dhomën e familjes në Solt-Lejk-Siti të Jutës në SHBA dhe iu përgjë- rua Zotit që të dinte përse ajo duhej të vdiste kaq e vogël. Sidoqoftë, motra e tij mori një bekim të priftërisë dhe jetoi.

Ky ishte një katalizator për Xhereminë 17-vjeçar që të “ishte në rregull me Perëndinë”, duke e bërë atë të lexonte seriozisht Librin e Mormonit për herën e parë. Më vonë ai shërbeu si misionar kohëplotë në Misionin e Ohajos, Klivland.

Vite më vonë, Xheremiu do të binte në gjuhë, në lutje të ndier në zemër ndërkohë që bashkëshortes së tij, Emit, i kishin filluar para kohe dhembjet e lindjes për fëmijën e tyre të tretë. “Në atë çast, ndjeva një paqe gjithëpushtuese – një paqe që mund të përshkruhet vetëm kur krahët e dashurisë së një Ati Qiellor më rrethuan me ngrohtësinë e Frymës së Shenjtë”, tha ai.

Ajo paqe e shoqëroi gjatë kohës së shkurtër që jetoi foshnja dhe muajve të pikëllimit që pasuan pas një ndër- prerjeje tjetër shtatzënie. “Ne të gjithë vihemi në provë sipas mënyrës sonë”, tha ai, “por ne ende e ‘konsidero[jmë] një gëzim të madh’ [Jakob [Bibël] 1:2] që Shpëtimtari ka siguru- ar një udhë që ne të kemi paqe e lumturi.”

Xheremi Robert Jagi iu lindi Robert Stenli Jagit dhe Xhudi En Rusit më 23 mars 1973 në Solt-Lejk-Siti të Jutës, në SHBA. Ai u martua me Emi En Stjuartin në Tempullin e Solt-Lejkut, më 12 qershor 1995. Ata janë prindër të pesë fëmijëve.

Plaku Jagi mori një diplomë universitare për shkencën e sjelljes dhe shëndetit nga Universiteti i Jutës dhe një diplo- më pasuniversitare ekzekutive për administrim biznesi nga Universiteti i Pepërdajnit. Ai po drejtonte shitjet krahinore për kompaninë Alkermes dhe po administronte pasuritë e patundshme tregtare te kompania HCA Investments në kohën e thirrjes së tij.

Plaku Jagi ka shërbyer si I Shtatëdhjetë Zonal, president i Misionit të Jutës, Ogden, ndihmësekretar ekzekutiv i kunjit, peshkop, president i kuorumit të pleqve, mësues seminari, këshilltar në presidencën e Të Rinjve të lagjes, mësues i për- gatitjes së misionarëve për kunjin dhe udhëheqës misioni për lagjen. ■



Plaku Kelli R. Xhonson

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Plaku Kelli R. Xhonson e mban mend mirë ditën kur u thirr si peshkop në moshën 31-vjeçare. Po atë ditë ai u diagnostikua me paralizën e Bellit – një gjendje në të cilën muskujt e njëres ane të fytyrës paralizohen ose dobësohen.

Ishte një kohë sfiduese, jo vetëm për shkak të sikletit dhe turpfit të shkaktuar nga gjendja, por edhe për shkak të shumë prej përgjegjësive të tij të reja. Por ajo kohë e vështirë u bë një bekim.

“Duke mos e ditur se cila do të ishte situata në një periudhë afatgjatë, unë zhvillova dhembshuri për individët, që më ka mbetur për tërë pjesën tjetër të jetës sime”, tha ai. “Vërtet mësova se njerëzit kalojnë përmes gjërave të vështira e të trishtuara, jashtë kontrollit të tyre, të cilat kanë ndikim mbi aftësitë, ndjenjat dhe vetëbesimin e tyre.”

Nganjëherë nuk është e lehtë të shërbesh në Kishën e Zotit. Por ashtu si dishepujt e Shpëtimtarit që “i lanë menjëherë rrjetat” (Mateu 4:20) për ta ndjekur Atë, “çfarëdo që na kërkohet të bëjmë, ne jemi të gatshëm ta bëjmë”, tha Plaku Xhonson.

Pavarësisht se ku e thërret Zoti atë ose familjen e tij, ata shkojnë me zemra dhe mendje të gatshme, duke u përpjekur të gjejnë të mirën pavarësisht nga rrethanat e tyre.

Kelli Rei Xhonsoni iu lindi Harold Rejmond Xhonson të Riut dhe Helen Kragun Xhonsonit, më 16 janar 1963 në Plezënt-Vju të Jutës. Ai u rrit në Ogden të Jutës dhe u martua me Teresa Lin Bartrëmin në Tempullin e Solt-Lejkut më 27 mars 1986. Ata kanë pesë fëmijë.

Plaku Xhonson u diplomua në Universitetin Shtetëror Uibër në vitin 1987 me një diplomë universitare për financë dhe mori diplomën e tij pasuniversitare për administrim biznesi nga Universiteti “Brigam Jang” në vitin 1989. Ai ka punuar si financier hetues për kompaninë KPMG International Cooperative dhe në kohën më të fundit punoi si financier hetues dhe partner për firmën “Norman, Townsend dhe Johnson”.

Plaku Xhonson, që po shërbente si I Shtatëdhjetë Zonal në kohën e thirrjes së tij, ka shërbyer si president misioni në Misionin e Tajlandës, Bangkok, ku shërbeu gjatë misionit të tij kohëplotë, dhe si president kunji, këshilltar në presidencë kunji, këshilltar i lartë, peshkop, president i kuorumit të pleqve, udhëheqës i misionit të lagjes dhe mësues për përgatitjen e misionarëve të kunjit. ■



Plaku Tieri K. Mutombo

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Plaku Tieri K. Mutombo pati një dëshmi të fortë për ungjillin kur mori thirrjen për në mision kur ishte djalë i ri. I pagëzuar me familjen kur ishte 10 vjeç, ai kishte dëshmuar mënyrën e fuqishme se si ungjilli e ndryshoi familjen e tij.

Por edhe ndërsa përgatitej që të shërbente një mision në Misionin e Bregut të Fildishtë, Abixhan, ai nuk kishte dëshmi të fortë për Librin e Mormonit. Nuk e kishte lexuar kurrë më parë.

Peshkopi i frymëzuar i Tierit e sfidoi ta lexonte Librin e Mormonit çdo ditë përpara se të largohej për në mision. Ai madje i dha Tierit një çelës për shtëpinë vendore të mbledhjeve të Kishës që të mund të studionte në paqe.

Tieri lexoi çdo ditë për tre muaj. Në kohën kur hyri në fushën e misionit, jo vetëm që kishte fituar dëshmi të fortë për Librin e Mormonit, por gjithashtu kishte zhvilluar zakone studimi që e ndihmuan si misionar.

“Mjeti më i shkëlqyer që kemi për t’i sjellë njerëzit te drita e ungjillit dhe për ta mbledhur Izraelin e shpërndarë, është Libri i Mormonit”, tha ai.

Tieri Kasuangi Mutombo iu lindi Antuan Kasuangi Mutombos dhe Mari Teres Matsanga Mutombos, më 31 janar 1976 në Kinshasë të Republikës Demokratike të Kongos. Ai u martua me Tshaji Natali Sindan në një ceremoni civile më 29 nëntor 2002. Ata u vulosën më vonë në Tempullin e Johannesburgut në Afrikën e Jugut më 19 nëntor 2004. Ata kanë gjashtë fëmijë.

Plaku Mutombo u diplomua në vitin 2010 në Universitetin e Kepromadit me një diplomë universitare për administrim biznesi dhe në vitin 2012 me një diplomë universitare për administrim të burimeve njerëzore. Ai punoi për Kishën në Republikën Demokratike të Kongos si administrator i Sektorit të Historisë Familjare dhe Burimeve Njerëzore dhe si mbikëqyrës i Sektorit të Administrimit të Materialeve.

Në kohën e thirrjes së tij si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë, Plaku Mutombo po shërbente si president i Misionit të Merilendit, Baltimorë në SHBA. Më parë ai shërbeu si president kunji, këshilltar në presidencë kunji, udhëheqës i misionit të lagjes, mësues i Shkollës të së Dielës dhe sekretar ekzekutiv i kunjit. ■



Plaku Adejinka A. Oxhediran

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Konferenca e përgjithshme e prillit 2020 ishte “një fundjavë e paharrueshme” për Plakun Adejinka A. Oxhediran.

I kthyeri në besimin në Kishë u mbështet si Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë – hera e parë për një shenjtor të ditëve të mëvonshme nigerian dhe afrikan-perëndimor. Mirënjohja dhe gëzimi i tij i jashtëzakonshëm u rritën edhe më shumë kur Presidenti Rasëll M. Nelson shpalli se tempulli i tretë në Nigeri do të ndërtohet në qytetin e Beninit.

“Nuk e prisja këtë”, tha Plaku Oxhediran, me një buzëqeshje të madhe. “Ta dëgjoja profetin tonë të thoshte se një tempull tjetër do të ndërtohet në Nigeri, ishte vërtet, vërtet e mrekullueshme. Për mua, ishte një pohim se puna e Zotit po lëviz me te shpejtë. Ne të gjithë kemi shumë për të bërë që t’i përgatitim fëmijët e Perëndisë për Ardhjen e Dytë të Birit të Tij.”

I lindur në Ibadan të Nigerisë më 5 prill 1967, me prindër Amos Adenijin dhe Karolina Anike Oxhediran, Adejinka Aiodeji Oxhedirani mori diplomën universitare për botanikë nga Universiteti i Ilorinit në vitin 1991 përpara se të merrte më vonë një diplomë pasuniversitare për administrim biznesi nga Universiteti i Teknologjisë “Ladoke Akintola”. Ai vazhdoi një karrierë në financë dhe administrim biznesi si një kontabilist profesionist me specializim të gjerë. Ai po punonte si një drejtor finance për biznesin e Shell-it në Nigeri përpara thirrjes së tij si Autoritet i Përgjithshëm.

Tre vjet pas pagëzimit të tij, ai u takua me Olufunmilajo Omolola Akinbexhen në një mbledhje shoqërore. Ata të dy më pas filluan të dilnin në takime, por punësimi në qytete të ndryshme do të thoshte që “ne lidheshim vetëm me anë të telefonit”.

Çifti më së fundi u martua në Nigeri në vitin 1998 dhe u vulos në Tempullin e Johannesburgut në Afrikën e Jugut më 14 nëntor 2002. Çifti Oxhediran ka një vajzë.

Plaku Oxhediran është mirënjohës për çdo thirrje që ka marrë në Kishë që nga koha kur u bashkua me Kishën në vitin 1990 kur ishte 23 vjeç. Çdo detyrë e caktuar kishtarë e ka ndihmuar të rritet dhe i ka dhënë atij mundësi të shenjta për t’i ndihmuar të tjerët të zhvillohen në thirrjet dhe detyrat e tyre përkatëse.

Plaku Oxhediran, që po shërbente si I Shtatëdhjetë Zonal në kohën e thirrjes së tij, gjithashtu ka shërbyer si këshilltar në një presidencë misioni, president kunji, këshilltar në një presidencë kunji, peshkop, këshilltar në peshkopatë dhe president dege. ■



Plaku Siro Shmail

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Plaku Siro Shmail gjithmonë është përpjekur fort që të jetë i bindur ndaj Zotit, edhe kur ai nuk e kuptoi arsyen për një urdhërim të veçantë. “Kur jemi të bindur, kur i zbatojmë urdhërimet”, ka mësuar ai, “Zoti do të na bekojë gjithmonë.”

Gjatë përmbushjes së thirrjeve të tij, ai ka parë bekimet që vijnë prej bindjes. Teksa shërbente si peshkop dhe president dege, ai pati shumë mundësi të çmuara që të “shihte njerëz ta ndryshonin jetën e tyre për shkak të dëshmisë së tyre për Shpëtimtarin dhe Librin e Mormonit”.

Plaku Shmail iu lindi Bruno dhe Erika Shmailit, që të dy të kthyer në besimin në Kishë, më 16 prill 1971 në Ponta-Grosa të Paraná në Brazil. Ai u rrit në Kuribita të Brazilit dhe rreth kohës që prindërit e tij u thirrën të kryesonin mbi Misionin e Brazilit, Kampinas, ai u largua që të shërbente në Misionin e Jutës, Ogden.

Teksa frekuentonte Universitetin e Jutës, Plaku Shmail u takua me Alesandra Makado Louzën, një studente në Universitetin “Brigam Jang”, në një takim shpirtëror. “Kur u takuam për herën e parë në takimin shpirtëror, ajo më shpërfilli tërësisht”, tha ai. Por për të, ishte dashuri me shikimin e parë.

Ata u martuan në Tempullin e San-Paolos në Brazil, në korrik të vitit 1994 dhe i përfunduan studimet e tyre në Shtetet e Bashkuara. Ata u kthyen në Brazil për 20 vjet përpara se të zhvendoseshin në Kolorado të SHBA-së dhe më pas në Florida të SHBA-së. Plaku dhe Motra Shmail janë prindërit e dy fëmijëve.

Plaku Shmail mori një diplomë universitare për arkitekturë nga Universiteti i Jutës në vitin 1995 dhe një diplomë pasuniversitare ekzekutive për administrim biznesi nga Universiteti i Ohajos në vitin 2010. Ai ka punuar për rrjetin e dyqaneve Walmart në Brazil si zëvendëspresident dhe drejtor i zhvillimit të pasurive të patundshme, si drejtues kryesor i veprimeve për Scopel-in, si administrator i përgjithshëm i qytetit Sia dhe më së fundi si kreu i pasurive të patundshme për kompaninë JBS S.A.

Plaku Shmail ka shërbyer si I Shtatëdhjetë Zonal, president kunji, këshilltar në një presidencë kunji, peshkop, president i kuorumit të pleqve dhe president dege. ■



Plaku Moses Vijanueva

Autoritet i Përgjithshëm I Shtatëdhjetë

Ai ishte vetëm 10 vjeç në atë kohë, por Plaku Moses Vijanueva kurrë nuk e ka harruar mënyrën se si u ndje kur misionarët ua dhanë mësim ungjillin atij dhe familjes së tij në Oahaka të Meksikës.

“E kujtoj Shpirtin që ata lanë, paqen që ndjeva në zemër”, tha ai.

Kur Mosesi u pagëzua me katër prej motrave e vëllezërve të tij, nëna e vet – si prind i vetëm që po rriste Mosesin dhe shtatë fëmijë të tjerë në rrethana të vështira – u bë sërish aktive në Kishë.

Më vonë, kur Mosesi 18-vjeçar po përgatitej për misionin e tij, familja e vet vazhdoi të përballej me sfida materiale. Ai kishte dyshime për vendimin e tij që të shkonte në mision dhe i tha nënës se donte të qëndronte në shtëpi për ta ndihmuar.

“Nëse vërtet dëshiron të më ndihmosh”, i tha ajo, “shko dhe shërbeji Zotit.”

I gjuhëzuar pranë shtratit të tij portativ në mbarim të ditës së tij të parë në Misionin e Meksikës, Hermosijo, Mosesi ndjeu se Zoti ishte i kënaqur me vendimin e tij. Ai ia jep misionit meritën për rritjen e dëshmisë së tij për ungjillin e rivendosur.

“Kjo Kishë udhëhiqet nga Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti”, tha Plaku Vijanueva. “Ai e njuh secilin prej nesh me emër. Ai i di nevojat tona, sfidat tona dhe shqetësimet tona. Ai gjithashtu i di anët tona të forta dhe madje dëshirat e zemrave tona.”

Moses Vijanueva Lopes iu lindi Ruben Vijanueva Platasit dhe Delfina Lopes Domingesit më 13 dhjetor 1966, në Oahaka të Meksikës. Ai u martua me Letisia Avalos Losanon në Tempullin e Meksiko-Sitit në Meksikë më 30 qershor 1995. Ata kanë tre fëmijë.

Plaku Vijanueva mori një diplomë universitare për administrim biznesi nga Universiteti Krahinor Juglindor në vitin 1997 dhe një diplomë pasuniversitare për risi në përmirësimin e biznesit nga Universiteti Teknologjik i Montereit në vitin 2011. Kohët më të fundit ai punoi si drejtori ekzekutiv kryesor i Sertehas, një kompanie transporti.

Në kohën e thirrjes së tij, Plaku Vijanueva po shërbente si I Shtatëdhjetë Zonal në Meksikë. Ai ka shërbyer edhe si president i Misionit të Kalifornisë, Arkadia dhe si këshilltar i lartë, këshilltar në presidencë kunji, peshkop dhe drejtor i çështjeve publike. ■



Stiven J. Land

President i Përgjithshëm i Të Rinjve

Si Presidenti i ri i Përgjithshëm i Të Rinjve, Stiven J. Landi ka pranuar një detyrë të shenjtë për të ndihmuar që të udhërrëfehen qindra mijëra djem të rinj, të moshës së Priftërisë Aarone në një Kishë mbarëbotërore.

Nëse do të ishte e mundur të takohej një për një me secilin prej tyre, ai e di saktësisht se çfarë do të thoshte: “Që të jesh një anëtar i suksesshëm i mbretërisë së Perëndisë nuk është e ndërlikuar. Ati Qiellor të do. Thjesht nevojitet që edhe ti ta duash Atë. Dhe nëse e bëjmë këtë gjë, ne do të jemi të sigurt e të lumtur. . . . Jeta jonë do të ketë njëfarë kuptimi.”

Marrja e Kishës me seriozitet nuk ndodh vetëm të dielën. Është një mundësi e përditshme, sipas avokatit që është bërë drejtues biznesi.

“Leximi i shkrimeve të shenjta, vajtja në kishë, pendimi sapo të kemi dalë nga udha e drejtë, të folurit për ungjillin dhe të qenit një shembull i ungjillit – ky është plani i Atit tonë Qiellor”, tha ai.

Vëllai Land iu lindi Xhej dhe Toi Ellën Landit, më 30 tetor 1953 dhe u rrit si në Kaliforninë e Veriut (Santa-Rosa) ashtu edhe në Kaliforninë e Jugut (Long-Biç), SHBA. Shërbimi i tij në Ushtrinë e SHBA-së e çoi sërish në Europë, një kontinent që ai kishte arritur ta donte gjatë shërbimit të tij në Misionin e Hollandës, Amsterdam.

Pasi e mbaroi shërbimin ushtarak, ai u regjistrua në Universitetin “Brigam Jang”, ku u takua sërish me Kejllin Kërkun, një të re me të cilën ishte njohur ndërkohë që ishte i vendosur si ushtar në Gjermani. Stiveni dhe Kejllina së fundmi u martuan në Tempullin e Solt-Lejkut më 8 gusht 1980. Ata janë prindër të katër fëmijëve.

Pasi mori diplomën për juridik në UBJ, Vëllai Land punoi si avokat përpara se të bëhej më së fundi presidenti dhe drejtori ekzekutiv i kompanisë Nu Skin Enterprises. Ai është aktualisht kryetari ekzekutiv i kryesisë së drejtorëve të kompanisë. Ai është edhe anëtar këshilli i Sistemit të Arsimit të Lartë të Jutës.

Vëllai Land ka shërbyer si president i Misionit të Atlantas, Xhorxhia dhe si bashkërendues i Komitetit për Përkushtimin e Tempullit të Provo-Siti-Sentërit. Ai gjithashtu ka shërbyer si anëtar i kryesisë së përgjithshme të Të Rinjve dhe si I Shtatëdhjetë Zonal. ■



Ahmad S. Korbit

*Këshilltar i Parë në Presidencën e
Përgjithshme të Të Rinjve*

Ahmad S. Korbiti, 57 vjeç, iu lindi Xhejms Ērl Korbitit dhe Amelia Korbitit në gusht të vitit 1962. Familja ishte e varfër dhe jetonte në lagjet e programit social të strehimit të Filadelfias në Pensilvani të SHBA-së, e rrethuar nga krimi dhe dhuna e bandave. Nuk kishte siguri të udhëtoje nga një lagje në tjetrën.

Por mbresat shpirtërore të nënës së tij i udhërrëfyen 10 fëmijët e saj dhe i mbajtën ata të sigurt. Vetvetiu ajo e dinte se kur duhej të luanin jashtë fëmijët dhe kur duhej të qëndronin brenda.

Ishte ajo ndjeshmëri shpirtërore që më vonë e bëri t'i ftone në shtëpinë e saj misionarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Gjatë shumicës së fëmijërisë dhe rinisë së vet, Ahmadi dhe familja e tij kishin adhuruar bashkë me lëvizjen Kombi i Islamit dhe më pas ai u pagëzua si protestant. Por tani ai ndjeu dashurinë e bashkësisë vendore të shenjtorëve të ditëve të mëvonshme.

Nëna e tij dhe disa nga vëllezërit e motrat u pagëzuan në muajin në vazhdim. Më 16 gusht 1980, në ditëlindjen tij të 18-të, edhe Ahmadi hyri në ujërat e pagëzimit. Njerku i tij, Henri Brendford Kempbelli, u bashkua me Kishën vitin pasardhës.

“Nuk ishte merita jonë”, tha ai. “Ishte e Perëndisë dhe asaj që Ai donte që të bënim. Ishim të gatshëm që të ishim të përlulur dhe të hapur. Ai na udhëhoqi përgjatë udhës.”

Pasi ndoqi Kolegjin Riks dhe shërbeu në Misionin e Porto-Rikos në San-Huan nga viti 1982 deri në 1984, ai u takua me Xhejn Xhoslinin në një udhëtim për në tempull me të rinj në moshë madhore beqarë. Çifti u martua më 24 gusht 1985, në Tempullin e Uashington DK-së dhe ata janë prindër të gjashtë fëmijëve.

Për nëntë vitet që pasuan, ai punoi gjatë ditës dhe ndoqi shkollën gjatë natës, duke marrë diploma nga Kolegji Riçard Stokton në Nju-Xhersi dhe Fakulteti Juridik i Universitetit Ratgërs.

Ai ka shërbyer si këshilltar në një presidencë kunj, si president kunj, këshilltar i lartë dhe president i Misionit Lindor të Santo-Domingos në Republikën Domenikane.

Vëllai Korbit punoi si avokat gjyqësor, në marrëdhëniet publike dhe si drejtor i Zyrës së Nju-Jorkut të Kishës për Çështjet Publike dhe Ndërkombëtare. Ai është aktualisht i punësuar nga Sektori i Misionarëve i Kishës. ■



Bredli R. Uilkoks

*Këshilltar i Dytë në Presidencën e
Përgjithshme të Të Rinjve*

Ndërkohë që merrte pjesë në një konferencë rinie në Kaliforni, Bredli (Bred) R. Uilkoks u takua me një të ri i cili nuk donte të ishte atje. Ai u bashkua me adoleshentin nën hijen e një peme dhe shpejt po diskutonin temën e parapëlqyer të të riut – skejtboardin.

Vëllai Uilkoks i kërkoi të riut që t'i tregonte disa nga lëvizjet në skejtboard. Ngaqë i la mbresa, ai e ftoi të riun që të bënte një demonstrim skejtboardi në programin Enkas për Rininë (EFY) atë verë. I ri u ngurroi, por më së fundi ra dakord. Tek EFY-ja, ai pati një përvojë që ia ndryshoi jetën dhe gjeti dëshminë e tij për ungjillin.

“Ai shkoi tek EFY-ja me një skejtboard, por u largua si misionar”, tha Vëllai Uilkoks.

“E kam kaluar jetën me fëmijë dhe adoleshentë”, tha Vëllai Uilkoks, “dhe e dua rininë.”

Bredli Rei Uilkoksi iu lindi Rei T. Uilkoksit dhe Val C. Uilkoksit më 25 dhjetor 1959, në Provo, Jutë, SHBA. Ai u rrit në Provo me përjashtim të kalimit të pak viteve të fëmijërisë në Etiopi.

Pasi shërbeu në një mision kohëplotë në Misionin e Kilit në Vinja-del-Mar, Vëllai Uilkoks u martua me Debora Ganellin në Tempullin e Provos në Jutë më 7 tetor 1982. Ata janë prindër të katër fëmijëve.

Vëllai Uilkoks ka diploma universitare dhe pasuniversitare nga Universiteti “Brigam Jang” dhe doktoratë në fushën e arsimit nga Universiteti i Uajomit. Vëllai Uilkoks është ndërruar me disa çmime për punën e tij në arsim, i ka kushtuar më shumë se 30 vjet programit Enkas për Rininë të UBJ-së dhe i pëlqen shumë të jetë instruktor në Javën e Edukimit në Kompleksin Universitar.

Vëllai Uilkoks dhe familja e tij kanë jetuar në Zelandën e Re dhe në Spanjë, ndërkohë që ai drejtonte programet e studimit jashtë shtetit për UBJ-në. Ai ka shkruar disa libra dhe aktualisht është profesor në Sektorin e Shkrimeve të Shenjta, të Lashta të UBJ-së.

Vëllai Uilkoks ka shërbyer si president i Misionit Lindor të Kilit në Santiago dhe si anëtar i kryesisë së përgjithshme të Shkollës të së Dielës, si këshilltar në një presidencë kunj dhe peshkop i një lagjeje për të rinjtë e të rejtat në moshë madhore beqarë. Në kohën kur mori thirrjen e tij, ai po shërbente si këshilltar i lartë dhe si president i Të Rinjve të kunjit. ■



Çaste të Shënuara nga Konferenca

Siç premtoi Presidenti Rasëll M. Nelson, kjo konferencë e përgjithshme ishte e paharrueshme në shumë mënyra.¹ Këtu janë disa prej çasteve të shënuara të konferencës.

Simboli i Ri

Presidenti Nelson shpalli një simbol të ri për Kishën (shih faqen 73). Simboli përfshin emrin e Kishës të futur brenda një drejtkëndori që përfaqëson një gur të qoshes. Mbi të qëndron një statujë “Kristus” nën një hark, që na kujton për Shpëtimtarin dhe varrin e Tij të zbrazët.

Proklamata në Dyqindvjetor

Presidenti Nelson lexoi dokumentin “Rivendosja e Plotësisë së Ungjillit të Jezu Krishtit: Një Proklamata në Dyqindvjetor drejtuar Botës”, e cila i fton njerëzit kudo qofshin që të mësojnë se ungjilli i Jezu Krishtit, për të cilin flitet në Dhiatën e Re, është përsëri në tokë sot. Përkthimi zyrtar mund të gjendet brenda kapakut të përparmë të këtij botimi në 12 gjuhë. Anëtarët që ende

po presin për një përkthim zyrtar, mund të gjejnë përkthime paraprake të proklamatës në bisedën e Presidentit Nelson (shih faqen 91).

Kuvendi Solemn

Një “kuvend solemn” u mbajt në mëngjesin e së dielës si pjesë e kremtimit nga Kisha të dyqindvjetorit të Vegimit të Parë. Gjatë kësaj mbledhjeje të shenjtë, Presidenti Nelson i udhëhoqi shenjtoret në Thirrjen Hosana, një shprehje e bashkuar përlëvdimi, e përdorur në ngjarje të veçanta si përkushtimi i tempujve (shih faqen 92).

Agjërimi i Dytë Mbarëbotëror

Për herë të dytë brenda nëntë ditëve, Presidenti Nelson e ftoi botën për të agjëruar e për t’u lutur “që pandemia e tanishme të mund të kontrollohet, që kujdestarët e shëndetit të mbrohen, ekonomia të forcohet dhe jeta të normalizohet” (faqe 74). Ky agjërime i dytë mbarëbotëror ndodhi në të Premten e Mirë më 10 prill 2020.

Tempujt e Rinj

Presidenti Nelson njoftoi plane për të ndërtuar tetë tempuj të rinj anembanë botës (shih faqen 115). Ka 168 tempuj të përkushtuar anembanë botës, me 7 prej tyre në restaurim e sipër.

Folësit nga Rinia

Sesioni i mbrëmjes të së shtunës paraqiti biseda nga dy adoleshentë, Laudi Ruth Kouku dhe Enco Serhe Petelo, të cilët folën rreth mënyrës se si priftëria e bekon rininë (shih faqet 56 dhe 58). Kanë kaluar më shumë se 20 vjet që kur folës nga rinia u përfshinë në konferencën e përgjithshme.

Muzika e Fuqishme

Numrat muzikorë për konferencën ishin regjistruar paraprakisht. Shenjtoret përreth botës e mbyllën konferencën duke kënduar “Të Falemi, Zot, për Profetin” me kore në Ganë, Zelandën e Re, Meksikë, Korenë e Jugut, Gjermani dhe Brazil (shih faqen 2). ■

SHËNIM

1. Shih Rasëll M. Nelson, “Fjala e Mbylljes”, *Liahona*, nëntor 2019, f. 122

COVID-19: Mesazhe Udhërrëfimi, Shërimi dhe Shprese

Anëtarët dëshmojnë se e kanë parë dorën e Zotit madje edhe gjatë kësaj periudhe të ndryshimeve, ankthit dhe humbjes.

Shënimi i redaktorit: Kur filloi konferenca e përgjithshme më 4 prill, pamjet e Qendrës së heshtur të Konferencave u bënë kujtues të pandemisë përreth nesh, por mesazhet e udhëheqësve tanë u përqendruan tek optimizmi dhe shpresa. Gjatë javëve të fundit, kemi marrë histori të ngjashme besimi nga anëtarët e Kishës anembanë botës. Faqet vijuese përmbajnë pjesë të shkëputura nga disa prej historive tuaja, si edhe informacion rreth artikujve të tjerë në internet. Me dhembshurinë si të Krishtit, ne mund të vazhdojmë ta ndihmojmë njëri-tjetrit të shërohet nga pasojat e kësaj pandemie.

Ai ishte me Mua në Atë Kohë; Ai është me Mua Tani

Teksa qëndroja e ulur në shtëpi duke u përpjekur të qetësoja ankthin tim lidhur me atë që po ndodhte në botë, hapa ditarin tim rastësisht dhe lexova sa vijon: “Frika na vjen nga shumë gjëra kur ngrihemi nga shtrati çdo ditë në këtë botë, por me besim te mësimet e ungjillit, ne mund t’i hedhim hapat përpara një e nga një. . . Besimi përherë e mund frikën.”

E dija se sapo kisha marrë zbulës të fuqishme vetjake dhe se Ati Qiellor ma dha atë nëpërmjet vetë shkrimeve të mia në ditar nga disa vite më parë. U bekova me një çast paqeje dhe diturie se Ati Qiellor ishte me mua atëherë dhe Ai është pikërisht këtu me mua tani.

Danet Grei, Jutë, SHBA

Fryma e Shenjtë Mund të Punojë në Internet

U ndjeva e frymëzuar të filloja që të zhvilloja orë mësimore seminari nëpërmjet bashkëbisedimeve me video në grupe. Dy ditë përpara se qyteti ynë të vendosej në karantinë, klasa jonë pati mësimin e parë në internet.

Disa nga prindërit gjithashtu u bashkuan me klasën tonë, përfshirë ata që nuk janë anëtarë. Mezi i mbajta lotët kur studiuam së bashku kapitullin 2 te Mosia. Ne të gjithë e ndiem Shpirtin kur mësuam se shërbimi ndaj të tjerëve është gjithashtu shërbim ndaj Perëndisë. Mësova shumë rreth marrjes dhe dallimit të zbulës vetjake. Fryma e Shenjtë do ta shfaqë të vërtetën e ungjillit në shumë metoda të ndryshme. Pavarësisht se çfarë po

ndodh në botë, asgjë nuk mund ta ndalojë përparimin e punës së Atit Qiellor për shpëtimin e fëmijëve të Tij.

Marites Pineda, Mindanao, Filipine

Nuk kemi humbur asnjë Ditë nga Seminari

Edhe me gjithçka që ka ndodhur me virusin korona, unë jam e lumtur të them se nuk kemi humbur asnjë ditë nga seminari. Dhënia mësim në orët e mia mësimore me anë të bashkëbisedimit me video paraqet disa sfida, por më pëlqen shumë kur i shoh prindërit dhe motrat e vëllezërit më të vegjël që i dëgjojnë bashkëbisedimet tona. Më pëlqen shumë që kjo jep një ndjenjë vazhdimësie dhe rutine për familjet tona dhe veçanërisht më pëlqen shumë që mund të vazhdojmë t’i japim dëshmi njëri-tjetrit për Jezu Krishtin dhe dashurinë e Tij për ne.

Mendi Krendëlli, Jigo, Guam

Shërbimi ndaj Njerëzve në të Dyja Anët e Velit

Po shërbeja si motër misionare në moshë të thyer, në Misionin e Indipendënsit në Misuri, kur mbledhjet e Kishës u anuluan dhe ne filluam të vetizoloheshim në apartamentet tona. Përdorëm telefonat dhe kompjuterët tanë që të mbanim lidhje me anëtarët dhe të lidheshim me njerëzit me të cilët po punonim, por nuk e ndiqnin kishën rregullisht.

Që të merresha me punë, vendosa të bëja diçka me historinë familjare, ndonëse për mjaft kohë ka qenë e vështirë për mua që të gjej ndonjë emër të ri. Kur u futa në FamilySearch, gjeta një njoftim për një dokument në pritje për t’iu bashkëlidhur një emri. Ai dokument i vetëm më bëri të gjeja rreth 70 njerëz në linjën time. Pas pesë ditësh, rrjedhja e emrave ndaloi. Po atë ditë më vonë, ne të gjithë mësuam



se do të liroheshim nga misioni për të shkuar në shtëpi. Më vjen keq që të largohem, por gjithashtu ndihem e bekuar që isha në gjendje t'i shërbeja familjes në anën tjetër të velit gjatë kësaj kohe të vështirë.

Kim Nillsëni, Oregon, SHBA

Bërja e Pjesës Sonë për ta Mbajtur në Lëvizje Punën e Zotit

Ndërkohë që misionarët në zonën tonë u këshilluan të qëndronin në apartamentet e tyre, ne jemi përpjekur të bëjmë pjesën tonë duke e ftuar një mik që të mësojë për Kishën. Misionarët po i bëjnë mësimet me telefon me mikun tonë. E ndiejmë forcën e Shpirtit në shtëpinë tonë falë teknologjisë që kemi sot. Ka qenë mahnitëse të shohim se puna e Zotit akoma vazhdon, madje me gjithë sfidat në botë.

Illejna Raishi, Uashington, SHBA

Shpëtimtari e Dëgjon Këngën Tonë

Unë shërbej si misionare me shërbim në Kishë për programin Pathway-Connect në kunjin e Kievit në Ukrainë. Udhëheqësit e programit vendosën të na trajnonin ne të gjithëve që udhëheqim, në mbledhje me prani fizike, me qëllim që t'i drejtonim ato nëpërmjet internetit. Pikërisht të nesërmen qeveria shpalli masa karantine në Kiev.

Më pëlqen së tepërmi mundësia për t'u mbledhur së bashku për PathwayConnect. Dhe më pëlqen pa masë mundësia për t'u mbledhur së bashku që të adhurojmë, si dhe të këndojmë së bashku në shtëpi të die-lave. Jam mirënjohëse për sigurinë që atje ku dy ose tre mblidhen në emrin e Tij, Ai është aty. Askush nuk e di se sa kohë do të jemi në karantinë në Kiev, por ne e dimë se Shpëtimtari do ta dëgjojë këngën tonë.

Katerina Serdiuku, Kiev, Ukrainë

"Është Koha të Rifitosh Familjen Tënde"

Kur u shtuan lajmet lidhur me COVID-19, mendova se ishte



ekzagjeruar jashtë mase. Më pas, tekса ditët kalonin, fillova të ndihem në siklet dhe madje në panik për të ardhmen e botës sonë.

Një mëngjes nuk më zinte më gjumi pasi u zgjova dhe qëndrova e ulur duke përsiatuar se për çfarë ishte e gjithë kjo gjë. Atëherë më erdhi paqja. Shpirti më mësoi se Zoti më kishte dhënë një dhuratë. "Është koha të rifitosh familjen tënde", tha Ai.

Jeta është kaq e zënë me gjëra. Kjo pandemi e ka dhënë familjes sonë mundësinë që të përqendrohet tek ai që ka rëndësi: ungjilli i Jezu Krishtit. Unë mund t'i nxjerr jashtë disa nga

ato ndikimet helmuese të botës dhe të përqendrohem për t'u mësuar fëmijëve të mi që të shohin te Krishti. Ati ynë në Qiell është gjithmonë i vetëdijshëm për ne. Tani e ndiej këtë gjë më shumë se kurrë.

Meri Ostleri, Nebraskë, SHBA

Zoti na Ka Përgatitur për Këtë

Kur fillimisht m'u tha që mbledhjet e Kishës u pezulluan përkohësisht, isha pak e shqetësuar. Por tani mund ta shoh se si Zoti na ka përgatitur për këtë gjë nëpërmjet profetëve të Tij. Studimi i ungjillit i përqendruar te shtëpia mund të na ndihmojë gjatë kohëve sprovuese. Jam mirënjohëse që ende mund të marr pjesë në sakrament të dielave dhe të përdor fjalët e profetëve. Është ngushëlluese të di se derisa të mund të mblidhemi së bashku përsëri, ne mund ta ndiejmë të njëjtin Shpirt.

Ema van Asi, Gauteng, Afrikë e Jugut

Na Është Mësuar si të Adhurojmë

Kur bashkëshorti im dhe unë morëm pjesë në ordinancën e sakramentit në shtëpinë tonë për herë të parë, e ndjeva Shpirtin kaq fuqishëm sa kisha vështirësi të këndoja himnin që kishim zgjedhur. Në 70 vjetët e më shumë të frekuentimit prej nesh të shërbesave të adhurimit, nuk e mbaj mend që t'i kem vlerësuar kaq thellësisht bekimet që i kemi marrë nëpërmjet anëtarësisë dhe pjesëmarrjes sonë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Na është mësuar se si të adhurojmë dhe kë të adhurojmë. Po, na mungon shoqërimi me bashkëshenjtorët tanë dhe do të jemi të lumtur që të kthehemi në gjendje "normale" sa më shpejt që të mundemi, por unë jam mirënjohëse për mësimet që kemi mësuar ndërkohë, tekса ndjekim këshillën e profetit në adhurimin tonë "të përqendruar te shtëpia, të përkrahur nga Kisha".

Suzana Preatori, Montana, SHBA

Gjetja e Paqes dhe Unitetit

Zhvillimi i mbremjes së shtëpisë është diçka që biri im dhe unë e presim me shumë dëshirë çdo javë. Ishim mësuar të kishim shpesh anëtarë, miq dhe misionarë në shtëpinë tonë. Më pas gjërat ndryshuan jashtëzakonisht për shkak të pandemisë. Tani e bëjmë mbremjen e shtëpisë me miqtë tanë me anë të telefonit. Nëpërmjet kësaj kohe së bashku, ne kemi qenë në gjendje të bëjmë shumë gjëra që na kanë afruar më pranë.

Jam shumë mirënjohëse për profetin tonë të dashur, i cili na ftoi të gjithëve që të agjëronim. Shumë nga ne ishin në gjendje ta ndienin fuqinë e unitetit dhe të paqes nëpërmjet asaj përvoje. Në kohë si këto, paqja që na nevojitet, vjen nga Shpëtimtari Jezu Krisht.

Roshen Mek-Kenzi, Kingston, Xhamajkë

Perëndia e Ka Kontrollin

E fillova misionin tim vetëm dy muaj e gjysmë më parë. U caktova të shërbeja në Hermosijo të Meksikës. Çdo ditë kisha mundësinë të takoheja me njerëz të mrekullueshëm, të cilët ishin përgatitur për ta pranuar ungjillin e rivendosur. E ndjeva se sa po filloja ta plotësoja qëllimin tim, kur COVID-19 ma ndërpreu misionin.

U lëndova që i lashë ata njerëz që i doja aq shumë, por gjithashtu kam ndier paqe dhe siguri të madhe, sepse unë e di që Perëndia vazhdon ta ketë kontrollin. Jam mirënjohëse që kemi një profet dhe Apostuj që na udhërrëfejnë në këtë kohë. Si shumë prej misionarëve në botë, unë kam besim se ky nuk do të jetë mbarimi i misionit tim. Së shpejti, unë sërish mund të ndihmoj për ta çuar përpara punën e Zotit dhe mund të vazhdoj të jem një mjet në duart e Tij për të sjellë më shumë shpirta në pendim. ■

Karolina Roman, Porto-Riko

Vazhdoni të Kërkoni në Internet

Lexoni më shumë histori rreth mënyrës se si anëtarët u janë përgjigjur ndikimeve të pandemisë në jetën e tyre me besim e shpresë.

A keni nevojë për shpresë?

- Mësoni se si anëtarët anembanë botës kanë gjetur shpresë se Perëndia po vëzhgon mbi ta.
- Lexoni rreth mënyrës se si anëtarët shkuan përpara në kohë të tjera në historinë e Kishës kur u anuluan mbledhjet e sakramentit.

A keni nevojë për ndihmë?

- Mësoni se si të dalloni pikëllimin brenda vetes dhe se si të vajtoni me ata që vajtojnë.
- Zbuloni se si i janë përshtatur të tjerët adhurimit në shtëpi.

A keni nevojë për ide?

- Merrni ide për mënyrën se si mund të vazhdoni të jepni shërbesë në këto rrethana të pashoqe.
- Mësoni se si misionarë të tjerë kohëplotë u janë përshtatur ndryshimeve në thirrjet e tyre. Për t'i lexuar këto histori dhe më shumë, shkoni te pjesa e veçantë e revistës *Liahona*, "COVID-19: Mesazhe Besimi". Gjejini pjesën duke shkuar te revistat në programin kompjuterik Gospel Library [Biblioteka e Ungjillit] ose në internet te ChurchofJesusChrist.org.

Burime të Dobishme Shtesë për Prindërit

- Botimi i muajit maj i pjesës *Miku* përfshin histori të fëmijëve që mësojnë e shërbejnë.
- Hapeni programin kompjuterik Gospel Living [Të Jetuarit e Ungjillit] dhe botimet më të fundit të revistës *New Era* që të shihni histori rreth rinisë që ecën përpara me besim dhe gjen mënyra të pashoqe për të shërbyer.
- Të jemi të mbyllur së bashku në mjedise të vogla, mund të jetë sfiduese. Për ide se si të ndërtoni një marrëdhënie më të fortë me bashkëshortin/en dhe familjen tuaj, hidhuni një sy këtyre artikujve:
 - "Falling Out of Love . . . And Climbing Back In", *Liahona*, janar 2005.
 - "Nurturing a Love That Lasts", *Liahona*, maj 2000.
 - "Për Paqe në Shtëpi", *Liahona*, maj 2013.
 - "Më të Zellshëm dhe më të Përfshirë në Shtëpi", *Liahona*, nëntor 2009.
 - Trishtueshëm, disa njerëz mund të reagojnë ndaj kësaj kohe të stresuar duke i keqtrajtuar të tjerët. Nëse po ju lëndojnë, ju lutemi, shqyrtojini burimet tek **abuse.ChurchofJesusChrist.org** dhe kërkoni ndihmë. Ju meritoni siguri dhe respekt.

Zbuloni Më Shumë

- Për përditësimet më të fundit nga Kisha rreth ndikimeve të pandemisë nga COVID-19, shkoni te ChurchofJesusChrist.org.



Eja, Më Ndiq Të Mësojmë nga Mesazhet e Konferencës së Përgjithshme

Mësimet e profetëve të gjallë dhe udhëheqësve të tjerë të përgjithshëm të Kishës na sigurojnë udhërrëfim të frymëzuar ndërsa synojmë që të marrim pjesë në punën e Zotit. Të dielën e dytë dhe të katërt të çdo muaji, presidentat e kuorunit dhe të Shoqatës së Ndhmës përzgjedhin një mesazh të konferencës për ta diskutuar, bazuar në nevojat e anëtarëve dhe udhërrëfimin nga Shpirti. Me raste, edhe peshkopi ose presidenti i kunjit mund të sugjerojë një mesazh. Në përgjithësi, udhëheqësit duhet ta vënë theksin te mesazhet nga anëtarë të Presidencës së Parë dhe të Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve. Megjithatë, mund të diskutohet çfarëdo mesazhi nga konferenca më e fundit.

Udhëheqësit dhe mësuesit duhet të gjejnë mënyra për t'i nxitur anëtarët që ta lexojnë mesazhin e përzgjedhur përpara mbledhjes.

Për më tepër informacion, ju lutemi drejtojuni kapitujve për mbledhjet e Priftërisë Melkizedeke dhe Shoqatës së Ndhmës te *Handbook 2: Administering the Church [Manuali 2: Administrimi i Kishës]* (2019).



Planifikimi për Mësimdhënien

Pyetjet vijuese mund t'i ndihmojnë mësuesit ndërsa planifikojnë të përdorin një mesazh nga konferenca e përgjithshme për ta dhënë mësim.

1. Çfarë dëshiron folësi që të kuptojmë ne? Çfarë parimesh të ungjillit po jep mësim ai apo ajo? Si gjejnë zbatim këto parime në kuorumin tonë apo Shoqatën e Ndhmës?
2. Çfarë shkrimesh të shenjta përdori folësi për ta mbështetur mesazhin e tij apo të saj? A ka shkrime të tjera të shenjta që mund t'i lexojmë, të cilat do të na e thellonin kuptueshmërinë? (Ju mund të gjeni disa te poshtëshënimet e mesazheve ose tek Udhëzuesi Tematik.)
3. Çfarë pyetjesh mund të bëj që do t'i ndihmonin anëtarët ta përsiatnin mesazhin? Çfarë pyetjesh do t'i ndihmojnë ata që ta kuptojnë rëndësinë e mesazhit në jetën e tyre, në familjet e tyre dhe në punën e Zotit?
4. Çfarë mund të bëj tjetër për ta ftuar Shpirtin në mbledhjet tona? Çfarë mund të përdor për ta rritur nivelin e diskutimit, përfshirë histori, analogji, muzikë dhe vepra arti? Çfarë përdori folësi?
5. A bëri folësi ndonjë ftesë? Si mund t'i ndihmoj anëtarët që ta ndiejnë dëshirën për të vepruar sipas atyre ftesave?

Ide për Veprimtari

Ka shumë mënyra për t'i ndihmuar anëtarët që të mësojnë nga mesazhet e konferencës së përgjithshme. Ja tek janë disa shembuj; ju mund të keni ide të tjera që do të funksionojnë më mirë në kuorumin tuaj ose Shoqatën tuaj të Ndhimës.



- **Diskutoni në grupe.**

Ndajini anëtarët në grupe të vogla dhe caktojini secilit grup një pjesë të ndryshme nga mesazhet e konferencës për ta lexuar e diskutuar. Pastaj kërkojini secilit grup të tregojë një të vërtetë që e mësuat. Ose mund të formoni grupe që kanë studiuar pjesë të ndryshme, dhe lërin t'ia tregojnë njëri-tjetrit atë që kanë mësuar.

- **Përgjigjuni pyetjeve.**

Ftojini anëtarët që t'u përgjigjen pyetjeve si ato në vijim rreth mesazhit të konferencës: Çfarë të vërtetash të ungjillit gjejmë në këtë mesazh? Si mund t'i vëmë në zbatim këto të vërteta? Çfarë ftesash dhe bekimesh të premtuara u dhanë? Çfarë na mëson ky mesazh rreth punës që Perëndia do që ne të bëjmë?

- **Shpërndajini citimet tek të tjerët.**

Ftojini anëtarët që të shpërndajnë te të tjerët citime nga mesazhi i konferencës, që i frymëzojnë ata për t'i përbushur përgjegjësitë e tyre në punën e shpëtimit. Nxitini ata që të marrin parasysh se si mund t'i shpërndajnë këto citime për të bekuar dikë, përfshirë njerëzit e dashur dhe ata të cilëve u japin shërbesë.

- **Jepni mësim me sende.**

Paraprakisht, ftojini disa anëtarë që të sjellin objekte nga shtëpia që mund t'i përdorin për të dhënë mësim rreth mesazhit të konferencës. Gjatë mbledhjes, kërkojuni anëtarëve që të shpjegojnë se si lidhen ato objekte me mesazhin.

- **Përgatiteni një mësim që ta jepni në shtëpi.**

Kërkojuni anëtarëve që të punojnë në dyshe për të planifikuar një mësim për mbrëmjen në shtëpi, të bazuar te mesazhi i konferencës. Si mund ta bëjmë mesazhin që të ketë më shumë të bëjë me familjet tona? Si mund t'ua shpërndajmë këtë mesazh njerëzve, të cilëve u japim shërbesë?

- **Tregoni përvoja.**

Lexoni së bashku disa thënie nga mesazhi i konferencës. Kërkojuni anëtarëve që të tregojnë shembuj nga shkrimet e shenjta dhe nga jeta e tyre, të cilët e ilustron ose e përforcojnë doktrinën që na mësohet në këto thënie.

- **Mësoni rreth një shkrimi të shenjtë.**

Ftojini anëtarët që të lexojnë një shkrim të shenjtë të përmendur në mesazhin e konferencës. Kërkojuni atyre që të diskutojnë se si i ndihmojnë mësimet në mesazh për t'i kuptuar më mirë shkrimet e shenjta.

- **Gjeni një përgjigje.**

Përpara se të filloni, krijoni disa pyetje, përgjigjet e të cilave mund të gjenden duke përdorur mesazhin e konferencës. Përqendrohuni te pyetjet që nxitin mendim të thellë ose zbatim të parimeve të ungjillit (shih *Mësimdhënia sipas Mënyrës së Shpëtimtarit*, f. 31–32). Më pas lejoni që anëtarët të përzgjedhin një pyetje dhe t'i gjejnë përgjigjet te mesazhi. Ftojini ata që t'i diskutojnë përgjigjet e tyre në grupe të vogla.

- **Gjeni një frazë.**

Ftojini anëtarët që të kërkojnë mesazhin e konferencës, duke kërkuar fraza që janë kuptimplote për ta. Kërkojuni atyre t'i thonë frazat dhe atë që mësojnë prej tyre. Si na ndihmojnë këto mësimet për ta përbushur punën e Zotit?

- **Krijoni diçka.**

Ftojini anëtarët që të bëjnë një afishe ose libërshenjues që përfshin një thënie të shkurtër frymëzuese nga mesazhi i konferencës. Jepuni atyre një mundësi për ta treguar atë që krijuan. ■



Vendi Qendror i Shpëtimtarit

Presidenti Rasëll M. Nelson njoftoi një simbol të ri për ta identifikuar Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (shih faqen 73). Emblema thekson emrin e Jezu Krishtit dhe rolin e Tij qendror në gjithçka që bën Kisha. Emri i Kishës përmbahet brenda një forme drejtkëndore që përfaqëson një gur të qoshes – duke qenë Jezu Krishti guri kryesor i qoshes mbi të cilin është ngritur Kisha (shih Efesianëve 2:19–21). Në qendër të simbolit është një figurë e statujës së mermertë të Thorvaldsenit, Kristusi. Figura paraqit Zotin e ringjallur, të gjallë duke qëndruar poshtë një harku si kujtues i daljes së Tij nga varri tri ditë pas vdekjes së Tij.

Për ta respektuar natyrën e shenjtë të simbolit të Kishës dhe për ta ruajtur mbrojtjen ligjore, simboli zyrtar i Kishës duhet të përdoret vetëm siç miratohet nga Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve.



“Çfarë do të thotë për ju që ungjilli i Jezu Krishtit është rivendosur në tokë?” pyeti Presidenti Rasëll M. Nelson gjatë Konferencës së Përgjithshme Vjetore të 190-të të Kishës.

“Do të thotë që ju dhe familja juaj mund të vuloseni së bashku përgjithmonë! Do të thotë që, për shkak se jeni pagëzuar nga dikush që ka autoritet nga Jezu Krishti, dhe jeni konfirmuar anëtar/e i/e Kishës së Tij, ju mund të gëzoni shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë. . . . Do të thotë që nuk do të mbeteni kurrë pa ngushëllim apo pa të drejtën e përdorimit të fuqisë së Perëndisë për t’ju ndihmuar. Do të thotë që fuqia e priftërisë mund t’ju bekojë kur i merrni ordinancat thelbësore dhe bëni besëlidhje me Perëndinë e i mbani ato. Çfarë spirance janë këto të vërteta për shpirtin tonë, veçanërisht në këto kohë kur furtuna vazhdon plot furi!”

